Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI   nr. 98 / 2011

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI   nr. 98 - 2011

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:
Hajrullah Hoxha

Lektor:
Bislim Berisha

Korrektor:
Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**

Redaktor teknik &
Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtyp: KOHA - Prishtinë

Tirazhi: 600

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI nr. 98 / 2011

Prishtinë
2011

EDITORIAL

Qemajl Morina

"AL-AZ-HARI" DHE AKTUALITETET NË EGJIPT

Më 20 qershor, shejhi i Universitetit të "Al-Az-harit", Dr. Ahmed Tajib, bëri publik dokumentin për të ardhmen e Egjiptit. Ky ishte rezultat i një pune të mundimshme dhe pas konsultimeve të gjata që kishte pasur me mendjet më të ndritura të universitetit më të vjetër në botë, por edhe jashtë tij. Ky dokument u mirëprit nga dijetarët myslimanë, por edhe të krishterë. Lëvizjet fetare e cilësuan iniciativë të pjekur, kurse kisha egjiptiane nismë "historike".

"Al-Az-hari" u themelua me themelimin e Kajros, në vitin (359h / 969), ishte pjesëmarrës në të gjitha ngjarjet me rëndësi që u zhvilluan në Egjipt, gjatë historisë së tij. Në revolucionin e 25 janarit të këtij viti, nuk ishte aq i zëshëm, për ç'gjë edhe u kritikua nga një numër i konsiderueshëm i intelektualëve. Këtë, ai u përpoq ta kompensojë me formimin e nismës "Shtëpia familjare", sepse menjëherë pas revolucionit në skenë dolën përpjekjet për përçarje në baza fetare mes krishterëve dhe myslimanëve, për ç'gjë fajësoheshin elementë të pushtetit të ish-presidentit Hosni Mubarak. Kjo dukuri ishte e huaj për Egjiptin, sepse egjiptianët myslimanë e të krishterë me shekuj të tërë kishin

jetuar në tolerancë dhe harmoni. Tek ata është e njohur sentenca: "Feja i takon Zotit, kurse atdheu është i të gjithëve"!

Dokumenti, të cilin e shpalli shejhi i "Al-Az-harit" përmban disa elemente me rëndësi, të cilat do të ndihmojnë stabilizimin e pushtetit në Egjipt, për arsye se në skenën politike janë paraqitur disa lëvizje fetare me ambicie politike, siç janë: "Vëllezërit Myslimanë", Lëvizja selefiste, Xhihadi islamik etj.

Dokumenti i "al-Az-harit" kërkon themelimin e shtetit kombëtar me sistem demokratik bashkëkohor, mbështetur në kushtetutën, të cilën e miraton i tërë populli në mënyrë demokratike, ku bëhet ndarja e pushteteve legjislative dhe atyre ekzekutive. Të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e çdo individi të shoqërisë.

I pari i "al-Az-harit" potencoi në mënyrë shumë të qartë pikën më të përfolur këto ditë në media, e ajo ka të bëjë me qeverisjen islame. Në dokument potencohet: "Islami nuk ka njohur në civilizimin e tij, në jurisprudencën e as në historinë e tij të gjatë, ajo që në kulturat tjera njihet si shtet fetar apo regjim priftërinjsh, i cili mbizotëroi në disa vende, duke shkaktuar vuajtje për njerëzit në disa periudha kohore të historisë njerëzore".

Megjithatë, shejhi e "al-Az-harit" potencoi që "principet kryesore të sheriatit islam të jenë bazë e jurisprudencës, për t'u mundësuar pakicave fetare që çështjet e tyre familjare t'i rregullojnë në pajtim me ligjet e tyre fetare".

Dokumenti potencon "domosdoshmërinë e respektimit të lirive elementare, siç është liria e shprehjes, respektimi i plotë i të drejtave të njeriut, të gruas dhe të fëmijës, duke u mbështetur në përgjegjësinë e qytetarisë pa farë dallimi në fe, racë, gjini, gjuhë apo kombësi. Respektimi i plotë i diversitetit si dhe tri besimeve monoteiste".

Dokumenti thërret në respektimin e plotë të etikës së diversitetit dhe etikës së dialogut. Mënjanon fjalorin e blasfemisë e të tradhtisë. Ndalon keqpërdorimin e fesë për futjen e përçarjes dhe armiqësisë mes njerëzve. Çdo diskriminim në aspektin fetar, sektar apo racor konsiderohet krim kundër kombit.

Në hartimin e dokumentit të quajtur, "Pikëpamja e "al-Az-harit" dhe intelektualëve për të ardhmen e Egjiptit", morën pjesë shkrimtarë, mendimtarë, ulema, intelektualë, jo vetëm nga universiteti islam më i vjetër në botë, por edhe dijetarë tjerë të pavarur dhe nga institucione tjera, bile edhe mendimtarë të krishterë. Po përmendim disa prej tyre: Hasan Shafii, ish-rektor i Universitetit Islamik në Pakistan , Dr. Ahmed Kemal Abul Mexhd, mendimtar islam dhe anëtar i Institutit për Hulumtime Islame, Mustafa al-Fekki, Semir Mirkas, dr. Lejla Tikla (të krishterë), Xhelal Ahmed Emin, Xhabir Ahmed Asfur, shkrimtarët: Xhemal al-Gajtani, Jusuf al-Kaid, Biha Dhahir dhe rexhisori Muhamed Fadil.

Ky dokument po vjen në momentin, kur Egjipti është i përfshirë në një debat politik të nxehtë, lidhur me atë se a duhet së pari të hartohet Kushtetuta para se të organizohen zgjedhjet kombëtare apo pas zgjedhjeve. Mbretëron bindja se grupi i "Vëllezërve Myslimanë", i cili është më i organizuari, mund të fitojë numrin më të madh të ulëseve, pastaj do ta hartojë Kushtetutën sipas pikëpamjeve të tij.

Mirëpo, "Vëllezërit Myslimanë", tashmë e kanë bërë të ditur se ata nuk janë për themelimin e një shteti fetar në Egjipt. Ndërkohë vërehet shtimi i ndikimit të "selefijve", të cilët gjatë sundimit të regjimit të mëparshëm kanë qenë larg politikës, por dyshohet se ata qëndrojnë pas sulmeve ndaj disa kishave që kanë ndodhur kohëve të fundit në Kajro.

Këshilli i Lartë Ushtarak, i cili po udhëheq Egjiptin, që nga 11 shkurti i këtij viti, kur ish-presidenti egjiptian Hosni Mubarak u detyrua të tërhiqej nga pushteti, në një prononcim për opinion pati deklaruar, se ai nuk do të lejojë që Egjiptin ta udhëheqë një "Humejn i ri", si shenjë për Ajatullah Humejnin, i cili udhëhoqi revolucionin e Iranit në shkurt të vitit 1979.

Dokumenti i Al-Az'harit mbi të ardhmen e Egjiptit

Me iniciativën bujare të Sheikh-ut Al-Az'harit, Prof. dr. Ahmed Tayeb, është mbledhur plejada e intelektualëve egjiptianë, pavarësisht përkatësive të tyre intelektuale dhe fetare, me një numër të dijetarëve e studiuesve kryesorë në Al-Az'har Ash-Sherif. Gjatë takimeve të tyre kanë diskutuar disa nga rrethanat historike e vendimtare nëpër të cilat po kalon Egjipti pas Revolucionit të 25 janarit dhe rëndësinë e tyre në drejtimin e së ardhmes të Egjiptit drejt qëllimeve fisnike, të drejtat e popullit për liri, dinjitet, barazi dhe drejtësi sociale.

Pjesëmarrësit janë dakorduar për domosdoshmërinë e marshimit të atdheut drejt parimeve të përgjithshme dhe rregullave të plota, të cilat do t'i diskutojnë forcat e shoqërisë egjiptiane dhe të reflektojnë në mënyrë racionale. Kjo në fund do të çojë drejt strukturave intelektuale të drejta për rregullat e shoqërisë dhe qasjes së duhur.

Duke u njohur nga të gjithë roli udhëheqës të El-Az'harit në zhvillimin e mendimit të moderuar islam, pjesëmarrësit kanë theksuar rëndësinë e tij dhe konsiderimin si fener ndriçues. Nga ai kërkohet përcaktimi i marrëdhënieve të shtetit me fenë dhe sqarimi i themeleve legjitime të drejta që duhet ndjekur, duke u bazuar në përvojat e tij të akumuluara, historinë e tij shkencore dhe kulturore, e cila është bazuar mbi dimensionet e mëposhtme:

1. *Dimensioni juridik në ringjalljen e shkencave të fesë dhe rinovimin e tyre, sipas doktrinës synite, e cila kombinon midis mendjes e transmetimit dhe zbulon nga rregullat e interpretimit të teksteve të Sheriatit.*
2. *Dimensioni historik i rolit të Al-Az'harit të Lavdishëm në udhëheqjen e lëvizjes kombëtare drejt lirisë dhe pavarësisë.*
3. *Dimensioni kulturor për ringjalljen e shkencave të ndryshme natyrore, letërsisë dhe arteve me llojet e ndryshme të saj.*
4. *Dimensioni praktik në udhëheqjen e lëvizjes së shoqërisë dhe formimin e udhëheqësve të opinionit në jetën egjiptiane.*

5. Dimensioni që bashkon dijen, lidershipin, përparimin dhe kulturën në botën arabe dhe islame.

Pjesëmarrësit janë kujdesur që të frymëzohen në diskutimet e tyre nga shpirti i trashëgimisë së krerëve të mendimit, rilindjes, përparimit dhe reformave në Al-Az'har ash-Sherif, duke filluar nga Sheikh al-Islam, Hasan al-Attar dhe nxënësi i tij, sheikh Rifa'a at-Tahtawi, e deri te imam Mohamed Abduh, nxënësit e tij dhe imamët muxhtehidinë nga ulematë e tij, si al-Meragi, Mohamed Abdullah Deraz, Mustafa Abdel-Razek, Shaltout dhe dijetarë të tjerë të Islamit deri në ditët e sotme.

Ata janë frymëzuar gjithashtu edhe nga të arriturat e intelektualëve të njohur egjiptianë, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e njohjes dhe njerëzimit. Ata kanë marrë pjesë në formimin e mendjes moderne egjiptiane dhe arabe në përparimin e rinovuar, nga njerëzit e filozofisë e ligjit, letërsisë dhe arteve, dhe njohurive të tjera që kanë hartuar mendimin, ndërgjegjen dhe vetëdijen publike. Ata janë përpjekur në gjithë këtë dhe janë përqendruar në vendosjen e emëruesve të përbashkët midis tyre. Këta emërues synojnë qëllimin e lartë, i cili kënaq të gjithë njerëzit e urtë të kombit, dhe që manifestohen siç vijon:

Përcaktimi i parimeve të drejta për kuptimin e lidhjes së Islamit me shtetin në periudhën e tanishme kritike, dhe atë në kuadër të një strategjie për kompromis. Kjo i jep formë shtetit modern të dëshiruar dhe sistemit qeverisës në të, e shtyn kombin në rrugën drejt përparimit e qytetërimit, duke ndihmuar procesin e demokratizimit dhe siguron drejtësinë sociale. Kjo i siguron Egjiptit hyrjen në epokën e prodhimit të dijes, shkencës dhe sigurimit të prosperitetit e paqes, duke ruajtur vlerat shpirtërore, njerëzore dhe kulturore. Kjo ruan parimet islame, të cilat janë stabilizuar në ndërgjegjen e kombit, dijetarëve e intelektualëve për t'u mos u anashkaluar, shtrembëruar, ekzagjeruar dhe keqinterpretuar. Këtë duhet mbrojtur nga rrymat e ndryshme devijante, të cilat mund të ngrenë slogane fetare sektare apo ideologjike që nuk janë në pajtim me bazat e umetit tonë. Kjo është në devijim me thelbin e përmbajtjes e modernen, është në kundërshtim me thelbin e Islamit për liri, drejtësi e barazi, dhe largon nga toleranca e të gjitha feve monoteiste.

Nga këtu shpallim pajtimin e pjesëmarrësve për parimet e mëposhtme lidhur me përcaktimin e natyrës së referencës së ndriçuar islame, e cila përfaqësohet kryesisht në numrin e çështjeve të përgjithshme, të nxjerra nga tekstet fetare të pakundërshtueshme dhe të prera, si shprehje të saktë të fesë. Këto parime i përmbledhim në pikat e mëposhtme:

***Së pari:** Mbështetja e krijimit të shtetit kombëtar demokrat me Kushtetutë moderne, i cili do të mbështetet në Kushtetutën e pranuar nga populli, që ndan kompetencat e shtetit dhe institucionet ligjore. Ajo duhet të përcaktojë kuadrin e qeverisjes, të sigurojë të drejtat dhe detyrimet për të gjithë në mënyrë të barabartë, ku pushtetin legjislativ do ta kenë përfaqësuesit e popullit, i cili është në përputhje me konceptin e drejtë të Islamit.*

Islami nuk ka njohur as në legjislacionin, as në civilizimin e as në historinë e tij atë që njihet në kulturat tjera si shteti i priftërisë fetare që dominon mbi njerëzit. Nga kjo ka vuajtur njerëzimi në disa periudha të historisë, por i lejoi njerëzit të administrojnë shoqëritë e tyre dhe zgjedhjen e mekanizmave e institucioneve për realizimin e interesave të tyre, me kusht që parimet e plota të Sheriatit Islam të jenë burimi kryesor i legjislacionit. Duhet siguruar për pasuesit e feve të tjera monoteiste mbështetjen te legjislacionet e tyre në çështjet personale.

***Së dyti:** Adoptimi i një sistemi demokratik, i bazuar në zgjedhjet e lira direkte, që është formula moderne për realizimin e parimeve të Shures Islame, duke garantuar shumëllojshmërinë dhe rotacionin paqësor të pushtetit. Kjo duhet të përcaktojë përgjegjësitë dhe monitorimin e performancës e llogaridhënien e pushtetarëve para përfaqësuesve të popullit, kërkimin e të mirave të popullit e interesat e tyre publike në të gjitha legjislacionet dhe vendimet, administrimin e çështjeve shtetërore me ligj (dhe vetëm ligji) luftimin e korrupsionit, realizimin e transparencës së plotë dhe lirinë e qasjes në informata dhe qarkullimin e tyre.*

***Së treti**: Përkushtimi ndaj sistemit të lirive themelore në mendim dhe opinion, me respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, gruas dhe*

fëmijëve, si dhe konfirmimit të parimit të pluralizmit e respektimit të feve monoteiste dhe konsiderimin e shtetësisë si fokus të përgjegjësisë në shoqëri.

***Së katërti**: Respektimi i plotë i etikës së dallimit dhe etikës së dialogut, domosdoshmërisë për të shmangur blasfeminë, shfrytëzimin e fesë për nxitjen e ndarjes, rivalitetit dhe armiqësisë midis qytetarëve. Nxitja në konflikt sektar dhe thirrjet raciste duhet konsideruar krim në dëm të kombit. Në marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme të popullit duhet mbështetur në dialogun e barabartë, dhe respektin e ndërsjellë, duke mos bërë dallim në të drejta e detyrime mes gjithë qytetarëve.*

***Së pesti**: Riafirmimi i angazhimit për konventat dhe rezolutat ndërkombëtare, respektimi i të arriturave kulturore në marrëdhëniet njerëzore, veprimi në përputhje me zakonet tolerante të civilizimit islamik e arab, konsistenca me përvojën e civilizimit të gjatë të popullit egjiptian në periudhat e ndryshme, si dhe shembujt e rëndësishëm të ofruar të bashkëjetesës paqësore dhe kërkimin e së mirës për gjithë njerëzimin.*

***Së gjashti**: Përpjekja e plotë për të ruajtur dinjitetin e popullit egjiptian dhe dinjitetin e tij kombëtar. Konfirmimi i mbrojtjes së plotë, respektimi i plotë i rolit të adhurimit për ndjekësit e tri feve monoteiste, garantimi i ushtrimit të lirë i të gjitha riteve fetare pa ndonjë pengesë, respektimi i të gjitha manifestimeve të adhurimit pavarësisht formave të saj, pa nënvlerësuar kulturën e popullit apo shtrembërimin e traditave të tij autentike. Gjithashtu, përpjekja e plotë për të ruajtur lirinë e shprehjes, krijimtarisë artistike e letrare në kuadër të sistemit të vlerave kulturore të qëndrueshme.*

***Së shtati**: Konsiderimi i arsimit, hulumtimit shkencor dhe hyrjes në epokën e diturisë si lokomotivë e progresit qytetërues në Egjipt, dhe shenjtërimi i të gjitha përpjekjeve për të kuptuar atë që kemi humbur në këto fusha. Mobilizimi i fuqisë së gjithë shoqërisë për asgjësimin e analfabetizmit, investimin e kapitalit njerëzor dhe realizimin e projekteve të mëdha të së ardhmes.*

***Së teti**: Realizimi i prioriteteve në arritjen e zhvillimit të drejtësisë sociale, përballjen me tiraninë, luftimin e korrupsionit dhe uljen e papunësisë. Kjo duhet të udhëheqë forcat e shoqërisë dhe risitë e saj në aspektin ekonomik, programet shoqërore, kulturore e mediatike që të jenë në krye të prioriteteve që i kërkon populli për rilindjen e tij të tanishme, duke marrë në konsideratë kujdesin e vërtetë shëndetësor si obligim të shtetit ndaj të gjithë qytetarëve.*

***Së nënti**: Ndërtimin e marrëdhënieve të Egjiptit me vëllezërit arabë, rrethinës islamike, dhe rrethinën e tij afrikane e botërore. Avokimi për të drejtat e palestinezëve, ruajtja e pavarësisë të vullnetit egjiptian, rikthimi i rolit udhëheqës historik mbi bazën e bashkëpunimit për të mirën e përbashkët dhe realizimi i të mirës së popujve në kuadër të barazisë dhe pavarësisë së plotë. Vazhdimi i pjesëmarrjes në përpjekjet fisnike njerëzore për të mirën e njerëzimit, ruajtja e mjedisit dhe arritja e paqes midis kombeve.*

***Së dhjeti**: Mbështetja e projektit të pavarësisë së Al-Az'harit, rikthimi i "Institucionit të Dijetarëve të Mëdhenj", kompetencat e tij për kandidim dhe zgjedhjen e Sheikh-ut të Al-Az'harit. Puna për ripërtëritjen e programeve mësimore të Al-Az'harit, për të rimarrë rolin e tij autentik intelektual dhe ndikimin e tij në pjesë të ndryshme të botës.*

***Së njëmbëdhjeti**: Konsiderimi i Al-Az'harit si autoritet kompetent, i cili është përgjegjës për çështjet e Islamit, shkencave, trashëgimisë dhe fetvave të fikut dhe çështjeve moderne, duke mos ua marrë të drejtën e të gjithëve në dhënien e opinionit kur të plotësojnë kushtet shkencore të nevojshme, dhe me kusht të përmbajtjes së etikës së dialogut dhe respektimit të asaj për të cilën janë pajtuar dijetarët e kombit.*

Dijetarët e Al-Az'harit dhe intelektualët pjesëmarrës në përgatitjen e kësaj deklarate u bëjnë thirrje të gjitha partive dhe drejtimeve politike në Egjipt, që t'i përmbahen punës për përparimin e Egjiptit në aspektin politik, ekonomik e shoqëror në kuadër të përcaktimeve themelore që janë përfshirë në këtë deklaratë.

Allahu e bekoftë atë që është për të mirën e kombit!

Al-Az'hari më 17 Rexhep 1432 / 19 qershor 2011

Dijetarët e al-Az’harit	Elita intelektuale
Imami i Madh, Sheikh al-Az’har	Mohamed Hafez Diab
Mahmoud Hamdy Zaqzouq	Mostafa al-Fiki
Ahmed Kamal Ebu al-Magd	Nabil Abdel-Fatah
Hassan El Shafei	Samir Morcos
Abdoul al-Mu’ti Mohamed Bayoumi	Mustafa Farid Razzaz
Mohamed Abdel Fadeel Elkoussy	Jaber Ahmed Asfour
Mahmoud Azab	Salah Fadl
Mohammed Kamal al-Din Imam	Gamal al-Ghitani
Mohamed Saber Arab	Mohamad Fadel
	Amr Abd –As-Semi’ Abdullah
	Salahudin Al-Gevhery
	Yusuf al-Akid
	Helmy an-Nemnem
	Mohamed Afefy
	Bahaa Taher
	Sameh Fevzee
	Neam al-Baz
	Leyla Tekla
	Hamdy Hasan Efu al-Anin
	Gelal Ahmed Emin
	Eymen Fouad Seyid
	Es-Seyid Jasen

Qemajl Morina

“AL-AZHAR” AND THE CURRENT EVENTS IN EGYPT

(Summary)

On June 20, Dr. Ahmed Tayib, the head of the “Al-Azhar” University, presented a document on the future of Egypt. This document was the result of very hard work and followed consultations with the brightest minds of the oldest university in the world, as well as elsewhere. The document was welcomed by both Muslim and Christian scholars. Religious movements consider it a good initiative, whereas the Egyptian church considers it a historic initiative.

كمال مورينا

الازهر الشريف و الاحداث الجارية فى مصر

(خلاصة البحث)

بتاريخ 20 يونيو 2011 قام الشيخ الازهر ، الدكتور احمد الطيب باعلان وثيقة الازهر عن مستقبل مصر . و كان هذا نتيجة لجهود مضنية و مشاورات مستمرة بذلت من قبل عقول مستنيرة فى اقدم جامعة فى العالم و خارجها . و قد تلقت هذه الوثيقة ترحابا و استقبالا كبيرا لدى اوساط العلماء المسلمين وكذلك المسيحيين ، و قد اعتبرتها الحركات الاسلامية "مبادرة ناضجة" بينما اعتبرتها الكنيسة القبطية "مبادرة تاريخية" .

AKAID

Nexhat Ibrahimi

BESIMI NË ALLAHUN xh.sh.

أمنت بالله

Hyrje

Besimi (**الإِيمَان** - Imani) në Allahun xh.sh. është kushti i parë i besimit islam. Besim do të thotë bindja e fuqishme se Allahu xh.sh. është Zoti një dhe i vetëm, Sundues dhe Krijues i çdo gjëje. Besimi në Allahun xh.sh. Një dhe i Vetëm do të thotë t’ia drejtojmë Atij të gjitha ibadetet tona, të besojmë se Allahu posedon Emrat e tij të bukur dhe Atributet e përkryera dhe të besojmë se Ai është larg mangësive dhe të metave që janë karakteristika të krijesave.

Besimi në Allahun është e para dhe themelorja e bazave të besimit, sepse ekzistimi dhe uniteti i Allahut është bërë fondament dhe të gjitha bazat tjera mbështeten mbi besimin në Allahun xh.sh..

Këtë çështje Allahu xh.sh. në Kur'an e shtron kështu:

آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِن رَّبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ ۚ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ .

“Pejgamberi beson në atë çka i shpallet nga Zoti i tij, edhe besimtarët: secili i beson Allahut, edhe engjëjve të tij, edhe librave të tij, edhe profetëve të tij. “Ne nuk dallojmë asnjë nga profetët e tij”. Dhe thanë: “Dëgjuam dhe iu bindëm; Na fal o Zoti ynë; Te Ti do të kthehemi.” *(El-Bekare: 285).*

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا آمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَالْكِتَابِ الَّذِي نَزَّلَ عَلَىٰ رَسُولِهِ وَالْكِتَابِ الَّذِي أَنزَلَ مِن قَبْلُ ۚ وَمَن يَكْفُرْ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا .

“O besimtarë, besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij, edhe Librit të cilin Ai ia shpall Profetit të vet, edhe Librit që e shpalli më parë. Kurse ai që mohon Allahun, engjëjt e Tij, të dërguarit e Tij, librat e Tij edhe botën tjetër, ai ka humbur shumë keq.” *(En-Nisa': 136).*

Muhammedi a.s. nëpërmjet një hadithi të gjatë na shpjegon gjerë e gjatë çështjen e besimit:

عن عُمَرُ بْنُ الْخَطَّابِ قَالَ بَيْنَمَا نَحْنُ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهم عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ذَاتَ يَوْمٍ إِذْ طَلَعَ عَلَيْنَا رَجُلٌ شَدِيدُ بَيَاضِ الثِّيَابِ شَدِيدُ سَوَادِ الشَّعَرِ لاَ يُرَى عَلَيْهِ أَثَرُ السَّفَرِ وَلاَ يَعْرِفُهُ مِنَّا أَحَدٌ حَتَّى جَلَسَ إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهم عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَأَسْنَدَ رُكْبَتَيْهِ إِلَى رُكْبَتَيْهِ وَوَضَعَ كَفَّيْهِ عَلَى فَخِذَيْهِ وَقَالَ يَا مُحَمَّدُ أَخْبِرْنِي عَنِ الإِسْلاَمِ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهم عَلَيْهِ وَسَلَّمَ الإِسْلاَمُ أَنْ تَشْهَدَ أَنْ لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهم عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَتُقِيمَ الصَّلاَةَ وَتُؤْتِيَ الزَّكَاةَ وَتَصُومَ رَمَضَانَ وَتَحُجَّ الْبَيْتَ إِنِ اسْتَطَعْتَ إِلَيْهِ سَبِيلاً قَالَ صَدَقْتَ قَالَ فَعَجِبْنَا لَهُ يَسْأَلُهُ وَيُصَدِّقُهُ قَالَ فَأَخْبِرْنِي عَنِ الإِيمَانِ قَالَ أَنْ تُؤْمِنَ بِاللَّهِ وَمَلاَئِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الآخِرِ وَتُؤْمِنَ بِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ قَالَ صَدَقْتَ قَالَ فَأَخْبِرْنِي عَنِ الإِحْسَانِ قَالَ أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ .

Transmetohet, gjithashtu, nga Umeri radijall-llahu anhu, i cili ka thënë:

Një ditë ishim duke ndenjur te i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në

të nuk hetohej shenja e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njohëm. U ul pranë të Dërguarit s.a.v.s., duke i mbështetur gjunjët e vet në gjunjët e tij, i vendosi duart e veta në kofshën e tij dhe tha: "O Muhammed, më trego ç'është Islami?" I Dërguari s.a.v.s., tha: "Islami është të dëshmosh që nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Zotit, ta kryesh namazin, ta ndash zekatin, ta agjërosh ramazanin, ta vizitosh Ka'ben nëse ke mundësi ta bësh këtë! "Ai tha". Të vërtetën e the." Ne u çuditëm: po e pyet dhe po ia vërteton. Ai tha: "Më trego, ç'është imani?" (Pejgamberi) tha: "Të besosh Zotin, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e fundit dhe të besosh në të caktuarit e Tij të së mirës dhe së keqes." Tha: Të vërtetën e the". Tha: "Më trego ç'është ihsani?" (Pejgamberi) tha: Ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai vërtet të sheh ty. ..." (Muslimi).

Në këtë hadith theksohen disa shkallë:

E para: *Islami* është shkalla e parë. Këtë shprehje Pejgamberi a.s. e ka përdorur për veprat dhe fjalët e dukshme e këto janë: shehadeti, kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit.

E dyta: *Imani* është shkalla e dytë. Këtë shprehje Pejgamberi a.s. e ka përdorur për besimin në Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe përcaktimin e së mirës dhe së keqes.

E treta: *Ihsani* është shkalla e tretë. Këtë shprehje Pejgamberi a.s. e ka përdorur për zbukurimin e lashtësisë duke bërë ibadet dhe të brendisë me sinqeritet (ihlas) të plotë.[1]

Të gjitha këto së bashku përbëjnë fenë universale, të cilën Allahu xh.sh. e ka dërguar nëpërmjet Pejgamberit a.s. që është e qartë nga hadithi i cekur më lart.

A. Besimi në Zot gjatë historisë

[1] Abdul Medžid Aziz Ez-Zindani, po aty, fq. 333-335.

Nëse i hedhim një shikim historisë nuk do të gjejmë ndonjë popull jobesimtar. Çdo popull apo bashkësi ka besuar, qoftë edhe në mënyrë të shtrembër. Studimet më të fundit të feve krahasuese tregojnë se edhe në periudhat e hershme ka ekzistuar feja e mirëfilltë, monoteizmi dhe se politeizmi paraqet vetëm një shtrembërim të së vërtetës. Edhe Kur’ani, sikur edhe mesazhet hyjnore të tjera, flet për çështjen e dërgimit të të dërguarve në çdo etapë historike dhe te çdo popull:

...وَ إِن مِّنْ أُمَّةٍ إِلاَّ خَلاَ فِيهَا نَذِيرٌ.

“... e nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.” *(Fatir: 24).*

Edhe pse Allahu kurrë nuk e ka lënë pa drejtues botën, të cilët ndihmuan që njeriu t’i përshtatet udhëzimit origjinal, megjithatë, me kalimin e kohës, për një varg shkaqesh ky komunitet ra në mosmarrëveshje e në kundërshtim me njëri-tjetrin. Këto dy pole kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë. Ka disa faktorë për këtë devijim:

- Njeriu në parim është i krijuar me predispozicione për t’i kuptuar të vërtetat e fesë, por nga shkaku i vrojtimit dhe meditimit sipërfaqësor, disa herë është lëkundur në bindjet e tij, duke mohuar Krijuesin suprem.

- Njeriu është qenie racionale, por herë-herë ai shndërrohet në qenie imituese, duke trashëguar jo vetëm pasurinë materiale nga e kaluara, por edhe bindjet e mjedisit. Kështu kemi lajthitje, duke mohuar udhëzuesit e Allahut.

- Një grup njerëzish me karakter kushtëzues mohojnë Krijuesin, duke pohuar se nuk ekziston bota transcendente, se çdo gjë duhet t’u nënshtrohet kritereve “shkencore”. Ata mohojnë Krijuesin por nuk arsyetojnë asgjë, pos kryeneçësisë së tyre. Ata në vend që arsyen ta përdorin për të medituar dhe gjetur të vërtetën, ata e përdorin të kundërtën, si ta mbyllin kapacitetin e arsyes për të medituar. Dhe në mungesë të një udhëheqësi mes tyre, ata përpiqen ta “krijojnë” një të tillë nga krijesat dhe materia. Kur’ani këta i përshkruan si vijon:

...وَمَا يَتَّبِعُ الَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِ اللَّهِ شُرَكَاءَ ۚ إِن يَتَّبِعُونَ إِلاَّ الظَّنَّ وَإِنْ هُمْ إِلاَّ يَخْرُصُونَ.

“E ata që, pos Allahut adhurojnë idhujt, shkojnë vetëm pas hamendjeve dhe vetëm gënjejnë.” *(Junus: 66).*

...إِن يَتَّبِعُونَ إِلاَّ الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى الأَنفُسُ...

“... Ata ndjekin vetëm hamendjen dhe atë që janë të prirë ...”. *(En-Nexhm: 23).*

Emri i qenies së lartë e të domosdoshme në gjuhën arabe është *Allah*, të cilin dijetarët e përkufizojnë si *“qenie të lartë me ekzistencë të domosdoshme, që është i denjë për të gjitha lavdërimet.”* Allahu është i domosdoshëm sepse mosekzistenca e Tij nuk mund të imagjinohet. Ai është krijues dhe drejtues i gjithësisë, kurse cilësitë që Ai i posedon shprehin përsosmëri dhe transcendencë.

B. Dëshmitë e besimit në Allahun xh.sh.

Besimi në Allahun *një* dhe *të vetëm* është detyrim (farz) për çdo njeri që është i shëndoshë mentalisht dhe që e ka arritur moshën e madhërisë. Sipas dijetarëve më të mëdhenj të ehli-s-sunetit, Imam Ebu Hanifes dhe Imam El-Maturidiut, të gjithë njerëzit janë të detyruar ta gjejnë ekzistencën dhe njësinë e Allahut edhe në saje të mendjes. Besimi është i bashkëlindur me njeriun, andaj edhe po të ndikohet njeriu nga mjedisi, ai duhet ta besojë Atë. Është e natyrshme që në çdo shoqëri të gjenden njerëz që për shkaqe të ndryshme të mohojnë Krijuesin apo të dyshojnë në ekzistimin e Tij. Për këtë arsye, ka rëndësi argumentimi i ekzistimit të Zotit me disa mënyra:

- Argumenti racional. - Meqë besimi në Allahun është kongjenital dhe i pamënjanueshëm, argumentet duhet kërkuar brenda njeriut dhe krijesave të tjera dhe jo jashtë tyre. Këto argumente nevojiten vetëm për të nxitur, ngacmuar njeriun për ta zhvilluar informacionin për vetveten e tij dhe në vetëdijen e tij. Njeriu është i krijuar ashtu që mund ta kuptojë ekzistimin e Zotit, vetëm duke parë gjerat brenda dhe

jashtë botës së vet, të cilat vërtetojnë ekzistimin e Zotit. Sidomos, krijimi i vetë njeriut është një argument i hapur i ekzistimit të Zotit:

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

إِنَّ فِي السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ لآيَاتٍ لِّلْمُؤْمِنِينَ . وَفِي خَلْقِكُمْ وَمَا يَبُثُّ مِن دَابَّةٍ آيَاتٌ لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ . وَاخْتِلاَفِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَمَا أَنزَلَ اللَّهُ مِنَ السَّمَاءِ مِن رِّزْقٍ فَأَحْيَا بِهِ الأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَتَصْرِيفِ الرِّيَاحِ آيَاتٌ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ .

“Në qiej dhe në tokë, me të vërtetë, ka argumente për besimtarët. Edhe në të krijuarit tuaj dhe çka ka shpërndarë nga shtazët ka argumente për njerëzit që janë të bindur. Edhe në ndërrimin e ditës dhe të natës dhe çka lëshon Allahu nga qielli prej furnizimeve që me anë të tij e ngjall tokën, pasi të ketë vdekur, si edhe ndërrimi i erërave janë argumente për njerëzit e mençur.” *(El-Xhathije: 3-5).*

سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الآفَاقِ وَفِي أَنفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ...

“Ne do t’ua tregojmë atyre ajetet tona në horizonte dhe në vetveten e tyre që ta kuptojnë qartë se Ai është i Vërtetë.” *(Fussilet: 53).*

- Argumenti i krijimit. - Çdo njeri i mençur e pranon ekzistimin e një fuqie mbinatyrore. Kjo është një ndjenjë dhe vetëdije e natyrshme. Këtë e vërejmë sa herë kemi një fatkeqësi apo hare të pazakonshme.

Kur’ani kështu e përshkruan këtë gjendje:

وَإِذَا مَسَّ الإِنسَانَ الضُّرُّ دَعَانَا لِجَنبِهِ أَوْ قَاعِدًا أَوْ قَائِمًا فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُ ضُرَّهُ مَرَّ كَأَن لَّمْ يَدْعُنَا إِلَىٰ ضُرٍّ مَّسَّهُ ۚ كَذَٰلِكَ زُيِّنَ لِلْمُسْرِفِينَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ .

“Kur njeriut i bie ndonjë e keqe, na lutet Neve në çdo pozicion që të jetë, ndenjur, shtruar apo në këmbë. Por, kur ia largojmë të keqen, kalon sikur të mos kish ndodhur gjë, sikur të mos na ishte lutur Neve për të keqen që e kishte gjetur.” *(Junus: 12).*

أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمُ الْخَالِقُونَ . أَمْ خَلَقُوا السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضَ ۚ بَل لاَّ يُوقِنُونَ.

"A mos vallë ata janë krijuar pa Krijues, apo mos janë ata krijues të vetvetes?! A mos vallë ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Jo, por ata nuk duan të besojnë." *(Et-Tur: 35-36).*

- **Argumenti i rregullsisë**. - Duke parë me anë të shqisave harmoninë ekzakte pohojmë se kjo harmoni në gjithësi është vepër e një krijuesi që di gjithçka dhe që ka fuqi për gjithçka:

أَفَلاَ يَنظُرُونَ إِلَى الإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ . وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ . وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ . وَإِلَى الأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ .

"A nuk shohin njerëzit se si është krijuar deveja, si është ngritur qielli, si janë vendosur malet, si është shtruar toka...". *(El-Gashijeh: 17-20).*

Në të gjitha argumentet ka hapësirë dhe detyrim për meditim. Kjo botë mahnitëse nuk mund të jetë pa krijues. Kjo mrekulli as nuk mund të jetë krijim i dy e më shumë zotërave, sepse do të duhej ujdi apo kundërshtim mes tyre për krijim. Nëse do të kundërshtoheshin mes veti, kjo do të çonte në moskrijimin e gjithësisë. Nëse do të pajtoheshin, kjo tregon në mangësinë e tyre dhe në faktin se ata (zotat) kanë nevojë për njëri-tjetrin. Këto cilësi të pamjaftueshmërisë nuk janë imanente për Zotin. Prandaj, Zoti duhet të jetë Një dhe i Vetëm.[2]

C. Uniteti i Allahut xh.sh.

Uniteti i Allahut - tevhidi (monoteizmi) do të thotë të njësosh, të unifikosh, të pranosh për një gjë se ajo është e vetme dhe unike. Mirëpo, në kohën kur Islami (Kur'ani) doli në skenë popullsia kishte devijuar, kurse çështja e individualitetit (dhat) dhe atributeve (sifat) kuptohej në mënyra të ndryshme.

[2] Besimi, I-II (Akaidi), Stamboll, 2003, fq. 45-48.

Gjatë historisë së Islamit janë bërë shmangie nga besimi i mirëfilltë, andaj atë (tevhidin) duhet kërkuar në katër gjera: individualitetin (dhat), atributet (sifat), veprimet (ef'al) dhe adhurimin (ibadet) ndaj Zotit.

1. Individualiteti (dhat). - Gjatë historisë islame 14 shekullore në sipërfaqe kanë dalë disa shkolla besimore dhe grupe që dallojnë nga njëra-tjetra, por numri i atyre që i kanë dhënë hyjnimet dikujt tjetër pos Allahut është mjaft i madh dhe këta individë kanë pasur shumë pak përkrahës.

2. Atributet (sifat). - Individët apo grupet që janë lëkundur në besim në aspekt të atributeve quhen përngjasues (muteshabih, antropomorfistë). Të tillët disa atribute të Allahut ua atribuojnë krijesave, por edhe këta janë të pakët, ndërsa shumica e tyre janë njerëz të sinqertë dhe bindjet e tyre janë rezultat i problemeve në metodë dhe i perceptimit shkencor.

3. Veprimet (aktet, ef'al). - Allahu është ai që e ka krijuar dhe që e administron gjithësinë në tërësinë (kul-lijjat) dhe imtësinë (xhuz'ijjat) e saj. Edhe individë të tillë ekzistojnë, por numri i tyre është i vogël (si disa filozofë dhe mu'tezilitë) dhe nuk duhet dyshuar në sinqeritetin e tyre në besim.

4. Adhurimi (ibadet). - Këtë grup e përbën uniteti në adhurim, që do të thotë se përkushtimi i adhurimit është vetëm për Allahun dhe zbatimi i adhurimit vetëm për kënaqësi të Tij. Prishja e këtij parimi lind veprimin e shtirjes, dukjes (rijasë). Kjo çështje është e natyrës psikologjike dhe nuk e ka kuptimin e asaj që dikush i bën dikujt tjetër adhurim pos Allahut.[3]

[3] (Bekir Topaloglu etj., Bazat e besimit islam, Prishtinë, 2002, fq. 59...; Më tej: Bazat e besimit).

Ç. Llojet e unitetit (tevhidit)

Në Kur’an përmbushja e misionit njerëzor kushtëzohet me dy gjera: besim dhe akt. Ai që i bashkon këto dy parime (teorike dhe praktika) është besimtar në kuptimin e mirëfilltë.

Prandaj, kemi dy lloj unitetesh, atë në besim dhe atë në adhurim.

1. Uniteti në besim

Uniteti në besim është pranimi i Allahut Një të Vetëm në individualitetin, atributet dhe aktet e Tij si dhe mospërngjasimi i Tij në këto pika me dikë tjetër. Ky unitet ndahet në tri nëngrupe të tjera:

a. Uniteti në individualitetin e Allahut. - Individualiteti i Allahut (dhat’ull-llah) do të thotë vetë Ai, do të thotë pranim i njësisë së Tij, pranim i faktit se Ai është Një dhe i Vetëm. Kjo ndjenjë dhe nevojë njerëzore është ndier gjatë gjithë historisë, ndonëse ndonjëherë ky besim ka qenë i drejtë e ndonjëherë jo i drejtë. Vërehet edhe dukuria vijuese se në histori më shumë është i pranishëm politeizmi sesa mohimi. Më herët kjo ndodhte nga injoranca e së fundi kjo ndodh nga neglizhenca dhe papërgjegjësia njerëzore. Besimi te disa fe se Zoti ka bir (hebraizmi pohon se Uzejri është bir i Zotit, kurse krishterizmi pohon se Isai është bir i Zotit) tregon shtrembërim të fesë:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ . اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ . صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلاَ الضَّالِّينَ .

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë! Udhëzona në rrugë të drejtë. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi, e jo në *(rrugën)* ***e atyre që kanë shkaktuar pezmin*** *(Tënd),* ***as në rrugën e atyre që janë të humbur!“*** *(El-Fatiha: 5-7).*

b. Uniteti në atributet e Allahut. - Allahu xh.sh. nuk është Një dhe i Vetëm në individualitetin e Tij por është Një dhe i Vetëm edhe në **atributet** e Tij. Atribute janë quajtur veçoritë dhe karakteristikat që Allahu na i ka bërë të ditura me qëllim për ta njohur Atë si i paraqenë (i pafillim), i pasqenë (i pafundmë), parës, dëgjues etj. Disa nga këto atribute janë ekskluzivisht të Zotit dhe me to nuk mund të cilësohet asnjë krijesë (i pafillim, i pafundmë etj.). Një pjesë tjetër, sikur: parës, dëgjues, mund të përdoren edhe për krijesa të tjera.

Mes Krijuesit dhe krijesës nuk ka asnjë ngjashmëri, asgjë të përbashkët, në kuptimin e ajetit kur’anor:

...لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ...

“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij.” *(Esh-Shura: 11).*

Një pakicë dijetarësh myslimanë, nga droja e përngjasimit, kanë mohuar një pjesë të atributeve të Allahut (siç vepruan mu’tezilitët duke i integruar atributet brenda individualitetit të Allahut).

c. Uniteti në aktet e Allahut. - Aktet e Allahut mund të përmblidhen në “bërje” dhe në “krijim”. Allahu krijon, zhvillon dhe ndryshon në çdo çast çdo gjë tjetër pos Tij. Ai krijon i vetmi nga hiçi. Allahu xh.sh. thotë:

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ۖ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ.

“Allahu e ka krijuar çdo gjë dhe Ai e administron dhe kujdeset për çdo gjë.” *(Ez-Zumer: 62).*[4]

2. Uniteti në adhurim

Nëse *Uniteti në besim* përmbante aspektin teorik të çështjes, *Uniteti në adhurim* është vënia në praktikë e aspektit të parë, duke e inkuadruar mendjen dhe dijen. Kjo do të thotë që njeriu ta dojë me zemër Allahun, unitetin e të cilit e konceptoi me mendje dhe e provoi me sjellje e veprime. Nëse uniteti në besim ndriçon mendjen dhe e siguron lirinë e mendimit, uniteti në adhurim e ndriçon zemrën dhe lirinë e ndjenjës.

Në historinë e mendimit njerëzor filozofitë e ndryshme kanë formuar pikëpamjet e tyre rreth krijimit (kozmogoni). Disa mendojnë se materia është e pafillim dhe e pakrijuar. Disa mendojnë se Zoti ekzi-

[4] (Bekir Topaloglu, Bazat e besimit, po aty, fq. 62-67).

ston dhe se është qenie tejmateriale, që e ka krijuar dhe e drejton gjithësinë. Të tillët e kanë pranuar unitetin dituror dhe mendor të Zotit, por jo edhe unitetin ndiesor dhe praktik. As grupi i parë as i dyti nuk janë të pranuar në Islam. Sepse, dashuria ndaj Allahut kushtëzohet me adhurimin (ibadetin) ndaj Tij.

Uniteti në adhurim do të thotë besim se vetëm Allahu është i denjë për t'u adhuruar, për t'iu bindur e nënshtruar; do të thotë lidhje me zemër pas kësaj të vërtete.[5]

Allahu xh.sh. thotë:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ .

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!" *(El-Fatiha: 5).*

D. Emrat dhe atributet e Allahut xh.sh.

Konceptet që na njohin me Allahun xh.sh., duke marrë parasysh ndryshimin terminologjik, janë quajtur diku *emra* (el-esma') e diku *atribute* (es-sifatu). Dijetarët tanë, bazuar në Kur'an dhe hadith, kanë përcaktuar qindra emra kushtuar Allahut të njohur, por ka edhe të tjerë të panjohur, e që janë në dijen e Allahut.

1. Emri i përveçëm "Allah"

Dijetarët myslimanë pohojnë se fjala "Allah" është emër i përveçëm arab që nuk derivon nga ndonjë fjalë apo rrënjë foljore tjetër. Kjo fjalë nuk ka formë shumësi as duali, por është trajtë unike për qenien e përveçme që adhurohet. Gjithashtu, këtë fjalë nuk mund ta përkthejmë në gjuhë të tjera në mënyrë meritore as ta zëvendësojmë me ndonjë fjalë qoftë nga gjuha arabe. Në Kur'an kemi disa emra të tjerë me kuptim të Zotit, si: *ilah, rabb, mevla* etj., të cilat tërthorazi janë në lidhje me fjalën *Allah*.[6]

---

[5] Bekir Topaloglu, Bazat e besimit, po aty, fq., fq. 68-71.
[6] Besimi I-II, po aty, fq. 58. Këto emërtime i mësojmë nga vetë Ai.

2. Emri më i Madh (Ism'ul-a'dham) i Zotit

Togfjalëshi "Emri më i Madh i Zotit" (Ism'ul-a'dham) në terminologjinë fetare përdoret për një grup emrash, për emrat më të bukur të Allahut. Disa thonë se emrat nuk kanë dallim mes vete, por shumica mendojnë se disa nga emrat janë më të mëdhenj e më të shquar (Ism'ul-a'dham), por është vështirë të përcaktohen se cilët janë këta emra. Disa thonë se ky emër është Allah, e disa të tjerë thonë se është: Err-Rrahman, Err-Rrahim, El-Hajj'ul-Kajjum, Dhu'l-Xhelal etj.

Edhe pse Muhammedi a.s. e ka ditur se cili është ky emër, ai këtë nuk e ka theksuar, mbase nga motivi që të mos favorizohet një emërtim e të neglizhohen emrat tjerë. Kjo tregon se ne nuk bën të sajojmë emra për individualitetin hyjnor.[7]

3. Emrat e bukur të Allahut (Esma'ul-husna)

Emrat e bukur (الأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ - Esma'ul-husna) janë koncepte të shenjta që shprehin lartësinë më të shquar dhe epërsinë absolute. Janë të posaçëm vetëm për Allahun sepse vetëm Ai është zotërues i të gjitha përsosmërive dhe aftësive. Ndryshe i quajnë edhe *Esma'ul-ilahijj* (Emrat hyjnorë).

Në aspektin terminologjik Emrat e Bukur do të thonë: Bindja e fuqishme që Allahut xh.sh. i përkasin të gjithë emrat dhe cilësitë e përsosura, se Ai është larg të gjitha atributeve me mangësi dhe se Ai me cilësitë e Tij shquhet mbi të gjitha krijesat, pa ndonjë ndryshim të tyre, pa mohimin e tyre të tërësishëm apo individuale, pa tentimin për perceptimin e plotë të tyre, pa tentimin për shpjegimin e thelbit të tyre apo pa krahasim me cilësitë e krijesave.

Allahu i madhërishëm ka shumë emra që përmenden në Kur'an dhe në hadithe. Duke i njohur këta emra ne e njohim më mirë e më thellë Allahun. Si pasojë e kësaj, ne do ta duam dhe do ta adhurojmë

---

[7] Besimi I-II, po aty, q. 58; Udhërrëfyesi i një muslimani, po aty, fq. 85-86.

Atë edhe më shumë. Njëkohësisht, njohja e emrave të Tij do të na largojë nga veset dhe shprehitë e këqija.

وَلِلَّهِ الأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا ...

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë me to...”. *(El-A’raf: 180).*

Të vërtetën e *Emrave të Allahut* ne e mësojmë vetëm nga pohimet e Pejgamberit a.s.

... وَلاَ يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلاَّ بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضَ ۖ وَلاَ يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ .

“Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç asaj që Ai ka dashur t’ua tregojë. Froni *(Madhëria)* ***e Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vjen rëndë t’i ruajë ato. Ai është shumë i Lartë, i Madhëruar!”.*** *(El-Bekare: 255).*

Sipas një hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre, Muhammedi a.s. ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهم عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: لِلَّهِ تِسْعَةٌ وَتِسْعُونَ اسْمًا مَنْ حَفِظَهَا دَخَلَ الْجَنَّةَ.

“Allahu ka 99 emra. Kush i mëson përmendsh do të hyjë në xhenet.” (Buhariu: Kitab’ush-shurut).

Këta emra sipas hadithit janë:

Allah: Emri i përveçëm i Zotit që argumenton Individualitetin (Dhat), i cili përmbledh në vetvete të gjithë emrat dhe atributet e veta.

1. Rrahman (Gjithëmëshirshmi)
2. Rrahim (Mëshirëploti)
3. Melik (Sundimtar)
4. Kuddus (I Shenjtë)
5. Selam (Shpëtues)
6. Mu’min (Besimtar, Besues)
7. Muhejmin (Mbrojtës, Ruajtës)
8. Aziz (I çmuar)

9. Xhebbar (Shtrëngues, detyrues)
10. Mutekebbir (Madhështor)
11. Halik (Bërës, Krijues)
12. Bari’ (Hyjni)
13. Musawwir (Projektues)
14. Gaffar (Falës i fajeve)
15. Kahhar (Prishës, Shkatërrues)
16. Vehhab (Falës, Dhurues)
17. Rrezzak (Furnizues, Ushques)
18. Fettah (Ngadhënjyes)
19. Alim (Dijetar)
20. Kabid (Rrëmbyes i shpirtrave)
21. Basit (Zgjerues i të mirave)
22. Hafid (Poshtërues i mohuesve)
23. Rafi’ (Lartësues)
24. Muiz (Vlerësues, Lartësues)
25. Mudhil (Zhvlerësues)
26. Semi’ (Dëgjues)
27. Besir (Shikues)
28. Hakem (Gjykues, Ndarës)
29. Adil (I drejtë)
30. Latif (Favorizues)
31. Habir (I informuar)
32. Halim (Sjelljebutë)
33. Adhim (Madhështor)
34. Gafurr (Falës i gjerë)
35. Shekur (Shumë falënderues)
36. Alij (I lartë)
37. Kebir (I madh)
38. Hafidh (Roje, Ruajtës)
39. Mukit (Përgatitës furnizimi)
40. Hasib (Llogarikërkues)
41. Xhelil (I lartë në cilësi)
42. Kerim (Shumë bujar)

43. Rakib (Vëzhgues)
44. Muxhib (Pranues i lutjeve)
45. Vasi’ (I gjerë në dije dhe mëshirë)
46. Hakim (I urtë)
47. Vedud (Dashamirës)
48. Mexhid (I lartë në nder)
49. Baith (Ringjallës)
50. Shehid (Dëshmues)
51. Hak (I vërtetë)
52. Vekil (Dorëzanës)
53. Kavij (I fuqishëm)
54. Metin (I fortë)
55. Velij (Kujdestar)
56. Hamid (I denjë për lavdërim)
57. Muhsi (Numërues)
58. Mubdi (Bërës nga e paqena)
59. Muid (Vdekjedhënës dhe ringjallës)
60. Muhji (Ngjallës)
61. Mumit (Vdekjedhënës)
62. Hajj (I gjallë)
63. Kajjum (Që qëndron në këmbë dhe që mban çdo gjë në këmbë)
64. Vaxhid (Zbulues)
65. Mexhid (I famshëm)
66. Vahid (Një i vetëm)
67. Samed (I vetëmjaftueshëm)
68. Kadir (Zotërues)
69. Muktedir (Fuqiplotë)
70. Mukaddim (Priorizues)
71. Muahhir (Prapësues)
72. Evvel (I Parë, I paraqenë)
73. Ahir (I pasqenë)
74. Dhahir (I Dallueshëm)
75. Batin (I fshehur, i brendshëm)
76. Vali (Administrues)

77. Muteali (I tejzakonshëm)
78. Berr (Mirënjohës)
79. Tevvab (Pranues i pendesës)
80. Muntekim (Shpagimtar)
81. Afuvv (Falës)
82. Reuf (I dhembshur)
83. Malikul-mulk (Pronari i mallit)
84. Dhul Xhelali (I madh)
85. Vel Ikram (Dhurues)
86. Muksit (Synues)
87. Xhami (Përmbledhës)
88. Ganij (I pasur)
89. Mugni (Pasurues)
90. Mani (Pengues)
91. Derr (Dëmtues)
92. Nafi (Dobisjellës)
93. Nur (Dritë)
94. Hadi (Orientues)
95. Bedi’ (Novator)
96. Baki (I gjithëqenë)
97. Varith (Trashëgimtar)
98. Reshid (Udhërrëfyes)
99. Sabur (Durimtar).[8]

Përveç emrave të bukur të theksuar, ka edhe të tjerë për të cilët ne nuk kemi njohuri. Me një rast Muhammedi a.s. ka thënë: “... *Për nderim të çdo emri tënd që e ke përmendur në Librin tënd, që ia ke mësuar dikujt nga krijesat tua ose që ia ke lënë vetes në Dijen Tënde të fshehtë ...*”.

[8] Sipas: Udhërrëfyesi i një muslimani, po aty, fq. 88-94.

4. Atributet e Allahut (Sifat'ull-llah)

Pasuesit e fesë dhe të filozofisë pajtohen se Zoti, si qenie e domosdoshme, duhet t'i posedojë të gjitha cilësitë (sifatet) e përsosura dhe se duhet të jetë i privuar nga çdo mangësi e mundshme.

Të gjitha atributet e Allahut janë të paraekzistuese dhe pasekzistuese, ekzistenca e tyre nuk ka as fillim as fund dhe nuk i përngjasojnë atributeve të krijesave. Edhe pse në emërtime ka ngjashmëri formale sikur për shembull dituria, vullneti, jeta ato nuk ngjasojnë me diturinë, vullnetin dhe jetën e Allahut. Allahun e njohim nëpërmjet emrave dhe atributeve sepse *dhati* (individualiteti) dhe natyra e Tij nuk është i perceptueshëm ndryshe.

Allahu xh.sh. thotë:

لاَ تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الأَبْصَارَ ۖ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ.

"Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë, por Ai i përfshinë shikimet. Ai është bamirës i pakufi dhe di çdo gjë." *(El-En'am: 103).*

Në këtë pikëpamje edhe Muhammedi a.s. thotë:

تَفَكّروا في خلق الله، ولا تَفكّروا في الله فإنكم لن تقدروا قدره .

"Mendoni për krijesën e Allahut dhe mos mendoni për vetë Allahun. Pa dyshim ju për këtë nuk keni asnjë mundësi." (Ibn Abbasi).

Atributet e domosdoshme të Allahut janë klasifikuar në mënyra të ndryshme, varësisht prej shkollave akaidore dhe akaidologëve, por klasifikimi më i njohur dhe më i shtrirë është ai që i ndan atributet e Allahut në: **Sifat'udh-dhatijjeh** - atribute individuale, negative, respektivisht theksohen edhe me shprehjet *es-sifat'us-selbijjeh* apo *es-sifat'ut-tenzihijjeh* dhe **Sifat'uth-thubutijjeh** - atribute qenësore, pozitive.

a) Sifat'udh-dhatijjeh - Atributet individuale, negative

Sifat'udh-dhatijjeh (atributet individuale, negative) janë atribute të posaçme vetëm për Allahun dhe nuk mund t'i atribuohen asnjë krijese. Meqë e kundërta (mangësia, relativiteti dhe temporaliteti) nuk mund të mendohet për Allahun, këto atribute janë quajtur edhe *sifat'ut-tenzih* (atribute absolute) dhe *sifat'us-selbijje* (atribute mohuese).

Synimi i atributeve mohuese është që duke asgjësuar çdo lloj shenje politeizmi të vërtetohet besimi monoteist në tërë kuptimin e vet. Po ashtu, synimi i atributeve mohuese është që të zërë vend bindja se mes krijuesit dhe krijesës nuk ka ndonjë pikë të përbashkët apo ngjasim. Ajeti kur'anor لَيْسَ كَمِثْلِه شَيْءٌ ***"Asgjë s'është e ngjashme me Atë".*** *(Esh-Shura: 11)* është thelbi dhe shpjegimi kryesor për besimin e pastër islam (tenzih).

Atributet dhatijjeh janë "cilësi esenciale të Allahut, kurse për sa i përket njeriut, këto cilësi nuk janë esenciale nga vetë fakti se ato nuk janë më tepër se pikla rrezatimesh të Allahut, të cilat ia dhuron njeriut". Cilësitë me të cilat është pajisur njeriu ndryshojnë nga cilësitë e Allahut, si për nga vërtetësia po ashtu edhe për nga esenca e tyre. Pra, këto cilësi janë të përbashkëta me cilësitë e Allahut vetëm në emërtim."

Me qëllim të lehtësisë për mësim rreth këtyre çështjeve, e që imponohen nga vetë natyra e mësimeve islame, dijetarët i kanë përcaktuar gjashtë atribute:

1) El-Vuxhud (Ekzistencë). - Allahu është dhe ekziston. Ekzistenca e Tij është e domosdoshme dhe në vetvete. Nuk varet prej dikujt apo diçkaje tjetër. Nuk mund të mendohet e kundërta e këtij atributi, respektivisht mosekzistenca e Allahut xh.sh.. Arsyeja me të cilën jemi pajisur na udhëzon në bindjen se duhet medoemos të ekzistojë Qenia më e lartë. Nuk mund të mendohet se Dielli, Toka dhe i tërë kozmosi kanë mund të lindin rastësisht dhe vetvetiu. Vetvetiu nuk mund të lindë as atomi më i vogël. Çdo gjë ka krijuesin e vet, e ai është Allahu i madhërishëm.

Ky atribut është quajtur edhe atribut vetjak (sifat'ul-nefsijjeh).

Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ وَاخْتِلاَفِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَالْفُلْكِ الَّتِي تَجْرِي فِي الْبَحْرِ بِمَا يَنفَعُ النَّاسَ وَمَا أَنزَلَ اللّهُ مِنَ السَّمَاءِ مِن مَّاءٍ فَأَحْيَا بِهِ الأرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَبَثَّ فِيهَا مِن كُلِّ دَآبَّةٍ وَتَصْرِيفِ الرِّيَاحِ وَالسَّحَابِ الْمُسَخِّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالأَرْضِ لآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ .

***"Me të vërtetë në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në ndryshim të natës dhe të ditës; në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve; në ujërat që zbret Allahu prej qiellit, e me të cilët i ngjall tokat e vdekura** (tokat e thata) **nëpër të cilën ka shpërndarë gjithfarë lloj shtazësh; në ndryshimin e erërave e reve të nënshtruara lëvizjeve në mes qiellit e Tokës -** (në të gjitha këto) **ka shenja për të gjithë ata që mendojnë."** (El-Bekare: 164).*

2) El-Kidem (Allahu nuk ka fillim, i paraqenë). - Allahu nuk ka fillim (kidem, paraqenie). Ai nuk është një qenie që nuk ka qenë por që është bërë. Nuk mund të thuhet për individualitetin dhe atributet e Tij se janë krijuar pas. Nuk mund të mendohet një kohë kur Ai nuk ka ekzistuar. Sado të kthehemi pas, nuk do të mund të gjejmë një kohë që Ai të mos ketë ekzistuar. Ai nuk është i krijuar pas as asnjëherë. Sado para që ta çojmë mendimin nuk mund të gjejmë kohën kur Allahu të mos ekzistojë më.

Meqë ekzistimi i Allahut është i domosdoshëm (vaxhib'ul-vuxhud) edhe paraqenia e Tij është e domosdoshme. E kundërta e atributit "i paraqenë" është atributi "aksidental" (i krijuar në kohë), atribut ky që nuk mund të mendohet për Allahun.

Allahu xh.sh. thotë:

هُوَ الأَوَّلُ وَالآخِرُ...

***"Ai është i Pari dhe i Pasmi...".** (El-Hadid: 3).*

3) El-Beka (Allahu nuk ka fund, i pasqenë). - Ekzistenca e Allahut vazhdon pafundësisht. Ai nuk është i përkohshëm, i vdekshëm. Ai që është i paraqenë, Ai është edhe i pasqenë, i përhershëm dhe i ngahershëm (El-Baki). E kundërta e këtij atributi, zhdukja, prishja e mbarimi (fena`) nuk mund të mendohet për Allahun. Pafundësia (ed-daimu) rezulton nga pafillimësia, sepse ajo që nuk ka fillim duhet të jetë e domosdoshme, kurse çka është e domosdoshme nuk mund të zhduket. Zoti është qenie e domosdoshme, prandaj dy cilësitë e cekura (kidem dhe beka) duhet të gjendet domosdoshmërish, nga të cilat e para (kidem) mohon fillimin, kurse e dyta (beka) mohon fundin e ekzistimit të Zotit.

Allahu xh.sh. thotë:

...كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلاَّ وَجْهَهُ ...

***"... Çdo gjë, pos Tij, është e shkatërrueshme ... ."** (El-Kasas: 88).*

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ . وَيَبْقَىٰ وَجْهُ رَبِّكَ ذُو الْجَلاَلِ وَالإِكْرَامِ.

***"Çdo gjë që është në Tokë është e kalueshme** (do të shkatërrohet). **e mbetet vetëm Zoti yt, i Madhërueshmi dhe Bamirësi."** (Err-Rrahman: 26-27).*

4) El-Vahdanijeh (Njësi, Unitet). - Allahu është i vetëm, unik në individualitetin, atributet dhe aktet e Tij. Atributet kundërthënëse të atributit të unitetit, pluraliteti (teaddud) dhe ngjashmëria (shirk) nuk mund të mendohen për Allahun. Sipas doktrinës islame, Allahu është Një dhe i Vetëm, Unik. Kjo do të thotë se Allahu nuk është i përbërë nga elementët përbërëse, e as i formuar nga veçoritë. Allahu nuk është as tërësi që të pjesëtohet e as universal që të rreshtohet në individë dhe numra.

Ky unikalitet nuk është në aspekt të numrit por të esencës. Nuk ka krijues tjetër veç Tij, është i parival dhe nuk ka qenie tjetër që të adhurohet veç Tij.

Allahu xh.sh. thotë:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ . اللَّهُ الصَّمَدُ . لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ . وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ.

"Thuaj: "Allahu është Një! Allahut i drejtohen për çdo gjë! Ai nuk ka lindur prej ndokujt, as nuk ka lindur kë, Dhe askush nuk i ngjason Atij!" *(El-Ihlas: 1-3).*

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلاَّ اللَّهُ لَفَسَدَتَا ۚ فَسُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ .

"Sikur të kishte në to *(qiej dhe Tokë)* ***zota, përveç Allahut, do të shkatërroheshin të dyja. Qoftë i pastër Allahu - Zoti i Arshit, nga ato që ia përshkruajnë Atij!"*** *(El-Enbija: 22).*

...لاَ لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ ۗ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ.

"...Vetëm ai krijon dhe sundon. I Lartësuar është Allahu, Zoti i gjithësisë!" *(El-Enbija`: 54).*

5) El-Muhalefetu li'l-havadithi (Mosngjashmëria me qeniet e krijuara). - Allahu nuk u ngjan krijesave as në esencë e as me ndonjë atribut. Të gjitha sendet dhe krijesat janë e kundërta e Allahut. Ai nuk i përngjet asnjë sendi e asnjë krijese aksidentalisht. Allahu është një qenie përtej asaj ç'mund të mendojmë ne për Të. Ngjashmëria (mushabeheh) dhe identiteti (mumathileh) i Allahut me qeniet aksidenciale nuk mund të mendohet. Ai është i domosdoshëm, i mëvetshëm nga çdo gjë dhe i pazhdukshëm. Bota është e mundshme, e nevojshme, e lindur dhe e zhdukshme. Zoti nuk është materie, nuk është trup, nuk ka nevojë për vend, as që mund të matet me kohë. Nuk ka ngjyrë as formë, nuk mund të bashkohet me diç apo të mishërohet. Me këtë bindje kundërshtojnë:

- Ata që besojnë se Allahu është trup (muxhessimët);

- Ata që Allahun ia përshtatin krijesave të Tij, duke thënë: Allahu edhe pse nuk është trup. Ai megjithatë mund t'i ketë disa cilësi të trupit (mushebbihët).

- Ata të cilët besojnë në njëfarë unifikimi absurd (inkarnimi) i fytyrës hyjnore me njeriun.

- Panteistët të cilët nuk e mohuan Zotin por nuk e pranojnë si qenie të mëvetësishme. Sipas tyre, Zoti dhe bota janë po e njëjta gjë.

Allahu xh.sh. lidhur me këtë çështje prerazi thotë:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ .

"... Asgjë nuk i shëmbëllen Atij". *(Esh-Shura: 11).*

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلاَّ اللَّهُ لَفَسَدَتَا ...

"Sikur të kishte në to *(qiej dhe Tokë)* ***zota, përveç Allahut, do të shkatërroheshin të dyja …".*** *(El-Enbija: 22).*

6) El-Kijamu bi nefsihi (Ekzistencë në vetvete). - Për të ekzistuar Allahu nuk ka nevojë për asgjë. Allahu ekziston në vetvete dhe ekzistimin e vet e ka nga vetja por jo nga tjetërkush (el-kijamu bigajrihi). Do të thotë, Ai është që nuk ka nevojë për askënd, ndërsa të gjithë janë të nevojshëm për Atë; ai ndikon te krijesat por jo edhe e kundërta, sepse nuk është karakteristikë për Krijuesin.

Lidhur me këtë Allahu xh.sh. thotë:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ . اللَّهُ الصَّمَدُ.

"Thuaj: "Allahu është Një! Allahut i drejtohen për çdo gjë!" *(El-Ihlas: 1-2).*

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ ۖ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ .

"O njerëz! Ju jeni të varfër te Allahu, *(nevojtarë për çdo gjë).* ***E Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe është i denjë për falënderim."*** *(Fatir: 15).*[9]

[9] Shih gjerësisht: Besimi I-II, po aty, fq. 64-66; Mehmed Handzic, VI, po aty, fq. 359-364; Bekir Topaloglu, Bazat e besimit, po aty, fq. 97-99; Buti, El-Buti, Të vërteta e patundshme, po aty, fq. 90-99.

b. Sifat’uth-thubutijjeh - Atributet qenësore, negative

Sifat’uth-thubutijjeh (atributet qenësore, negative) janë atribute të domosdoshme që e pohojnë përsosmërinë. Quhen kështu pasi e bëjnë të njohur Allahun me cilësi qenësore e pozitive, si jeta, vullneti, fuqia etj. Atributet e kundërta me këto nuk mund të mendohen për Allahun. Gjithashtu, duhet thënë se këto atribute, të pafillimta dhe të pafundme, nuk u përngjajnë atributeve të njëjta te krijesat. Këto atribute në anën tjetër kanë lidhje me gjithësinë, prandaj edhe mund t’u jepen edhe krijesave, për dallim prej atyre individuale. Nuk duhet hequr nga mendja që atributet e Allahut janë të paraqenë, të pasqena, të pakushtëzuara etj., kurse ato njerëzore janë të kushtëzuara, të varura, të përkohshme, të mangëta, relative në çdo aspekt.

Pamë se Allahu është një në ekzistimin dhe krijimin e domosdoshëm dhe se tërë bota është vepër e Tij. Në atë vepër të Allahut shohim rend të urtë dhe harmoni të shkëlqyeshme. Sipas kësaj, mund të përfundohet se krijuesi i kësaj bote të përsosur posedon dije të përsosur, fuqi të pakufishme, vullnet plotësisht të lirë, aftësi për të krijuar dhe jetë të përsosur. Vetë arsyeja jonë kërkon që Zoti, si e vetmja qenie e domosdoshme, të posedojë të gjitha atributet e përsosura dhe të jetë i privuar nga të gjitha mangësitë dhe të metat.

Dijetarët islamë kanë dallim në perceptimin e këtyre atributeve, por shumica (sidomos ata maturidij) mendojnë se janë tetë:

1) El-Hajatu (Jeta). - Allahu është i gjallë dhe jeton ngaherë dhe përherë. Asnjë njeri i zakonshëm, asnjë mendimtar që beson në ekzistimin e Zotit nuk do të pohojë se Zoti i tij ka vdekur. Gjallesat kanë nevoja të ndryshme si nevojë për kohën, hapësirën etj., por kanë edhe fillimin dhe fundin e tyre. Atributi *jetë* njëkohësisht është themel i të gjitha atributeve të tjera të Zotit, si dija, fuqia etj. Sikur Allahu të mos kishte një jetë të tillë, nuk do të ishte më i përkryer nga krijesat që Ai i ka krijuar, kurse kjo është e pamundur.

Allahu xh.sh. për këtë thotë:

اللَّهُ لاَ إِلَٰهَ إِلاَّ هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ...

“Allahu është - s’ka tjetër zot përveç Tij, *(i cili)* ***jeton përgjithmonë dhe zotëron*** *(me gjithësinë)****!”*** *(El-Bekare: 255).*

وَعَنَتِ الْوُجُوهُ لِلْحَيِّ الْقَيُّومِ ۖ وَقَدْ خَابَ مَنْ حَمَلَ ظُلْمًا .

“Pa dyshim fytyrat janë drejtuar kah Allahu që është i gjallë dhe sundues mbi çdo gjë.” *(Ta Ha: 111).*

2) El-Ilmu (Dituria). - Allahu di, Ai ka dituri dhe dituria e Tij përfshin çdo gjë. Ai është kompetent i çdo gjëje të hapur e të fshehtë, të largët e të afërt, të madhe e të vogël me një dituri të pakufishme e të pafund. Ai di për çdo gjë dhe dija e Tij nuk varet nga koha, hapësira dhe mjetet e ndryshme. Po ashtu, për të ditur diçka, Atij nuk i nevojitet syri, veshi, libri, lapsi etj. Dija e tij nuk ka kufizime në konceptet e shkuara, e tanishmja dhe e ardhmja. Ajo as nuk shtohet as pakësohet. Allahu, jo vetëm që nuk varet nga këto koncepte, por tërësisht janë pyetjet e tilla absurde, sepse Ai është jashtë kohe, jashtë hapësirës, jashtë konceptit të të mësuarit nga mësuesi etj., dhe i di gjërat me dijen e Tij të paraqenë, tërësisht e jo pjesërisht në mënyrë të përsosur.

Allahu xh.sh. thotë:

... وَأَنَّ اللَّهَ قَدْ أَحَاطَ بِكُلِّ شَيْءٍ عِلْمًا.

“... me të vërtetë, dijenia e Allahut i ka përfshirë të gjitha!“ *(Et-Talak: 12).*

...إِنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ.

“... Me të vërtetë, Allahu, është i dijshëm për çdo gjë.” *(Et-Tevbeh: 115).*

3) Es-Sem’u (Dëgjimi). - Allahu dëgjon dhe dëgjimi i Tij përfshin çdo gjë, pa u varur apo penguar nga ndonjë gjë. Gjithashtu, dëgjimi i një gjëje nuk e pengon të dëgjojë edhe disa gjëra të tjera njëkohësisht.

Ai dëgjon çdo tingull e çdo gjë të hapur e të fshehtë, me zë të lartë apo të ulur. Dëgjimi i Allahut nuk varet nga organet apo ndonjë mjet, që është karakteristikë e krijesave. Nuk mund të mendohet që Allahu të mos dëgjojë.

Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ.

“Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.“ *(El-Haxhxh: 75).*

قَالَ لاَ تَخَافَا ۖ إِنَّنِي مَعَكُمَا أَسْمَعُ وَأَرَىٰ.

“*(Allahu)* ***tha: “Mos u frikësoni! Unë me të vërtetë, jam me ju, dëgjoj dhe shoh”.*** *(Ta Ha: 46).*

4) El-Besaru (Shikimi). - Allahu sheh çdo gjë. Asgjë nuk mbetet e fshehur nga shikimi i Allahut. Ai sheh gjithçka në dritë dhe në errësirë. Allahu nuk sheh sikurse krijesa dhe jo nëpërmjet iluzionit, imagjinatës, organeve e mjeteve. Të shikuarit e Tij është absolut në hapësirë, kohë e rrethana të ndryshme dhe nuk mund të mendohet që Allahu të shohë me mangësi apo të mos shohë fare.

Ka shumë ajete që flasin për këtë temë, por ne do të mjaftojmë me këtë:

يَعْلَمُ خَائِنَةَ الْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِي الصُّدُورُ . وَاللَّهُ يَقْضِي بِالْحَقِّ ۖ وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِهِ لَا يَقْضُونَ بِشَيْءٍ ۗ إِنَّ اللَّهَ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ .

“*(Allahu)* ***di për shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra; Allahu gjykon drejt, e ata që iu luten atyre përveç Tij, nuk gjykojnë asgjë. Allahu me të vërtetë dëgjon dhe sheh*** *(çdo gjë).* *(Gafir (Mu’min): 19-20).*

5) El-Iradetu (Vullneti). - Allahu ka vullnet dhe dëshirë për të bërë dhe Ai përcakton vendin, gjendjen dhe cilësitë e krijesave të veta. Ndodh ashtu diç dëshiron Ai dhe jo e kundërta. E kundërta e këtij atributi nuk mund të mendohet për Allahun xh.sh. Aktet krijuese të

Zotit kanë të bëjnë me dëshirën dhe vullnetin e Tij dhe ato ndodhin pa shtrëngesë dhe detyrim. Po deshi Ai diçka, bëhet; po s’deshi, s’bëhet. Edhe trupat qiellorë, edhe gjethet e drunjve, edhe qepalla e syrit nuk veprojnë pa dëshirën e Tij.

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمُ الْحَقُّ مِن رَّبِّكُمْ ۖ فَمَنِ اهْتَدَىٰ فَإِنَّمَا يَهْتَدِي لِنَفْسِهِ ۖ وَمَن ضَلَّ فَإِنَّمَا يَضِلُّ عَلَيْهَا ۖ وَمَا أَنَا عَلَيْكُم بِوَكِيلٍ.

“Thuaj: “O njerëz, ju erdhi juve e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për dobi të vet, e kush është humbur, ka humbur në dëm të vet. E, unë nuk jam mbikëqyrësi juaj”. *(Junus: 107).*

Vullneti është dy llojesh:

- Vullneti krijues (Tekvin’ul-iradeh) është ai ku Allahu zotëron vullnet krijues dhe përfshin të gjitha krijesat. Shembull për këtë kemi ajetin kur’anor:

إِنَّمَا قَوْلُنَا لِشَيْءٍ إِذَا أَرَدْنَاهُ أَن نَّقُولَ لَهُ كُن فَيَكُونُ.

“Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, Na - vetëm me një të thënë për atë: “Bëhu!” dhe ajo bëhet.” *(En-Nahl: 40).*

- **Vullneti dëshirues** ose **legal** (teshri‘ul-iradeh, ndryshe quhet edhe vullnet fetar (din’ul-iradeh) është ai kur Allahu dëshiron diçka dhe e pëlqen atë do të thotë se urdhëron për të. Ndërkaq, fakti që Allahu dëshiron diçka me këtë lloj vullneti, nuk e bën të detyrueshëm krijimin e asaj gjëje. Ajeti kur’anor që vijon e bën të qartë këtë lloj vullneti:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنكَرِ وَالْبَغْيِ ۚ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ .

“Allahu me të vërtetë urdhëron që të veprohet me drejtësi, mirësi dhe t’u ndihmohet të afërmve, e ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon që të pranoni këshillat. *(En-Nahl: 90).*

Ndërsa vullneti krijues përfshin edhe të mirën edhe të keqen, edhe të dobishmen edhe të dëmshmen. Vullneti dëshirues ose legal ka të bëjë vetëm me të mirën dhe të dobishmen. Kjo do të thotë se ndërsa krijon edhe të mirën edhe të keqen, Allahu nuk e pëlqen të keqen, nuk e urdhëron të keqen dhe nuk pëlqen e nuk e miraton të keqen.[10]

6) El-Kudretu (Fuqia). - Allahu është i gjithëfuqishëm, kurse e kundërta e kësaj, dobësia, nuk mund të imagjinohet për Allahun. Asgjë nuk mund të ndodhë jashtë fuqisë së Tij dhe çdo gjë në gjithësi ndodh me fuqinë e Tij. Sepse si mund të mendohet një Krijues pa fuqi ose me fuqi të kushtëzuar e të kufizuar.! Allahu nga fuqia e Tij e pakufizuar krijoi nga hiçi këtë botë të madhe, me atë administron dhe e mban baraspeshën, rendin dhe harmoninë në të në mënyrë të përkryer.

يُقَلِّبُ اللَّهُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَعِبْرَةً لِّأُولِي الْأَبْصَارِ ﴿٤٤﴾ وَاللَّهُ خَلَقَ كُلَّ دَابَّةٍ مِّن مَّاءٍ ۖ فَمِنْهُم مَّن يَمْشِي عَلَىٰ بَطْنِهِ وَمِنْهُم مَّن يَمْشِي عَلَىٰ رِجْلَيْنِ وَمِنْهُم مَّن يَمْشِي عَلَىٰ أَرْبَعٍ ۚ يَخْلُقُ اللَّهُ مَا يَشَاءُ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ .

***"Allahu e sjell ditën dhe natën** (ndërrimin dhe zgjatjen e tyre). **Me të vërtetë, në këtë - ka këshillë për ata që janë largpamës. Allahu ka krijuar çdo lloj shtaze prej ujit: disa nga ato ecin me barkun e tyre, kurse një pjesë ecin në dy këmbë, e disa prej tyre në katër këmbë. Allahu krijon ç'të dojë. Me të vërtetë Allahu është i pushtetshëm për çdo gjë."** (En-Nur: 44-45).*

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَمْ يَعْيَ بِخَلْقِهِنَّ بِقَادِرٍ عَلَىٰ أَن يُحْيِيَ الْمَوْتَىٰ ۚ بَلَىٰ إِنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ .

***"A nuk shohin ata që Perëndia - i cili krijoi qiejt dhe Tokën, i cili nuk është lodhur në krijimin e tyre - është i pushtetshëm t'i ngjallë të vdekurit? Po, me të vërtetë, Ai është i pushtetshëm për çdo gjë".** (El-Ahkaf: 33).*

[10] Besimi I-II, po aty, fq. 68; Bekir Topaloglu, Bazat e besimit, po aty, fq. fq. 101-102; Mehmed Handzic, VI, po aty, fq. 367; Orhan Bislimaj, Akaidi hanefij, po aty, fq. 121 etj.

7) El-Kelamu (Fjala). - Allahu flet por e folura e Tij është ndryshe nga e krijesave. Nëpërmjet këtij atributi Allahu iu ka zbritur pejgamberëve libra hyjnorë, kurse me disa prej tyre ka folur. Ne nuk mund ta dimë natyrën e të folurit të Tij, i cili është i paraqenë dhe nuk përbëhet prej tingujve, siç është komunikimi njerëzor. Kur'ani është *Fjala e Allahut* siç ka pasur edhe para tij libra të tillë: suhufet, Tevrati, Zeburi, dhe Inxhili. Sipas ligjit hyjnor, Fjalën e Tij mund ta dëgjojnë engjëjt dhe pejgamberët. Atributi i të folurit gjithnjë është aktiv dhe nuk mund të mendohet që Allahu të heshtë, sepse heshtja është karakteristikë botërore.

وَلَوْ أَنَّمَا فِي الْأَرْضِ مِن شَجَرَةٍ أَقْلَامٌ وَالْبَحْرُ يَمُدُّهُ مِن بَعْدِهِ سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَّا نَفِدَتْ كَلِمَاتُ اللَّهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ .

***"Sikur të gjithë drunjtë të gjenden në Tokë - të jenë penda** (shkrimi), **e deti ngjyrë shkrimi, e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të soseshin fjalët e Allahut. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm."** (Lukman: 27).*

8) Et-Tekvinu (Krijimi, Gjeneza). - Allahu ka aftësi krijuese, do të thotë, ta bëjë të qenë diçka të paqenë, ta nxjerrë diçka në shesh të ekzistencës. Fjala *tekvin* shpreh atributet praktike të Zotit, siç janë: krijimi, furnizimi dhe ushqimi, ringjallja, shkaktimi i vdekjes, dhënia e dhuntive, ndëshkimi dhe shpërblimi etj. Ai është i vetmi krijues, me fuqinë e Tij të pafundme duke e ditur me diturinë e Tij të paraqenë. Shkolla maturidite këtë parim e numëron ndër atributet pozitive dhe bazë të atributeve hyjnore të veprimit (sifat'ul-ef'al), siç janë: krijimi i botës, ndarja e nafakës (rizkut), ringjallja dhe vdekja). Esh'arinjtë këtë

atribut nuk e numërojnë si të veçantë por në kuadër të atributit të fuqisë (kudret).[11]

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ ۖ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ.

"Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është mbikëqyrës i çdo gjëje." *(Ez-Zumer: 62).*

[11] Besimi I-II, po aty, fq. 66-69; Bekir Topaloglu, Bazat e besimit, po aty, fq. fq. 100-103; Mehmed Handzic, VI, po aty, fq. 364-368; Orhan Bislimaj, po aty, fq. 127-149.

Nexhat Ibrahimi

FAITH IN ALLAH

(Summary)

Introduction

Faith in Allah (Iman) is the first pillar of Islam. Iman is the firm conviction that there is only one God, the ruler and creator of all things; and that He is the Ilah who is alone worthy of undivided worship and that He is distinguished by all the attributes of perfection and completeness and that He is above any faults or deficiencies.

Faith in Allah is the first and most fundamental principle in Islam, since the existence and the unity of Allah is the foundation of the religion of Islam and everything else is based on it.

آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِن رَّبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ ۚ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ .

نجاد ابراهيمى

الايمان بالله جل شأنه

(خلاصة البحث)

اللايمان بالله جل شانه هو الشرط الاول للايمان فى الاسلام ، و الايمان معناه الاعتقاد القوى بان الله هو الرب و هو الواحد الاحد و هو المسيطر و هو خالق كل شىء . و الايمان بالله جل شأنه الواحد الاحد معناه ان نخلص اليه كل عباداتنا و ان نؤمن بان الله له الاسماء الحسنى و اجمل الصفات و ان نؤمن بانه بعيد كل البعد و نزيه من النواقص و التى تتميز بها المخلوقات .

الايمان بالله يعتبر من اولويات الشروط فى الاسلام لان وجودالله و واحدانيته يعد اساسا للايمان و كل الشروط الاخرى تنبنى على الايمان بالله جل شانه .

و نرى ان القران الكريم حول هذا الامر يقول :

آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِن رَّبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ ۚ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ .

JURISPRUDENCË ISLAME

Ejup Haziri

PARIMET E LEGJISLACIONIT ISLAM

Legjislacioni islam ka parimet e veta që e dallon atë nga legjislacionet tjera, ku ndër të tjera do të sjellim këtu vetëm parimet kryesore:

Parimi i parë: E drejta e jetës

Jeta padyshim që është dhuratë hyjnore për krijesën njeri. Legjislacioni islam i ka kushtuar rëndësi të posaçme këtij parimi, saqë e ka bërë marrjen e jetës së dikujt çështje të ndërlidhur vetëm me kompetencat e Krijuesit, e jo të dikujt tjetër, ndërkaq lidhur me këtë thuhet:

وَإِنَّا لَنَحْنُ نُحْيِۦ وَنُمِيتُ وَنَحْنُ ٱلْوَٰرِثُونَ ﴿٢٣﴾

***"Ne, vërtet jemi që japim jetë e vdekje dhe Ne jemi trashëgues** (të qiejve e tokës)**."**[1]*

Ky legjislacion ka përcaktuar se secili person duhet të jetojë në suaza që Krijuesi ia përcaktoi, e jo të tejkalojë limitet e tij duke bërë ngatërresa e padrejtësi që rezultojnë në mbytjen e ndokujt, ndaj tekstet e legjislacionit në këtë çështje janë shumë të ashpra:

...مَن قَتَلَ نَفْسًۢا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِى ٱلْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ ٱلنَّاسَ جَمِيعًا
وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَآ أَحْيَا ٱلنَّاسَ جَمِيعًا ۚ ... ﴿٣٢﴾

***"...kush mbyt një njeri** (pa të drejtë), **pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë** (krimi i tij) **është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit."**[2]* Akoma më kërcënues është teksti në vijim që flet për atë që pa të drejtë ia merr jetën tjetrit:

وَمَن يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُّتَعَمِّدًا فَجَزَآؤُهُۥ جَهَنَّمُ خَٰلِدًا فِيهَا وَغَضِبَ ٱللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُۥ
وَأَعَدَّ لَهُۥ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿٩٣﴾

***"Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh."**[3]*

Me këto dy tekste të prera, ka ndaluar në mënyrë të prerë, ashpër e rigoroz, marrjen e jetës së dikujt, pa të drejtë, e ata që nuk përcjellin këto por veprojnë siç iu vjen për shtati, atëherë le ta dijnë se ata i pret një dënim i ashpër në botën tjetër, i shoqëruar me hidhërim e mallkim nga Krijuesi, e tëra kjo për shkak të veprës së ligë, të cilën e ka ndaluar me ndalesë të rreptë.

Gjithashtu këtu hyn edhe mbytja e vetvetes, e cila po ashtu është e ndaluar në çfarëdo rasti dhe rrethane. Besimtarit nuk i lejohet t'i japë fund jetës së tij për arsye të ndryshme, pa marrë parasysh gjendjen dhe rrethanat e tij, në asnjë mënyrë nuk i lejohet ky veprim. I Madhërishmi ka potencuar:

... وَلَا تَقْتُلُوٓا۟ أَنفُسَكُمْ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا ﴿٢٩﴾

***"...mos mbytni veten tuaj** (duke mbytur njëri-tjetrin)**. Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm për ju."**[4]* Ndërsa më pas ka sqaruar se kush

[1] Kur'ani, Hixhr: 23.

[2] Kur'ani, Maide: 32.
[3] Kur'ani, Nisa: 93.
[4] Kur'ani, Nisa: 29.

vepron këtë ligësi, qëllimisht, ai do të jetë i përbuzur dhe i dënuar në botën tjetër:

وَمَن يَفۡعَلۡ ذَٰلِكَ عُدۡوَٰنًا وَظُلۡمًا فَسَوۡفَ نُصۡلِيهِ نَارًاۚ وَكَانَ ذَٰلِكَ عَلَى ٱللَّهِ يَسِيرًا ﴿٣٠﴾

“Kush bën këtë** (që ndaloi Zoti) **qëllimisht dhe tejkalon kufijtë, Ne do ta hudhim atë në një zjarr të fortë. Dhe kjo është leht për Allahun.”[5]

Pra, e drejta e jetës është e drejtë për secilin individ, e cila është një dhuratë hyjnore me të cilën Krijuesi i sprovon njerëzit në këtë jetë, që më pas t’i gjykojë ata në botën e përtejme:

ٱلَّذِى خَلَقَ ٱلۡمَوۡتَ وَٱلۡحَيَوٰةَ لِيَبۡلُوَكُمۡ أَيُّكُمۡ أَحۡسَنُ عَمَلاًۚ وَهُوَ ٱلۡعَزِيزُ ٱلۡغَفُورُ ﴿٢﴾

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi.”[6]

Secili ka të drejtën e jetës si të dojë, por ata që thyejnë kornizat dhe shenjat hyjnore meritojnë ndëshkimin, e ata që iu binden shenjave, meritojnë shpërblimin, ndaj të ecurit në këtë jetë sipas shenjave ekzistuese është rrugëtim i sigurt, pa telashe e pa probleme, e ata që s’i përfillin rregullat një ditë do të mbarojnë keq, e dita sado e gjatë që të jetë, nata patjetër se do të vijë.

Gjithashtu nuk duhet harruar faktin se islami që nga ditët e para të shpalljes së tij, i ka luftuar gjitha zakonet e mbytjes që ekzistonin, si mbytja e fëmijëve pas lindjes, zakon që bëhej nga arabët paraislamikë, për shkak të varfërisë dhe shkaqeve tjera:

وَلَا تَقۡتُلُوٓاْ أَوۡلَٰدَكُمۡ خَشۡيَةَ إِمۡلَٰقٍۖ نَّحۡنُ نَرۡزُقُهُمۡ وَإِيَّاكُمۡۚ إِنَّ قَتۡلَهُمۡ كَانَ خِطۡـًٔا كَبِيرًا ﴿٣١﴾

[5] Kur’ani, Nisa: 30.
[6] Kur’ani, Mulk: 2.

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”[7] Madje ky legjislacion ka arritur kulmin e tij të mëshirës, kur ndalon edhe abortin, duke respektuar kështu edhe fetusin që ndodhet në barkun e nënës, me fjalë tjera ndalon mbytjen e një krijese të re, madje edhe nëse ajo krijesë vjen nga marrëdhëniet e paligjshme, për arsye se ajo është krijesë e pafajshme dhe duhet ta jetojë jetën, e assesi të mbytet për gabimet e të tjerëve.

Parimi i dytë: Liria e besimit

Legjislacioni islam si parim kryesor ka lirinë e besimit, ku ka lënë derën e hapur për besimet tjera, ndaj secili person mund të besojë çfarë të dojë dhe se askush s’ka të drejtë që t’ua imponojë të tjerëve besimin e tij apo t’i detyrojë ata që të kryejnë rite e adhurime të caktuara, pa dëshirën e tyre.

Ligjvënësi ka obliguar që njerëzit të respektojnë besimin e tjerëve, pa marrë parasysh besimin e tyre, e nuk i lejohet askujt që imponimin t’ia adresojë dikujt tjetër, nëse nuk është i kënaqur me idetë dhe besimin e tjetrit, atëherë le të tentojë ta bindë atë, e jo me imponim e detyrim.

Tekstet për lirinë e besimit janë të qarta në legjislacionin islam, ku s’ka nevojë analizë apo koment rreth tyre, për shkak të qartësisë së tyre. Prej tyre veçojmë:

لَآ إِكۡرَاهَ فِى ٱلدِّينِۖ ... ﴿٢٥٦﴾

“Në fe nuk ka dhunë…”[8] Ky ajet është indikacioni më i qartë se legjislacioni e feja nuk janë të bazuara në dhunë e imponim, e kush i përdor këto të fundit, nuk do t’i pranohen. Po ashtu thotë:

[7] Kur’ani, Isra: 31.
[8] Kur’ani, Bekare: 256.

وَلَوۡ شَآءَ رَبُّكَ لَأٓمَنَ مَن فِي ٱلۡأَرۡضِ كُلُّهُمۡ جَمِيعًاۚ أَفَأَنتَ تُكۡرِهُ ٱلنَّاسَ حَتَّىٰ يَكُونُواْ مُؤۡمِنِينَ ﴿٩٩﴾

"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?"[9]

Askush s'mund të jetë mbizotërues ndaj tjetrit në çështjet e besimit, e tëra që mund të lejohet është përkujtimi, këshilla dhe polemika e mirë. Ligjvënësi e ka porositur të Dërguarin e Tij me këto fjalë:

فَذَكِّرۡ إِنَّمَآ أَنتَ مُذَكِّرٞ ﴿٢١﴾ لَّسۡتَ عَلَيۡهِم بِمُصَيۡطِرٍ ﴿٢٢﴾

"E ti pra këshillo, se je vetëm përkujtues, Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!"[10] I Dërguari i Allahut ishte përkujtues dhe këshillues, e tëra që bënte ishte komunikimi i lajmit, ngase ashtu qe porositur e urdhëruar:

... وَمَا عَلَى ٱلرَّسُولِ إِلَّا ٱلۡبَلَٰغُ ٱلۡمُبِينُ ﴿٥٤﴾

"...I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë."[11]

Legjislacioni islam ka arritur kulmin e tij kur ka përcaktuar lirinë e besimit për njerëzit në përgjithësi dhe për myslimanët në veçanti, madje edhe ka përcaktuar vetëmbrojtje dhe liri ndaj jomyslimanëve që jetojnë në vendet islame, ngase në secilin shtet islam jomyslimani mundet që lirshëm dhe haptazi ta praktikojë e shfaq fenë dhe besimin e tij, si dhe t'i proklamojë e praktikojë ritet e fesë së tij. Çifutët kanë të drejtë ta shfaqin besimin dhe adhurimin e tyre, madje edhe në mënyrë zyrtare, ata mund të kenë edhe shkolla, në të cilat mësojnë për fenë e tyre, ashtu siç mund të shkruajnë çfarë të dojnë për fenë e tyre, por edhe të krishterët me të gjitha grupet e ndarjet e tyre, ku secilit grupim i lejohet shfaqja e besimit haptazi, sikurse që mund të kenë edhe shkolla, ku mund të mësojnë për besimet e tyre, të shkruajnë çfarë të duan si dhe ta përhapin atë që e shkruajnë në vendet islame.[12]

[9] Kur'ani, Junus: 99.
[10] Kur'ani, Gashije: 21-22.
[11] Kur'ani, Nur: 54.

Parimi i tretë: Fjala e lirë

Legjislacioni islam ka lejuar fjalën e lirë, madje këtë e ka bërë të drejtë për secilin individ, por edhe shpeshherë e ka bërë fjalën të domosdoshme për njeriun në çdo gjë që e cenon moralin, interesat e përgjithshme, sistemin shoqëror dhe në çdo gjë që legjislacioni e konsideron të keqe dhe të shëmtuar; bazuar në fjalët e Allahut të Madhëruar:

وَلۡتَكُن مِّنكُمۡ أُمَّةٞ يَدۡعُونَ إِلَى ٱلۡخَيۡرِ وَيَأۡمُرُونَ بِٱلۡمَعۡرُوفِ وَيَنۡهَوۡنَ عَنِ ٱلۡمُنكَرِۚ وَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡمُفۡلِحُونَ ﴿١٠٤﴾

"Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja."[13]

Po ashtu thotë:

ٱلَّذِينَ إِن مَّكَّنَّٰهُمۡ فِي ٱلۡأَرۡضِ أَقَامُواْ ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتَوُاْ ٱلزَّكَوٰةَ وَأَمَرُواْ بِٱلۡمَعۡرُوفِ وَنَهَوۡاْ عَنِ ٱلۡمُنكَرِۗ ... ﴿٤١﴾

"*(Ai ndihmon)* ***Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes..."***[14] Ndërsa i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Ai i cili e sheh ndonjë të keqe le ta ndryshojë me dorën e tij, e nëse nuk mundet atëherë le ta ndryshojë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet atëherë le ta ndryshojë me zemrën e tij, por ky është besimi më i dobët."*[15] Një

[12] Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 27-28.
[13] Kur'ani, Ali Imran: 104.
[14] Kur'ani, Haxh: 41.
[15] Muslimi në Sahihun e tij, nr. i hadithit 70; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 4003. Hadithi është autentik.

rast tjetër ka potencuar: *"Xhihadi më i vlefshëm është t'ia thuash fjalën e drejtë (të vërtetë) një tirani zullumqar."*[16]

Njëherë i Dërguari i Allahut u tha shokëve të tij: *"Feja është këshillë." Ata e pyetën: "Për kënd o i Dërguar i Allahut?" "Për Allahun, të Dërguarin e Tij, për librin e Tij, për udhëheqësit e myslimanëve dhe për masën e gjerë"*[17],ishte përgjigja e të Dërguarit të Allahut.

Por, kjo liri e fjalës së lirë nuk është e përgjithshme, ngase ajo është e kufizuar, ajo lejohet në suaza të cilat legjislacioni e lejoi, në të kundërtën kur ajo ndeshet me moralin e mirë, edukatën dhe kur ajo sulmon pamëshirshëm nderin e individit, ajo bëhet e ndaluar.[18]

Së këndejmi, ajo që ka ndodhur kohës së fundit dhe është duke ndodhur, kur dikush në emër të lirisë së fjalës sulmon shëmbëlltyrën e njerëzimit, të Dërguarin e Allahut[19], vizaton e pikturon piktura denigruese e fyese nëpërmjet konkurseve nëpër revista e gazeta[20], kur bëhen skena teatrale[21] e krijohen edhe filma për njollosjen e një personaliteti apo nënçmimin e një feje[22]...etj,.në këto raste liria e fjalës nuk vjen në shprehje, ngase ajo qëllimshëm po krijon urrejtje dhe nënçmim me parandjenja të qëllimshme, si dhe diskriminim ndaj figurave të njohura apo ndaj një feje të caktuar. Në këso raste, legjislacioni islam ka mbyllur dyert fjalës së lirë ngase dëmi është jashtëzakonisht i madh,

[16] Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 3781; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 4001; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 2100. Hadithi është autentik.
[17] Muslimi në Sahihun e tij, nr. 82; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1849; Daremiu në Sunenin e tij, nr. 2810. Hadithi është autentik.
[18] Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 28-29.
[19] Si fjalimi fyes i Papës ndaj të Dërguarit Muhamed.
[20] Siç kishin bërë danezët në gazetën e njohur 'Jyllands Posten' ku më 30 shtator të vitit 2005 kishin botuar 12 karikatura satirike të Profetit Muhamed, me titull 'Fytyrat e Muhamedit', piktura të cilat ishin vizatuar nga piktorë dhe artistë të ndryshëm, ngase gazeta kishte shpallur konkurs për këtë.
[21] Si ajo e vitit 2000 në Roterdam të Holandës me emrin 'Aishja dhe gratë e Medinës' që kishte për qëllim talljen dhe nënçmimin me Aishen dhe gratë e besimtarëve, apo tjetra e vitit 2006 në Berlin të Gjermanisë me emrin 'Idomeneo'.
[22] Si rasti me regjisorin Theo Van Gogh dhe filmi fyes i tij 'Submission', në të cilin kishte akuzuar femrën myslimane në veçanti dhe islamin në përgjithësi. Apo rasti i Geert Wilders ku në filmin dhe deklaratat e tij Islamin e quan religjion fashist, ndërsa Kur'anin e krahason me librin 'Mein Kampf' të Adolf Hitlerit.

më i madh se dobia (nëse ka dobi), e në legjislacionin islam nuk shkelet shoqëria për individ. Me fjalë tjera, legjislacioni islam ka ndaluar fjalën e lirë që shpie në armiqësi, keqpërdorim dhe që krijon urrejtje e ndasi.

Ndaj kësaj lirie në fjalë e shprehje, Ligjvënësi e dërgoi të Dërguarin e Tij që ta proklamojë metodologjinë e fjalës dhe shprehjes së lirë. Ai u dërgua që ta përmbushë misionin e caktuar, t'i ftojë njerëzit në besim, të bëjë polemika me politeistët, përgënjeshtruesit dhe femohuesit:

خُذِ ٱلۡعَفۡوَ وَأۡمُرۡ بِٱلۡعُرۡفِ وَأَعۡرِضۡ عَنِ ٱلۡجَٰهِلِينَ ﴿١٩٩﴾

***"Ti** (Muhammed) **merre të lehtën, urdhëro për mirë dhe hiqu prej të padijshmëve."**[23]*

Por, ligjvënësi ia kufizoi lirinë e fjalës, ia përshkroi rrugën e thirrjes, duke ia sqaruar edhe metodologjinë e fjalës dhe debatit:

ٱدۡعُ إِلَىٰ سَبِيلِ رَبِّكَ بِٱلۡحِكۡمَةِ وَٱلۡمَوۡعِظَةِ ٱلۡحَسَنَةِ ۖ وَجَٰدِلۡهُم بِٱلَّتِي هِيَ أَحۡسَنُ ۚ
إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعۡلَمُ بِمَن ضَلَّ عَن سَبِيلِهِۦ ۖ وَهُوَ أَعۡلَمُ بِٱلۡمُهۡتَدِينَ ﴿١٢٥﴾

***"Ti** (Muhammed) **thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata** (kundërshtarët) **me atë mënyrë që është më e mira."**[24]* Ia bëri obligim që në thirrjen e tij të mbështetet në urtësi, këshillë dhe polemikë të matur e të mirë, të mos përdorë fjalë e shprehje të rënda, të mos i shajë ata që besojnë idhuj:

وَلَا تَسُبُّواْ ٱلَّذِينَ يَدۡعُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ فَيَسُبُّواْ ٱللَّهَ عَدۡوَۢا بِغَيۡرِ عِلۡمٖۗ … ﴿١٠٨﴾

***"Ju mos ua shani ata** (zota) **që u luten** (idhujtarët), **pos Allahut, e** (si hakmarrje) **të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)..."**[25]*

[23] Kur'ani, Araf: 199.
[24] Kur'ani, Nahl: 125.
[25] Kur'ani, Enam: 108.

Ai ka sqaruar se kur lejohet të nxjerren fjalët e këqija, e që janë rastet kur në shesh del padrejtësia:

۞ لَّا يُحِبُّ ٱللَّهُ ٱلۡجَهۡرَ بِٱلسُّوٓءِ مِنَ ٱلۡقَوۡلِ إِلَّا مَن ظُلِمَۚ ... ﴿١٤٨﴾

"Allahu nuk do publikimin e shprehjeve të këqia përveç** (publikimit) **të atij që i është bërë e padrejtë..."[26]

Kështu legjislacioni islam vizatoi skicën se si duhet të jetë liria e fjalës dhe shprehjes, madje kjo liri e fjalës dhe shprehjes erdhi atëherë kur njerëzit nuk mendonin atë që e thoshin, madje besimtarët e parë trajtoheshin në mënyrë të tmerrshme, ata dënoheshin e persekutoheshin në mënyra barbare, por prapë duronin e nuk dilnin jashtë suazave të legjislacionit islam.

Liria e fjalës dhe shprehjes nuk duhet të jetë në suaza të shfrenimit dhe jashtë kontrollit, por ajo duhet të jetë e mbikëqyrur, duke mos cënuar të drejtat e të tjerëve, ngase liria e fjalës duhet të vlejë deri aty ku nuk cenohen interesat dhe të drejtat e askujt, e në momentin kur cënohet e drejta e dikujt, asaj më s'i thuhet liri e fjalës.

Ky legjislacion u priu legjislacioneve laike, së paku për njëmbëdhjetë shekuj, ngase këtë të drejtë evropianët e fituan vetëm në fund të shekullit të 18-të, ngase deri atëherë nuk e njihnin të drejtën e fjalës së lirë, përkundrazi i dënonin ashpër gjithë ata mendimtarë që kundërshtonin besimin që e ndiqnin dhe praktikonin udhëheqësia.[27]

Parimi i katërt: E drejta e konsultimit

Legjislacioni islam miratoi të drejtën e konsultimit si parim mjaft të rëndësishëm dhe koncept të vlerës. Ligjvënësi me tekste të qarta urdhëroi konsultimin para çështjeve madhore e të rëndësishme:

... وَأَمۡرُهُمۡ شُورَىٰ بَيۡنَهُمۡ ... ﴿٣٨﴾

[26] Kur'ani, Nisa: 148.
[27] Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 31.

"…dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta…"[28]

Po ashtu thotë:

... وَشَاوِرۡهُمۡ فِي ٱلۡأَمۡرِۖ ... ﴿١٥٩﴾

"…e konsultohu me ta në të gjitha çështjet…"[29]

Me këto dy tekste të qarta nënkuptohet se parimi i konsultimit është i përgjithshëm në të gjitha çështjet, ku edhe parisë nuk i lihet e drejta të veprojë sipas mendimeve e tekeve të tyre personale pa pasur në konsideratë konsultimin me të tjerët, për çështje të ndryshme.

Përveç kësaj, legjislacioni islam ka sjellë edhe shembuj të gjeneratave të hershme për konsultimin, në çështje të rëndësishme. Le të sjellim rastin e mbretëreshës Belkizë, kur asaj i arriti letra e të dërguarit Sulejman:

قَالَتۡ يَٰٓأَيُّهَا ٱلۡمَلَؤُاْ أَفۡتُونِي فِيٓ أَمۡرِي مَا كُنتُ قَاطِعَةً أَمۡرًا حَتَّىٰ تَشۡهَدُونِ ﴿٣٢﴾

"Ajo tha: "O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timen se unë nuk do të vendosë asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!"[30]

Paria e saj ishin njerëzit e zgjedhur të saj, megjithëse ishte mbretëreshë dhe kishte mundësinë e vendosjes pa u konsultuar fare, ajo çështjen e hodhi në konsultim për të marrë mendimin dhe këshillën e parisë së saj, edhe pse mendimi i tyre ishte jo i duhur:

قَالُواْ نَحۡنُ أُوْلُواْ قُوَّةٖ وَأُوْلُواْ بَأۡسٖ شَدِيدٖ وَٱلۡأَمۡرُ إِلَيۡكِ فَٱنظُرِي مَاذَا تَأۡمُرِينَ ﴿٣٣﴾

"Ata** (paria) **i thanë: "Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh!"[31] Ata nuk i dhanë asaj një konsultim, por e nxitën edhe më tepër që të përgatitet për luftë, duke ia sqaruar asaj fuqinë e tyre ushtarake, megjithëse kjo çështje nuk i mungonte Belkizes që ata t'ia rikujtonin

[28] Kur'ani, Shura: 38.
[29] Kur'ani, Ali Imran: 159.
[30] Kur'ani, Neml: 32.
[31] Kur'ani, Neml: 33.

asaj.[32] Mençuria e saj ishte më e madhe se e parisë së saj, ajo në vend të luftës zgjodhi paqen duke argumentuar:

قَالَتۡ إِنَّ ٱلۡمُلُوكَ إِذَا دَخَلُواْ قَرۡيَةً أَفۡسَدُوهَا وَجَعَلُوٓاْ أَعِزَّةَ أَهۡلِهَآ أَذِلَّةٗۚ وَكَذَٰلِكَ يَفۡعَلُونَ ٣٤

"Ajo tha: "Kur sunduesit e pushtojnë ndonjë vend, ata e rrënojnë atë, ndërkaq parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu veprojnë ata!"[33] Ajo kishte urtësi, mençuri dhe politikë largpamëse.

Edhe Faraoni, prishësi i rendit dhe drejtësisë, dikur u konsultua me parinë e vet për çështjen e Musait:

قَالَ لِلۡمَلَإِ حَوۡلَهُۥٓ إِنَّ هَٰذَا لَسَٰحِرٌ عَلِيمٞ ٣٤ يُرِيدُ أَن يُخۡرِجَكُم مِّنۡ أَرۡضِكُم بِسِحۡرِهِۦ فَمَاذَا تَأۡمُرُونَ ٣٥

"*(Faraoni)* ***Parisë që e rrethonin, u tha: "Vërtet, ky qenka magjistar shumë i aftë! Që me magjinë e vet dëshiron t'ju dëbojë nga toka juaj, e ç'më propozoni mua?"***[34]

Me fjalë kërkonte propozimet e tyre në çështjen e Musait, por ajo që duhet theksuar këtu është konsulta e kërkuar e tij erdhi në kohën më të vështirë, kur udhëheqësi e kishte humbur fuqinë e vet, ndaj u detyrua në këtë situatë të kërkojë propozime.[35] Faraoni ishte i kundërt me Belkizen, ajo që në fillim shqyrtoi propozimet në bazë të konsultave, e ky në fund kur nuk mbeti opsion tjetër alternativ.

Legjislacioni islam ka vendosur rregulla edhe në çështjet e konsultimit, duke marrë për bazë mendimin e shumicës, por duke pasur respekt e konsideratë edhe ndaj mendimit të pakicës. I Dërguari i Allahut

[32] Muhamed ibn Shakir Esh-Sherif, *Hakikatu-sh Shura Bejn-l Itbai' ve-l Id-diai*, Revista Bejan, nr. 217, fq. 4.
[33] Kur'ani, Neml: 34.
[34] Kur'ani, Shuara: 34-35.
[35] Muhamed ibn Shakir Esh-Sherif, *Hakikatu-sh Shura Bejn-l Itbai' ve-l Id-diai*, Revista Bejan, nr. 217, fq. 4.

fuqizoi këtë rregull parimor dhe punoi sipas tij gjatë gjithë jetës së tij, e më pas shembullin e tij e ndoqën edhe shokët besnikë të tij. I Dërguari i Allahut kur kuptoi se Kurejshët ishin përgatitur për betejën e Uhudit dhe se ata ia kishin mësyrë Medines, duke iu afruar kodrës Uhud, mblodhi shokët e tij dhe u konsultua me ta se çfarë të bënte, a t'iu dilte atyre apo të qëndronte në Medine? Mendimi i tij personal ishte të mos dilte ai dhe shokët e tij, por të qëndronin në Medine, në fortifikatat e saj, e kur të vinin kurejshët, atëherë këta të luftonin me ta, e gratë e besimtarëve të luftojnë nga çatitë e shtëpive, këtë mendim e mbështeti Abdullah ibn Ubejje dhe disa shokë të tij, mirëpo shumica e shokëve të të Dërguarit të Allahut dhanë mendimin dhe ngulën këmbë në të, që të dilnin jashtë Medines. I Dërguari i Allahut qe i pari ai që pranoi mendimin e shumicës duke e bërë atë mendim të zbatueshëm dhe realizues.[36]

Edhe shokët e tij punuan sipas traditës profetike, e këtë e dëshmon më së miri ngjarja e renegimit të njerëzve pas vdekjes së Profetit, ku mendimi i shumicës ishte që të mos luftoheshin ata, e në vend të luftës t'iu ofrohej atyre paqe, mirëpo mendimi i pakicës ku bënte pjesë edhe prijësi i myslimanëve, Ebu Bekri, ishte që t'i luftojnë ata dhe të mos i tolerojnë. Pas një polemike të gjatë e të qetë, erdhën në përfundim se mendimi i pakicës kësaj radhe ishte më i mirë dhe më i drejtë, ndaj ata u bindën, e kur ai mendim u vu në zbatim, kundërshtarët e dikurshëm ishin të parët që e zbatuan.[37]

Ky parim në legjislacionin islam zë vend të rëndësishëm e meritor, i cili është praktikuar që nga koha kur legjislacioni islam shtriu rrezet e tij ndriçuese në Gadishullin Arabik, kur vendet tjera sundoheshin nga sistemi diktatorial, i cili ishte në praktikë deri në shekujt e fundit, ku masës së gjerë i mbyllej gjuha, e nuk guxonte të shprehej lirshëm e lëre më të vinte në shprehje konsultimi. Mirëpo, as sistemi i ri e

[36] Ebu Amr Jusuf ibn Abdullah En-Nemrij El-Kurtubij, *Ed-Durer fi Ihtisari-l Megazi ves-Sijer*, bot.I-rë, Vizaretu-l Evkaf el-Misrijetu, Kajro-Egjipt, 1415h-1995m, fq. 154: Ebu-l Kasim Abdurrahman ibn Abdullah ibn Ahmed Suhejli, *Err-Rrevdu-l Unuf*, vëll. III, fq. 245; Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 33.
[37] Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 33.

aktual, ai demokratik nuk është i përsosur, edhe ky ka mangësitë dhe dobësitë e veta. Në sistemin demokratik konsultimi dhe zbatimi i mendimit janë dy çështje krejtësisht të ndryshme, mund të konsultohet dhe ka liri konsultimi por zbatimi varet vetëm nga shumica, pakica sado që e drejta të jetë e tyre, në fund fjalën kryesore e ka shumica.

Në miratimin e parimit të konsultimit, legjislacioni islam u ka paraprirë legjislacioneve tjera për së paku dhjetë shekuj, ngase deri në shekullin e 17-të nuk ishte njohur parimi i konsultimit, në atë shekull ligji anglez njohu parimin e konsultimit[38], ndërsa në gjysmën e shekullit të 18-të ligji i Shteteve të Bashkuara të Amerikës[39], miratoi parimin e konsultimit, përderisa ligji francez e miratoi parimin e konsultimit në fund të shekullit 18-të[40], me revolucionin francez, thënë ndryshe ky parim erdhi pas luftërave të gjata për të drejtat e njeriut.

Parimi i pestë: Drejtësia

Një prej parimeve bazike të këtij legjislacioni është drejtësia, ku gjithë njerëzit i trajton të barabartë, duke mos bërë dallime mes tyre, por që aplikon një drejtësi të mbështetur në parimet e një sistemi, ku aplikohet dhe mbrohet rendi e siguria si dhe ofrohet gjykimi real e i drejtë ndaj gjithë shoqërisë, pa marrë parasysh shtresat e njerëzve dhe pozitat e tyre. Ligjvënësi lidhur me këtë drejtësi porosit duke thënë:

۞ إِنَّ ٱللَّهَ يَأۡمُرُكُمۡ أَن تُؤَدُّواْ ٱلۡأَمَٰنَٰتِ إِلَىٰٓ أَهۡلِهَا وَإِذَا حَكَمۡتُم بَيۡنَ ٱلنَّاسِ أَن تَحۡكُمُواْ بِٱلۡعَدۡلِۚ إِنَّ ٱللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُم بِهِۦٓۗ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ سَمِيعَۢا بَصِيرٗا ﴿٥٨﴾

"Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni."[41]

[38] Me Ligjin për të drejtat (Bill of Rights) të vitit 1689.
[39] Është fjala për Deklaratën për pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të vitit 1776.
[40] Më saktësisht në vitin 1789 me Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit.
[41] Kur'ani, Nisa: 58.

Ky ajet apo këto fjalë zbritën ditën e çlirimit të Mekes, kur Othman ibn Talha[42] kishte mbyllur dyert e Qabesë dhe kishte marrë çelësin. I Dërguari i Allahut kërkoi çelësin e Qabesë prej tij, por ai refuzoi. Ndërkohë Aliu rrëmbeu fuqishëm çelësin nga dora e tij dhe shkoi e çeli derën e Qabesë. I Dërguari i Allahut hyri brenda dhe fali dy reqate namaz, e kur doli nga Qabeja, Abbasi kërkoi prej tij që t'ia jepte çelësin që ai ta barte atë, mirëpo Allahu i Madhëruar zbriti fjalët e mësipërme, ndaj i Dërguari i Allahut e urdhëroi Aliun që t'ia kthente çelësin Othmanit dhe t'i kërkonte falje atij. Aliu shkoi te Othmani dhe i tha: "Merre çelësin, le të mbetet përjetësisht me ty." Kjo e çuditi tepër Othmanin, ndaj i tha Aliut: "Me forcë e more atë e pastaj erdhe me butësi?" Aliu ia ktheu: "Allahu i Madhëruar zbriti Kur'an për çështjen tënde", pastaj ia lexoi ajetin e zbritur:

۞ إِنَّ ٱللَّهَ يَأۡمُرُكُمۡ أَن تُؤَدُّواْ ٱلۡأَمَٰنَٰتِ إِلَىٰٓ أَهۡلِهَا وَإِذَا حَكَمۡتُم بَيۡنَ ٱلنَّاسِ أَن تَحۡكُمُواْ بِٱلۡعَدۡلِۚ إِنَّ ٱللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُم بِهِۦٓۗ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ سَمِيعَۢا بَصِيرٗا ﴿٥٨﴾

"Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni."[43]

Fjalët e fundit e mahnitën Othmanin, e ky i fundit kuptoi se kjo fe është e vërtetë, ndaj menjëherë e pranoi islamin duke thënë fjalët "dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij". Xhibrili kishte zbritur dhe e kishte informuar të Dërguarin e Allahut se çelësi i Qabesë do të mbetet përjetësisht te pasardhësit e Othmanit. Pas vdekjes së Othmanit, çelësi iu dorëzua vëllait të tij, Shejbes, e kështu mbeti deri në ditët tona, madje do të mbetet deri në fund të kohës.[44]

[42] Ishte jomysliman deri në këtë kohë. Tradicionalisht familja e tij kishin bartur qelësin e Qabesë.
[43] Kur'ani, Nisa: 58.
[44] Zuhejli, Vehebeh, *Et-Tefsiru-l Munir fi-l Akideti vesh-Sheriati ve-l Menhexh*, bot.II-të, Daru-l Fikr el-Muasir, Damask-Siri, 1418h, vëll. V, fq. 121. Ibni Kethiri sjell ngjarjen më të detajizuar, me ca ndryshime të vogla. Shih: Ibni Kethir, Ebu-l Fida Ismail, Tefsiru-l Kur'anu-l Adhim, bot.I-rë, El-Meketebu-th Thekafij, Kairo-Egjipt, 2001m, vëll. I, fq. 504-505.

Burimi i drejtësisë në legjislacionin islam nënkupton arsyen dhe urtësinë, e cila ka për qëllim që t'i mundësohet njeriut ta fitojë drejtësinë e tij në rrugën më të afërt dhe më të lehtë.

Ligjvënësi urdhroi që të jemi të drejtë, duke dëshmuar për drejtësinë në të gjitha çështjet, Ai ka thënë:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ كُونُوا۟ قَوَّٰمِينَ لِلَّهِ شُهَدَآءَ بِٱلْقِسْطِ ۖ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَـَٔانُ قَوْمٍ عَلَىٰٓ أَلَّا تَعْدِلُوا۟ ۚ ٱعْدِلُوا۟ هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ ۖ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ خَبِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٨﴾

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni."[45]

Madje ka urdhëruar dhe porositur që të jemi të drejtë edhe ndaj interesave personale apo ndaj familjes dhe të të afërmve:

۞ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ كُونُوا۟ قَوَّٰمِينَ بِٱلْقِسْطِ شُهَدَآءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰٓ أَنفُسِكُمْ أَوِ ٱلْوَٰلِدَيْنِ وَٱلْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَٱللَّهُ أَوْلَىٰ بِهِمَا ۖ فَلَا تَتَّبِعُوا۟ ٱلْهَوَىٰٓ أَن تَعْدِلُوا۟ ۚ وَإِن تَلْوُۥٓا۟ أَوْ تُعْرِضُوا۟ فَإِنَّ ٱللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١٣٥﴾

"O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër *(interesit)* ***vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të të afërmve, le të jetë ai*** *(për të cilin dëshmohet)* ***pasanik ose varfnjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, Allahu hollësisht di se çka punoni."***[46]

[45] Kur'ani, Maide: 8.
[46] Kur'ani, Nisa: 135.

Kolosi i komentimit të Kur'anit, Ibni Kethiri, në komentin e ajetit të mësipërm thotë: "Allahu i Madhëruar ka urdhëruar robërit e Tij besimtarë që të jenë dëshmues ndaj drejtësisë, të mos anojnë djathtas as majtas kur në pyetje është drejtësia, të mos ia kenë frikën askujt dhe të mos i largojë askush nga ajo, si dhe të jenë ndihmues dhe kooperues ndaj njëri-tjetrit vetëm për hir të Allahut, e kjo do të ishte drejtësi e vërtetë, e distancuar nga ndryshimi, ndërrimi apo fshehja."[47]

Drejtësia në legjislacionin islam nuk është e ndikuar nga dashuria apo urrejtja e ndokujt, nuk ka dallim mes myslimanëve dhe jomyslimanëve, sikurse që nuk bën dallim mes familjeve fisnike dhe jo-fisnike. Urdhri për drejtësi është i përgjithshëm dhe i prerë. Në hadithin kudsij thuhet: ***"O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar dhunën Vetes Sime, por edhe ndaj jush e kam bërë të ndaluar, ndaj mos bëni padrejtësi..."***[48]

Ndërsa i Dërguari i Allahut kishte thënë: *"Të drejtët do të ringjallen në ditën e kiametit në minbere prej nurit (dritës) në anën e djathtë të Mëshiruesit. Ata ishin ata të cilët vepruan me drejtësi ndaj vetes, familjes së tyre dhe ndaj atyre që i kishin në sundim."*[49]

Parimi i gjashtë: Barazia

Prej parimeve të legjislacionit islam është edhe barazia, që trajton gjithë njerëzit të barabartë para Krijuesit, duke mos dalluar zotërinë para robit, as gjykatësin nga i gjykuari, por trajtim i njëllojtë, ndërkaq lidhur me këtë ka proklamuar:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ ٱتَّقُوا۟ رَبَّكُمُ ٱلَّذِى خَلَقَكُم مِّن نَّفْسٍ وَٰحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَآءً ۚ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ٱلَّذِى تَسَآءَلُونَ بِهِۦ وَٱلْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴿١﴾

[47] Ibni Kethir, Ebu-l Fida Ismail, Tefsiru-l Kur'anu-l Adhim, vëll. I, fq. 554.
[48] Pjesë nga hadithi i gjatë. Muslimi në Sahihun e tij, nr. 4674.
[49] Ibni Hibbani në Sahihun e tij, nr. 4561.

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje** (njeriu) **dhe nga ajo krijoi palën** (shoqën) **e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin** (akraballëkun), **se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”[50]

Ia rikujton njeriut, se gjeneza e tij është nga dy njerëzit e parë, prej të cilëve u shtua njerëzimi, me fjalë tjera janë gjithë të barabartë, duke mos bërë dallime mes njerëzve, pa marrë parasysh ndarjen e njerëzve në fise, popuj e shtete. I Madhërishmi thotë:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ إِنَّا خَلَقۡنَٰكُم مِّن ذَكَرٖ وَأُنثَىٰ وَجَعَلۡنَٰكُمۡ شُعُوبٗا وَقَبَآئِلَ لِتَعَارَفُوٓاْۚ إِنَّ أَكۡرَمَكُمۡ عِندَ ٱللَّهِ أَتۡقَىٰكُمۡۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٞ ﴿١٣﴾

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur** (këqijat), **e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”[51]

I Dërguari i Allahut ka thënë: *“O ju njerëz! Me të vërtetë, Zoti juaj është një, po ashtu edhe babai juaj është një. Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit, as i kuqi ndaj të ziut, sikurse as i ziu ndaj të kuqit, përveçse me devotshmëri.”*[52]

Pra, të gjithë janë të barabartë, pa marrë parasysh vendin, statusin apo reputacionin e tyre, madje as që vihet në konsiderim shtresa apo grupi shoqëror që ata i takojnë, ngase legjislacioni islam nuk njeh segregacione klasore, shtresë dominuese apo popull i zgjedhur, siç pandehin disa[53].

Vlera e njerëzve është e njëjtë. Edhe arabi edhe joarabi, edhe i bardhi edhe i ziu, edhe gjykatësi edhe i padituri, edhe pasaniku edhe i

[50] Kur’ani, Nisa: 1.
[51] Kur’ani, Huxhurat: 13.
[52] Ahmedi në Musnedin e tij, nr. 22391; Shuabul Iman, nr. 4774.
[53] Popull i zgjedhur e konsiderojnë veten çifutët, ndërsa racë e zgjedhur përveç çifutëve, pandehin edhe arianët.

varfri, edhe punëdhënësi edhe punëtori, edhe burri edhe gruaja, edhe i liri edhe robi, të gjithë këta janë njerëz. Meqë të gjithë janë njerëz, atëherë vijmë në përfundim se të gjithë janë të barabartë mu si dhëmbët e krehërit.[54]

Megjithëse legjislacioni islam ka proklamuar barazinë e njerëzve, ajo edhe është dëshmuar në raste të shumta, e sa për ilustrim do të sjell dy ngjarje që e tregojnë këtë barazi.

Rasti i parë: Një grua nga fisi Mahzum kishte vjedhur diçka, ndaj fisi i saj autoritativ deshën që ta dërgojnë dikë për të ndërmjetësuar tek i Dërguari i Allahut për të anuluar dënimin ndaj saj për shkak të vjedhjes, dikush tha se Usame ibn Zejdi, i dashuri i të Dërguarit të Allahut duhet t’i flasë atij për këtë çështje. Usameja i foli atij, por i Dërguari i Allahut ia ktheu: *“A po ndërmjetëson për (ta penguar) një dispozitë prej dispozitave të Allahut?”* Më pas u ngrit dhe ligjëroi, e nga ato fjalë ishin edhe këto: *“Ata që ishin para jush u shkatërruan, ngase kur vidhte një person nga shtresa e lartë e falnin, ndërsa kur vidhte një person nga shtresa e ulët e dënonin. Për Zotin, sikur Fatimja, e bija e Muhamedit, të vidhte, do t’ia kisha prerë dorën asaj.”*[55]

Rasti i dytë: Është me Omerin dhe guvernatorin e Egjiptit, Amr ibn Asin. Djali i guvernatorit e kishte rrahur një kopt[56] duke u krekosur se është “bir i fisnikëve”. Pas kësaj, kopti kishte marrë udhën prej Egjiptit dhe kishte ardhur në Medine që të ankohet kundër personit që e kishte dëmtuar dhe ta kërkojë drejtësinë. Omeri e thirri guvernatorin me djalin e vet dhe urdhëroi që ky i fundit të ndëshkohet sipas parimit të hakmarrjes, e në fund i shtoi këto fjalë që kanë bërë famë: “Prej kur i keni robëruar njerëzit, kur e dini se nënat e tyre i kanë lindur të lirë.”[57]

Kjo drejtësi në islam ka trajtuar gjithë njerëzit njësoj pa marrë parasysh racën, gjuhën, vendin dhe fenë. Islami me barazi e bëri skllavin

[54] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 104.
[55] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 3216, 3453, 3965; Muslimi në Sahihun e tij, nr. 3196, 3197; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 3802; Ibni Maxhe në Sunenin e tij, nr. 2537; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1350. Hadithi është autentik.
[56] Banor egjiptas.
[57] Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 107.

(robin) e panjohur me ngjyrë të zezë, të mirënjohur për sa të ekzistojë njerëzimi, e ai është Bilalli, që para islamit ishte një njeri i parëndësishëm e i panjohur, por në islam ai edhe pse ishte zezak, nuk pati dallime nga të tjerët.

Ndërsa për këtë barazi që folëm, e cila është rrënjosur para 14 shekujve, në kulturat dhe shoqëritë tjera ende ekziston, madje edhe në shtetet që e quajnë veten model të demokracisë, si në SHBA, ku të zezakët nuk janë trajtuar si të bardhët, madje për këtë edhe janë zhvilluar luftëra civile si ajo e vitit 1861-1865, e që prej atëherë lufta për barazi ndërmjet racave ka vazhduar për afro një shekull, gjersa pas Luftës së Dytë Botërore është përmirësuar pak, por akoma sot e kësaj dite ekziston dallimi racor.[58] Mjafton këtu të sjellim një rast: Zezakja Rosa Parks kishte refuzuar t'ia lëshonte ulësen një të bardhi, e për këtë vepër ajo edhe burgoset.[59] Apo në Afrikën e Jugut, ku raca e zezë ka qenë e ndarë dhe e veçuar nga raca e bardhë. Këtu edhe kishte lindur aparteidi, që përveç urrejtjes racore që ekzistonte, ata ishin të ndarë edhe sipas zonave, ku jetonin.[60] Të bardhët i gëzonin të gjitha privilegjet, e të zitë jetonin pa kurrfarë të drejte, madje akoma racizmi ekziston, edhe pse flitet e përflitet shumë me të drejta ndërkombëtare se ai nuk duhet të ekzistojë, por ja që rezultati na tregon se ai është akoma i fuqishëm.

---

[58] Për të zhdukur këtë dallim racor në Amerikë, rol të rëndësishëm kishin dhënë administrata e presidentëve Truman, Kenedi, Xhonson, Nikson etj.

[59] Kjo kishte ndodhur në vitin 1955. Rastet e tilla e kishin shtyrë udhëheqësin dhe priftin e njohur zezak Martin Luther King që të vë në lëvizje miliona njerëz për të kërkuar drejtësi e barazi ndërmjet zezakëve dhe të bardhëve. Është i njohur 'Marshi i Lirisë' në Uashington më 28 gusht të vitit 1963 ku masës prej më shumë se 250.000 njerëz i drejtohet Kingu me fjalimin e paharruar: "Unë kam një ëndërr (I have a dream). Që kjo më vonë u bë slogan në fushatën e presidentit me ngjyrë Barack Obama.

[60] Ligji i Hercogut që u miratua në vitin 1936 parashihte që të bëhet ndarja e territorit shtetëror sipas racave. Territori i racës me ngjyrë të zezë përfshinte tokën më të keqe e më të ligë. Përveç kësaj kanë qenë të ndaluara edhe martesat e përziera.

Ejup Haziri

PRINCIPLES OF ISLAMIC LEGISLATION

(Summary)

Islamic legislation has its principles which make it different from other legislations. The following are some of the basic principles:

First principle: The right to life

Life is a divine gift for mankind. Islamic legislation has paid special attention to this principle. According to it, only God can take it.

And certainly We! We it is Who give life, and cause death, ***and We are*** **THE HEIRS (of the heavens and the earth).**

أيوب حازيرى

مبادىء التشريع الاسلامى

(خلاصة البحث)

التشريع الاسلامى له مبادئه الخاصة التى تميزه عن بقية التشريعات و سوف نذكر هنا مبادئه الرئيسية.

المبدأ الأول: الحق في الحياة.

لا شك بان الحياة هبة من الله لمخلوق اسمه الانسان و التشريع الاسلامى اعطى أهمية قصوى لهذا المبدأ حتى اعتبر أخذها تدخلا فى تختص بالخالق سبحانه و تعالى ، و حول هذا الموضوع نرى القران الكريم بقول :

وَإِنَّا لَنَحْنُ نُحْيِۦ وَنُمِيتُ وَنَحْنُ ٱلْوَٰرِثُونَ ﴿٢٣﴾

Dr. Zaglul Nexhar

NDALIMI I MARTESËS ME IDHUJTARE

"Dhe mos i martoni idhujtaret derisa ato të besojnë"!!.
(el-Bekare: 221)

Ky tekst kur'anor, cili ka ardhur në pjesën e fundit të sures el-Bekare dhe i cili përqendrohet në një pjesë të mrekullisë legjislative në ndalimin e martesës së myslimanëve me idhujtare, si dhe ndalimin e martesës së myslimaneve me idhujtarë, ashtu siç e përcakton ky ajet i bekuar.

Prej aspekteve të mrekullisë legjislative në tekstin kur'anor

Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë thotë:

(**لا تنكحوا المشركات حتي يؤمن ولأمة مؤمنة خير من مشركة ولو أعجبتكم ولا تنكحوا المشركين حتي يؤمنوا ولعبد مؤمن خير من مشرك ولو أعجبكم أولئك يدعون إلي النار والله يدعو إلي الجنة والمغفرة بإذنه ويبين آياته للناس لعلهم يتذكرون**).(البقرة:221).

"Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtarë. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, dhe nëse kjo e fundit mund t'ju pëlqejë. Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i

fundit mund t'ju pëlqejë. Ata ju thërrasin me Zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e tij, ju thërret në Xhenet e falje *(të gjynaheve).* ***Ai ua shpjegon njerëzve Shpalljet e Veta, që të mendojnë ata".*** *(El-Bekare:221).*

Në këtë ajet kur'anor, All-llahu xh.sh. i urdhëron të gjithë meshkujt myslimanë që të mos martohen me idhujtare derisa të besojnë Zotin, që është i Vetëm, i pashoq, që nuk i ngjason asgjë, i padiskutueshëm, i pashoq dhe i pa fëmijë dhe dinjitoz nga çdo përshkrim që i bëhet madhërisë së Tij, dhe të besojë melaiket e tij, Librat e tij, pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit e kadanë e kaderin. Këto janë shtyllat e besimit.

Ajeti kur'anor e konfirmon se për çdo mysliman martesa e tij me një robëreshë besimtare (skllavja nën pronësinë e tij) është më mirë se martesa me një të lirë idhujtare, pavarësisht bukurisë, pasurisë e pushtetit të saj, si dhe tundimeve tjera që mund të shtyjnë drejt martesës me të. Për këtë, Muhamedi a.s. thotë:

1) لا تنكحوا النساء لحسنهن فعسي حسنهن أن يرديهن – ولا تنكحوهن علي أموالهن فعسي أموالهن أن تطغيهن – وانكحوهن علي الدين – فلأمة سوداء جرداء ذات دين أفضل'(ابن ماجه).

(2) تنكح المرأة لأربع: لمالها – ولحسبها – ولجمالها – ولدينها – فاظفر بذات الدين تربت يداك'(البخاري ومسلم).

(3) الدنيا متاع وخير متاع الدنيا المرأة الصالحة'(مسلم).

(4) إذا أتاكم من ترضون دينه وخلقه فزوجوه - إلاتفعلوا تكن فتنة في الأرض وفساد عريض'(ابن ماجه).

1. "Mos i martoni gratë për bukurinë e tyre, sepse ndoshta bukuria e tyre i shkatërron ato. Mos i martoni për shkak të pasurisë së tyre, sepse pasuria mund ......
   Martohuni me ato të cilat janë me fe, edhe në qoftë se është robëreshë e zezë e shterpë, por është fetare është më mirë për ju (Ibnu Maxhe).

2. “Martohet vajza për katër gjëra: për pasurinë e saj, trashëgiminë e saj, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj, zgjedh atë që është me fe”, (Buhariu dhe Muslimi).
3. “Dynjaja është kënaqësi,dhe kënaqësia më e mirë është një grua e devotshme”, (Muslimi).
4. “Në qoftë se ju propozon ndonjëri me fe dhe moral martojeni, dhe në qoftë se nuk pranoni do te jetë fitne në tokë dhe shkatërrim i madh” (Ibnu Maxhe).

Nga ana tjetër, Allahu i madhërishëm urdhëron të gjithë myslimanët që në asnjë mënyrë të mos i martojnë idhujtarët nga gratë e tyre besimtare derisa të mos besojnë këta idhujtarë në Allahun e madhërishëm, një Zot të Vetëm, të pashoq, që nuk i përngjan askujt, që nuk ka lindur prej askujt dhe është i pastër prej të gjitha cilësive të krijesave të Tij. Të besojnë në melaqet e Tij, në librat, pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit, në kaderin si dhe hajrin dhe sherrin.

Ajeti kur’anor vërteton që martesa e myslimanes me mysliman është më mirë për të se martesa e saj me jomysliman, sa do që të jetë pasuria e jo myslimanit, autoriteti dhe pozita e tij. Dhe kjo nuk ka të bëjë me kurrfarë fanatizmi fetar, sepse Islami përkrah dhe vërteton vëllazërinë mes njerëzimit, të cilët e kanë prejardhjen nga një babë (Ademi) dhe një nënë (Havaja), por urtësia nga ky legjislacion është se lidhja martesore është lidhja më e thellë mes një mashkulli dhe një femre, sepse ajo mbështetet në ngritjen e shtyllës më të fortë dhe më të gjatë kohore, ajo ishte shtylla e besimit të vërtetë në Zotin e lartësuar, i cili bazohet në kuptimin e njeriut për misionin e tij në jetën e kësaj bote: adhurues i Zotit, adhurimin vetëm të Tij, ashtu siç ka urdhëruar Ai. Duke lënë zëvendës të Tij në tokë, kërkoi që mbizotërimi të jetë në nivelin e duhur, duke e rinovuar tokën dhe duke e zbatuar ligjin e Zotit dhe drejtësinë e Tij në të gjitha meridianet e saj. Kjo fillon pikërisht nga familja, sepse ajo është baza e shoqërisë, në qoftë se riparohet ajo riparohet i tërë populli, dhe nëse prishet familja atëherë shkatërrohet e tërë shoqëria. Sistemi i shoqërisë në Islam është bazuar në sistemin i familjes. Për këtë, ai konsideron çfarëdo marrëdhënie

mes dy gjinive jashtë kësaj kornize marrëdhënie të ndaluar në mënyrë të prerë.

Familja përmbush të gjitha nevojat e natyrës së njeriut sepse ajo i mbledh dhe i bën një nën hijen e saj zemrat dhe mendjen dhe prodhon kuptimet dhe ndjenjat. Dhe në qoftë se nuk fillon familje në bazën e fesë korrekte ky bashkim nuk ka mundësi të realizohet. Sepse jeta me natyrën e saj është mbushur me sprova dhe me vështirësi dhe në qoftë se nuk përballohet me fenë korrekte kështu që kjo marrëdhënie martesore shumë shpejt shkatërrohet nën presionet e problemeve. Dhe ky shkatërrim është nga pasojat që nuk i di askush tjetër përveç Zotit. Dhe nga kjo përgjigje e shpejtë stuhia e kaluar përballë syve të shejtanit nuk mundet që të jetë e justifikuar për një lidhje martesore edhe pse ndryshon feja mes bashkëshortëve sa do që të jenë tundimet për të realizuar atë. Përvojat e mëhershme të gjitha ato e vërtetojnë pashmangshmërinë e rënies së këtyre marrëdhënieve, pa marrë parasysh sa të motivuar për të arritur tërheqëse, të arritshme dhe e mundshme në vendin e parë. Gruaja në qoftë se nuk është në fenë e burrit të saj ajo mundohet ta ndryshojë shtëpinë e saj sipas mendimit të saj, dhe këto mendime ndikojnë në mendjen dhe në zemrat e fëmijëve të saj, gjë e cila çon familjen në shkëputje fetare, adhurimi dhe sjellje. Gjatë rritjes së fëmijëve shkaqet të cilat mund të ndodhin janë: kur ata rriten dhe fillojnë të kuptojnë ndryshojnë sjelljet e tyre, fenë e tyre dhe adhurimin e tyre dhe për këtë arsye Zoti ka thënë në ajetin kuranor: ***“Ata ju thërrasin në Zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e tij, ju thërret në Xhenet e falje*** *(të gjynaheve).* ***Ai ua shpjegon njerëzve Shpalljet e Veta, që të mendojnë ata”.*** *(el-Bekare:221).*

Miqësia e jobesimtarëve i çon myslimanët në zjarr. Qëndrimi tek urdhrat e Zotit “Ndalimi i martesës me jobesimtarët” i çon myslimanët te xheneti i Zotit dhe falja e tij. Zoti i lartësuar i qartëson arsyet e çështjeve të Tij për njerëzit, që të zgjohen nga rrënojat e pretendimet materiale, dhe të bëjnë dallimin mes të mirës dhe të keqes dhe ajo që ju nevojitet në këtë dynja dhe në dynjanë tjetër dhe se çka ju bën dëm atyre. Zoti thotë të vërtetën dhe udhëzon për shpëtim. Zoti i lartësuar ka thënë:

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, dhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë“, që do të thotë: mos u lidhni me martesën e jobesimtareve derisa të besojnë një besim të sinqertë dhe të rregullt. Qëllimi i kurorëzimit është akt martesor. Zoti i lartësuar ka thënë në ajetin kuranor:

”Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t’ju pëlqejë“.

Vërteton ndalimi i martesës e myslimanes me jobesimtarë, sa do që të jenë presionet nuk duhet të bini në atë mëkat. Shkaku i ndalesës së kurorëzimit me jobesimtar nga një besimtare është sepse burri është i pari i shtëpisë në familje, dhe në qoftë se burri jobesimtar mund të përdorë fuqi për ta fshehur fenë e gruas të tij besimtare ose ta torturojë atë për shkak të fesë së saj dhe e ndalon t’i praktikojë adhurimet e saj, ose e detyron që ta lërë fenë e saj plotësisht dhe ta kthejë atë në fenë e tij, dhe shkatërron plotësisht besimtaren në dynjanë dhe në ahiretin e saj. Veçanërisht se myslimania beson të gjithë profetët e Zotit dhe të dërguarit e tij dhe librat e tij pa asnjë dallim, dhe jobesimtarit nuk i intereson fare, kështu që fëmijët zakonisht e ndjekin babanë sa do që të jetë bindje e kotë e shkatërron babanë e tyre jetën e tyre plotësisht në këtë dynja dhe në ahiret.

Zoti i lartësuar në Kur’an thotë: ***“Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij ju thërret në xhenet e falje*** *(të gjynaheve).* ***Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e veta që të mendojnë ata”.***

Është e ditur se falja i paraprin adhuruesit për të hyr në xhenet, por në këtë ajet është paraqitur fjala “xhenet” para fjalës “falje” që të përballohet me fjalën “zjarr”, për të plotësuar kuptimin, qëllimin dhe të dallohet me lejen e Zotit.

Teksti kuranor vërteton që mosbesimi drejton për në zjarr, Allahu xh.sh., në ajetin vijues ka thënë:

”Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut *(në adhurim),* ***ka bërë gjynah të tmerrshëm”.*** *(Surja Nisa: 48).*

Ne e shohim urtësinë e këtij legjislacioni, hyjnor e madhështor, sot në kohën tonë në të cilën po jetojmë, dhe e cila lehtëson lidhjen e myslimanit me jomyslimanet dhe myslimanes me jomyslimanët nëpërmes telefonit, celularit, internetit, “facebook” nga udhëtimet jashtë apo qëndrimit në vendet e jomyslimanëve. Këtu shejtani të dy palëve mund t’ua përshkruajë mundësinë e jetesës në lidhjen martesore me gjithë ndryshimet që kanë mes tyre në aspektin e fesë dhe të adhurimit. Mund të përpiqen të dy palët duke e detyruar veten e tyre për të jetuar me këtë ndryshim për një kohë të caktuar. Pas një kohe qetësohen ndjenjat e infektuara dhe fillojnë bashkëshortet me përballimin e shpenzimeve të jetesës së vështirë. Fillon përplasja e pashmangshme me vështirësitë, të cilat të dy palët i konsideronin nën prersonin e ndjenjave të dashurisë së verbër, e cila i çoi ata deri te lidhja martesore, duke i ditur ndryshimet e thella, të cilat i ndanin ata për shkak të fesë, adhurimeve, moralit dhe sjelljeve, si dhe nga ana e ushqimeve, pijeve dhe zakoneve.

Me fillimin e prishjes së marrëdhënieve familjare, shpejt prishen ëndrrat të cilat i kishin ëndërruar për të ardhmen dhe planifikimet që i kishin bërë për të ardhmen. Shumë shpejt këto marrëdhënie të ndaluara ballafaqohen me një tragjedi vrasëse. Zakonisht në shumicën e rasteve, gruaja është viktimë, sepse tek ajo paraprin pasioni para mendjes. Fillojnë vuajtjet deri në fund të jetës në këtë dynja. Vetëm Allahu i madhërishëm e di se cili do të jetë fati i tyre në botën tjetër, nëse nuk ka pasuar pendimi dhe kthimi tek Allahu xh.sh. pas këtij vendimi i cili është marrë pa menduar fare. Tragjedia do të jetë edhe më e madhe, nëse kjo lidhje e ndaluar rezulton me martesë, atëherë fëmijët do të jenë të humbur në mënyrë të pashmangshme për shkak të ndarjes së prindërve të tyre. Ata do të vuajnë nga pasojat e përçarjes psikologjike, fetare, intelektuale dhe sjelljes së prindërve që do t’i përcjellë gjatë tërë jetës së tyre, kjo mund të jetë shkak për shkatërrimin e tyre të tërësishëm në këtë botë dhe në botën tjetër.

Këtë nuk e them pa fakte, por për këtë më kanë kontaktuar me dhjetëra të rinj myslimanë që iu ka ndodhur që të jenë njoftuar me gjysmën tjetër me jomyslimane, nëpërmes bisedave telefonike apo të internetit.

Më kanë pyetur për vazhdimin e kësaj lidhjeje që të çon deri në martesë, dhe gjithmonë i këshilloja për largimin e këtyre iluzioneve të humbura.

Disa prej tyre iu bindeshin këshillave të mia, kurse disa të tjerë i ka tërhequr dashuria e verbër dhe e kanë realizuar martesën, e cila shumë shpejt u shkatërrua dhe erdhën tek unë duke qarë për fatin e tyre të keq.

Nga ana tjetër, më ka ardhur një numër i myslimaneve, të cilat janë njoftuar me djem jomyslimanë nëpërmes internetit, ekskursioneve apo qëndrimit jashtë.

Këta djem paraqiten se kanë pranuar fenë Islame me qëllim që të plotësohet kjo martesë, e cila shumë shpejt do të shembet. Në këtë rast viktima e parë është femra e shkretë tek, e cila paraprin pasioni para mendjes dhe pasardhësit e pafajshëm, të cilët kanë ardhur si rezultat i këtyre marrëdhënieve, që ka paralajmëruar Kur’ani, nga rënia në rreziqet e tilla. Kur’ani i madhërishëm ka vendosur rregulla morale, të cilat e ruajnë rininë nga rënia në këto probleme, Allahu madhërishëm, në Kur’anin famëlartë thotë: “Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, dhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë. Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t’ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në Zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e tij, ju thërret në xhenet e falje (të gjynaheve) Ai ua shpjegon njerëzve Shpalljet e Veta, që të mendojnë ata”.

Këtu qartësohet mrekullia e legjislatives në këtë ajet të Kur’anit, dhe shpresojmë nga rinia myslimane që ta përsërisin leximin e këtij ajeti dhe të marrin shembull në të.

Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon për në rrugë të drejtë. Falënderimi i takon Zotit, Zoti i botëve dhe selami qoftë për profetin tonë

Muhamedin a.s. dhe për familjen e tij, shokët e tij dhe ata që e kanë ndjekur rrugën e tij deri në ditën e kiametit.

Përktheu nga arabishtja:
Desara Vathaj

Marrë nga gazeta: *“El-Ahram”*, Kajro, 15.06..2011

Dr. Zaglul Nexhar

FROM THE SECRETS OF THE QUR’AN

(Summary)

“And do not marry polytheistic women until they believe”. (Al-Baqarah:221)

This ayat from the noble Qur’an is part of the legislative miracle banning marriages between Muslim men and women and polytheists.

In the noble Qur’an, Allah says:

(لا تنكحوا المشركات حتي يؤمن ولأمة مؤمنة خير من مشركة ولو أعجبتكم ولا تنكحوا المشركين حتي يؤمنوا ولعبد مؤمن خير من مشرك ولو أعجبكم أولئك يدعون إلي النار والله يدعو إلي الجنة والمغفرة بإذنه ويبين آياته للناس لعلهم يتذكرون). (البقرة:221).

د.زغلول النجار

تحريم زواج المسلم من المشركة

(خلاصة البحث)

" و لا تنكحوا الممشركات حتى يؤمن "

هذا النص القرانى الذى ورد فى الجزء الاخير من سورة البقرة والذى يرتكز على الاعجاز التشريعى حول تحريم زواج المسلم من مشركة كما تحدده هذه الآية القانية: **(لا تنكحوا المشركات حتي يؤمن ولأمة مؤمنة خير من مشركة ولو أعجبتكم ولا تنكحوا المشركين حتي يؤمنوا ولعبد مؤمن خير من مشرك ولو أعجبكم أولئك يدعون إلي النار والله يدعو إلي الجنة والمغفرة بإذنه ويبين آياته للناس لعلهم يتذكرون).(البقرة:221).**

Eglantina Muçaj

XHAMITË E QYTETIT TË TIRANËS - (2)

TIRANA PAS PAVARËSISË DERI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE (1912-1944)

Tirana, që nga koha e themelimit, ka qenë shumë e lidhur me objektet fetare të kultit islam. Historiku i xhamive të Tiranës është i lidhur me predikime e ngjarje shumë të rëndësishme të fesë islame. Në xhamitë e Tiranës kanë predikuar teologë e hoxhallarë nga më të shquarit e vendit. Ato kanë zier nga pjesëmarrja e besimtarëve për të dëgjuar predikimet e Mulla Hysen Shehrit - "profesorit të profesorëve tanë", siç e kanë cilësuar atë nxënësit e medresesë së asaj kohe në fjalimet e ceremonisë mortore, të Ali efendi Derhemit, i zgjedhur nënkryetar i Komunitetit Mysliman në Kongresin e Parë të vitit 1923, të Hafiz Ibrahim Dalliut, të Sulejman Kadiut, të Haxhi Hafiz Mahmut Dashit, të Haxhi Tahir Hallullit, të Ali efendi Kazazit - hoxhallarë të dëgjuar tiranas, që kanë jetuar gjatë gjysmës së parë të shekullit të 20-të. Por populli fetar i Tiranës në xhamitë e qytetit të vet ka dëgjuar edhe predikimet e Haxhi Vehbi Dibrës, të Hafiz Ali Korçës, të Hafiz Ismet Dibrës, të Sheh Qazim Hoxhës e sa e sa të tjerëve; ka dëgjuar zërat melodikë të hafizëve që këndonin Kur'an dhe veçanërisht gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit dhe mevludeve.

Tirana në vitin 1920

Për sa i përket Tiranës para pavarësisë, bazuar te shënimet e Hafiz Ibrahim Dalliut, konstatojmë se në atë kohë Tirana ka qenë një nënprefekturë që lidhej me prefekturën e Durrësit dhe me vilajetin e Shkodrës; ajo ka pasur mbi 15.000 frymë, njëqind e sa shtëpi ortodokse brenda në qytet dhe pesë a gjashtë shtëpi katolikësh. Pjesa tjetër e të gjithë popullsisë ishte myslimane shqiptare, Ehli Sunet. Në Tiranë ka pasur 12 teqe të sektit kadiri e halveti dhe 3-4 shtëpi bektashinjsh; populli ishte i lidhur shumë pas Medresesë, ku kishte tre myderrizë (profesorë). Populli i Tiranës ka qenë shumë besimtar.[1]

Hafiz Aliu tek "Bolshevizma çkatërrimi i njerëzimit" (1925) dhe "Shtatë ëndërat e Shqipërisë" (1924), ashtu edhe Ibrahim Dalliu tek "Patriotizmi në Tiranë" e patën paralajmëruar popullin shqiptar për të këqijat e ideologjisë komuniste, por askush nuk i vuri re paralajmërimet e hoxhallarëve. Murtaja e shekullit XX përfshiu edhe Shqipërinë. Feja islame u mbulua me hi brenda një periudhe 22-vjeçare (nga 1945

[1] Për më tepër për këtë çështje shiko: Hafiz Ibrahim Dalliu. Patriotizma në Tiranë. Shtëpia botuese "Imazh", Tiranë, 1995, fq. 19-27.

deri në 1967). Në 1967, Islami dhe objektet e kultit islamik - ashtu si edhe fetë e tjera - u shpallën antiligjore dhe antiideologjike në frymën komuniste. Shqipëria u deklarua si shtet ateist.

Me shpalljen e pavarësisë, Shqipëria deklaron shkëputjen prej Perandorisë Osmane. Shumë dijetarë të njohur islamë kanë dhënë kontribut të madh patriotik dhe arsimor, ku dallohen Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Haxhi Vehbi Dibra, me përpjekjet e të cilit më pas do të formohej edhe bërthama e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Vehbiu iu përkushtua fesë me mish dhe me shpirt. Në fund të vitit 1912, pasi la detyrën e kryetarit të Senatit, ai u shpall prej Qeverisë shqiptare si kryemyfti i myslimanëve dhe kishte detyrë që të organizonte njësinë administrative për vakëfet, shkollat islame dhe xhamitë. Në 1916 u krijua Këshilli i Naltë i Sheriatit, në krye të të cilit u vendos vetë Haxhi Vehbiu. Ai u shqua për organizimin, drejtimin dhe mbarëvajtjen e Komunitetit Mysliman si dhe për krijimin e marrëdhënieve të reja me Shejhul Islamin e Stambollit, tashmë si një njësi politike autonome në rang shteti, por e njëjtë fetare-islame.

Shqipëria ishte rajoni i vetëm ballkanik, së bashku me Bosnjën, ku Islami arriti të vendosej me një bashkësi që është shumicë në krahasim me besimtarët e feve të tjera. Më 1937, myslimanët ishin 69.3% e popullsisë, sipas statistikave shqiptare, të cilat e vlerësonin numrin e tyre në rreth 720.000. Sipas një regjistrimi të bërë më 1945, nën qeverinë e re komuniste, ata përbënin 72% të popullsisë. Shtimi në përqindje mund të shpjegohet me shkëmbimin e detyrueshëm të ortodoksëve me çamët që ngelën në territoret e Greqisë.

Më 1921, bashkësia sunite shqiptare shpalli shkëputjen prej Shejhul Islamit. Zyrtarisht kjo shkëputje u krye në shkurt-mars të 1923, me rastin e Kongresit të Parë të Myslimanëve në Tiranë, duke zgjedhur si kryetar të bashkësisë kryemyftiun e deriatëhershëm, Vehbi Dibrën. Në tetor të 1923 fillon botimin revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman e titulluar “Zani i Naltë”. Në të vërehen tonet patriotike dhe atdhetare të autorëve që lanë në të shënimet dhe shkrimet e tyre.

Më 1 prill 1928, në Shqipëri hyn në fuqi kodi civil, i bazuar në modelet perëndimore të kodeve francezë, italianë, gjermanë dhe zviceranë, duke i bashkangjitur atyre disa nga normat dhe zakonet kanunore shqiptare, si dhe disa ligje egjiptiane për sa u përket tokave dhe pronave vakufore. Shteti përvetësoi statusin laik. Me këtë shumë gjyqtarë (kadinj) u hoqën nga puna dhe në fund të 1928 u përfundua kushtetuta e re monarkiste. Qysh në 1924, mbreti Zogu i kishte nxjerrë një dekret, sipas të cilit, të gjitha komunitetet fetare duhet që të pajiseshin me statutet përkatëse. Sipas dekretit, shteti duhet të kishte një kontroll të plotë mbi komunitetet fetare dhe këto të fundit nuk duhet të subvencionoheshin nga shtete të tjera jashtë territorit shqiptar.

Një vit pas dekretit, në 1925 u mblodh një kongres i dytë i myslimanëve sunitë, në të cilin u ra dakord që të plotësoheshin kërkesat e dekretit mbretëror. Një tjetër dekret po kaq polemizues ishte edhe ai për heqjen e perçeve në 1937. Gjendja vazhdoi e tensionuar deri në 1938, kur çdo gjë ra në qetësinë e përkohshme. Një vit më vonë fillon Lufta e Dytë Botërore.

Në vitin 1922 u hap rruga e re e Durrësit, rruga e vjetër kalonte nga Xhamia e Et’hem beut, futej aty ku sot fillon rruga e Kavajës dhe kthente pas godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve, në atë që sot quhet rruga “Mihal Duri”. Me hapjen e kësaj rruge u prish Xhamia e Karapicëve dhe në vend të saj u ndërtua Bashkia e Tiranës dhe lulishtja rreth saj - sot Muzeu Kombëtar. Me hapjen e Bulevardit të Madh, që shtrihet nga Universiteti i Tiranës e deri në Stacionin e Trenit, u ngushtua ndjeshëm trualli i Xhamisë së Et’hem beut, i cili ka qenë rreth 8 dynymë. Ky truall u përdor për rrugët e këtij bulevardi si dhe për ndërtimin e lulishtes te Sheshi “Skënderbej”.

Me fillimin e ndërtimit të rrugëve, ndër të parat që u zhdukën, qenë varrezat që ndodheshin pranë çdo xhamie, p.sh., mbi truallin e varrezave të Xhamisë së Vjetër dhe të Medresesë së Vjetër, u hap Rruga Mbretërore (Rruga e Barrikadave) dhe rruga “28 Nëntori”. Xhamia e Vjetër si dhe tyrbja mbi varrin e themeluesit të saj, Sulejman Pashës, u dogjën dhe u dëmtuan rëndë gjatë luftës që u zhvillua për çlirimin e qytetit (30 tetor - 17 nëntor 1944). Pas çlirimit, regjimi i kohës e rrafshoi përtokë dhe në vendin e saj u vendos më 1952 monumenti “Partizani”.

Me zgjerimin e rrugës “Xhemal pashë Zogu” - rruga e Dibrës, më 1925-ën, u prishën disa varreza të vjetra që kalonin pranë vijës së mullirit dhe që ishin prona të familjeve Horasani, Gjinali, Bega dhe u ngushtua trualli i teqesë së Toqit, që gjendej në kryqëzimin e kësaj rruge me rrugën e Saraçëve. Në vazhdim të zgjerimit të kësaj rruge mbi truallin e varrezave të Halliasit, u ndërtua më 1931, godina trekatëshe e Medresesë së Përgjithshme (sot Medreseja “Haxhi Mahmud Dashi”).

Hapja e Pazarit të Ri (sot Sheshi Avni Rustemi), që lidhte disa rrugë të qytetit, prishi varrezat që gjendeshin aty dhe i dha një pamje të re edhe Xhamisë së Kokonozit, duke e nxjerrë në pah, por pas çlirimit në truallin e saj u ndërtuan godina shumëkatëshe, dyqane, magazina, që i zënë frymën, ndërsa vetë xhamia më 1966 u shndërrua në depo, duke iu shembur edhe minarja. Në vitin 1960 u shemb Xhamia e Stërmasit. Kështu, me zgjerimin e Rrugës “28 Nëntori” në harkun e lidhjes së saj me rrugën e Barrikadave (ish-Mbretnore), në mjaft prona që mbetën në kufijtë e pronave të Xhamisë së Vjetër, të Medresesë së Vjetër, të Xhamisë së Stërmasit dhe buzë rrugëve të reja, u bënë ndërtime njëkatëshe.

XHAMITË E TIRANËS TË NDËRTUARA PAS PAVARËSISË DERI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Xhamia e Medresesë

Kompleksi i sotëm i Medresesë është përuruar më 20 dhjetor 1931 në prani të elitës së kohës. Kjo medrese e lartë u ngrit në vitin 1923 në shtëpinë e Haqim Laçit, në lagjen Sulejman Pasha, pranë xhamisë së Sulejman Pashës dhe godinës së vjetër të Komunitetit Mysliman, ku sot gjendet ish-kinemaja Partizani.

Në kuadër të nevojave të Komunitetit Mysliman, del nevoja e ngritjes së një medreseje të kohës dhe aty është edhe sot, mbi truallin e Varrezave të Halliasit.

Me vendim të regjimit komunist, kjo medrese kalon në pronë të shtetit dhe i jepet Fakultetit të Mjekësisë, degës së Stomatologjisë. Pas 32 vjetësh i rikthehet Komunitetit Mysliman dhe aty vendoset sërish medreseja[2].

[2] Tirana kryeqytet, ndryshimet urbane dhe objektet e kultit musliman, prof dr. Myzafer Kazazi, Drita Islame, numër 15, shtator 1999, fq 4.

Medreseja, në bazë të rregullores së botuar në "Zanin e Naltë", do të shërbente për të përgatitur myfti, myderrizë, vaizë, hatibë, imamë, fakihë dhe teologë në shërbim të fesë dhe të moralit islam. Sot, diploma e kësaj medreseje njihet nga shteti dhe shërben për të ndjekur studimet jo vetëm fetare, por për cilëndo degë të universitetit.

Pas ndryshimit të regjimit monist, në Tiranë është e vështirë të gjesh troje për xhami, qoftë edhe duke i blerë. Prandaj, Komuniteti Mysliman e pa të arsyeshme që ta ndërtojë këtë xhami duke përshtatur mjediset e saj. Xhamia ka një derë në rrugën "5 Maji", në anën veriore të godinës dhe pranë hyrjes është ndërtuar një minare 30 m e lartë, salla është katërkëndëshe dhe ka edhe mafilin për gratë. Kjo xhami e vogël, brenda është zbukuruar me pllaka majolike si Xhamia e Xhurës. Për shkak të xhematit të madh, edhe oborri i saj është përshtatur në ambient faljeje për xhumanë.

Xhamia e haxhi Hafiz Dashit
(e Dine Hoxhës)

Kjo xhami ndodhet në rrugën e Kavajës, në perëndim të sheshit Skënderbej. Është ndërtuar më 1933. Fillimisht është njohur me emrin Xhamia e Re dhe u ndërtua në të ashtuquajturën Mëhalla e Re në kryeqytet, në bulevardin "Musolini", më pas rruga e Kavajës. Trualli u dhurua nga Dine Hoxha, ndërsa paratë e ndërtimit i dhanë banorët e kësaj mëhalle. Punimet e kësaj xhamie u përuruan më 6 nëntor 1932 me një ceremoni të posaçme, ku merrnin pjesë edhe nxënësit e medresesë, populli i Tiranës dhe kryemyftiu i Tiranës, Muharrem Mullahi.



Photo "Zani i Naltë" 1933.

Në më pak se 9 muaj xhamia u ndërtua dhe më 30 korrik 1933 u përurua. Kjo xhami më pas u emërua nga populli xhamia e Dine Hoxhës, me të cilin njihet edhe sot. Në fotot e viteve 1930, shohim se xhamia ka pesë kupola dhe katër gjysmëkupola, të cilat në kohën e re-

gjimit komunist zhduken brenda ndërtesës. Gjatë këtij regjimi, kjo xhami u vu në shërbim të ndërmarrjes së dekorit, që zbukuronte Tiranën gjatë festave të ndryshme. Në muajin maj 1993, kjo xhami rifillon aktivitetin e vet si më parë dhe rindërtimi i saj përfundon në vitin 1996. Edhe më pas ka pasur përmirësime të ndryshme dhe hyrja kryesore e saj është në rrugën e Kavajës. Pas rihapjes mori emrin e imamit të njohur në Tiranë, H.H. Mahmud Dashi, por prapë njihet më shumë si xhamia e Dine Hoxhës.

Kjo xhami ka qenë me përmasa të vogla sepse ishte për t’i shërbyer mëhallës. Hyrja e saj ka qenë nga veriu, por pas rregullimeve të bëra në vitet e demokracisë, hyrja kaloi nga jugu. Xhamia ka pësuar disa ndryshime. Katër kupola dhe gjysmëkupola u zhdukën gjatë regjimit komunist dhe më pas kur u rindërtua mbeti me vetëm një kupolë.

Brenda ndërtesës është edhe oborri i saj. Në krahun lindor të xhamisë është shtuar një sallë faljeje me përmasa 10m me 7.65 m sepse është shtuar numri i besimtarëve. Më pas hyhet në pjesën kryesore të xhamisë, salla kryesore e faljes është katrore me brinjë 9 m dhe ka kupolën kryesore.

Në fillim të kësaj salle janë dy kolona, të cilat mbajnë edhe katin e dytë të xhamisë, pastaj edhe dy të tjera, që janë më përpara. Aktualisht kjo xhami ka edhe katin e tretë, ku falen gratë dhe një pjesë është për burrat.

Kjo xhami ka dy dyer dhe abdes’hane të ndara. Burrat futen në derën kryesore të xhamisë, djathtas, kurse në bodrum janë banjat dhe abdes’hania e tyre, e rinovuar dhe e rregulluar kohët e fundit.

Në të majtë të derës kryesore është një derë e vogël për gratë, rrugica e kësaj dere, e ndarë me kangjella nga pjesa tjetër e oborrit, të çon në një derë tjetër dhe me anë të shkallëve të jashtme gratë shkojnë në katin e tretë.

Edhe abdes’hania për gra është brenda pjesës së tyre. Ndërsa banjat e vjetra të xhamisë dhe abdes’hania e vjetër, që janë në pjesën e majtë të kësaj xhamie, pas derës së grave, përdoren tashmë nga burrat, por të ndara nga pjesa ku futen gratë. Salla e grave lart është e vogël.

TIRANA NË VITET 1945-1990

Foto e qendrës së Tiranës në vitin 1945, ku shihet xhamia e Et'hem beut e dëmtuar

Hafiz Aliu tek "Bolshevizma çkatërrimi i njerëzimit" (1925) dhe "Shtatë ëndërat e Shqipërisë" (1924), ashtu edhe Ibrahim Dalliu tek "Patriotizmi në Tiranë" e patën paralajmëruar popullin shqiptar për të këqijat e ideologjisë komuniste, por askush nuk i vuri re paralajmërimet e hoxhallarëve. Murtaja e shekullit XX përfshiu edhe Shqipërinë. Feja islame u mbulua me hi brenda një periudhe 22-vjeçare (nga 1945 deri në 1967). Në 1967, Islami dhe objektet e kultit islamik - ashtu si edhe fetë e tjera - u shpallën antiligjore dhe antiideologjike në frymën komuniste. Shqipëria u deklarua si shtet ateist.

Në kuadrin e luftës kundër besimit, objektet e kultit islam u tjetërsuan ose u prishën. Në Rrugën Ali Demi, në vendin e Xhamisë së Tetovës, u ndërtua shkolla tetëvjeçare "Kushtrimi i Lirisë", ndërsa në rrugën e "Barrikadave", në vendin e Xhamisë së Met Firës dhe të teqesë së Sheh Dyrrit, u ndërtua shkolla e mesme "Sami Frashëri". Po

kështu, në rrugën e Fortuzit - ish rruga "Asim Vokshi", pranë bashkimit të saj me rrugën

"Mine Peza", u prish Xhamia e Islam Allës dhe në vend të saj u ndërtua shkolla "Jeronim De Rada". Edhe shkolla "Kristoforidhi" në rrugën "Shyqyri Bërxolli" është ndërtuar në vendin e xhamisë dhe të teqesë së Sheh Zelës.

Me vendime të veçanta u ndërtuan pallate banimi disakatëshe dhe, duke zënë trojet e objekteve të kultit me to, u zhduk çdo mundësi për rindërtimin e objekteve të kultit. Kështu p.sh., u ndërtuan pallate në vendin e xhamisë dhe të teqes së Vathit - në rrugën "Qemal Stafa", përballë shkollës "Kongresi i Lushnjës". Në rrugën e Zajmit, dikur "Thanas Ziko", që lidh rrugën "Qemal Stafa" me "4 Dëshmorët", në truallin rreth Xhamisë së Zajmit, fillimisht u ndërtua një çerdhe ditore, ndërsa më pas në vendin e xhamisë, e të çerdhes, sigurisht në ish-truallin e xhamisë, u ndërtua një pallat pesëkatësh. Në rrugën "Hoxha Tahsin" u prish Xhamia me Teneqe dhe u ndërtua një ndërtesë katërkatëshe, ndërsa në rrugën "Budi" të njëjtin fat pësoi Xhamia e Mujës.

Në lindje të rrugës "Qemal Stafa" kanë ekzistuar "Varrezat e Bamit" dhe në hyrje xhamia e teqeja e tyre. I gjithë trualli i tyre, përfshirë varrezat, u shndërrua në shesh ndërtimi për banesa. Trualli i disa objekteve të tjera të kultit, pas shembjes së tyre, u përdor për banesa të personave privatë, si p.sh., në vendin e Xhamisë së Sheh Voglit në rrugën "Vllazën Huta", trualli i Xhamisë së Balit në rrugën "Mihal Grameno", i Xhamisë së Bërxollit në rrugën "Ali pashë Gucia" etj.

Më 1967 besimet fetare dhe institucionet e tij e ndërprenë me dhunë veprimtarinë e tyre për të filluar sërish pas lëvizjeve demokratike të vitit 1990. Lëvizja kundër institucioneve fetare e nxitur nga shteti diktatorial komunist u mbulua gjoja me një lëvizje të rinisë ateiste. U prishën 2169 objekte kulti si kisha, xhami e teqe. Atëherë u burgosën 217 klerikë për terror e disa prej tyre vdiqën nëpër burgje ose u pushkatuan. Kodi penal i vitit 1977 dënonte propagandën fetare si dhe përhapjen e liturgjisë. Sipas këtij kodi u dënuan shumë ish-klerikë, por edhe laikë.

Pavarësisht regjimit të egër komunist, shqiptarët nuk linin festë fetare pa festuar me metodat e tyre sa të lashta aq edhe moderne në kushtet e një fukarallëku të tmerrshëm të një furnizimi me listë dhe triska deri më 1990. Në këtë ilegalitet të përgjithshëm dhe frike u forcua edhe ndjenja e tolerancës fetare.

Nëse në vendet e Lindjes komuniste njihej ateizmi praktik, në Shqipëri ai ishte futur me ligj (në kushtetutë shpallej që Shqipëria është një vend ateist). Analizimi i ndalimit të fesë ka për qëllim të shohë pasojat, se si funksionoi mekanizmi i transformimit të shpirtit njerëzor, i vizionit të mendimit, pasi feja ishte “opium për popullin”.

Fenomenet e dëmtimit të objekteve të kultit islam qenë nga më të ndryshmet. Kështu, disave prej tyre iu prish minarja dhe ambientet shërbyen për një kohë relativisht të gjatë për destinacione nga më të ndryshmet; ambientet e Xhamisë së Tabakëve, pasi iu prish minarja, përdorën si vend ku banda muzikore frymore ushtronte stërvitjet e saj përgatitore, por një pjesë e truallit të saj u përdor për ndërtime pesëkatëshe. Edhe Xhamisë së Kokonozit në sheshin “Avni Rustemi” në Pazarin e Ri, iu prish minarja dhe ambientet e saj shërbyen si magazina për ndërmarrjen ushqimore, ndërsa në hyrje dhe rreth saj, sikurse e evidentuam, u ndërtuan në truallin e xhamisë dyqane artizanati, të cilat më vonë ua shitën privatëve, duke mbyllur kështu derën, ku dikur ka qenë hyrja e xhamisë, por edhe duke përvetësuar pa të drejtë pjesë të truallit të saj. Xhamia që ndodhet në rrugën e Kavajës, pasi iu prish minarja, iu dha ndërmarrjes së dekorit të qytetit dhe piktorët punonin aty duke bërë banderola që përdoreshin për ditë festash. Për rastet kur xhamitë qenë tjetërsuar, puna ka qenë më e lehtë për t’i rehabilituar ato dhe për t’i kthyer në identitet, pra si objekte kulti.

Ardhja e demokracisë dhe rihapja e xhamive

Pas viteve ’90, gradualisht në Tiranë u vunë në funksionim disa xhami, ndërmjet tyre vetëm Xhamia e Et’hem Beut ishte mirëmbajtur si muze, ndërsa të tjerat si ajo e Kokonozit, e Tabakëve dhe e Rrugës së Kavajës patën nevojë për investime të mëdha rehabilituese. Më vonë u ndërtua pothuajse në periferi të qytetit, tek “Oxhaku”, Xhamia e Xhurës, trualli i së cilës u dhurua nga familja me të njëjtin emër. Kjo xhami është bërë bashkëkohore jo vetëm për sallën e faljeve që është e bollshme, me zbukurimet e veta të brendshme, por, ç’është më e rëndësishme, sidomos me ambientet e shumta komode që ka pranë, të cilat janë ndërtuar për t’u vënë në shërbim të saj. Po kështu, është ndërtuar xhamia në bllokun e ndërtesave të Al’Maku-t, truallin e së cilës e dhuroi familja Kallçiu. Janë përshtatur në xhami disa ambiente në Medrese, që quhet Xhamia e Medresesë, që u nis vetëm për nxënësit e shkollës, të cilët aty falin 5 vaktet, por në të falen edhe shumë besimtarë e besimtare nga xhemati i lagjes ku ndodhet xhamia. Më në fund, nuk duhet harruar zgjerimin i xhamisë së Dine Hoxhës dhe të Tabakëve kapaciteti i të cilave është dyfishuar.

Xhamia e Çullhajve

Kjo xhami ndodhet në Kombinat, në rrugën Bedri Çullhaj

Kjo xhami është e vogël dhe e tipit të xhamisë së mëhallës. Ajo është ndërtuar mbi truallin e dhuruar nga familja e Çullhajve. Karakteristikë është se afër xhamisë ka shumë familje me këtë mbiemër. Xhamia ka formën e drejtkëndëshit dhe në hyrje të saj ka edhe një sallon me përmasa 11m me 4.75 metra dhe më pas sallën e faljes me përmasat 8m me 12m. Në ketë xhami mund të falen 250 veta.

Kompleksi i Xhurës

Kjo xhami ndodhet në rrugën Aleksandër Moisiu, mbi oxhakun, te pallatet parafabrikate. Kjo xhami është ndërtuar në vitin 1996.

Kjo xhami është një kompleks i ri, i ndërtuar pas ndryshimit të regjimit komunist në Shqipëri dhe gjendet në pjesën juglindore të Tiranës. Trualli është dhuruar nga Ismail Xhura, prandaj edhe xhamia mban emrin e familjes së tij. Një nga kushtet e dhurimit të tokës ishte që të ndërtohej përveç xhamisë edhe një qendër edukimi, që do t'i shërbente lagjes dhe komunitetit përreth. Nga xhamitë e reja të ndërtuara në Tiranë pas rënies së komunizmit është më e madhja dhe nuk është një xhami e thjeshtë mëhalle. Salla e faljes së bashku me mafilin e grave lejojnë që në këtë xhami të falen mbi 600 persona. Kjo është një xhami me sallë dhe me kupolë.

Hyrja e xhamisë është e vendosur në anën perëndimore të xhamisë dhe aty është një hajat i gjerë 5 m dhe i gjatë 4m, ku vendosen edhe këpucët. Pas hajatit gjenden banja dhe abdes'hania. Në të djathtë të hyrjes, brenda në hajat, është hyrja për të shkuar në sallën kryesore të faljes, që është një sallë katrore me përmasa 17 me 17m. Në cepin jugperëndimor të xhamisë gjendet minarja, rreth 27 metra e lartë. Kur hyn brenda, të bie në sy veshja me pllaka majolike, që shkon deri në 3.4 metra lartësi.

Mihrabi i zbukuruar me pllaka me kaligrafi arabe

Është e para xhami në Tiranë e veshur me pllaka majolike dhe me dekoracione dhe kaligrafi arabe, pasi më vonë e ngjashme është bërë edhe xhamia e Medresesë. Në ballë të sallës së faljes është vendi i hytbes, në të djathtë të mihrabit, në mes është mihrabi dhe në të majtë vendi ku mbahet vaza nga ligjëruesi, ndërtime të bukura të stilit osman të veshura me pllaka majolike, ku dominon tulipani, ndërsa nga ngjyrat bluja e errët me vishnje, të vendosura në sfond të bardhë. Kjo lloj pllake shkon deri në 3 metra, ndërsa më sipër në tri anë, atë të perëndimit, jugut dhe lindjes së xhamisë, fillon dhe mbaron sureja Jasin e shkruar në arabisht, e gjitha me pllaka majolike.

Në fasadën perëndimore të xhamisë fillon sureja Jasin dhe mbaron në fasadën lindore.

Te mihrabi është shkruar ajetul Kursij dhe sipër fjalët Allah dhe Muhamed. Poshtë ajetul Kursisë është shkruar në arabisht ajeti: “Dhe fytyrën tënde drejtoje nga xhamia e Qabes”, Kuran, sure Bekare, 144.

Kupola nga brenda është e bardhë dhe ka disa frëngji, që fusin dritë.

Xhamia në bllokun Al-Mak

E ndërtuar në vitin 1998, kjo xhami është e re dhe modeste. Kjo xhami është ndërtuar për nevojat e besimtarëve të asaj lagjeje. Xhamia është në bllokun e ndërtesave të firmës Al-Mak dhe truallin e dhuroi familja Kallçiu, kurse ndërtimin e bëri një fondacion bamirës islam.

Xhamia e Tufinës

Kjo xhami është në pjesën verilindore të qytetit, fare pranë komunës Dajt, pa shkuar te kthesa e varrezave të Tufinës.

Kjo xhami ka një histori ndryshe nga xhamitë e tjera. Sipas një përfaqësuesi të familjes Allushi, trualli ku është ndërtuar xhamia ka qenë pronë e familjes tiranase Beka. Në vitin 1995, një anëtare e familjes Beka, e cila kishte pjesën e vet të tokës aty, ia dhuron familjes së Allushëve për të ndërtuar xhami dhe më vonë fillon ndërtimi i xhamisë, që mbaron në vitin 2002.

Kati përdhes i objektit është servis makinash i familjes Allushi, ndërsa në katin e dytë është xhamia. Në kat të dytë pra është salla e namazit për burrat, ndërsa gratë falen në katin e tretë. Nën kulmi është menduar për klasa të mësimit të fesë.

Familja Beka edhe sot e kësaj dite ka pretendimet e veta për atë tokë dhe nuk pranon se e ka dhuruar. Sipas tyre, toka është zaptuar dhe jo dhuruar. Ky konflikt vazhdon edhe sot.

Për shkak të kësaj situate, kjo xhami nuk ka kaluar as në pronësi të Komunitetit Musliman dhe shpenzimet për të mbulohen privatisht.

Xhamia është në formë drejtkëndëshe, me përmasa afërsisht 7m me 12m dhe ka një minare që nuk i kalon 15m lartësi.

Xhamia Manallari

Kjo xhami, që ndodhet në Unazën e Re të Tiranës, është ndërtuar me kontributin kryesor të familjes Manallari, që ka dhuruar edhe truallin dhe ka financuar ndërtimin e objektit, e ndihmuar edhe nga anëtarë të tjerë të komunitetit rreth xhamisë. Xhamia është përfunduar në tetor 2007.

Xhamia gjendet në aksin e djathtë të rrugës së Unazës së Re, kur shkon nga aksi që lidh rrugën e Kombinatit Ushqimor me atë të Laprakës. Xhamia ka filluar funksionimin e saj në fund të muajit të Ramazanit, pas datës 1 tetor 2007. Planimetria e xhamisë është drejtkëndëshe me përmasa 8 m me 12 m. Xhamia ka edhe minare, ndërsa në oborrin e saj gjendet edhe abdes'hania dhe klasat për mirëbesim. Kjo xhami nuk figuron nën juridiksionin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe imamët dhe funksionarët e tjerë paguhen nga xhemati dhe donatorë.

Përfundim

Tirana, qyteti më i madh i Shqipërisë, i themeluar si qytet nga myslimanët dhe me popullsi shumicë myslimane edhe sot, ka në vetvete histori të madhe, edhe pse si qytet i banuar daton vonë. Me islamizimin e banorëve të fshatrave të qytetit, Tirana nis e merr formë si një qytet islam, me xhami të ndërtuara në pikat kyçe të qytetit gjatë gjithë historisë së saj, deri para vitit 1945, gradualisht në varësi edhe të shtimit të popullsisë islame dhe zhvillimit ekonomiko-shoqëror të qytetit.

Xhamitë u përkasin periudhave të ndryshme, duke nisur nga shekulli XVII deri në XXI, kur kemi disa xhami të reja. Këto xhami kanë pasur karakteristikat e arkitekturës osmane të kohës, por janë ndërthurur edhe me traditën vendëse, pasi mjeshtërit që i kanë ndërtuar kanë qenë shqiptarë. Edhe pse shumë prej tyre u rrënuan për shkak të ndryshimeve urbane të qytetit dhe më pas nga diktatura e egër komunisteateiste, prapëseprapë kanë mbetur elemente ose xhami të plota të cilat shërbejnë si monumente historike dhe janë trashëgimi e bukur për Tiranën. Shpirti besimtar i banorëve të Tiranës, i familjeve autoktone të saj, është dëshmuar me dhjetëra herë falë dhurimit të trojeve për ndërtimin e xhamisë dhe për financimin e tyre.

Kjo traditë e bekuar nuk është ndërprerë me kalimin e shekujve, pasi dëshmohet edhe pas ardhjes së demokracisë.

Në një kohë kur të gjithë njerëzit ishin të preokupuar si të zinin trojet e të tjerëve pa të drejtë dhe të përfitonin padrejtësisht e në mënyrë mizore duke grabitur pronën private ose shtetërore, anembanë Shqipërisë e sidomos në Tiranë, pati familje tiranase që dhuruan tokë brenda qytetit të Tiranës, edhe pse çmimi i saj ishte shumë i lartë.

Të tilla familje janë ato me mbiemrin Xhura, Manallari, Çullhaj, Beka, Kallçiu, duke treguar fisnikëri të lartë dhe përkushtim ndaj fesë së Allahut xhele shanuhu. Allahu ua pranoftë veprat dhe ua shtoftë të mirat!

Me ardhjen e demokracisë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë mori sërish në dorëzim disa xhami dhe objekte të rëndësishme islame, si Medreseja e Tiranës, ndërtesën e Komunitetit Musliman, Xhaminë e Et’hem beut, e vetmja e mbetur pa u prishur ose transformuar, pastaj atë të Dine Hoxhës, Xhaminë e Pazarit, Xhaminë e Tabakëve, ndërsa të tjerat u shembën në kohën e Zogut ose nga regjimi komunist.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka vite që kërkon t’i jepet leja për një xhami të madhe në qendër të Tiranës, mundësisht në Sheshin e Namazgjasë, por njëkohësisht t’i kthehen edhe pronat e saj të vakëfit, të cilat mbahen padrejtësisht nga shteti për interesa të caktuara ekonomike dhe politike, në një kohë kur komunitetet tjera fetare, si bektashitë, katolikët dhe ortodoksët, i kanë marrë pronat e tyre dhe madje kanë ndërtuar objekte kulti në vende ku nuk ka pasur historikisht objekte kulti të tilla. Zmadhimi i Tiranës dhe shtimi i popullsisë e bëjnë imperativ ndërtimin e disa xhamive, sidomos në zonat e populluara pas viteve 90, por edhe në zona si ajo e Tiranës së Re, e stadiumit “Selman Stermasi”, nga 21 dhjetori deri në Misto Mame, zona e stacionit të trenit etj., por duket e vështirë duke qenë se ndërtimet private kanë rrëmbyer edhe atë pak tokë që ka qenë në dispozicion.

Por Allahu është ndihmës i kësaj feje dhe e lusim Atë t’i bekojë ata që i kanë dhuruar trojet, që i kanë ndërtuar dhe që i mirëmbajnë këto xhami, trashëgimia më e bukur e kryeqytetit shqiptar.

Nga sa u tha më sipër, mund të përfundojmë se numri i xhamive të Tiranës nga themelimi deri para Luftës së Dytë Botërore kishte 22 xhami. Pas viteve ’90-të ndërtohen pesë xhami të reja. Aktualisht Tirana ka dhjetë xhami, pa Sheshin e Namazgjasë.

Për nevoja urbanistike para Luftës së Dytë Botërore janë prishur dy xhami: Xhamia e Karrapicit dhe Xhamia e Kodrës së Kuqe.

Nga Lufta e Dytë Botërore u prish Xhamia e Sulejman Pashës.

Gjatë regjimit komunist janë prishur 11 xhami: Xhamia e Zajmit, Xhamia e Firës, Xhamia e Mujos, Xhamia e Stërmasit, Xhamia e Islam agë Petrelës, Xhamia e Bërxollit, Xhamia me Teneqe, Xhamia e Bamit, Xhamia e Balit, Xhamia e Vathit dhe Xhamia e Tetovës.

U tjetërsuan gjatë regjimit monist 5 xhami: Xhamia e Tabakëve, Xhamia e Kokonozit, Xhamia e Haxhi Hafiz Dashit (e Dinë Hoxhës), Xhamia e Medresesë dhe Sheshi i Namazgjasë.

U rihapën pas demokracisë pesë xhami: Xhamia e Tabakëve, Xhamia e Kokonozit, Xhamia e Haxhi Hafiz Dashit (e Dinë Hoxhës), Xhamia e Medresesë, Xhamia e Et'hem beut. Sheshi i Namazgjasë u përdor për namazin e Bajrameve disa herë nga besimtarët dhe Komuniteti Musliman, por sot jo.

Me ardhjen e demokracisë, u ndërtuan pesë xhami të reja: Xhamia e Xhurës, Xhamia e Çullhajve, Xhamia Manallari, Xhamia e bllokut Al-Mak dhe Xhamia e Tufinës.

Xhamia e Et'hem beut është xhamia e vetme që ka shpëtuar nga periudha osmane. Në periudhën 1967-1991 nuk prishet, nuk tjetërsohet, sepse është monument kulture. Rihapet në vitin 1991.

Literatura e konsultuar:

- Aliaj, Besnik, Lulo, Keida. Myftiu, Genc. Tirana, sfida e zhvillimit urban, Tiranë, 2003.

-Basha, Ali M, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Tiranë, 2000.

-Dalliu, Hafiz Ibrahim. Patriotizma në tiranë. Tiranë, 1995.

-Historia e Tiranës, në foto të rralla, *Tirana Observer, 24 nëntor 2005.*

- Hysa, A Roald. Xhamitë e Tiranës, Roald A Hysa, Tiranë, 2008

-Hysi, Shyqyri, muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1990, monografi, Sh. B. Mësonjëtorja, Tiranë, 2006

-Kazazi, Muzafer. Drita islame. Nr. 13 (169), nr. 15 (170).

-Kazazi Myderriz, Tirana kryeqytet, ndryshimet urbane dhe objektet e kultit musliman, Drita Islame, nr 15, shtator 1999.

- Krasniqi, Nehat, Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam, version i zgjeruar i kumtesës së lexuar në simpoziumin e dytë ndërkombëtar "Kultura dhe civilizimi islam në Ballkan", Tiranë 5-7 dhjetor 2003.

- Frashëri, Kristo. Historia e Tiranës si qytet deri më 1920. Vëll. I, Tiranë, 2004.

- Frashëri, Kristo. Fillimet e historisë së Tiranës. Buletin për Shkencat Shoqërore ii, 1955.

-Kultura islame. Viti i, nr. 3-5, nëntor - mars 1942 - 1943. Viti i, nr. 11, korrik, 1943.

-Maçi, Xhavit. Drita Islame nr. 2 (157), shkurt, 1999.

-Meksi, Aleksandër. Ndërtimet e kultit musliman në Shqipëri, studimet historike, 1/1980, Instituti i Historisë.

- Meksi, Aleksandër. Arkitektura e xhamive të Shqipërisë, Uegen , Tiranë 2007.

- Michael Kiel, Ottoman Architecture in Albania 1385-1912, Istanbul, 1990.

-Myderrizi Osman. Tirana, 1604 - 1937. Botim special i bashkisë së kryeqytetit.

-Myderrizi Osman, Qyteti i Tiranës, 0604-0937, Tiranë 1998, revista "Zani i Naltë", fruer 1924, nr 5.

-"Zani i Naltë", *Tirana zbukurue me dy xhami të reja*, gusht 1933, nr. 12.

Eglantina Muçaj

TIRANA'S MOSQUES (2)

(Summary)

Tirana between the period following the declaration of independence and WWII (1912-1944)

The history of Tirana, since its foundation, was closely interrelated to Islamic religious objects. The history of Tirana's mosques is closely interrelated to very important religious events. Some of the most distinguished theologians and hodjas in Albania have preached in them. Usually, these mosques were full of people, who would come to listen to the preachings of Mulla Hysen Shehri who was considered the “teacher of teachers” by the madrassa students of the time, Ali efendi Derhem who was appointed vice-chairman of the Muslim Community in the first congress of 1923, and Hafiz Ibrahim Dalliu, Sulejman Kadiu, Haxhi Hafiz Mahmut Dashi, Haxhi Tahir Hallulli, Ali efendi Kazazi, distinguished hodjas from the second half of the XX century. The pious have also listened to the preachings of Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra, Sheh Qazim Hoxha and many others; and to the melodic voices of the hafiz, who recited the Qur'an (in particular during the holy month of Ramadan and mawlid).

أغلانتينا موتشاى

جوامع مدينة تيرانا (2)

(خلاصة البحث)

تيرانا بعد الاستقلال و حتى الحرب الالعالمية الثانية (1944–1912)

تيرانا منذ تأسيسها كانت مرتبطة رباطا وثيقا بدور العبادة للدين الاسلامى فتاريخ جوامع تيرانا يرتبط بالقاء محاضرات او باحداث مهمة من التاريخ الاسلامى . و فى جوامع تيرانا قام بالوعظ والارشاد من اثهر علماء الاسلام فى البانيا باكملها فقد اتيحت الفرصة لجماعة المسلمين ان يستمعوا الى مولى حسين شهرى "استاذ الاساتذة " كما اطلق عليه تلاميذو المدرسة فى خطاب على دى درهم الذى تم انتخابه نائبا لرئيس لمجلس الاسلامى فى المؤتمر الاول سنة 1923 بمناسبة مراسيم دفن حافظ ابراهيم دالليؤ و سليمان القاضى و الحاج حافظ محمود داشى و الحاج طاهر حالوليت و على افندى كزازى من كبار علماء تيراتا المشهورين الذين عاشوا فى النصف الاول من القرن العشرين.

و لكن لقد أتيحت الفرصة للشعب تيرانا و جوامعها ان يستمع من قبل الى علماء الرعيل الاول مثل : الحاج وهبى ديبرا و حافظ على كورتشا و حافظ عصمت ديبرا و الشيخ كاظم هوجا و اخرين غيرهم .

Mr. Qemajl Morina

HASAN EF. NAHI – STUDENT NË UNIVERSITETIN E “EL-AZ-HARIT” NË KAJRO (1930-1934)

Më shumë se një mijë vjet "El-Az-hari" është simbol drite për botën islame. Kordova, Granada, Damasku, Bagdadi, kanë qenë qendra të kulturës islame para Kajros, në zemër të së cilës është "El-Az-hari". Ato vetë e kanë shprehur këtë përparësi dhe dallim. Sot "El-Az-hari" njihet si qendër botërore e edukimit islam. "El-Az-hari" ka edukuar një numër shumë të madh të dijetarëve, të cilët me fjalët dhe veprat e tyre kanë lënë gjurmë të thella në historinë e njerëzimit. "El-Az-hari" ishte dhe mbetet simbol i urtësisë, të vërtetës, drejtësisë dhe besimit, duke u rezistuar të gjitha përpjekjeve për dhunimin e shenjtërisë së Islamit.

Studentët shqiptarë në Universitetin e “El-Az-harit”

Kjo temë është e një rëndësie të veçantë për historikun e arsimit te shqiptarët në përgjithësi dhe të atij në botën e jashtme në veçanti. Në këtë aspekt popujt tjerë përreth nesh kanë bërë disa hapa konkretë në këtë drejtim[1], për fat të keq te ne kjo temë, pothuajse është fare e paprekur. Nëse përjashtohen disa hulumtime që janë bërë lidhur me

[1] Jusuf Ramic, Bosnjaci na El-Ezharu, Sarajevo 1997.
- Trajan Petrovski , Asharovci (roman), Skopje, 1998.

prezencën e shqiptarëve në Egjipt[2], kur dihet se një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve që nga fillimi i shekullit njëzet kanë studiuar në universitetin e El-Az-harit. Me këtë rast, unë kam për qëllim vetëm të shpalos këtë temë, me shpresë se kjo çështje do të jetë preokupim i të rinjve tanë, në të ardhmen. Bile do të ishte e udhës që kjo temë, me interes kombëtar dhe fetar, të jetë objekt i një teze të magjistraturës apo doktoranturës të studentëve tanë që ndjekin studimet e tyre në “El-Az-har”. Për të qenë studimi sa më i saktë do të ishte mirë që për këtë temë të hulumtohen të dhënat që trajtojnë këtë temë në Arkivin i “El-Az-harit” dhe në Arkivin Kombëtar të Egjiptit në Kajro. Sepse vetëm në këtë mënyrë mund të nxirren të dhënat sa më të sakta bio-bibliografike të studentëve shqiptarë që kanë studiuar në Universitetin e “El-Az-harit” në periudha të ndryshme kohore.

Sipas shumë të dhënave si duket prej studentëve të parë shqiptar që studioi në El-Az-har duhet të jetë Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi. U lind dhe vdiq në Prizren. Mësimet e para i mori në vendlindje, medresenë në Stamboll, ndërsa studimet universitare në Universitetin "El-Az-har" të Kajros, gjatë viteve (1901-1905).[3]

Hasan ef. Nahi (1905-1991)

Në mesin e studentëve të gjeneratës së mëvonshme që studioi në Universitetin e “El-Az-harit” është edhe Hasan ef. Nahi nga Gjakova, i cili u bë i njohur për arsye se pas përfundimit të studimeve u kthye në Kosovë, ku dha kontributin e tij imam, vaiz dhe myderriz.

Hasan ef. Nahi u lind më 12 mars 1905, në Gjakovë, nga një familje e ngritur fetarisht dhe intelektaulisht. Mësimet fillestare si dhe

[2] Aleksander Xhuvani, Jeta e Mehmet Aliut, Tiranë, 1921.
- Dr. Muhamed Mufaku, Shqiptarët në botën arabe , Prishtinë, 1990.
- Emin Azemi e Shkëlzen Halimi , Shkup, 1993.

[3] Mark Krasniqi, Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, revista "Jeta e Re", nr. 5/1955, Prishtinë.
- Fjalori Enciklopedik shqiptar, Tiranë, 1985, fq.789.
- Hasan Hasani, Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë (1501-1990), Prishtinë, 1994, fq. 223

medresenë e kreu në vendlindje, ku edhe mori ixhazetin në Medresenë e Madhe të Gjakovës, ku jepte mësim edhe babai i tij Islam ef. Nahi.[4]

Me qëllim të zgjerimit të horizonteve të diturisë ai në vitin 1930 shkoi për të studiuar në Kajro. U regjistrua në Universitetin e El-Az-harit, ku qëndroi gjatë viteve (1930-1934), pas katër vjetëve mbaroi studimet dhe u kthye në vendlindje.

Në maj të vitit 1935 caktohet në detyrën e "sej-jar vaizit", (predikues shëtitës) e krahas saj jep mësim edhe në Medresenë e Ferizajt.

Më 1943 emërohet drejtor i Medresesë "Mehmet Pasha" në Prizren, e paralelisht me këtë emërohet edhe kryemyfti i Dukagjinit. Që nga viti 1948, kur edhe mbyllet Medreseja Mehmet Pashës deri në vitin 1958 punoi si imam në Gjakovë.

Në shtator të vitit 1958 emërohet myderriz në Medresenë "Alauddin" të Prishtinës, ku shërben dy dekada dhe pikërisht këtu dha kontributin më të çmuar në arsimimin e gjeneratave më të reja.

Hasan ef. Nahi edhe pse u pensionua në vitin 1978, iu rrek punës së përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, të cilën e përfundoi në vitin 1988. Me këtë hyri në histori edhe si përkthyes i Kur'anit në gjuhën shqipe.

Vlen të theksohet se Hasan ef. Nahi ishte prej studentëve të pakët që pasi mbaroi studimet në Kajro u kthye në vendlindjen e tij.

Hasan ef. Nahi ishte njëri prej dijetarëve të njohur, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Për fat të keq, ashtu siç është veprua me personalitete tjera edhe me të, vlera e tij u zbulua shumë vonë. Kjo më së miri shihet nga intervista e parë që "Dituria Islame" nr. 18 e muajit tetor 1990 zhvilloi me të. Kur, ai kuptoi qëllimin e vizitës së redaksisë, si në gjysmë shaka pyeti: "A mos jeni vonuar paksa?!"

Në ballinë të revistës së numrit në fjalë, Redaksia ka pas botuar diplomën e alimit, që kishte marrë në Universitetin e "El-Az-harit" në Kajro, në vitin 1934. Vlera e saj qëndronte në atë se ajo ishte marrë 56 vjet më parë, në një universitet me renome botërore, siç ishte "El-Az-hari", universitet me një traditë njëmijëvjeçare. Vlen të përmendim se

[4] Dituria islame, nr.22-23, shkurt-masr 1991, fq.14.

shumë bashkëpunëtorë dhe nëpunës të Bashkësisë Islame në atë kohë, na patën thënë se ne kemi dyshuar se ai mund të ketë marrë diplomë në "El-Az-har".

Hasan ef. Nahi, ashtu siç ishte i hapur nga vetë natyra e tij, në intervistë foli me shpirt dhe zemër të hapur. Kjo zaten ishte ndoshta edhe hera e parë që atij po i ofrohej shansi për një gjë të këtillë. Por, ai foli më pak për vete e për jetën e tij e më shumë për dijetarët e mëdhenj që Gjakova me rrethinë kishte dhënë jo vetëm Kosovës dhe Shqipërisë, por edhe Perandorisë Osmane, me emra e mbiemra dhe vendlindjet e tyre si: Ali efendiun nga Carabregu, që në literaturë njihet me mbiemrin El-Jakovi. Pastaj Haxhi Osman Morinën, Hafiz Sadriun si dhe sa e sa emra tjerë që i ka mbuluar pluhuri nëpër arkivat osmane.

Nisja për në Misir

Hasan ef. Nahi ashtu si shumica e paraardhësve të tij pas kryerjes së medresesë së Gjakovës, dëshironte që studimet e tij të mëtutjeshme t'i vijonte në Stamboll, sepse ai për pesë shekuj ishte qendër shpirtërore, arsimore dhe fetare e shqiptarëve të besimit islam. Mirëpo, me anulimin e halifatit nga ana e Kemal Ataturkut në vitin 1923 si dhe reformave tjera që ishin bërë në arsimin fetar në atë kohë, Stambolli më nuk mund të konsiderohej qendër shpirtërore e myslimanëve.

Kjo shihet edhe nga intervista e Hasan ef. Nahit, që i kishte dhënë "Diturisë Islame" dhe të dhënat që ai kishte marrë nga kushëriri i vet Ismail bej Kosova, i cili jetonte në Stamboll. Në pyetjen e tij për mundësinë e vazhdimit të studimeve në Stamboll, ishte përgjigjur shkurt: "Medresetë e vjetra janë suprimuar, ka filluar reforma shkollore".

"Zhvillimi i ngjarjeve nuk po shkonte në favor tonin. Turqia dhe Jugosllavia po shikojnë leverditë e tyre politike". Ismail beu, në vazhdim shkruante: "Shqiptarët po shpërngulen mjaft, ndaj është mirë që t'i të orientohesh diku tjetër!"

Këto të dhëna e kishin bërë Hasan ef. Nahin që ta zgjedhë Egjiptin për studime. Për Universitetin e El-Az-harit, vetëm sa kishte dëgjuar.

Këtë ide, ai ia kishte tregua edhe disa shokëve në Gjakovë. Më në fund, tre shokë vendosën të shkojnë në studime në Egjipt. Ata ishin: mulla Tahir Brovina dhe Mulla Asllani nga Cermjani. Ishin të parët nga ajo anë, që po ia mësynin Misirit".

Pas peripecive të shumta, Hasan ef. Nahi më 30 tetor 1930 arrin në Egjipt, së bashku me dy shokët e tij. Vendoset në lagjen e studentë-ve "Ravakul Atrak", ku banonin studentët e Ballkanit. Aty gjen disa studentë shqiptarë si: Abdurrahman ef. Murati nga Podujeva, Bedri ef. Hamidin nga Shkupi, Abdul ef. Muminin nga Kumanova, Kasim ef. Shefkiun nga Tirana. Përmend edhe disa studentë nga Bosnja si: Mehmet Hanxhiqin, Besim Korkutin, Kasim Dobraqen etj.

Numri i shqiptarëve në Egjipt ishte shumë i madh, sepse dinastia shqiptare e Mehmet Ali Pashës ishte në sundim. Në ato vite në fron ishte mbreti Fuad, i cili ishte dashamirës i madh i arsimit, kishte themeluar Universitetin e Kajros, që metoda e mësimit ishte sipas standardeve evropiane dhe ekzistonte një lloj konkurrence me Universitetin e "El-Az-harit".

Hasan ef. Nahi me njohuritë e tij që kishte arritur në medresenë e madhe të Gjakovës nuk gjen vështirësi për t'u regjistruar siç e përshkruan në degën e teologjisë "Al-Kismul-Ali", (departamentin e latë) ku regjistroheshin studentët që kishin mbaruar shkollën e mesme të "El-Az-harit". Meqenëse tregoi aftësi, fakultetin e mbaroi në afat rekord, brenda katër vjetëve. U diplomua më 12 prill 2934. Për katër vjet asnjëherë nuk kishte shkuar në Kosovë.

Përveç që ishte dalluar në mësime studime, ai ishte marrë edhe me shkrime, punimet e tij i kishte publikuar në revistën e "El-Az-harit" si dhe revistën e njohur të asaj kohe "Livaul Islam" (Flamuri i Islamit).

Hasan ef. Nahi ishte aktiv edhe në jetën kulturore dhe shoqërore të kolonisë shqiptare që vepronte në ato vite në Egjipt. Lidhur me këtë për alimin tonë flet Qerim Haxhiu, bashkëkohanik dhe hallka e fundit e studentëve shqiptarë që studiuan në "El-Az-har"nga gjenerata në

mes dy luftërave botërore, si dhe doajeni i fundit i kolonisë shqiptare të Misirit[5]..

Në kohën kur Hasan ef. Nahi po studionte në "El-Az-har", në Universitetin e Kajros në Fakultetin e Filologjisë po punonte si pedagog, poeti më i njohur i Turqisë me prejardhje shqiptare, autor i tekstit të himnit kombëtar turk, "Marshi i pavarësisë", Mehmet Akif Arsoi. Ata takoheshin rregullisht për çdo javë me intelektualë tjerë egjiptianë për të diskutuar për çështje, të cilat po e preokuponin inteligjencën islame të asaj kohe. Kështu në mesin e shumë librave në bibliotekën e Hasan ef. Nahit gjendet edhe botimi i parë i përmbledhjeve të poezive "Safahat" (Rrjedhat) që Mehmet Akifi ia kishte dhuruar alimit dhe myderrizit tanë të nderuar.

Ajo që dallon Hasan ef. Nahin nga shumë bashkëkohanikë tjerë të tij, që studiuan në "El-Az-har" është ndjenja dhe lidhja e tij e fuqishme me atdheun dhe popullin e tij. Me gjithë krajatat dhe peripecitë e shumta me të cilat u ballafaqua pas kthimit në Kosovë, ai asnjëherë nuk u përul para tyre. Fatin e tij e lidhi me fatin e popullit të vet.

Për fat të keq shokët e tij nuk ndërmorën një hap të këtillë, në mesin e të cilëve edhe vëllai i tij Tefik Islami. Ata u katandisen në të katër anët e botës. Kontributi i tij ishte më i madh, sepse punoi dhe veproi aty ku u lind dhe jetoi. Ashtu, siç thotë populli, "Njeriu peshon më shumë në vendin e vet". Andaj, ky përkujtim le të jetë një shpërblim për sakrificat e tij për ne që në një mënyrë apo tjetër ishim nxënësit e tij.

Allahu i madhërishëm e shpërbleftë për të mirat e Tij të pakufishme.

[5] Vdiq dhe u varros në Kajro në dhjetor 2001.

Mr.Qemajl Morina

HASAN EF. NAHI – A STUDENT OF THE AL-AZHAR UNIVERSITY IN CAIRO (1930-1934)

(Summary)

For more than one-thousand years “Al-Azhar” is a symbol of light for the Islamic world. Cordoba, Granada, Damascus and Baghdad were centers of Islamic culture prior to Cairo. Al-Azhar was in its heart. Today, Al-Azhar is renowned as a center of Islamic education. A very large number of scholars, whose words and deeds have left deep traces in the history of mankind, have studied there. Al-Azhar was and still remains a symbol of wisdom, the truth, righteousness and faith. It continues to resist all efforts to violate the holiness of Islam.

كمال مورينا

حسن أفندى ناحى – طالب بجامعة الازهر فى القاهرة (1930–1934)

(خلاصة البحث)

ظل الازهر الشريف لاكثر من ألف عام رمز ضياء ونور فى العالم الاسلامى و قد كانت قرطبة و غرنادا و دمشق و بغداد مراكز للثقافة قبل القاهرة فى قلبها يوجد الازهر الشريف . والازهر ما زال حتى اليوم يواصل رسالته و هو بحق يعتبر اكبر مركز تعليمى و تربوى فى العالم الاسلامى. و بحق يقال اليوم بأن الازهر كان و سيظل رمزا للحكمة و الحق و العدل و الايمان و سيبقى على مدى الوقت سدا منيعا لمقاومة جميع المحاولات التى تحاول النيل من قدسية الاسلام .

PORTRETE

Selim Musliu

MULLA EMIN ALI ZHITIA

"Me xhonturqit diqysh, me Serbinë kurrqysh"

E tërë filozofia e qëndrimit politik e atdhedashës të Mulla Eminit është përmbledhur me thëniet e tij: *"Kush shkon në kufi Zoti ia dhashtë, kush shkon në Drnogllavë Zoti e vraftë"* dhe *"Me xhonturqit diqysh, me Serbinë kurrqysh"*.

Mulla Emini është ndër hoxhallarët e rrallë, për të cilin flitet se nuk kishte qëndrim të drejtë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të Lidhjes së Prizrenit, veçmas ndaj Lëvizjes në Moravën e Epërme, në vitet 1908-1912, sepse, sipas tyre, ata që e luftonin *"Babën M'ret"*, ishin *"murtatë"* dhe në shërbim të jomyslimanëve, d.m.th. në shërbim të sllavit dhe "llatinit".

Lidhur me këta intelektualë shqiptarë të besimit islam, Sadullah Brestovci konstaton: *"Ata sikur propagandonin se shqiptarët me luftën e tyre po i ndihmonin korridorit ballkanik (shteteve të krishtera ballkanike) andaj veprimtarët e dalluar në Lëvizjen Kombëtare i quanin "murtatë" (tradhtarë). Ata konsideronin po ashtu se shqiptarët po bënin gabim të madh që po kërkonin bashkëpunim me serbët, sepse sipas tyre, prej tyrej ishin sulmuar e tradhtuar shumë herë. Kështu që çdo afrim apo përpjekje për t'u afruar me popuj tjerë ishte i rrezikshëm. Sipas tyre, e vetmja rrugë e shqiptarëve është lidhja e fatit të tyre me Turqinë, jo vetëm pse shtetet ballkanike ishin kundër shqiptarëve, por edhe për shkak se shqiptarët myslimanë kishin krijuar mentalitet të afërt me turqit."*[1]

Sipas kujtesës popullore, ekzistonte bindja se kishte tradhtarë në radhët e personaliteteve të larta politike dhe ushtarake të Perandorisë Osmane, që ishin larguar nga parimet islame dhe osmane e po vepronin në dobi të kundërshtarëve osmanë dhe islamë në planin evropian dhe kundër shqiptarëve në planin ballkanik. Ngjarjet pasuese në raport me shtetet fqinje: Greqinë, Serbinë dhe Malin e Zi treguan se çdo aleancë shqiptare me ta për luftë kundër osmanëve dhe të tjerëve (bullgarëve, austro-hungarezëve, italianëve dhe gjermanëve) ishte një iluzion i parisë shqiptare, për të cilin iluzion këngëtari popullor do të këndojë: *"Shqiptarët besë nuk kanë me shka/ A e dinë vllaznit qysh na kanë vra."*[2].

Shtrohet pyetja ishte i tillë apo jo Mulla Emin Zhitia? Përgjigjja mbështetur në kujtesën popullore është jo, sepse ky hoxhë nuk është i përfolur as në rrethin e gushtë e jo më të gjerë si personalitet i dalluar i kësaj ane, siç është rasti me Shabi Kajen. Maliq Vërnakollën, Beçë Ballancën e Ramë Toplanën dhe të tjerë.

Mulla Emin Zhitia – po ashtu qe njëri prej klerikëve myslimanë, të cilët në kohën e kryengritjeve shqiptare, sidomos gjatë asaj të vitit 1910 u deklaruan për lidhshmëri me "babën mret". Edhe ai u deklarua kundër shkuarjes së farefisit dhe fshatarëve të Zhitisë në njësite vullnetare kryengritëse të vitit 1910 e 1912. Por, të gjitha këto ai i bëri për shkak të injorancës. Ai kishte bindje të thellë se për shqiptarët e vetmja rrugë e drejtë ishte që ta lidhin fatin e tyre me Turqinë. Sepse, sipas tij, ata nuk e kishin mik të vërtetë asnjë "popull ballkanik". Kështu ai e identifikonte popullin me shtetin, andaj mendonte se të gjithë popujt e Ballkanit ishin njësoj armiq të Turqisë dhe të shqiptarëve, të luftës së tyre për pavarësi. Pra, hoxha i Zhitisë qe përfa-

[1] S. Brestovci, Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit, Instituti Albanologjik I Prishtinë, Prishtinë 2008, fq. 130

[2] Mr. Kadri Rexha: 85-vjetori I rënies së Azem Galicës…, Zëri, 10.08.09/19

qsues i asaj rryme të klerit mysliman, i cili nuk ishte kundër Lëvizjes Kombëtare vetëm për shkak të interesit klasor, por, në radhë të parë për shkak të injorancës, rrymë kjo e cila nuk ishte aq fanatikisht e lidhur me Turqinë, por ai nuk bënte dallime ndërmjet masave të gjëra të përkatësive të tjera kombëtare, sidomos serbe dhe të shteteve të tyre. Mulla Emini dhe rryma e tij, paraqitnin porosinë e shqiptarëve (muslimanë) se janë të afërt me turqit, etj...

Më në fund edhe mulla Eminin, sikur edhe disa të tjerë, të cilët qëndruan në ato baza konservative, e gjeti vdekja në mesditë në Gjilan, pas hyrjes së ushtrisë serbe, në vitin 1912. Së pari ia morën kalin e "shpirtit", e pastaj meqenëse u angazhua shumë kundër një plaçkitje të këtillë, e vranë te Banja e Gjilanit. Në bazë të asaj që thamë më lart mendojmë se duhet të dallohen disa rryma në radhët e klerit mysliman të kazasë së Gjilanit si dhe më gjerë, në tërë Kosovën".[3]

Mendoj se ky vlerësim i autorit për qëndrimin e Mulla Eminit ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Moravën e Epërme, dhe ndaj çështjës shqiptare në Ballkan, është bërë sipas kërkesave klasore dhe ideore të kohës dhe se si i tillë duhet rivlerësuar në kushte e rrethana të reja politike e shoqërore dhe në bazë të burimeve historike më të reja. Kjo duhet bërë jo për shkak të një hoxhe, prifti apo popi; jo për shkak të një feje apo rryme fetare, i cilitdo konfesion qoftë; jo për shkak të një personaliteti të folur e përfolur të një kohe të caktuar, por për shkak të së vertetës historike gjithnjë në pajtim me parime e kritere objektive, të liruara plotësisht nga dobësitë që mund të përcillnin hulumtuesin shkencor, aq më tepër kur kjo punë kaq e rëndësishme është bërë në fillim të krijimit të kuadrove hulumtuese dhe zhvillohej në kushte të një mentaliteti të ulët arsimor e kulturor, politik e shoqëror e të ngarkuar me subjektivizëm fanatik, në njerën anë, për të mbivlerësuar, e në tjetrën anë, për të përçmuar, apo së paku anashkaluar qoftë personalitetet, qoftë ngjarjet, e një shtrese të caktuar shoqërore sipas metodës "bardhë e zi", duke krijuar edhe "turkoshakë", "sllavofilë", "llatinofilë" dhe "grekofilë" e "fila" të tjerë edhe të paqenë. Këtë fat

[3] . Po aty, fq. 134.

do ta përjetojë edhe mulla Emini, ngase i përkiste shtresës së pasur dhe ishte kundërshtar i bashkëpunimit me sllavë, grekë dhe vllahë e bullgaro-maqedonas, në luftë kundër Perandorisë Osmane dhe Xhonturqëve, sepse prapa këti bashkëpunimi fshihej qëllimi djallëzor i fqinjëve për të përfshirë sa më shumë troje shqiptare në shtetet e tyre dhe për të dëbuar tërë myslimanet shqiptarë dhe të tjerë nga e tërë Rumelia. Të kujtojmë lexuesin se kundër këtij qëllimi fashizoid antishqiptar të fqinjëve të krishterë, ushte ngritur edhe Fan S. Noli, i cili i kishte shkruar edhe ... të kishës ortodokse ruse. (Shiko F.S. Noli për urrejtjen dhe luftërat ballkanike, Dituria Islame/212, mars, 2008., f. 55.)

Sa i përket Luftës së Drenogllavës, të vitit 1910, në të cilën morën pjesë shumë zhitias dhe u vra edhe daja i Mulla Eminit nga Mirosala, duhet pranuar se në popull qëndron bindja se nuk është luftuar kundër Perandorisë Osmane, por kundër "murtatit" që ishte futur në rradhët e kësaj perandorie, njëri ndër të cilet ishte edhe Dërgut (Dragutin) pasha, një antishqiptar i dalluar me prejardhje bullgare, në rradhët e ushtrisë së të cilit kishte edhe shqiptarë që amortizuan urdhrat e oficerëve joshqiptarë në rradhët e ushtrisë turke dhe të tillë që penguan ose së paku amortizuan krimet e Dërgut Pashës ndaj shqiptarëve kryengritës. Një rol të tillë luajti edhe Mulla Emini në mbrojtje të Zhitisë, dhe si dijetar mysliman i dalluar pati ndikim edhe për mbrojtjen e të tjerëve.

Kur është fjala për mulla Eminin dhe disa hoxhollarë tjerë, duhet pranuar të vërtetën se është njëri ndër hoxhollarët e kohës, për të cilin pak dihet dhe ka një mendim se kishte elemente serbofile. Nga ajo që u tha më lart mësojmë se ky jo vetëm që nuk ishte "sllavofil", por kishte një qëndrim shumë të drejtë ndaj bashkëpunimit me serbët dhe të tjerët në luftë kundër Perandorisë Osmane.[45] Edhe qëndrimi i tij, se

[4] Shih Fan Stlian Noli për urrejtjen dhe luftërat ballkanike, Dituria Islame/212, mars 2008, fq.55, ku ndër të tjera citohet Noli:
a. Megjithatë, duam të qrtësojmë se nuk u kundërvehemi Shteteve të Aleancës Ballkanike për shkak të urrejtjës së tyre racore, por për shkak të politikës së tyre të padrejtë dhe pretendimeve të tyre arrogante për qytetërimin e gadishullit Ilirian… dhe

jemi më të afërt me turqit sesa me fqinjët tjerë ballkanas, nuk është për t'u gjykuar ashpër dhe apriori, sepse kriter për vlerësimin e afërsisë ndaj njeri-tjetrit, sipas kërkesave fetare, ishte vetëm përkatësia fetare, përkundër asaj të gjakut dhe të fëqinjësisë, kritere këto që te shqiptarët ishin më të përcaktuara se te çdo popull tjetër ballkanik. Derisa shqiptarët ishin të rrezikuar, jo vetëm nga shtetet e porsaformuara fqinje ortodokse, por edhe nga popujt: sllavë, helenë, llatinë e mongolë, të tjerët ishin të mbrojtur nga Fuqitë e Mëdha të krishtera. Kjo më së miri u vërtetua me vendimet e Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit dhe zhvillimet e mëtejmë të rrjedhave historike gjithnjë në dëm të shqiptarëve në përgjithësi dhe myslimanëve ballkanikë në veçanti. Nëse kemi parasysh se tragjedia shqiptare e përcjellë me holokaust në shkallë kombëtare dhe shumë holokauste të tjera lokale përcolli shqiptarët për një shekull të tërë, atëherë, medoemos duhet pranuar qëndrimin e Mulla Eminit dhe të tjerëve ndaj bashkëpunimit me popullin apo shtetin serb, sepse koha kishte treguar dhe po tregon se nuk kishte dallim nga njëri-tjetri, sepse prapa tyre qëndron Kisha Ortodokse ruse, serbe dhe greke, armike e përhershme e shqiptarëve që nga formimi i tyre e deri më tani.

Ngjarjet që pasuan gjatë tërë shekullit të XX, gjatë viteve 1912-1915, 1919-1941, 1925-1955, 1989-1999, ripërsëritën tragjedinë shqiptare të pas Paqes së Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit 1878, dhe qëndrimin e drejtë të ylemas myslimane ndaj pushtuesve të huaj si dhe angazhimin e tyre në luftën e armatosur për mbrojtjen kombëtare e fetare në bashkëpunim edhe me klerikët shqiptarë të krishterë katolikë e ortodoksë. Që në rastin e parë që iu dha Serbisë dhe Malit të Zi, më 1912-1913, sipas Kosta Novakoviqit, *u vranë 120.000 shqiptarë, qindra fshatra u bombarduan dhe u dogjën krejt"*. Sipas shumë të tjerëve, shqiptarë e joshqiptarë, të mëparshëm dhë të pas vitit 1999, që në fillim të depërtimit të ushtrisë serbe dhe malazeze, *"nisi fushata e egër për kthimin me dhunë të popullsusë shqiptare të rrafshit të Dukagjinit në fenë ortodokse. Për më tepër prej shqiptarëve u kërku të ndërronin jo vetëm fenë, por edhe emrat dhe veshjen e tyre. Ky operacion zhvillohej nën didakturën absolute ushtarake, duke udhëhequr kështu një poitikë të hapur shkombëtarizuese dhe gjenocidiale, sepse kryenin veprime ndër më të përbindëshmet ndëshkimore për ata që kundërshtonin. Midis ideologëve ishte edhe mitropoliti i Pejës, Gavrillo Duzhiq dhe ministri i Arsimit i Malit të Zi, Mirko Mijushkoviq..."* [6]

b. E sulmuar nga të gjitha anët nga të krishterët hipokritë dhe tradhtarë, Shqipëria nuk ka streh tjetër veç flamurin e Hënës.

Mulla Emini në librin "RAMË AVDYLI dhe bashkëluftëtarët e tij të Hysen Terziut"

Në pjesën e librit të tij Ramë Avdyli..., aty ku bëhet fjalë për fshatin Zhiti të Moravës Epërme, Hysen Terzziu thotë: "...*mulla Emin Aliu u bë* ***njëri ndër propaganduesit më të mëdhenj*** *të lëvizjes kundër pushtuesit osman në fshatrat Zhiti, Ballancë, Devajë e Radivojcë. Ai i printe propogandës, por afër vetes kishte Beqir Rerxhepin nga lagja Ferati të Zhitisë, udhëheqës i kreut anamoravas; Shaqir Mehmetin nga lagja e njëjtë e këtij fshati; Sylë Hasanni të lagjes Tafaj të Zhitisë dhe trima e luftëtarë të tjerë".*

"Trimëri të veçantë mulla Emin Aliu tregoi në burgun e Gjilanit. Rojës së burgut i kishte thënë: "Ni shpyrtë e kam, ni shpyrt mun' t'ma merrni..... Vdiq nga djegia me benzinë në burgun e Gjilanit më 1913, si luftëtar i dalluar kundër regjimit serb"[7].

Konstatimi se *ai u* ***bë njëri ndër propaganduesit më të mëdhenj*** *të lëvizjes kundër pushtuesit osman*, nuk është në pajtim me vlerësimin e popullit se në lëvizje kishte "murtat" dhe se shumë nga përkrahësit e lëvizjes ishin pikërisht kundër "murtatëve" që po tradhtonin si sulltanin ashtu edhe Perandorinë Osmane dhe interesat kombëtare e fetare shqiptare në favor kryesisht të Serbisë e Greqisë, pa harruar edhe atë të Italisë dhe Austro-Hungarisë. Po të ishte kështu, siç shkruam autori, atëherë do të dilte se mulla Emini do të ishte fanari i inteligjencies

[6] Abdullah Konushevci: Qerime Halil Radisheva: Zhan d'ark - Nëna Tereze, Zëri, 13.08.09/19.

[7] Hysen Terziu, Ramë Avdyli dhe bashkëluftëtarët e tuj, Prishtinë, 1997 fq. 167-68

islame në Moravën e Epërme, sepse kjo nuk ndodhi me askënd nga hoxhallarët të kësaj ane, përkundër faktit se kishte hoxhollarë të cilët shumë vite më parë kishin shkuar “gjynli” në luftën greko-turke.

Një pyetje që do sqaruar është, pse hoxhollarët e kësaj ane dhe më gjerë nuk ishin të përfshirë adekuat në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare të Kazasë së Gjilanit, kur dihet se bartës të Rilindjes Shqiptare dhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte inteligjencia fetare shqiptare e të tri konfesioneve fetare. Pse të gjithë personalitetet bartëse të kësaj lëvizjeje ishin analfabetë? Përgjigjja mund të jetë se shkalla e arsmimit të hoxhollarëv të kohës, Pos mulla Sylës së Terpezës dhe Mulla Eminit të Zhitisë ishte e ulët, dhe se në këtë anë ideja e Lëvizjes Kombëtare nuk ishte ngritur në shkallë të duhur adekuat me mjediset tjera, përkundër faktit që në bibliotekën e Mulla Sylës është gjetur Evetari i gjuhës, i Bukureshtit.

Nipi i Beqirit, Beqa i dytë, (1925) ende gjallë, nuk di gjë tjetër karakteristike për mulla Eminin, pos se ka qenë hoxhë i fortë dhe se ka paralajmëruar shpërbërjen e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e Kosovës nga Serbia. Nga kjo mund të konkludohet se Mulla Emini ishte njohës i mirë i situatës politike në Ballkan, dhe se ai ishte i rezervuar ndaj luftës kundër ushtrisë osmane, për të ruajtur të gjitha energjitë luftarake kundër rrezikut më të madh që po u përgadtitej shqiptarëve nga shtetet fqinje ortodokse.

Në librin e përmendur të H. Tërziqit dhe në librin e tij të dytë, Gjenocidi serb 1912-1956, thuhet se mulla Emini ishte aktiv në mbrojtjen e Ferizajt kundër ushtrisë serbe, më 1913, dhe se kishte rolin e intidantit apo depoistit dhe shpërndarësit të armëve në Pozheran pjesëmarrësve shqiptarë në luftën e Ferizajt, të tetorit të vitit 1912. Kjo duhet hulumtuar ngase deri më tani nuk kemi të dhëna për organizimin paraprak të kësaj rezistence, por kemi të dhëna të argumentuara se në këtë luftë është vrarë mulla **Ibrahim Kurteshi** nga Pozherani, dhe se është plagosur për vdekje mulla Hajdini i Trestenikut dhe ...

Sipas nipit të tij, Ilaz Hajdin Ibrahimit nga Tresteniku, Mulla Emini ishte zyrtar në kajmekamllëkun e Gjilanit. Ai ishte i angazhuar për mobilizimin e redifëve për të luftuar kundër Serbisë dhe shpërndarjen

e armëve vullnetarëve që do të merrnin pjesë në mbrojtje të shtetit dhe atdheut. Mulla Emini shfrytëzoi pozitën e tij për të ndihmuar e strehuar të përndjekurit nga “urfija” e Dërgut Pashës, si që ishte rasti me Haxhi Tahirin e Komogllovës dhe Mulla Hajdinin e Trestenikut, të plagosur në Luftën e Ferizajt, më 1912, të cilin e strehoi në shtëpi të vet.[8]

Sipas Feriz H. Halimi, nga Gjylekaresi i Moravës Epërme, Mulla Emini ishte hoxhë i dalluar i kësaj ane, i cili dallonte nga paria e kësaj ane që në bashkëpunim me Serbinë e luftonte Turqinë. Mulla Emini ishte në shërbim të parisë së rrethit të Gjilanit. Ishte përgjegjës i deponisë së armëve në Gjilan. Me rastin e shpërndarjes së armëve redifëve që do të dërgoheshin në kufi me Serbinë, u thonte redifëve: “Merr avdes e t’u gjetë deri në vdekje! Lufto për fe e atdhe! Mos lufto për Serbi e Mal të Zi!” dhe shprehte mallkimin e thellë: “Mos luftofsh për mbret e vrafsh veten!”

Fakti se Mulla Emini u vra nga pushteti serb ndër të parët, flet se Mulla Emini ishte armik i përbetuar i pushtuesit serb, logjikon xha Ferizi 93- vjeçar.[9]

Mulla Emini në librin “Gjenocidi serb 1912-1956” të Hysen H. Terziqit

Duke bërë fjalë për gjenocidin serb në Moravë të Epërme në vitet 1912-1956, Terziqi përshkruan edhe rastin e Mulla Eminit. Sipas tij, fshati Zhiti shpëtoi nga masakra kolektive falë tre serbëve, të cilët kundërshtuan masakrën kolektive duke u thënë udhëhqësve të ekspeditës serbe se bashkëfashatarët tanë shqiptarë janë ata që “na ruajtën nga derti i Kohës”. Sipas Terziqit, serbët kriminelë e dinin se kush është Mulla Emini, se ai ka kryer shkolla të larta në Stamboll, se ka pasur pozita të larta në kajmekaminë e Gjilanit, se ka qenë mbikëqyrës i depos së armatimit në Gjilan, se ka nxitur e ka rekrutuar redifët që duhej

[8] Ilaz Hajdin Ibrahimi, 1907, Trestenik, bujk, analfabet.
[9] Biseda me Feriz Hysk Halimin-Sadikun, bujk, autodidact, u zhvillua në odën e tij më 30.09.2009

të shkonin në frontin e Kumanovës dhe se u ka shpërndarë armë vullnetarëve për të shkuar në luftën e Ferizajt, në tetor të vitit 1912. Sipas tij, mulla Emini ishte njohës i mirë i ecurive politike dhe parashikonte se pushtuesi serb do të përdorë metoda joshëse për të përçarë shqiptarët, duke u ofruar peshqeshe e pozita parisë shqiptare, të cilët do t'i vënë para aktit të kryer, sepse ata që nuk do t'i pranojnë këto "peshqeshe" do të rrezikojnë veten dhe familjet e tyre. Kështu do të ndodhë edhe me mua, parashikonte hoxhë Emini. Kështu edhe ndodhi.

Sipas Hysenit, hoxhë Emini u zu në Gjilan, kur kishte shkuar te dhëndri i tij. Atë e morën dy përcjellës, njëri nga të cilët e goditi rrugës për në burg. Mulla Emini ia ktheu goditjen. Gjatë përleshjes u plagos nga përcjellësi tjetër. Ashtu i plagosur u dërgua në burg, ku vazhduan maltretimet dhe kërcnimet nëse nuk heq dorë nga "kokëfortësia e arnautit kokëçmendur". Hoxha i vendosur dhe i vetëdijshëm për rrezikun që po e priste, u përgjigj në stlin e atdhedashësit të përbetuar: *"Një shpirt e kam e një shpirt mund të ma merrni, po nuk do të arrini dot të nënshtroni asnjë shqiptar, as me lutje, as me frikë e as me vrasje"*. Nga zemërimi për qëndrimin e ti serbët e dogjën me benzinë, ashtu të gjallë, më 1913.[10]

Kush ishte Mulla Emini?

Mulla Emin Ali Aga, nga Zhitia e Moravës së Epërme, u lind në këtë fshat, sipas të gjitha gjasave, në dhjetëvjetëshin e dyzet të shekullit të XIX. Ruzhdi Q. Ibrahimi, pasarëdhës i Mulla Eminit, profesor, i lindur më 1956, mendon se hoxhë Emini është i lindur rreth vitit 185O. Ishte nip Mirasele e stërnip Luboteni të Shkupit. Siç shihet nga atributi Ali aga, del se i ati i tij ishte pasanik i dalluar i këtij fshati. Nuk ka asnjë të dhënë se ofiqi ka të bëjë edhe me ndonjë pozitë të tij në pushtetin osman. Sipas pasardhësve të Ali agës, i cili kishte 4 djem: Ibrahimin, Eminin, Shahinin dhe Ahmetin, i ati i tij ishte trim i dalluar. Ai i shpëtoi miqtë e tij nga egërsirat para se të miqësohej me ta. Ishte pasanik i madh. Mbante pela hergjele, dele, lopë, buallica etj.

[10] Hysen H. Terziqi, vepra e përmenudr, Prishtinë 2005, fq. 58.

Nuk ka të dhëna as për shkollimin e Mulla Emnit në fëmijëri dhe rini, pos gojëdhënës se ishte shkolluar edhe në Stamboll dhe ***se atje kishte qëndruar 18 vjet.*** Nga të dhënat tani më të njohura, dihet se në Gjilan, që në vitet e pesëdhjeta të shekullt XIX, ka ekzistuar shkalla e parë dhe e dytë e shkollimit fetar, prej nga mund të supozohet se Mulla Emini mësimet e para ka mundur t'i ketë marrë në këtë qytet. Nga ana tjetër, si stërnip i Lubotenit të Shkupit, nuk përjashtohet mundësia që ai të jetë shkolluar edhe në Shkup, prej nga do të jetë dërguar në Stamboll. Në këtë kombinim nuk duhet përjashtuar as Mirosalën, si vend ku ka mundur të inspirohet apo edhe të marrë ndonjë element arsimi dhe edukate. Nuk dihet as kur dhe sa kohë ka qëndruar në Stamboll, si dhe kur është kthyer në vendlindje. Mendohet se kthimi në vendlindje do të ketë ndodhur pas luftës Ruso-Turke më 1877/78. Mbështetje për këtë konkludim është kritika e muhaxhirëve .... që i bëhet hoxhës për mosvendosjen e tyre në Kllokot, por në Kravaricë, ish-pronë e Ali Agës. Sipas pasardhësve të hoxhë Eminit, kjo akuzë është e pabazë, sepse mulla Emini nga dhembja e thellë për muhaxhirët, iu ndihmoi atyre që të punojnë në tokat e tij bujqësore dhe vendosi që ta falë pronën .... Arsyeja për mosvendosjen e tyre në Kllokot, nuk ka të bëjë me mosdëshirën e tij, por me politikën e pushtetit të kohës për të mos ngushtuar e ngacmuar rajën serbe, të mbrojtur edhe nga Fuqitë e Mëdha. Përndryshe hoxha njihej edhe si bamirës, por edhe si njeri që kërkonte që t'iu mundësohet njerëzve të varfër që të jetojnë nga puna e tyre, ngase mëshira nuk është zgjidhje. Përkundrazi, ajo çon në varësi dhe demeli të përhershme. I shtyrë nga ky parim ai iu bëri vend muhaxhirëve në pronat e tij. Ai ishte shpërndarës i mishit falas, por edhe shitës i tij, sepse si falja ashtu edhe shitja duhet bërë me masë, sepse nuk mund të falësh tërësinë, por as nuk mund të jetosh vetëm nga të falurit që vjen nga të tjerët.

Lagjja e Hoxhëve të Zhitisë - trashëgimtare e Mulla Eminit

Emin Ismajl Emini, stërnip i Mulla Eminit, bujk 80-vjeçar, në bazë të asaj që ka mbajtur mend nga ajo që ka dëgjuar nga gjyshi e babai, tregon se Ali Aga kishte pasur katër djem: Eminin dhe Shahinin me njërën grua dhe Ibrahimin dhe Ahmetin me tjetrën grua. Mulla Emini la Ismajlin dhe Shefkiun. **Ismajli** ka lënë Vehbiun dhe Abdiun me njërën grua dhe Fehmiun, Eminin II dhe Muslinë, me tjetrën grua; **Shefkiu** ka lënë: Xhemën, Faikun dhe Mustafën. Nga këta u krijua Lagjja e Hoxhëve, që mban ... mbiemra zyrtarë: Emini, Ibrahimi, Shahini, Aliu.

Mulla Emini ishte i lidhur për vendlindjen, përkundër rreziqeve që i kërcnoheshin atij dhe pasardhësve të tij nga regjimi pasues serb. Gjatë gjendjes kritike të paspushtimit serb, diti të ruhet duke u strehuar nëpër të njohur. Asnjëherë nuk i shkoi mendja të largohet me familje nga vendlindja. Përballoi disa kërkesa të grabitçarëve serbë. Pas qetësimit të gjendjes ushtarake, pranoi kërkesën e shokëve që të marrë pjesë në tubimet që do të mbaheshin në xhaminë e Gjilanit, për informatorët me qëllim të panjohur. Qëllimi i tubimit, sipas të gjitha gjasave, ishte zgjedhja e myftiut të Myftemisë së rrethit të Gjilanit. Mulla Emini, pranimin e detyrës e kishte kushtëzuar me sigurim të xhamisë në shkallë gatishmërie për të mos lejuar burgosjen e tij, sepse ky nuk do të pranonte kushtet që do t’i viheshin për zgjedhjen e tij myfti i rrethit.

- Nuk them si thonë ata, thoshte hoxha, dhe shtronte pyetjen: A jeni të gatshëm të më mbroni?

- Katër mbrojtësit e tij, shokë të fshatit ishin: Tafë qorri i Beqirajve[11], Salihu kushëri i tij, Latifi ... dhe një tjetër, emri i të cilit nuk iu kujtohet informatorëve. (Mund të ketë qenë Hasan Dedja i Gjilanit, dost i Mulla Eminit). Sipas marrëveshjes, këta përcjellës do të shtinin

[11] U vra në kohën e Bullgarit të parë bashkë me të birin Ilazin, për shkak se ia gjetën armët e fshehura nën këmbët e dyerve të oborrit.

me armë, nëse për këtë jep shenjë mulla Emini, duke shtënë me alltinë e tij.

Tubimi u zhvillua në xhaminë e rrethuar nga të gjitha anët. Mulla Emini kërkoi që myftiu të jetë në shërbim të xhematit dhe të veprojë sipas ligjeve islame. Nuk kemi të dhëna se kush ishte kundërshtari i tij, i adhuruar i pushtetit serb. Supozojmë se ky do të kishte qenë Haxhi Mulla Isufi i Gjilanit, i ardhur nga fshati Desivojcë, i cili vlerësohet si njëri nga klerikët më të dalluar kundërshtarë të Lëvizjes Kombëtare të Gjilanit, i cili qëndroi në krye të Bashkësisë Islame gjatë sundimit serb (192-1915), sundimit bullgar, (191501918). Dhe gjatë mbretërisë së Jugosllavisë së vjetër. Ishte mik i ngushtë i Toma Popoviqit, mik i mbretit Aleksandër Karaxhorgjeviq[12].

Pas këtij tubimi, mulla Emini vazhdoi të strehohet te jatakët e vet, ndër të cilët ishte edhe dhëndri i tij në Gjilan, për të cilin e kishte dhënë të bijën, Fatimen dhe dosti Hasan Dedja. Nipi i tij në Gjilan, Xhafer Riza Mahmuti, pas vetes ka lënë nipin, i cili është gjallë dhe jeton në Gjilan.

Lidhur me burgosjen dhe likuidimin e tij ka disa variante. Sipas variantit të informatorit Emin Emini, në prani të Hajrush dhe Danush Eminit, xhandarët serbë e kërkuan në shtëpi. Hoxha u kishte thënë të mos tregojnë se është këtu. Pastaj e mori atin dhe shkoi në Gjilan. Këtu e kërkojnë xhandarët me pretekst se duhet të paraqitet në gjyq. Hoxha e dinte se nuk është rend gjyqi, se do të likuidohej pa gjyq. Në rrugë e sipër, kur arrin të Baja, kërkon leje nga xhandarët që të marrë abdes për t’u falur. Xhandarët e lejojnë, pasi fal namazin e caktuar, sulmon xhandarët, të cilët e vrasin në vend. Nuk dihet ku është varrosur.

[12] S. B. Vep. e cit. f. 131, 132, 133.

Familja Hoxha e Zhitisë, familje e dalluar përparimtare arsimdashëse dhe atdhetare

Pasardhësit e mulla Eminit, ashtu si edhe shumë pasardhës të personaliteteve të shquara kombëtare e fetare, përkundër vështirësive që patën, arritën të krijojnë e formojë personalitete që i kontribuan avancimit të shkallës së edukimit dhe asaj arsimore. Kjo familje dha Mulla Vehbiun, djali i të cilit Mërxhan Emini është i pari zhitias që kreu shkollën fillore shqipe në Terpezë dhe vazhdoi Shkollën administrative dyveçare në Kaçanik, për t'u bërë mësues më 1951, drejtor i shkollës 8-vjeçare më 1968, dhe arsimtar i Gjuhës shqipe në fillim të viteve të shtatëdhjeta. Më parë, Musliu që kishte krye shkollën fillore në gjuhën shqipe ishte punësuar si administrator në pushtetin "popullor" të porsaformuar. Fehmi Emini, vllai i Vebi Eminit, autodidakt, ishte kryetar e Këshillit të parë të vendit në Tërpezë, dhe shfrytëzoi rastin për të njoftuar Musliun, të atin e Ramadan Agushit, se organet e sigurimit po e kërkonin Ramadanin... Fehmiu ishte i pari nga Zhitia, i cili e dërgoi vajzën e tij në Gjimnazin Shtetëror Shqiptar në Pozheran, në fillim të viteve të pesëdhjeta. Nga kjo familje tani kanë dalë mbi 40 intelektualë profilesh të ndryshme universitare, ndër të cilat edhe femrat e para të këti fshati: Ramizja, Hazirja, Nysretja etj.

Pas demonstratave të vitit 1968 dhe 1981, si dhe në vitet e nëntëdhjea u dallua Hajrush Emini, duke mos u pajtuar me masat që kërkohej të merreshin ndaj demonstruesve dhe duke formuar Këshillin për financimin e arsimit paralel shqiptar.

Në fillim të viteve 90-ta u vra në ushtri, biri i Emin Q. Eminit ....

Selim Musliu

MULLA EMIN ALI ZHITIA

(Summary)

The whole philosophy of his political and patriotic views has been summarized in his sayings: "those, who go to the border to defend it, may God give to them; whereas those, who go to Drnogllava, may God punish them" and "we can co-exist with the young Turks (somehow) but there is no way that we can co-exist with Serbia".

Mulla Emin was among the few hodjas, who is said not to have had a proper stance towards the Albanian National Movement (the Prizren League), and in particular towards the Upper Morava Movement in 1908 and 1912, since, according to him, those who fought the Sultan (the father-king) were in the service of non-Muslims, i.e., the Slavs.

سليم موسليؤ

مولا أمين على جيتيا

(خلاصة البحث)

"مع الاتراك الجدد كانت علاقتنا الى حد ما و مع صربيا لم تكن هناك أية علاقة"

كانت كل فلسفة و موقف السياسى لمولا أمين جتيا ينحصر على المقولات التالية: "من يذهب الى الجبهة فليعط الله كل شىء و من يذهب الى "درنوغلاف" فليقتل الله! و علاقتنا مع الاتراك الجدد الى حد ما ومع صربيا ليس هناك اى شىء ".

يعد الشيخ مولا أمين من العلماء النوادر الذى يقال بأنه لم يكن له موقف عادل حول قضية رابطة بريزرين و بالاخص حول المقاومة فى "مورافا العليا" خلال سنوات (1908-1912) لان حسب اقوالهم فان الذين حاربوا لالسلطان ارتدوا عن الاسلام و هم كانوا فى خدمة السلاف و الكاثوليك .

AKTUALITETE

Mr. Rexhep Suma

IMPAKTI I FESË NË NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-TURKE

"Impakti i fesë në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro - turke" është e një rëndësie të madhe për kohën dhe rrethanat që po kalon ymmeti islam në përgjithësi dhe dy popujt në veçanti.

Dr. Xhonatan Saks ka thënë se "feja është bërë forcë madhore në formësimin e ngjarjeve në botë dhe nëse nuk është pjesë e zgjidhjes është me siguri pjesë e problemit". Kurse ish-presidenti i SHBA-së, Xhimi Karter është shprehur se: "vitet e fundit besimi fetar ka hyrë në një shkallë të pabesueshme në mbretërinë e politikës... dhe se... ka një prirje drejt fondamentalizmit në të gjitha fetë". (*Longley, 2002:148; Carter, 2005: 16- 30)*

Sfera e përgjithshme e problemit të shtruar në këtë punim, në mënyrë të mjaftueshme është rrahur në tematikat e mëposhtme. Deri më tash, akoma me sa di unë, nuk është paraqitur ndonjë studim i mirëfilltë apo vepër gjithëpërfshirëse lidhur me impaktin i fesë në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke. Sipas Sejid Muhamed Nakib El-Attas, nuk ka dyshim se bota tashmë po qëndron në udhëkryq, i cili mund të jetë shumë fatal për myslimanët. Nën një ndikim sistematik të vesternizimit të indoktrinuar si sinonim ideologjik dhe filozofik për shekullarizimin, vetëdija e identitetit mysliman me shpejtësi dobësohet dhe humbet. Karakteri kulturor dhe identiteti qytetërimor i islamit mund të shpëtojnë vetëm nëse ndërhyrjet konkrete në sistemin edukativ të shteteve islame arrijnë të ndërtojnë vizion të tyre autentik dhe program intelektual. Islami qe barrierë, që ndërpreu greqizimin dhe sllavizimin e shqiptarëve. Perandoria Osmane përfshinte 22.9 milionë km² në majë të lulëzimit në shek. XVI duke mbajtur nën sundim viset nga Afrika Veriore, Lindja e Afërt, Kaukazi deri në Evropë.

Populli autokton shqiptar, që nga e kaluara me ndjenja të larta dhe me një solidaritet të plotë i ka shërbyer fesë Islame, pozitës së Hilafetit dhe famës e autoritetit të shtetit duke shënuar kështu një ndër faqet më të ndritshme të historisë Islame. Ata njihen botërisht për sakrificat e tyre me shpirt e me mall që i bënë në kohërat më të vështira e në sprovat më të mëdha për përparimin e fesë dhe të shtetit. Takimet e para të myslimanëve me popujt ballkanikë, me intensitete të ndryshme, datojnë nga shekulli VIII , për t'u intensifikuar dhe institucionalizuar me ardhjen e osmanlinjve në shekullin XIV-XV. (*Arnold, 2004: 172*)

Është indikativ edhe fakti se procesi i islamizimit të vullnetshëm të popujve ballkanikë ka zgjatur me shekuj për t'u deislamizuar vetëm për disa dekada si pasojë e dhunës, vrasjeve, persekutimeve, dhunimeve nga pala tjetër. Kjo gjendje ka qenë më pak e praktikuar në Kosovë, Shqipëri, Sanxhak, Bosnjë e Hercegovinë dhe pjesërisht në Bullgari. Numri i saktë i myslimanëve në Ballkan paraqet problem të llojit të vet. Mosekzistimi i rubrikës dhe mosevidencimi i qytetarëve gjatë regjistrimeve kombëtare sipas përkatësisë fetare në vendet komuniste ka bërë që shifrat vetëm përafërsisht të jenë të sakta. Disa hulumtues mendojnë se numri i myslimanëve në Ballkan është rreth 10 milionë, respektivisht rreth 24 % të popullsisë së përgjithshme. Zentrak-Institut Islam-Archiv Deutchland (SOEST) pohon se aktualisht në Evropë jetojnë 53 milionë myslimanë.

Bashkimi i qëndrimeve dhe bashkëpunimi i ndërsjellë janë obligim Islam

Natyrisht se bashkëpunimi, uniteti i radhëve dhe shmangia nga përçarja janë imediat i kohës. Feja Islame, sikur asnjë fe tjetër ka bërë thirrje në vëllazërim, bashkim, bashkëpunim, solidaritet e mirëqenie dhe e ka tërhequr vërejtjen nga përçarja. Dy vendet (Kosova dhe Turqia) në saje të bashkëpunimit reciprok dhe bilateral kanë krijuar mundësi që fushat e bashkëpunimit të jenë të sferave të ndryshme. Kësaj i kanë kontribuar edhe vizitat zyrtare të liderëve më të lartë të dy vendeve. Turqia, si një mik dhe aleat i jonë, ka ofruar mbështetjen e integrimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë.

Kur'ani famëlartë urdhëron e thotë: ***"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin*** *(fenë dhe Kur'anin)* ***e Allahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehenemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur. Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit. E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh. Në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe ka fytyra që nxihen. E për sa u përket atyre fytyrave që janë nxirë*** *(u thuhet):* ***"A edhe pas besimit tuaj u bëtë pabesimtarë? Vuajeni pra dënimin për shkak se ishit që nuk besonit!".*** *(Ali Imran, 103-106)*

Marrëdhëniet mes dy shteteve po shënojnë një rritje të fuqishme në interes të dy vendeve mike. Kështu që presidenti i Turqisë, Abdullah Gyl, gjatë takimit me ish-presidentin kosovar, Fatmir Sejdiun, ka theksuar se Kosova ka arritur suksese dhe sipas tij, integrimi sa më i shpejtë i saj në institucionet euroatlantike, (Bashkimin Evropian dhe në NATO) do të siguronte paqe dhe stabilitet të përhershëm në gjithë rajonin. Ai ka thënë se Turqia e mbështet Kosovën në të gjitha forumet ndërkombëtare dhe ka premtuar lobim të mëtejshëm për njohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Nga ana tjetër, gjatë vizitës që presidenti Sejdiu i bëri Turqisë ka theksuar se Kosova është thellësisht e përkushtuar që marrëdhëniet mes dy vendeve të intensifikohen edhe më shumë për të mirën e qytetarëve të të dyja vendeve . Turqia do ta përkrahë anëtarësimin e Kosovës drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian

Turqia është ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, dhe ajo është njëfarë udhërrëfyesi që edhe vendet e tjera islamike ta njohin shtetin më të ri në botë. Gul ka vlerësuar se marrëdhëniet mes Kosovës dhe Turqisë janë të shkëlqyeshme. "Turqia e shikon Kosovën si motër, sepse atje kemi një komunitet turk të fuqishëm dhe kjo luan rolin e urës lidhëse midis dy vendeve. Po ashtu nuk duhet harruar se edhe në Turqi ka një numër të madh të shqiptarëve që jetojnë atje". I pari i Turqisë, i pyetur për mundësinë dhe rrezikun e ndryshimit të kufijve në Ballkan, ka thënë se stabiliteti dhe siguria e Ballkanit është e rëndësishme edhe për Turqinë si një vend i këtij rajoni. "Përgjatë këtyre 20 vjetëve të fundit është derdhur shumë gjak dhe se Ballkani po ndërtohet përsëri. E rëndësishme është pjesëmarrja e shteteve të Ballkanit në institucionet euroatlantike.

Ne me respekt mirëpresim pavarësinë dhe sovranitetin e çdo shteti, por në anën tjetër duhet të kemi kujdes që thellimin e marrëdhënieve ta fokusojmë në të ardhmen, e jo të ndalemi në të kaluarën. Në kuadër të kësaj, vendet e Ballkanit duhet t'u kushtojnë rëndësi dhe prioritet marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore që të ruajnë stabilitetin". Krerët fetarë të BIK-së vazhdimisht kanë bërë kontakte me autoritetet turke për ushtrimin e ndikimit që ata kanë në mekanizmat ndërkombëtarë për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Myftiu i Kosovës, mr. Naim ef. Tërnava, gjatë një takimi që ka zhvilluar në Ankara me kryeministrin turk, Recep Tayyip Erdogan, ka kërkuar nga ai personalisht dhe diplomacia turke të përdorin ndikimin e tyre në shtetet mike të Turqisë, e sidomos në shtetet e Konferencës Islamike që ende kanë hezitim për ta njohur Kosovën, që këtë ta bëjnë sa më parë. Turqia si deri më tash edhe në të ardhmen do të jetë një përkrahëse e

fuqishme e shtetit të Kosovës në rrugën e saj për t'u konsoliduar në arenën ndërkombëtare. "Madje, kryeministri turk u shpreh se edhe ai vetë po edhe diplomacia turke do të vazhdojnë që të lobojnë në shtetet që ende nuk e kanë njohur Kosovën".

Myftiu Tërnava dhe kryeministri turk Erdogan patën biseduar edhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kanë dy Bashkësitë Islame të dy vendeve. Myftiu e njoftoi kryeministrin se me DIJANET-in kanë bashkëpunim të shumanshëm, bashkëpunim ky i fokusuar në krijimin e mirëbesimit mes komuniteteve dhe popujve, si dhe angazhimin për paqe, tolerancë e mirëkuptim. Po ashtu në këtë vazhdë nuk bën të anashkalohet edhe kujdesi i kryeministrit turk, Erdogan, për t'i takuar edhe medresantet nga Kosova në qytetin Tekirdag. Ai, duke iu drejtuar medresanteve tha se kur Kosova shpalli pavarësinë, ne ishim në kontakte të vazhdueshme me SHBA-të dhe paralelisht, ndër të parët kemi njohur Kosovën si shtet të pavarur e sovran. Jemi shumë të lumtur që e kemi bërë këtë, sepse ata janë vëllezërit tanë.

Islami - barrierë që ndërpreu greqizimin dhe sllavizimin e shqiptarëve

Ardhja e turqve në Ballkan është moment me rëndësi në historinë e zhvillimit të sferës shpirtërore të shqiptarëve. (*Hasani, 2001: 103-104*). Kjo ardhje, sipas studiuesit Ismail Hasani, solli edhe një kulturë të re e të përpunuar, e cila më vonë do bëhet pjesë përbërëse e identitetit shqiptar. Kështu, Islami, si një fe e re, me kalimin e kohës u bë besim sundues dhe pati karakter mbrojtës gjithëshqiptar. Ç`është e vërteta, studiues të njohur, ndër ta edhe Roberto Maroco dela Roka (*Maraco dela Roka, 1994:23*), tashmë e kanë vërtetuar me argumente të pathyeshme, se Islamizmi ka pasur rolin vendimtar në ruajtjen e identitetit kombëtar të jetesës absolute të popullit shqiptar.

I po këtij mendimi, sipas historianit Renzo Falaschi, kishte qenë edhe Ismail Qemali, sikundër edhe Kasem Biçoku, i cili, ndër të tjera, shkruan: "Procesi i islamizmit nisi qysh me pushtimet e para osmane në Shqipëri. Ai u përhap gjerësisht gjatë shek. XVI-XVII dhe përfshiu

pjesën më të madhe të shqiptarëve. Islami lehtësoi integrimin e tyre në jetën e Perandorisë Osmane dhe u bë një barrierë e fuqishme që ndërpreu greqizimin dhe sllavizimin e shqiptarëve.." (*Falashi, 1985:11; Ferraj, 1998:51).*

Dihet se roli i Kur`anit, i fesë dhe kulturës islame ndër shqiptarët ka qenë i një rëndësie të veçantë dhe jo "incident kalimtar" siç thotë Ismail Kadare . Nga aspekti kulturor shpeshherë dy vendet përkujtojnë veprën e figurave që janë edhe shqiptare edhe turke. Kështu që në këtë drejtim është mbajtur simpozium shkencor dedikuar poetit turk me origjinë shqiptare, që u mbajt në Prishtinë, nga Agjencia Turke për Bashkëpunim e Zhvillim Tika. Koordinatori i projektit për Kosovë i TIKA-së, Kurshad Mahmat, foli për anët e përbashkëta të dy kombeve: "...Anët tona të përbashkëta, afërsia jonë është shumë më e madhe sesa në të vërtetë po dihet. Kultura e përbashkët dhe mënyra e përafërt e jetesës e formuar gjatë historisë... për fat të keq ende nuk po dihet aq sa duhet, ashtu siç edhe nuk po i jepet shumë rëndësi... Në këtë kuptim, ne po mundohemi që vëllazërinë turko-shqiptare, jetesën e përbashkët dhe afërsinë historike në çdo rast ta përmendim dhe po bëjmë përpjekje që në mënyrë të drejtë kjo të kuptohet".

Pra feja ruajti, kultivoi dhe u bë mbështjellësi më i mirë i ruajtjes së qenies kombëtare shqiptare dhe identitetit shqiptar dhe se identiteti fetar aspak nuk ishte incident rasti, siç thuhet nga disa. Do thënë se kështu dhe në këtë mënyrë Kur`ani dhe Islami ndër shqiptarët me kohë do të bëhen përbërës dhe përcaktues edhe të identitetit qytetërues-shqiptar dhe se procesi i thellimit të kalimit në Islam, kultivimi dhe ruajtja e Islamit si fe e pjesës absolute të popullsisë. Një pjesë e kulturës sonë dhe e letërsisë sonë është e përshkuar ndjeshëm nga Kur`ani dhe Islami, që është një dimension i ri (letrar e kulturor, filozofik e kuranor) e që përbën njëkohësisht edhe njërin nga tre përbërësit kryesorë-përcaktues të identitetit tonë qytetërues. Kjo mbase mund të duket e papranueshme, por është e vërtetë dhe reale.

Islami - faktor i universializmit, historizimit dhe i ndërmjetësimit

Tradita fetare turke ka lënë gjurmë të pashlyeshme në mënyrën e organizimit të jetës fetare dhe stilin e predikimit fetar, te ne si popull. Në përgjithësi në botën e sotme Islame janë të përhapura tri metoda klasike të mësimit të hivzit: a) stili osman, me ç'rast nxënësi (talebe) mëson hivzin duke nisur mësimin nga faqja e fundit e secilit xhuz, pastaj faqen e parafundit të secilit xhuz, e kështu me radhe deri në fund të mësimit të hivzit. Kjo metodë e mësimit të hivzit përdoret në trojet tona shqiptare si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Luginën e Preshevës, në Mal të Zi, po ashtu edhe në Sanxhak, Bosnjë e Hercegovine, Turqi etj.

Natyrisht që Turqia është një vend i madh që mund të aspirojë fare mirë për t'u bërë një fuqi globale, duke ndërmarrë për këtë qëllim dhe nismat e duhura politike, propagandistike etj. Nga ana tjetër, shqiptarët i kanë të gjitha arsyet ta shohin me simpati rritjen e pranisë politike dhe ekonomike turke në rajon, si dhe në vendin tonë ku, siç dihet, vitet e fundit vërehet një rritje e ndjeshme e kësaj pranie, sidomos në ekonomi.

Vlen të përmendet gjithashtu, rrjeti i gjerë i institucioneve arsimore turke në Shqipëri, me mbi 7.000 frekuentues (3860 aktualisht dhe 3260 që janë diplomuar) dhe 612 mësues e staf administrativ. Institucionet arsimore turke sot mbulojnë në Shqipëri thuajse gjithë ciklin arsimor, që nga kopshti deri tek universiteti, duke qenë padyshim dhe një faktor i rëndësishëm i promovimit të gjuhës dhe të kulturës turke. Ndër të tjera, kjo shpjegohet dhe me reputacionin e mirë që ato përgjithësisht gëzojnë, si për cilësinë, ashtu dhe për disiplinën që ofrojnë.

Kalimi nga besimi i krishterë në atë Islam i banorëve të trevave ilire para ardhjes së osmanlinjve dhe masivisht në shek XVI-XVII pas ardhjes së turqve, pati një ndikim të madh dhe pozitiv në formimin e kombit shqiptar. "*Shqiptarët u islamizuan*, thotë Myftar Spahija, *se nuk deshën me u ba serbë, deshën me mbet shqiptarë*". Armiqtë tanë

islamizimin e shqiptarëve e kanë paraqitur dhe vazhdojnë ende ta paraqesin si fatkeqësi për Ballkanin. Realisht është fatkeqësi për ta, mbasi kjo gjendje e re në Ballkan neutralizoi ambiciet e tyre për asimilimin e plotë të shqiptarëve. Publicisti dhe intelektuali i shquar Faik Konica thotë: "*Të mos ishte Islami, populli i ynë do të ishte shumë më tepër në numër, por jo shqiptar*". Çështja kombëtare mori një impuls të ri, kur populli përqafoi Islamin. Feja islame u bë faktor bashkues shpirtëror. Shumica myslimane e shqiptarëve solli kushte më të favorshme për unitetin dhe bashkimin kombëtar të tyre.

Orientimet e dy vendeve nga çështjet e rëndësishme për dy popujt

Sipas Gokalipsit, qytetërimi është ndërkombëtar kurse kultura kombëtare, ngase kombet që jetojnë në një rreth shoqëror të përbashkët mund të formojnë edhe qytetërim të përbashkët. (*Ozakpënar, 2003: 35*). Kurse Ahmed Sheuki, poet arab me të drejtë thotë se "problemet i bashkojnë njerëzit me probleme". Njerëzit më së shumti i bashkojnë problemet e përbashkëta dhe konfrontimi me armikun e njëjtë. Dy vendet me popullsi shumicë dërrmuese myslimane para vetes kanë sfida të llojeve dhe fushave të ndryshme, e sidomos në paraqitjen e islamit me fizionominë çfarë e ka në të vërtetë islame, e jo në atë që dikush po mundohet të bëjë islamin sipas dëshirave dhe grupeve të vogla të interesit, që po i bëjnë dëm të madh bashkësisë myslimane. Dy vendet të vazhdojnë në formimin dhe shkollimin e gjeneratave të ardhshme që do të bartin islamin mbi supet e veta.

Perspektiva e dy vendeve dhe integrimet

Proceset e integrimit brenda BE-së dhe për në BE për myslimanët janë të vështira, të paarritshme, të paqarta dhe shumë të shtrenjta. Integrimi për shumë qarqe sot në Evropë nënkupton asimilimin dhe shkrirjen e tipareve dalluese të grupeve pakicë në ato shumicë, përkatësisht të emigrantëve në grupet nacionale të shteteve përkatëse. Pra-

ndaj, identitetin e pashpërbëshëm islam disa e konsiderojnë refuzim ndaj integrimeve dhe kolonizim të vendeve të tyre .

E përbashkëta e të gjitha raporteve për diskriminim ndaj myslimanëve është konstatimi që rreth 70% e të gjitha diskriminimeve dhe abuzimeve kanë të bëjnë me gratë myslimane: të drejtat e tyre për manifestimin e lirive dhe bindjeve fetare për të mbajtur veshjen islame, të drejtat në arsim, punësim dhe qasje në shërbimet publike.

Faktori fe ishte ndër faktorët e rëndësishëm në procesin e integrimit të perandorive mesjetare, kurse roli i feve në integrimin e njësive etnokulturore e gjeopolitike kombëtare do të shfaqet në fillet e kohës së re, në periudhën e Rilindjes, me një rëndësi të shtuar gjatë Humanizmit, Iluminizmit dhe Rilindjes Kombëtare.

Të dhënat nga hulumtimet interdisiplinare albanistike tregojnë se roli i Islamit në procesin e integrimit të njësisë etnokulturore e gjeopolitike të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar ishte i natyrës komplekse politike, sociologjike, etnokulturore, filozofike, fetare, gjuhësore, letrare, arsimore, artistike, juridike etj. Roli i fesë dhe i kulturës islame në procesin e integrimit të njësisë etnokulturore e politike të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar do të kuptohet më mirë vetëm pasi të kemi një pasqyrë sa më të qartë të realitetit shoqëror, politik, administrative fetar, arsimor e kulturor në trevat albanofone në periudhën e dezintegrimit administrativ shtetëror, politik, ekonomik e fetar të pèrandorive, pjesë të të cilave ishin trevat e veçanta të truallit albanofon. (*Hammer, 1979:1*).

Për të sqaruar këtë çështje, paraprakisht është e nevojshme të kuptohet drejt e pa paragjykime fakti se ku e shpinte trevën albanofone ndarja mesjetare në shumë njësi administrative sistemesh të veçanta: greke, sllave e latine, italiano-frënge sikurse edhe copëtimi feudal i brendshëm, në kushtet e veprimit të tri kishave antagoniste antishqiptare; greke bizantine, serbe svetisaviane dhe katolike latino-evropiane e përçarë. Të ndriçohet drejt rëndësia që ka shteti unik, njësia administrative osmane mbi trevat albanofone për lidhjen e copave territoriale me tradita fetare, arsimore, kulturore e shtetërore të ndryshme dhe antagoniste e separatiste e njërës pjesë ndaj pjesës tjetër. Kontinenti evropian nuk ka prejardhje vetëm të krishterë.

Është i madh numri i intelektualëve dhe i politikanëve evropianë të cilët vitin e kaluar kanë kundërshtuar nismën për të futur në Kushtetutën e BE-së konceptin mbi prejardhjen e krishterë të kontinentit. Shkrimtari dhe teoriku i njohur italian, Umberto Eko, e kundërshton atë nismë për dy arsye: e para për arsye politike dhe e dyta për arsye historike... Kulturën evropiane e kanë pasuruar matematika e Indisë, mjekësia arabe, filozofia dhe shkenca greke, kur e kur e zbuluar në Evropë përmes arabëve, filozofia dhe shkenca romake, gjuha latine si gjuhë e ritualeve të shenjta, mitet dhe adetet pagane me trajtat e politeizmit, monoteizmi i hebrenjve. *(Qosja, 2006: 32-33)*

Fushata kundër Islamit në Shqipëri mund të ketë si pikënisje deklaratat e Ismail Kadaresë, më 1991, kur ai mbështeste fushatën kristjanizuese dhe zhdukjen e Islamit në vend, si kusht për integrimin e shqiptarëve në Evropë. Në vitet në vijim, pas Kadaresë janë rreshtuar një numër fondamentalistësh të krishterë dhe laikë. Piro Misha, Mustafa Nano, Aurel Plasari, Neshat Tozaj, Arben Xhaferri, Maks Velo, Remzi Lani, Rexhep Mejdani, Fatos Nano etj., janë disa nga ata dhjetëra emra, të cilët sa me fjalë aq edhe me vepra kanë nxitur racizëm dhe islamofobi, në Kosovë dhe në Maqedoni, kanë shpallur Islamin dhe myslimanët si të rrezikshëm, dhe u kanë kërkuar politikanëve shqiptarë që ta largojnë Shqipërinë nga Konferenca Islamike (OKI), pasi vetëm në këtë mënyrë mund t’i bashkohemi Evropës.

Racizmi dhe islamofobia e Kadaresë vazhdon të shfaqet edhe në shkrimet e tij të ditëve të sotme. Në esenë “Identiteti evropian i shqiptarëve” (2006) islamofobia dhe racizmi i veprës së tij, ndërlidhet me të ashtuquajturën luftë kundër terrorizmit, ku Kadareja përpiqet t’i bindë shqiptarët, që si evropianë që ata janë duhet të divorcohen nga Islami. Në esenë në fjalë Kadare sulmon pjesëmarrjen e Shqipërisë në OKI, si dhe përpjekjet e disa intelektualëve shqiptarë që i përshkruajnë shqiptarët si myslimanë. Ai i sulmon personat që e shohin Shqipërinë si pjesë të botës myslimane, madje sulmon edhe praktikat fetare të besimtarëve myslimanë, siç është përulja e tyre gjatë faljes. Sipas

Kadaresë, shqiptarët janë vetëm evropianë dhe si të këtillë nënkuptohet të jenë anti-islam.

Duke e ndarë botën në dy pjesë – në perëndim dhe atë që mbetet prej tij - Kadare deklaron se Shqipëria nuk mund të bëjë pjesë sa në Azi aq edhe në Evropë, por ajo bën pjesë vetëm në Evropë, dhe si rrjedhojë nënkuptohet, që i përket vetëm krishterimit. Nëse ju kujtohet, i pari shqetësimin për këtë e ngriti Arbër Xhaferi, në shtator 2007. Në shkrimin "Pasojat e akraballëkut" ai tërhiqte vëmendjen për faktin se segmente të caktuara të shoqërisë apo shtetit turk, nën petkun e veprimtarive fetare, po organizonin e financonin manifestime, qëllimi i vërtetë i të cilave dukej se ishte të tregonin se shqiptarët janë pjesë e pashkëputur e qytetërimit osman. Si ilustrim, ai përmendte një ngjarje të ndodhur në Librazhd, ku autoritetet fetare të kësaj ane, së bashku me segmente të caktuara turke, organizuan synetimin kolektiv të më se 200 fëmijëve shqiptarë, sipas traditës turke. Kamera e Top Channel-it, vazhdonte Xhaferi, na ofroi pamje nga kjo ngjarje bizare, ku fëmijë të veshur me rroba prej sateni të bardhë, me kapuç në trajtë të fesit ku shkruhej "Mashallah", valëvitnin herë flamuj të shtetit turk herë ata shqiptarë…. Ç'është e vërteta, vazhdonte ai, ngjarje të tilla politiko-fetare s'janë aksidentale….Kohë më parë në muajin e Ramazanit, struktura të tilla organizonin iftare kolektive në sheshet e qyteteve, që dikur ishin të sunduara nga Perandoria Osmane.

Ofendimi më i madh që islamofobët kanë prodhuar kundër myslimanëve shqiptarë në vitet e pas-komunizmit ka ardhur nga fjalimi i ish-presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu, bërë më 10 nëntor 2005, në Forumin e Oxfordit me titull "Toleranca ndërfetare në traditën shqiptare". Në fjalimin në fjalë ish-presidenti ndër të tjera ka deklaruar se "Islami në Shqipëri nuk është fe burimore, por i sjellë nga faktori ushtarak turk… islamizmi në Shqipëri nuk është fe e përhapur në kohën e origjinës, as besim rezidencial, por një dukuri e ardhur dhe e trashëguar në gjuhën dhe liturgjinë e atij faktori që e solli" dhe se "Si rregull është një islamizëm i cekët. Te çdo shqiptar, po të gërmosh pak do të zbulosh thelbin e tij të krishterë..."

Popullsia shqiptare e Kosovës, e cila është pothuajse e tëra myslimane ka dëshmuar një vlerë të identitetit kombëtar, duke mos u zhdukur apo asimiluar nga represioni serb. Me kulturën e tyre prej muslimanësh të devotshëm i dhanë kombit tonë një dimension të ri evropian për mënyrën se si do të marrin pavarësinë. Ne si popull kemi gjetur mbështetje në ajetet kur'anore ***"Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim."*** (*Nahl, 90*) ***"Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju; e nëse duroni pa dyshim ai është më i mirë për ata që durojnë."*** (*Nahl, 126*) Ky parim i mrekullueshëm islam e bën të qartë faktin, se nuk ka njerëz, racë e komb të veçantë që është më i mirë se të tjerët. Allahu na ka krijuar të barabartë. Allahu thotë se më të ndershmit nga ne janë të drejtët. Ky ajet na mëson të jetojmë në paqe me kombet jera dhe të respektojmë njëri-tjetrin për dallimet tona.

Duhet të mësojmë të jetojmë së bashku e të njohim njëri-tjetrin e të angazhohemi për dialog mes kombeve e të trajtohemi mes njëri-tjetrit si të barabartë në qenie të karakterit.

Turqizmat në gjuhën shqipe

Jo pak fjalë turke me kalimin e kohës janë bërë pjesë e së folmes dhe të shkrimit shqip. Elementet turke në gjuhën shqipe janë veçanërisht të theksuara në qytete, mbase edhe fare pak në fshatra. Këto elemente turke përfshijnë të gjitha anët e jetës sociale, shtëpiake, administratë shtetërore, si: arkitektura, mënyra e banimit, orenditë shtëpiake, kuzhina, gjellrat, kostumet, kozmetika, stolitë, zakonet e lindjes, martesat, festat, dëfrimet popullore, muzika me veglat muzikore, artizanalet, besimet popullore të jetës fetare me të gjitha terminologjitë islamike, jeta e përditshme sociale, terme të administratës, ushtrisë dhe luftës. Vërshimi i vërtetë i turqizmave në gjuhën shqipe të qyteteve filloi nga fundi i shek.XVII dhe në fillim të shek.XVIII, duke përfshirë këtu edhe fjalët me burime arabe dhe persiane, të cilat hyn në gjuhën shqipe përmes gjuhës turke.

Meshari i Buzukut, me vetëm 5 fjalë turqizma, fjalori latinisht-shqip i F.Bogdanit, me rreth 400 faqe, e që i takon gjysmës së parë të shek.XVII. Sot mendohet se në gjuhën shqipe janë dokumentuar rreth 4000 fjalë, të cilat kanë hyrë drejtpërdrejt në gjuhën shqipe dhe sipas burimit të tyre turqizma të mirëfillta janë rreth 2000 fjalë po aq arabizma 1500 dhe persianizma rreth 500, por të pranuara në gjuhën shqipe përmes turqishtes.

Sfera ku kanë hyrë turqizmat	**Numri i turqizmave për sferën përkatëse**
1	**2**
1. Administrata, gjykata, ushtria	rreth 800
2. Feja islame	rreth 170
3. Ushqimi, mjetet e gatimit e të ngrënies	rreth 360
4. Veshmbathja e stolitë	rreth 420
5. Zejtaria, ndërtimi e arkitektura	rreth 380
6. Shëndetësia, mjekësia	rreth 250
7. Ekonomia, tregtia, marrëdhëniet pronësore ekonomike-shoqërore	rreth 320
8. Arsimi	rreth 90
9. Lojnat e zbavitjes	rreth 100
10.Etika, estetika	rreth 50
11 Masat e kohës, të vëllimit, të peshës dhe monedhat	rreth 120
12.Ngjyrat	rreth 30
13.Muzika	rreth 100
14. Lundrimi e mjetet e tij	rreth 70
15. Bujqësia e blegtoria (duke përfshirë florën e faunën)	rreth 430
16. Dukuritë gjeografike-natyrore	rreth 80
17.Sferat tjera	mbi 200

*(S. Ibrahimi, 2005:.54-56)

Roli i bashkësisë islame në forcimin e raporteve mes dy vendeve

Dy Bashkësitë Fetare, në mënyrë permanente janë angazhuar me vite të tëra që të mbjellin një klimë të favorshme si dhe të thellohen vizitat dhe kontaktet politike mes dy shteteve mike. Në kuadër të seminarit që u organizua nga DIJANET-i i Turqisë për trajnimin e administratës dhe personelit e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke u njoftuar për së afërmi me përvojën, sistemin dhe traditën e punës së zyrtarëve të këtij institucioni më të lartë fetar në Turqi.

Në saje të bashkëpunimit të ngushtë mes BIK-së dhe Dijanetit të Turqisë shumë studentëve kosovarë iu mundësua vazhdimi i studimeve në universitete të ndryshme të Turqisë. Njëri ndër universitetet që ka pranuar më së shumti studentë nga Kosova është Universiteti "ULUDAG" në Bursa, më 2007/2008 numëroi 24 studentë

Lidhjet fetare, kulturore dhe elementet e përbashkëta si dhe rileximi i historisë

Gjendja e vërtetë e Perëndimit jep shenja se e ka kapluar një sëmundje e pashërueshme, sepse feja të cilën e shekullarizoi Ilumunizmi dhe vlerat “shpirtërore” që i zhvilloi ai, janë harxhuar nga format moderne. Për Perëndimin është vështirë që të kthehet prapa. Nëse një herë ka hyrë në një rrugë edhe nëse dëshiron madje të kthehet prapa, nuk mund ta realizojë atë. Bile edhe nëse insiston të kthehet prapa, do ta gjejë mesjetën e vet. *(Bullaç, 2003:304)*

Në Shqipëri, islamofobia dhe qëndrimet raciste hasen shpesh në komunikimin publik të shumë medieve. Fyerjet kundër arabëve, turqve, aziatikëve, kinezëve, evgjitëve, myslimanëve me mjekra dhe grave me shami shpalosen herë pas here në shtypin tonë dhe shpesh prononcohen nga njerëz të cilët e kaluara komuniste e vendit tonë i ka ngritur në nivelin e “elitave”. Rasti i Ismail Kadaresë, me esenë e tij "Identiteti evropian i shqiptarëve" (2006), autori përshkruante shqiptarët të

ndarë si me thikë ndërmjet Azisë dhe Evropës, se ata i përkasin vetëm Evropës, e cila përshkruhej si e bardhë, e krishterë dhe e civilizuar – ndërsa Azia si jo e bardhë, myslimane dhe e paqytetëruar, janë një shembull par excellence i komunikimit islamofobik dhe racist të Shqipërisë pas-komuniste. Por, jo gjithmonë është e njëjta situatë.

Në Prishtinë, nën moton "Mehmet Akif Ersoy – poet i civilizimit tonë", më 12 mars u organizua një simpozium shkencor dedikuar poetit turk me origjinë shqiptare. Simpoziumi u mbajt në 89-vjetorin e pranimit të Himnit Kombëtar Turk, të shkruar nga Mehmet Akif Ersoj. Prezentë ishin shumë studiues e intelektualë nga bota shqiptaro-turke. Prof.Mehmet Xhemal Ciftciguzeli nga Turqia tha: "...Mehmet Akif Ersoy, patjetër se është njeri shumë i rëndësishëm... ai është një poet i mbushur me ndjenja nga këto troje. Ai ka shumë poezi lidhur me problemet shoqërore, me varfërinë... aty janë dhënë shembuj se si mund të mundet varfëria. Trashëgimia osmane në shoqërinë shqiptare ashtu si në të gjitha vendet tjera të Ballkanit është e shumtë dhe omniprezente: në fe, në gjuhën kombëtare, në mënyrat e jetesës, në rregullat e sjelljes, në jetën shtëpiake etj. Kuptimi i saj është ambivalente. Sepse trashëgimia osmane është e lidhur me kombin, bën pjesë në historinë kombëtare, bën pjesë në shqiptari, dhe e marrë në dorë nga fjalimet nacionaliste, perceptimi i saj prezanton një dualizëm të pastër të fakteve kombëtare: i njëjti realitet përdoret për të afirmuar një fakt dhe të kundërtën e tij.

Kështu nëse i referohemi historianit turk Abdul Kadir Ozcan thekson:

"Perandoria Osmane pati plot 34 kryevezirë (kryeministra) dhe ata qëndruan në krye të qeverisë afërsisht 100 vjet ose 1/6 e kohës së ekzistencës së kësaj perandorie".

Pse Evropa po i afron shqiptarët më ngadalë se popujt tjerë të Ballkanit? Sigurisht jo për shkak se në identitetin e tyre, në atë përgjithësinë, në atë të tërën, që i themi identiteti kombëtar i shqiptarëve, është i përmbajtur edhe identiteti mysliman i numrit më të madh të tyre.(*Qosja ,2006:79*) Kufijtë politikë përherë e më tepër po ripërcaktohen për t'u përputhur me kufijtë kulturorë; etnikë, fetarë e qytetrimorë. Bashkimet kulturore po zëvendësojnë blloqet e Luftës së ftohtë dhe vijat e shkëputjes ndërmjet qytetërimeve po bëhen vijat qendrore të konfliktit në politikën globale. (*Huntigton, 2004:193*)

Përfundim

Lidhja e fuqishme fetare mes dy vendeve, do të jetë shembull i bashkëpunimit serioz dhe në shërbim të Islamit në përgjithësi dhe hap perspektiva dhe mirëqenie për dy popujt mik, që shpeshherë i kanë ndarë fatet me njëri-tjetrin. Të dyja vendet duhet që edhe më shumë t'i intensifikojnë bashkëpunimet në rrafshin fetar, politik, ekonomik, kulturor e besa edhe atë medial, ku do të eliminohen edhe pak ato paqartësi që janë mbjellë nga ata që s'ia duan të mirën, së pari popullit shqiptar e më pas dhe atij turk. Feja ka luajtur dhe do të luajë një rol shumë pozitiv në zhvillimin e marrëdhënieve për paqe, tolerancë kudo në botë dhe mirëqenie mes dy popujve si dhe do të jetë një mekanizëm i cili do të ndihmojë në integrimin sa më të shpejtë të të dyja vendeve në Bashkimin Evropian, aty ku edhe e kanë vendin dy shtetet ku do të mundësonte që të dëgjohej dhe zëri i myslimanëve në seancat e Parlamentit Evropian dhe mekanizmave tjerë përcjellës. Bashkëpunimi dhe vëllazërimi i mëtejmë nxiten dhe zhvillohen në saje të elementit dhe identitetit fetar e kulturor që e ndajnë dy popujt.

Literatura e konsultuar:

Ahmeti, Sherif (1413), ”Kur’ani përkthim me komentim në gjuhën shqipe. Medine, Arabia Saudite.

ARNOLD, Thomas W (2004), “Historia e përhapjes së Islamit”, Prishtinë, p.172.

BULAç , Ali (2003), “Historia, shoqëria dhe tradita”, Logos A, f. 304.

CARTER, Jimmy (2005), “Our endangered values. America’s moral crisis”, p.16, 30.

DE LA ROKA, Roberto Maraco (1944,) “Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944”, Tiranë , f. 23.

FALASHI, Renzo (1985), Ismail Kemal bey Vlora, Romma, f. 11.

FERRRAJ,Hysamedin (1998), “Skicë e mendimit politik shqiptar” Koha, Tiranë, f. 51.

HAMMER, Von (1979), “Historija, turskog (osmanskog) carstva, 1, 2, 3” Zagreb, f. 1.

HASANI, Ismail (2001), “Vetëdija fetare dhe kombëtare te shqiptarët” UP, Prishtinë, f. 103-104.

IBRAHIMI, Nexhat (2002), “Islami në Ballkan para shekullit XV” bot. II, Prizren IBRAHIMI, Nexhat (2003), “Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar”, Shkup.

IBRAHIM, Sami (2005), “Ndikimi i gjuhës shqipe në turqishtën e folur në Maqedoni dhe në Kosovë/rrafshi fonologjikë”. Logos-A, f.54-56.

LONGLEY, Clifford (2002), “Chosen People...”, England, p. 148.

OZAKPËNAR, Jëllmaz (2003), “Kultura dhe qytetërimi/ një teori mbi qytetërimin”,Logos- A, f.35.

QOSJA, Rexhep (2006), “Realiteti i shpërfillur (vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar” Toena, Tiranë, f.32-33.

QOSJA, Rexhep (2006), “Realiteti i shpërfillur (vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar)”, Toena, Tiranë, 2006, f.79.

Mr. Rexhep Suma

THE IMPACT OF RELIGION IN BUILDING AND DEVELOPING ALBANIAN-TURKISH RELATIONS

(Summary)

The impact of religion in building and developing Albanian-Turkish relations is of great importance, especially nowadays, bearing in mind the circumstances the Islamic Ummah in general and the two nations in particular are going through.

Jonathan Sacks has stated: “Religion has become a major force in shaping world events - and if it does not become part of the solution, it will certainly be part of the problem”. On the other hand, Jimmy Carter, the former president of the USA, stated: “recently, religion has entered the political sphere… and there is… an inclination towards fundamentalism in all religions”.

رجب سوما

تأثير الدين فى بناء و تطوير العلاقات الالبانية التركية

(خلاصة البحث)

ان تأثير الدين فى بناء و تطوير العلاقات الالبانية–التركية له أهمية خاصة فى الزمن و الظروف التى تمر بها الامة الاسلامية بصفة عامة و الشعبين بصفة خاصة.

هكذا نرى جوناتان ساكس يقول: " لقد اصبح الدين قوة هائلة في لعب دور الأحداث في العالم و اذا لم يكن هو جزءا للحل فإنه يكون جزاء للمشكلة". وفي نفس الوقت نرى جيمي كارتر الرئيس الأسبق للولايات المتحدةيعبر عن هذا الموضوع بقوله "يسود الاعتقاد في السنوات الأخيرة بان العامل الديني دخل بدرجة عالية في مملكة السياسة و هناك اتجاه للتعصب في كل الاديان".

(Longley, 2000: 148; Carter, 2005: 16-30).

AKTUALITETE

THIRRJE NË UNITETIN ISLAM[G]

Shkatërrimi i Perandorisë Osmane, i fillimit të shekullit XX, ishte faktori kryesor që e përcaktoi gjendjen e botës islame deri në përfundimin e këtij shekulli për shumë shtete të reja që filluan të ngriten nga hiri i tyre. Megjithatë, asnjëra nga ato shtete për popullin e saj nuk e arriti kurrë më shkallën e stabilitetit dhe të kënaqësisë, të cilën ata e gëzonin gjatë kohës së Perandorisë Osmane.

Me fillimin e shekullit XXI shumë probleme dhe konflikte presin në zgjidhjen e çështjeve të tyre. Ekuilibri i shkatërruar me rënien e Perandorisë Osmane, asnjëherë më nuk u vendos në mënyrë të kënaqshme dhe mu për këtë lindën këto vatra nëpër territore të ndryshme dhe shumë të ndjeshme, të cilat në shumicën e rasteve ndodhen në botën islame. Disa nga këto probleme kaluan me masa të përkohshme, sepse u vazhdua me nxitjen e tensioneve dhe konflikteve tjera deri më sot.

Me shumicë këto konflikte i godasin vendet e dendura të banuara me myslimanë (p.sh. Palestina, Kashmiri, Avganistani, Iraku dhe të tjerë). Përveç kësaj, rritja në dukje si e pashmangshme e konfliktit të civilizimeve, si dhe sulmet propaganduese kundër myslimanëve, bënë që bota islame të jetë caku kryesor në sytë e disa individëve nga qarqet njerëzore. Mënyra e këtillë e afrimit shkakton tensione artificiale të panevojshme si dhe në mesin e shoqërisë krijon një frikë. Këto

probleme nxisin pyetjen siç është për shembull: “Cilën strategji më parë do ta parapëlqejnë myslimanët në shekullin XXI”?

Civilizimi islam, që prezantohej me Perandorinë e madhe Osmane, Safavide, dhe atë Mogule, në shekullin XVI dhe XVII ishte një fuqi predominante në Azinë qendrore dhe jugore, në Afrikën Veriore dhe në Evropën Jugore. Osmanët sundonin me një territor të madh, në të cilën përfshiheshin, Ballkani, Anadolli, Mesopotamia, dhe pjesët e Arabisë dhe të Afrikës Veriore; Safavidët sundonin me Persinë si dhe me disa krahina përreth; ndërsa Mogulët sundonin me një pjesë të madhe të nën kontinentit Indian. Ndërkaq, pushtimi islam gradualisht filloi të zvogëlohet dhe të dobësohet. Në fillim me rënien e Mbretërisë Mogule, filloi një epokë e re për myslimanët e Azisë Jugore. Trashëgimtari i Mbretërisë Safavide, nga dinastia e Kaxharëve, arriti që të mbijetojë deri në vitet e njëzeta të shekullit XX, por pa ndonjë forcë dhe ndikim. Këto vende gradualisht ranë nën pushtimin britanik dhe rus. Ndërkohë, që Perandoria Osmane, e cila ishte dobësuar mjaft gjatë humbjeve të njëpasnjëshme të territoreve dhe të kryengritjeve të brendshme, pas Luftës Parë Botërore përfundimisht u shkatërrua.

Shkatërrimi i Perandorisë Osmane, si shtetit më të madh dhe më me ndikim në botën islame, bëri ndërrime historike në gjeografinë islame, posaçërisht në Lindjen e Afërt dhe në pjesën e Gadishullit Arabik. Deri në fund të shek. XX, shtetet nacionale të vendosura nga depërtimet e fuqive evropiane, mbetën burim i tensioneve dhe të pakënaqësive rajonale. Bota islame, e cila kishte dhënë shumë për përparimin e civilizimeve të mëdha, filloi tërheqjen brenda saj. Myslimanët e Lindjes së Afërt, si dhe të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugore, nga sundimi kolonialist vuajtën dhe u shtypën shumë. Shumica e këtyre vendeve arritën ta fitojnë pavarësinë tek në gjysmën e dytë të shek. XX. Lufta për pavarësi në disa vende solli shumë gjakderdhje, si p.sh. ajo në Algjeri. Në këtë shtet vdiqën miliona njerëz të pafajshëm, kurse nga pasojat e ndjekjeve torturave dhe mundimeve që ushtroheshin ndaj tyre, një numër i konsiderueshëm i njerëzve mbetën invalidë të përjetshëm. Edhe pas arritjes së pavarësisë dhe tërheqjes së forcave kolonialiste, në ato vende nuk u vendos paqja dhe liria. Shkurt, pjesa e

madhe e botës islame në shek. XX jetoi duke toleruar luftëra, konflikte, varfëri, dhe pikëllime e mjerime. Ndërkaq, që duhet ditur se bota islame nuk ishte çdoherë kështu.

Historia, në XIV shekujt e fundit në tërësi, zbulon një fotografi tjetër: përparimi më i ndritshëm i kulturës dhe shkencës njerëzore u mundësua falë paraqitjes së islamit. Në kohën kur Evropa ishte në errësirë të plotë, myslimanët ishin ata që në rruzullin tokësor vendosën një civilizim të pabesueshëm, ndërsa morali islam ndriçonte botën.

Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi të shkruajë me pendë… *(El Alak,1-4).*

Feja islame, të cilin ne sot e njohim, lindi para 14 shekujve në Gadishullin Arabik, të Azisë Jugperëndimore. Zbulimi i fundit i librit të shenjtë Kur'anit nga Allahu xh.sh. të Dërguarit të Zotit Muhamedit a.s. qoftë Allahu i lumtur me të, pjesë përbërëse e së cilës është morali islam, bëri që njerëzit e pakulturuar, të padijshëm dhe të dhunshëm të këtij rajoni, të mësojnë për mirëkuptim, paqe kulturë dhe civilizim. Në fillim të shekullit VII, Arabia ishte njëra nga vendet më kaotike në botë. Në këto territore jetonin shumë fise, nga të cilat secila për vete kishte nga një idhuj të cilin e adhuronin. Ata i shpallnin luftë njëra-tjetrës, derdhën shumë gjak, dhe shkuan aq larg me krime sa që i mbytnin edhe fëmijët e vet, e tërë kjo ndodhte për shkak të idhujtarisë dhe besimeve të shtrembëruara. Mënyra e besimit të tyre nënkuptonte barbarizëm, urrejtje, dhe dhunë, në vend të dashurisë, mëshirës dhe mirësisë. Femrat i konsideronin qenie për të kënaqur epshet seksuale, kurse të varfrit dhe robërit shfrytëzoheshin në mënyrë më mizore.

Me ardhjen e islamit dhe normave morale të saj, kjo botë e përgjakur dhe e errtë tërësisht ndryshoi. Edhe pse arabët ishin të parët që e pranuan islamin, së shpejti edhe shumë popuj tjerë e përqafuan dritën të cilën ua solli morali islam. Zbulimet e Kur'anit, myslimanëve u mundësuan të arritura të pakrahasueshme në përparimin e shkencës, kulturës dhe të artit. Me shpalljen e ajeteve të para nga Kur'ani, populli i këtij rajoni, që deri në këto ngjarje të fillimit të shpalljes, ishte e ngujuar në një rreth të errësirës dhe së keqes, injorancës dhe dhunës së përgjakshme, për herë të parë u thirr që të mendojë dhe studiojë.

Shoqëria arabe, me ardhjen e islamit tërësisht ndryshoi. Për shembull, zakonet arabe kërkonin që të gjithë robërit e luftës të vriten, ndërsa i dërguari i Allahut, profeti ynë Muhamedi a. s. qoftë paqja dhe mëshira e Allahut mbi të, urdhëronte që ndaj robërve të tillë (lexo të luftës) të veprohet me mirësjellje, si dhe racionet e ushqimit të ndahen bashkërisht me të burgosurit, në mënyrë që edhe ata të ushqehen dhe të mbrohen nga uria. Ajeti i Kur'anit në vijim zbulon këto kualitete të myslimanëve:

Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. *(El Insan, 8).*

Gjëja e vetme që kërkohej nga këta robër, ishte që myslimanët t'i mësojnë me shkathtësitë e të shkruarit dhe të lexuarit, nëse ata i posedonin këto aftësi. Ndoshta ishte hera e parë që Arabia dëshmoi për mëshirë, falje dhe civilizim. Si rezultat i kësaj, Arabia e shijoi njërin nga periudhat më të suksesshme të kulturës dhe përparimit të saj.

Me kalimin e viteve, drejtësia dhe morali i lartë islam nëpër Arabi zgjerohej sikurse valët e detit. Sinqeriteti, nderi dhe vendosmëria e myslimanëve i përvetësonte shumë fiset arabe. Në vitin 630, ushtria e fuqishme myslimane u drejtua kah Meka. Idhujtarët e Mekës frikoheshin nga hakmarrja, të cilën myslimanët kishin mund ta ushtronin mbi ta si rezultat të mizorive të mëparshme ndaj myslimanëve. Ashtu siç e kërkonte zakoni arab, që meshkujt e fisit që kishin humbur luftën, vriteshin, ndërsa gratë dhe fëmijët dërgoheshin si robër. Ndërsa profeti ynë Muhamedi a.s. paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, duke treguar mëshirën e Allahut, vepronte në të kundërtën e këtij zakoni, me ç'rast i paralajmëroi se askush nga Mekja nuk do të pësojë nga hakmarrja, si dhe askush me dhunë nuk do ta pranojë islamin. Ky akt i faljes dhe i bashkëjetesës e tërhoqi vëmendjen e historianëve perëndimorë. Në filmin dokumentar të shtëpisë-TV, PBS, *Islami: Mbretëria e fesë*, të autorit Michael Seals, ligjërues në Universitetin Haverfordks, ja se si paraqiten lidhjet e vlerave të Muhamedit a. s.:

“Kur Muhamedi hyri në Meke, ai jo vetëm që nuk bëri hakmarrje të përgjakshme, por në të vërtetë ai i përqafoi ata të Mekës, të cilët luftuan tre vjet kundër tij dhe të cilët u munduan që në çdo mënyrë ta mbysin dhe ta heqin qafe. Kjo ngjarje bëri që të mbesin të hutuar gati të gjithë ata njerëz që ishin përreth tij. Kështu në vetë fillimin e fesë mund të vërehet një shpirtmadhësi shumë, e gjerë dhe e përcjellë me akte të jashtëzakonshme të mirësisë dhe dhembshurisë.”

Gjëja më e rëndësishme ishte që banorët e Mekës të lirohen nga besimet e tyre të gabuara. Për këtë arsye Pejgamberi ynë, shpëtimi dhe paqja e Allahut qofshin me të, shkoi drejt në Qabe, dhe hyri në brendinë e gurit të zi (Mesxhidu-l-Haram), ku i shkatërroi të gjitha idhujt të cilët ruheshin brenda saj. Kjo ngjarje shënoi fundin e idiolatrisë, dhe fundin e të gjithë mizorisë, padrejtësisë, egërsisë dhe dhunës, të cilat fillonin në emër të idiolatrisë. Pasi që e mësuan Kur’anin, arabët bënë zëvendësimin e të gjitha zakoneve paraislame, me një rend të ri, të bazuar në respekt, dashuri, bashkëpunim dhe drejtësi në mesin e të gjithë njerëzve.

Toleranca, drejtësia dhe mëshira në moralin islam

Përhapja e Islamit vazhdoi shumë shpejt edhe pas vdekjes së profetit, qoftë mëshira dhe paqja e Allahut me të. Brenda disa dekadave ajo u përhap në tërë Mesopotaminë dhe Afrikën Veriore, duke arritur në Perëndim deri në Spanjë, dhe në Lindje deri në Indi. Arabët të cilët deri para disa dekadave jetonin si nomadë nëpër shkretëtira, duke iu falënderuar mendjes, kulturës dhe gjithanshmërisë të cilën e arritën nëpërmes islamit, tani u bënë sundimtarë të mbretërisë. Kjo ishte përhapja më e shpejtë e një mbretërie të arritur ndonjëherë. Në qindvjetshin e parë, mbretëria myslimane përfshiu territore të mëdha duke futur rrënjët shumë thellë. Në këtë hapësirë të madhe gjeografike ekzistonin njerëz të besimeve të ndryshme, të cilët jetonin në paqe. Prej tyre më së shumti kishte të krishterë dhe hebrenj. Myslimanët, si pronarë të sundimit suprem, çdoherë ishin tolerantë ndaj të gjitha besimeve tjera, dhe në vendet e tyre popullin nuk e detyronin me dhunë që ta

pranojnë islamin, me çka dëshironin ta respektonin lirinë e bindjes të çdokujt ashtu sikurse që urdhëron Kurani: ***Në fe nuk ka dhunë...*** *(El Bekare, 256).* Kishat dhe sinagogat ishin të mbrojtura, në kohën kur konvertimet e dhunshme në fe ishin bërë të zakonshme. Një tolerancë e tillë ishte e veçantë. Njëra nga shembujt e një tolerance të jashtëzakonshme ishte pushtimi i Jerusalemit. Patriku i Kishës Vari i Shenjtë i Jerusalemit frikësohej nga myslimanët se mos do ta shkatërrojnë kishën e tyre, për këtë arsye kalifi i dytë Omeri r.a. e vizitoi këtë kishë dhe tha se nuk ka nevojë për frikë dhe brengosje. Kur erdhi koha për faljen e namazit Kalifi e pyeti patrikun që të lejojë faljen e namazit pranë kishës. Pastaj në këtë vend të veçantë u ngrit xhamia Al Aksa.

Në një rreth të tillë të tolerancës, jomyslimanëve iu mundësuan të drejtat demokratike që të shprehin edhe ankesat e tyre. Gjatë periudhës Omajade, një numër i madh i krishterëve në Damask (Sham), gëzonin pozita të rëndësishme në burokratin shtetërore, ashtu që shërbimet e veta fetare i bënin si të donin. Disa shkruanin edhe libra në të cilat akuzoheshin myslimanët, duke mos pasur frikë se dikush mund të hakmerret.

Ndërkaq në të njëjtin kohë në Evropë sundonte një errësirë e fondamentalizmit dhe e barbarizmit. Kisha katolike i shtypte hebrenjtë, por edhe të krishterët që ishin me orientime tjera. Të detyruarit e dhunshëm në fe, si dhe mundimet dhe vrasjet në emër të fesë ishin bërë punë e zakonshme. Nga ana tjetër, myslimanët gjithmonë u treguan të mirë, tolerantë dhe të mëshirshëm ndaj ithtarëve të librit (hebrenj dhe krishterë), sepse Allahu në Kur’an ashtu urdhëron. Shembull i kësaj tolerance, akoma është Kisha e Shën Gjonit në Damask. Myslimanët të cilët e pushtuan këtë rajon, namazin e xhumasë filluan ta falin në kishë, ndërsa të krishterëve iu lejua që të dielave të vazhdojnë ta shfrytëzojnë kishën për shërbimet e tyre fetare. Dy fe të ndara në mënyrë paqësore e ndanin një objekt fetar (faltore) së bashku. Me rritjen e numrit të myslimanëve në qytetin e Damaskut, duke kërkuar lejen e të krishterëve, udhëheqësit myslimanë bënë blerjen e kishës. Menjëherë pranë kishës u ndërtua xhamia. Gjatë historisë islame ndaj hebrenjve dhe krishterëve vazhdoi toleranca. Hebrenjtë me të ikur nga

terrori i inkuizicionit spanjoll strehim të sigurt gjetën nëpër territoret e Perandorisë Osmane. Burimi dhe shkaku i kësaj tolerance ndaj të tjerëve bazohej në moralin e Kur'anit:

Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuani: Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij. *(El Ankebutë-46).*

Myslimanët dhe shkenca

Njëra nga dritat e moralit islam, e cila ndriçoi rrugën e njerëzimit ishte mendimi shkencor. Arabët e kohës paraislame dhe disa popuj tjerë të Lindjes së Afërt asnjëherë nuk kanë qenë të interesuar për gjithësinë, krijimin e natyrës apo mënyrën e funksionimit të saj. Megjithatë, me fillimin e shpalljes së Kur'anit kjo mënyrë ndryshoi sepse Allahu xh. sh. u thotë njerëzve që të interesohen për krijimin e qiejve dhe tokës:

Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës: Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! *(Ali Imran-190-191).* Shpallja e këtij ajeti dhe ajeteve të ngjashme kanë ndihmuar në ngritjen shkencore të civilizimit islam, të cilët pastaj iniciuan në një rilindje shkencore deri më tani të paparë. Gjeneratori i kësaj ishte Bagdadi, kryeqyteti i dinastisë Abaside dhe i botës islame në tërësi. Shkencëtar, mendimtar, hulumtues, dhe intelektual tjerë nga e tërë bota islame vinin dhe tuboheshin në Shtëpinë e të urtëve (Dar-ull-Hikme), për të hulumtuar dhe gjetur fshehtësitë e krijimit të Zotit, sikurse që është gjithësia.

Kjo gjithanshmëri të cilën shkencëtarët myslimanë e arritën me pranimin e moralit të Kur'anit, shkencës ia mundësoi një kërcim më të shpejtë progresiv në historinë e deriatëhershme. Çiltëria e mendjes dhe urtësia të cilën myslimanët e mësuan nga Kur'ani, atyre iu mundësoi që të analizojnë, e që pastaj të vazhdojnë me të arriturat shkencore të civilizimeve të tjera duke mos u lodhur me paragjykime. Punimet shkencore të myslimanëve ishin plot vrojtime, eksperimente, preventiva dhe hulumtime nga tema të ndryshme.

Matematikanët myslimanë bënë sistemin decimal të numrave, shpikën algjebrën dhe trigonometrinë. Shkencëtarët myslimanë zbuluan dhe vendosën principet e astronomisë moderne. Ata kanë llogaritur dhe saktësuar orbitën e hënës rreth tokës dhe kanë vendosur formulën e këtij procedimi. Disa prej të arriturave më të mëdha shkencore të myslimanëve të asaj kohe ishin në fushën e mjekësisë. Spitalet e myslimanëve i kishin repartet e ndara dhe të veçanta për sëmundje të llojeve të ndryshme, ndërsa mjekët myslimanë për shërimin e të sëmurëve përdornin metodat më të zhvilluara mjekësore. Derisa myslimanët për shërimin e të sëmurëve mendorë përdornin terapinë-muzikore, dhe lloje tjera të terapisë, evropianët besonin se të sëmurit me çrregullime mendore janë shërbëtorë të shejtanit, dhe për këtë i kallnin në turmën e druve. Punimet shkencore për anatominë e njeriut të shkruara nga myslimanët, në të cilat thirreshin fakultetet e mjekësisë evropiane, kanë qenë aq precize sa që ato u shfrytëzuan në 600 vjetët vijues.

Në filmin dokumentar kushtuar botës islame, të cilin për "BBC"-in e përgatiti komentuesi Terry Jones, për standardet e larta shkencore islame, në vazhdim thuhet:

"Ja disa shembuj: një filozof nga qyteti i Haranit tashmë kishte bërë llogarinë e saktë të largësisë së tokës nga hëna, ndërsa një tjetër për atomin pohonte: 'sikur kishte qenë e mundur ndarja e saj, me atë rast ishte liruar aq shumë energji sa që kishte mundur të shkatërrohet një qytet i madh shumëmilionësh i madhësisë së Bagdadit të atëhershëm.' Në shkollën e mjekësisë e ndërtuar në vitin 1154 në Damask, të Sirisë, disa shekuj para Harveyit, mjekët tanimë i mësonin të tjerët në shkencën e anatomisë, në hulumtimet e mjekësisë, për kirurgjinë higjienike, për qarkullimin e gjakut etj..."

Për qarkullimin e gjakut mjekët myslimanë me shekuj para kolegëve të tyre evropianë kishin njohuri, dhe gjatë kontrollit te pacientët

bëhej matja e pulsit. Lindjet kryheshin në kushte më higjienike të arritura në atë kohë. Instrumentet e kirurgjisë, të përshkruar nëpër librat e mjekësisë të asaj kohe, dëshmojnë në përparimin e diturisë mjekësore. Shkencëtarët myslimanë kanë bërë zbulime shumë të rëndësishme në optikë dhe në kualitetin e dritës. Personi i parë i cili zbuloi formimin detal të syrit, ishte Ibn Hajsemi, i cili me hulumtimet e jashtëzakonshme në thjerrëza, e hapi rrugën drejt zbulimit të kamerës. Mjekët myslimanë ishin ata, të cilët e zbuluan shkaktarin e cila qëndronte pas dobësimit të pamjes, me ç'rast me sukses kryenin operimin e saj duke bërë largimin e katarakt-ës (perde e syrit), dhe këtë 1000 vjet para se t'i shkojë për dore ndonjë mjeku nga vendet evropiane.

Trashëgimia e madhe shkencore e botës islame e mundësoi rilindjen dhe renesancën evropiane. Shkencëtarët e të krishterë, shkollat e tyre shkencore në Evropë i vendosën në baza të njohurive dhe veprimeve të marra nga myslimanët. Pra, drita islame gjithashtu i ndriçoi edhe ata.

Myslimanët ngado shkonin, me vete bartnin civilizimin. Për nevojat e ujit të pijshëm në qytetin Tunizianë, ata bënë dizajnimin efikas të sistemit për pastrimin e saj. Uji ndalej dhe pastrohej në dy pishina të mëdha, dhe pastaj nëpërmes sistemit të gypave të mbyllur sillej në qytet. Ndërsa tek evropianët interesimi për këto punë lindi disa shekuj më vonë. Kryeqyteti i botës islame Bagdadi, ishte qyteti më modern dhe më luksoz në botë. Urbanizmi dhe arkitektura e tij ishin mahnitëse. Ja si e përshkruan Bagdadin një udhëpërshkrues me rastin e vizitës së tij në këtë qytet:

"Të gjitha mëhallët ishin të mbuluara me parqe, kopshte, shtëpia luksoze dhe me shëtitore të mrekullueshme të mbushur me pazare, dhe në fund me shumë xhamia dhe hamame."

Andaluzia (Spanja myslimane), edhe kjo ishte një qendër mallëngjyese e botës islame, e cila gradualisht bëhej vendi më i moderuar dhe më përparimtar në Evropë. Kryeqyteti i saj Kordova ishte përplot bukuri mahnitëse, me rrugë të pastra dhe të bukura, me biblioteka, spitale dhe pallate.

Në të njëjtën kohë qytetet e mëdha evropiane, sikurse Parisi dhe Londra, ishin të ndotura, të errëta dhe të lëshuara pas dore. Si rezultat i kësaj, të krishterët evropianë të cilët e vizitonin Kordovën mbeteshin të habitur me luksozin, kulturën dhe artin e këtij qyteti.

Në filmin dokumentar *Islami: Mbretëria e fesë*, historiania nga kolegji i Bostonit Sheilla Blair, duke e përshkruar luksin e Kordovës thotë:

"Qyteti i Kordovës në shekullin e IX dhe të X-të ishte njëra nga qytetet më të mëdha mallëngjyese të Evropës. Posedojmë vlerësimet e përshkruara të njerëzve të cilët me rastin e vizitave të tyre kanë parë në çdo anë lulishte të bukura, rrugë të mira dhe të gjëra me drita anash, të cilat në mbrëmje e ndriçonin qytetin. Kordova kishte ujë të pijshëm kullues në qytet. Njerëzit jetonin nëpër shtëpia të mëdha. Përkundër kësaj në Paris njerëzit jetonin nëpër kasolle pranë brigjeve të lumenjve."

Myslimanët përveç arkitekturës, kishin prirje përparimtare edhe për veshje. Punimet e tyre nga tekstili prodhonin pëlhura nga më të bukurat, ndërsa pranë tyre veshjet evropiane dukeshin krejtësisht të thjeshta. Ky ishte shkaku pse rrobat dhe pëlhurat, të cilat i prodhonin myslimanët, u bënë simbole të luksit dhe statusit për Evropën. Gjësendet më të shenjta kishtare ruheshin nëpër pëlhura të punuara nga myslimanët. Në të vërtetë myslimanët dirigjonin me modën botërore.

Civilizimi islam dhe Osmanlinjtë

Lindja e Perandorisë osmane në vitin 1299, u zhvillua si njëra nga perandoritë më të mëdha dhe më të ndritshme të mbarë mbretërisë Islame në botë. Sundimtarët osmanë e shikonin botën me syrin që bazohej në drejtësi dhe tolerancë, me ç'gjë lanë gjurmë nëpër ato vende në të cilat sunduan. Me këto njihet dhe nënkuptohet: arkitektura, pëlhurat, kaliografia dhe sistemi i përkryer i arsimit, në ç'gjë evropianët u merrnin lakmi.

Urtësia dhe prirja e sulltanëve osmanë për art, evropianët i bënte të mahniten. Shumë vende të cilat tash janë pjesë përbërëse të Evro-

pës, Afrikës Veriore, Azisë qendrore dhe të Lindjes së Afërt, si trashëgimi të rëndësishme historike, posedojnë ndërtime tejet impozante artistike, të cilat i zbukurojnë qytetet e tyre. Shembujt e arkitekturës dhe urbanizmit osman edhe sot gjenden në shumë qytete evropiane siç janë: Sofja, Beogradi, Sarajeva dhe qendra tjera.

Shteti osman dhe sistemi administrativ i saj kanë qenë të organizuar në principet e Kur’anit, dhe sot, shumë analitikë politikë i marrin si shembuj më të mirë të një sistemi shtetëror. Diplomacia e shtetit osman i ka vërë themelet e gjithmbarshme të diplomacisë së sodit.

Civilizimi osman ndikoi drejtpërsëdrejti në kulturën e Perëndimit. Osmanlinjtë në Hungari e futën kultivimin e orizit, diplomati habsburgian Busbek pas vizitës që i bëri Stambollit në shekullin e XVI, e përcolli kultivimin e tulipanit në vendet e Beneluksit (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg). Italianët prej osmanlinjve u mësuan për përpunimin e pëlhurës dhe ngjyrosjen e saj, zakoni i orkestrimit ushtarak në Evropë u mor prej osmanlinjve etj.

Këto fakte historike tregojnë për rolin e madh udhëheqës të moralit islam në zhvillimin e botës së sotme moderne. Që nga paraqitja e fesë islame në shekullin e VII, njerëzimit i shërbeu si një dritë e cila e çoi drejt së vërtetës, realitetit dhe bukurisë. Myslimanët kudo që shkonin përcillin moralin, si dhe tolerancën, urtësinë, shkencën, artin, prirjet për bukuri, pastërtinë dhe përparimin. Në kohën kur Evropa fundosej në errësirën e dogmatizmit dhe barbarizmit, bota islame ishte më përparimtarja dhe më një civilizim më moderne në botë. Vlerat, të cilat i murrën disa individë evropianë nga bota islame, luajtën një rol kyç në zhvillimin e civilizimit evropian. Historiani Eugen Myers për këtë realitet shprehet me këto fjalë:

“...Që nga fundi i shekullit IX deri XII, ndikimi i islamit në shkencat perëndimore ishte mjaft i madh...rëndësia e veprave kulturore e dijetarëve islamë vështirë se mund të tejkalohet...mu për këtë, rrënjët e mendimit perëndimor janë një përzierje e mendimit greko-arab dhe hebrenj.”

Nga ana tjetër, njëra prej shkaqeve pse bota islame në disa lëmenj ka mbetur mbrapa, është sepse ajo u largua nga intelekti, dashuria

(përzemërsia), dhe liria e mendimit, burimet e të cilave gjenden në ajetet e Kur’anit. E themi këtë sepse Kur’ani është burimi më i madh udhëzues që e nxjerr njerëzimin nga errësira e paditurisë dhe e shpie kah drita e diturisë së vërtetë.

Elif, Lamë, Ra. *(ky është)* ***Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxirrësh njerëzit prej errësirave në dritë; në rrugë të fuqiplotit, të Falënderuarit.*** *(Ibrahim-1).*

Myslimanët e sodit duhet ta njohin historinë e pasur dhe madhështor të civilizimit islam dhe ta nderojnë përgjegjësinë që vjen me të. Të mos harrojmë se myslimanët janë përfaqësues shembullorë të një trashëgimie të ndershme dhe të lavdishme, të cilën e ndërtoi njëra nga civilizimet më të mëdha në botë. Përveç kësaj, myslimanëve të atëhershëm, përfaqësuesit e civilizimeve dhe përkatësive tjera fetare çdoherë u merrnin lakmi. Eksperti i njohur për Lindjen e Afërt, Daniel Pipes, për guximin e myslimanëve shprehet kështu:

“Kontributi i këtij guximi të brendshëm është edhe kujtesa për të arriturat e jashtëzakonshme gjatë gjashtë apo më shumë shekujve të parë të islamit. Kultura islame ishte më përparimtarja, myslimanët gëzonin shëndetin më të mirë, jetonin më së gjati, kishin përqindjen më të madhe të diturisë në shkrim dhe lexim, investonin për hulumtimin e shkencave teknike më përparimtare, dhe zhvillonin një ushtri thuaja të pamposhtur. Që nga fillimi shihej formula e suksesit. I dërguari i Allahut, Muhamedi a. s. në vitin 622, si muhaxhir u largua nga Mekeja, ndërsa më vonë u kthye si pushtues i saj. Kur erdhi viti 715, që do të thotë pas 100 vjetëve, pushtuesit myslimanë vendosën mbretërinë e tyre, e cila shtrihej që nga perëndimi në Spanjë e deri te lindja në Indi. Të ishe mysliman nënkuptonte të ishe anëtar i një civilizimi fitimtar.”

Sot myslimanët nuk duhet të jetojnë me kujtimet e historisë së lavdishme të tyre, por duhet të punojnë në drejtimin e përkrahjes botës islame që prapë të ngjiten në majën e saj. Natyrisht se myslimanët mund të ndërtojnë një kulturë dhe civilizim të ngjashëm, me të cilën prapë kishin do të shndritnin botën, por kjo nuk do të arrihet derisa sërish myslimanët nuk e vendosin shpirtin e unitetit dhe vëllazërisë myslimane si dhe mëshirës mes vete, parime këto të cilat i kishin pa-

raardhësit e tyre. Nëse myslimanët e sodit tregohen të aftë në vendosjen e një kulture paqedashëse demokratike, tolerante dhe sistematike, e cila do të punonte në të mirën e islamit dhe të njerëzimit, duke mos i marrë për bazë interesat personale, atëherë kishin pasur mundësi që gjatë shekullit XXI ta ndërtojmë një civilizimin më të madh.

Duke iu falënderuar vlerave të brendshme të moralit islam (p.sh. dashurisë, mëshirës, ndjeshmërisë dhe tolerancës), regjimet tirane që sundojnë në vendet myslimane do të zhdukeshin. Zhvillimi dhe përparimi ekonomik dhe kulturor do të arrihej. Myslimanët të cilët vuajnë nga barbarizma dhe presione të ndryshme, qofshin ato edhe masakra më gjakftohte do ta gjenin paqen dhe sigurinë, ndërsa periudha e një bekimi të ri do të bëhej realitet.

∗ “OGLEDALO”, Sarajevë

Përktheu nga boshnjakishtja:
Shevki Sh. Voca

A CALL TO ISLAMIC UNITY

(Summary)

The fall of the Ottoman Empire, in the beginning of the XX century, was the main factor to determine the shape of the Islamic world up to now (that of the new states that rose from its ashes). Yet, none of these states could provide to its citizens the stability they enjoyed in the Ottoman Empire.

In the beginning of the XXI century many problems and conflicts remain unsolved. The balance that existed in the times of the Ottoman Empire was never fully regained, consequently, many troubled countries were born, most of which are in the Islamic world. Some of these problems were dealt with superficially but continue to simmer instigating further conflicts and tension.

الدعوة الى الاتحاد الاسلامي

(خلاصة البحث)

ميار الدولة العثمانية في بداية القرن العشرين كان عاملا رئسيا في تحديد حالة العالم الاسلامي حتى نهاية هذا القرن مع ظهور دول جديدة على رمادها. و لكن مع ذلك لم تستطع أية دولة جديدة ان تصل الى درجة النضوج التى كانا تتمتع بها في عهد الدولة العثمانية.

مع بداية القرن الواحد والعشرين هناك كثير من هذه الدول تنتظر حل لمشاكلها و لم تستطع الوصول الى التوازن الذى كانت تتمتع بها في عهد الدولة العثمانية لم تستطع ان تستقر بصورة مرضية و لهذا السبب ظهرت هذه المشاكل على اراضي تلك الدول في العالم الاسلامي.

Prof. dr. Ali Pajaziti[*]

WILLIAM MONTGOMERY WATT - ORIENTALISTI I FUNDIT

1. Hyrje

Të rrallë janë shkencëtarët që orientalizmin, i cili po ruan dimensionin e vet ideologjik dhe subjektiv, përçmues ndaj "tjetrit" deri në ditët tona, arrin ta mbajë në nivelin e intelektualizmit autentik. Ndër ta padyshim se zë vend edhe William Montgomery Watt, mendimtar skocez, i cili ka një qasje shumë thellësinore ndaj islamit dhe diskursit të tij doktrinar-historiko-jetik. Watt është një islamolog, apo me fjalët e S. Calderinit, një *islamicist* dhe arabist i rëndësishëm, i cili i përmbahet shumë kriterit të objektivitetit, që sipas Souzas, për dallim nga orientalistët tjerë ka arritur të zhvillojë një pikëpamje tjetërfare. Ky artikull, përveç jetës dhe veprave të Wattit, trajton edhe botën ideore që ka ndikuar tek ai, metodologjinë që ai ka përdorur në zbërthimin e fakteve dhe diskursin sociologjik wattian.

[*] Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë.

2. Jeta dhe vepra e W.M. Wattit

Kleriku i Kishës Episkopale Skoceze dhe islamologu i njohur për qarqet teologjike, njëri prej biografëve modernë më të frytshëm të Profetit Muhammed të shekullit XX, i cili sipas Khurshid Ahmad ka ndryshuar qëndrimin paragjykimor të të krishterëve ndaj islamit duke i dhënë atij ngjyrime më objektive dhe më dashamirëse. Montgomery Watt[1] është lindur më 14 mars 1909 në Ceres, vendbanim ky afër qytetit skocez bregdetar Fife.[2] Është fëmija i vetëm i Andrew Watt dhe Mary Burns. Nëna e tij është vajza e profesor Robert Donaldsonit.

Watt jetën arsimore e ka filluar më 1914 në Lakhall Academy, nga e cila del i diplomuar më 1919. Më pas, shkollimin e mesëm e vazhdon në Edinburgh, në George Watson College (1919-1927). Mes viteve 1927-1930 ka studiuar në Universitetin e Edinburghut. Në vitin 1930 magjistron për letërsi, ndërsa më 1932 diplomon në Universitetin e Oksfordit për "Literae Humaniores". Vitin e ardhshëm merr titullin master po në këtë universitet. Një vit më pas fillon studimet master për letërsi dhe pas tre vjetëve edhe atë e kryen.[3]

Watt në kohën kur po vazhdonte studimet pasuniversitare, mes viteve 1934-1938 ka punuar si asistent i filozofisë së moralit në Universitetin e Edinburghut. Nga viti 1936 vërehet se feja fillon të ketë

[1] W. Mongomery Watt, "Körfez Savaşı Sonrası Müslümanlar ve Hristiyanlar", përkth. Şinasi Gündüz, *Tezkire*, nr. 11-12, f. 149.
[2] "Professor W. Montgomery Watt: The Last Orientalist", *Trends*, Cilt 7/5, Essex, f. 10.
[3] Mustafa Alıcı, *W. Montgomery Watt'da Vahiy ve Nübüvvet Anlayışı*, M.Ü. Sosyal Bilimler Enstitüsü, tezë e pabotuar magjistrature, Stamboll,1995, f. 10.

ndikim gjithnjë e më të madh te Watt, i cili po ndiqte hapat e babait të vet që ishte një klerik. Në periudhën 1936-1941 ka punuar si ndihmës prift *(curate)* në kishën Mary Bolton të Londrës. Kisha, në vitin 1943, e dërgoi atë në Jerusalem dhe deri në vitin 1946 ka punuar si këshilltar i kishës anglikane për çështje islame. Kjo detyrë ndikon që atij t'i shtohet interesimi për botën lindore.[4]

Më pas kthehet në *Alma Mater*-in[*] e vet, d.m.th. në Universitetin e Edinburghut dhe ndërmjet viteve 1946-1947 ka ligjëruar filozofinë antike.[5] Në vitin 1949 fiton shpërblimin Levi Della (Los Angeles, SHBA). Mes viteve 1947-1964 ka punuar si lektor në katedrën e gjuhës arabe. Në vitin 1964 caktohet për shef të Departamentit për Studime Arabe dhe Islame. Këtë detyrë e ka ushtruar deri në vitin 1979, kur edhe pensionohet. Në periudhën 1978-1979 ka bërë punime lidhur me kulturën arabe në Universitetin Georgetown.[6] Vdiq në Edinburgh, më 24 tetor 2006, në moshën 97-vjeçare.

Watt, i cili është një dijetar i mirënjohur për intelektualët fetarë ka ushtruar edhe detyrën e kryetarit të Shoqatës angleze për Orientalistikë. Ka studiuar në mënyrë të thukët islamin dhe shoqëritë myslimane, marrëdhëniet myslimano-krishtere[7] dhe në këtë drejtim ka shkruar njëzet e nëntë libra dhe shumë artikuj, në të cilat shpreh vizionin dhe profilin e vet shkencor. Në vazhdim po japim listën e veprave të Watt-it, të cilat mund të jenë referencë për çdokë që është i interesuar në lëmin islamologjisë dhe orientalistikës:

[4] *Ibidem*.
[*] Lat. "nënë krenare", universitet, shkollë e madhe (Милан Vујаклија, *Лексикон страних речи и израза*, Просвета, Београд, 1954, f. 30).
[5] *Trends*, ibidem.
[6] Shih: *Who is Who 1992: An Annual Biographical Dictionary*, St. Martins Press, New York, 1992.
[7] *Ultimate Visions: Reflections on the Religions We Choose*, edited by Martin Forward, One World, Oxford, England-USA 1995, f. 280.

1. *Free Will and Predestination in Early Islam* (Vullneti i lirë dhe paracaktimi në islamin e hershëm), Luzac and Company Ltd., London, 1948.
2. *Muhammed at Mecca* (Muhammedi në Mekë), Oxford & Edinburgh, 1953.
3. *The Faith and Practice of Gazzali* (Besimi dhe praktika e Gazaliut), Allen and Unwin, London, 1953 .
4. *Muhammad at Medina* (Muhammedi në Medinë), Oxford Clarendon Press, London, 1956.
5. *Reality of God* (*E vërteta e Zotit*), London, 1957.
6. *The Cure of Human* (Shërimi i njeriut), Troubles, 1958.
7. *Islam and the Integration of Society* (Islami dhe integrimi i shoqërisë), Routledge & Kegan Paul, London, 1961.
8. *Muhammad Prophet and Statesman* (Muhammedi: Profet dhe burrështetas), Oxford University Press, London, 1961.
9. *Islamic Philosophy and Theology* (Filozofia dhe teologjia islame), Edinburgh University Press 1962.
10. *Muslim Intellectual: A Study of al-Ghazali* (Intelektuali mysliman: Një studim rreth Gazaliut), Edinburgh University Press 1963.
11. *Truth in the Religions: A Sociological and Psychological Approach* (E vërteta te fetë: Qasje sociologjike dhe psikologjike), Edinburgh University Press 1963.
12. *Islamic Spain* (Spanja islamike), 1965.
13. *A Companion to the Quran* (Një bashkëudhëtar i Kur'anit), Allen and Unwin, London, 1967.
14. *What is Islam?* (Ç'është islami?), Longmas Green, London, 1968.
15. *Islamic Political Thought* (Mendimi politik islam), Edinburgh University Press 1968.
16. *Islamic Revelation in the Modern World* (Revelata islame në botën moderne), Edinburgh University Press 1970.
17. *Bell's Introduction to the Qur'an*, Edinburgh University Press 1970 (*Hyrja në Kur'an e Bellit*).
18. *The Influence of Islam on Medieval Europe* (Ndikimi i islamit në Europën mesjetare), Edinburgh University Press 1972

19. *The Formative Period of Islamic Thought* (Periudha formuese e mendimit islam), Edinburgh University Press 1972.
20. *Majesty That Was Islam* (Madhështia që ishte islami), London Sidgwick, 1978.
21. *Islam and Christianity Today* (Islami dhe krishterimi sot), London Routledge 1984.
22. *History of al-Tabari* (Historia e Taberiut), State University, New York, 1987.
23. *Muhammad's Mecca: History in the Qur'an* (Meka e Muhammedit: Historia në Kur'an), Edinburgh University Press 1988.
24. *Islamic Fundamentalism and Modernity* (Fundamentalizmi islam dhe moderniteti), London Routledge, 1988.
25. *Early Islam: Collected Articles* (Islami i hershëm: Përmbledhje artikujsh), Edinburgh University Press 1991.
26. *Muslim Christian Encounters* (Përballjet muslimano-krishtere), London Routledge, 1991.
27. *Islamic Creeds* (Besimi islam), Edinburgh University Press 1994.
28. *Religious Truth for Our Time* (E vërteta fetare për kohën tonë), Oneworld, Oxford, 1995.
29. *A Christian Truth for Today* (Një e vërtetë krishtere për kohën tonë) Routledge, an imprint of Taylor & Francis Books, 2002).[8]

3. Bota ideore që ka ndikuar te Watti

Sipas Bryan S. Turner, është perspektiva dhe korniza orientaliste ajo që shekuj me radhë përcakton subjektet, këndvështrimet dhe rezultatet e shkencëtarëve perëndimorë lidhur me islamin si një sistem besimor dhe si strukturë socio-kulturore.[9] Edhe te Watti është një gjë e tejdukshme se është ndikuar shumë nga trashëgimia orientaliste. Madje edhe vetë është ndërtuar si orientalist, duke u shndërruar në "përfaqësues kryesor të një brezi ose grupi të ri të orientalistëve".[10] Si një botëkuptim, orientalizmi bazohet në disa premisa të thjeshta:

[8] Përveç këtyre, është autor edhe i përkthimit të Kur'anit bashkë me Marmaduke Pickthall (Shih: Marmaduke Pickhtall - W. Montgomery Watt, *Koran*, Everymans Library, 1992.)

[9] Bryan S. Turner, *Oryantalizm, Kapitalizm ve İslam*, Çev. Ahmet Demirhan, İnsan Yayınları, Stamboll, 1991, f. 16.

1. *Historia statike*. Krijimi i një vije kundërshtare mes strukturës së shoqërive të islamizuara dhe "karakterit dinamik-evolucionist të kulturës perëndimore krishtere".
2. Dhënia e një liste që shpjegon ngurtësimin e islamit.

Te Watti vërehet ndikimi i sociologjizmit të sociologut frëng, themelues i shkollës frënge të Sociologjisë, Emile Durkheim. Watt fenomenin fe e trajton si produkt të mjedisit socio-kulturor,[11] pra e sheh si një produkt shoqëror, jo si diçka hyjnore. Sipas konceptit të tij, struktura e fesë islame është rezultat i kushteve shoqërore. Për të, versetet kura'nore 11-14 të sures Mearixh "*...edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifikonte me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllanë e vet, edhe farefisin, që i gjendej pranë (ne jetën e Tokës), si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte"* thotë se është refleksion i dërrmimit të solidaritetit shoqëror në kohën e Profetit Muhamed dhe i zëvendësimit të tij me ndjenjat e individualizmit dhe egoizmit, refleksion i faktit që në Mekke kishte arritur të mbizotëronte ekonomia e tregut.[12]

Watt është ndikuar fort edhe nga teoria e evolucionit, evolucionit social, biologjizmi dhe social-darvinizmi.[13] Sipas tij, besimi monoteist paraqet apogjeun e ndryshimit të realizuar në konceptin fetar të Arabisë së Mesme, si pasojë e degradimit të politeizmit. Pra, sipas tij, në vijën e besimit islamik është shënuar një rrjedhë në kontekstin *politeizmi, Zoti suprem (high God) në mesin e hyjnive të shumta dhe monoteizmi*.[14] Pra për të, besimi në një Zot nuk është ide e bashkëlindur

[10] Ergün Göze, "W. Montgomery Watt ile", *Tercüman*, 24 shtator 1985, f. 7.

[11] Watt, *Religious Truth for Our Time*, Oneworld, Oxford, 1995, f. 7.

[12] Lawrence Conrad, "W. M. Watt, Muhammad's Mecca: History in the Qur'an", *Journal of Semitic Studies*, 35/2, Oxford,1990, f. 331.

[13] Watt, *Günümüzde İslam ve Hristiyanlık*, parathënia e përkthyesit.

[14] W. L. Treadwell, "W. M. Watt, Muhammad's Mecca: History in the Qur'an", *Journal of the Royal Asiatic Society*, nr. 2 (1989), f. 323.

te njeriu ose zbritur nga lart, por është "fryt" i kushteve shoqërore, i zhvillimit dhe ndryshimit shoqëror. Duket qartë se Watt shoqërinë e merr si determinante të të gjithë përbërësve shoqërorë qofshin ata materialë apo shpirtërorë.

Siç do të shprehet Edward Said, mendimtarët orientalistë kanë një perspektivë të përcaktuar nga mjedisi në të cilin jetojnë.[15] D.m.th., në hermeneutikën sociologjike dhe atë të fesë të Wattit shënohen elemente të traditës ideore dhe shkencore të Perëndimit dhe në veçanti të paradigmës orientaliste.[16] Kur flasim për Wattin duhet trajtuar në kontekst të kulturës dhe mendimit perëndimor dhe referimet e tij duhet ndërlidhur me këtë kod kulturor.

Mendimtari i njohur, çështjen e realitetit shoqëror të fesë më tepër e ndërlidh me funksionin e elementit religjioz në kuadër të shoqërisë. Duke zbërthyer fenë në aspektin sociologjik shfrytëzon pikëpamjen marksiste, kurse në atë psikologjik atë të Jungut dhe në analizat e vet më tepër i referohet sferës së nënvetëdijes.[17]

4. Metodologjia e Wattit

Nëse do të ishim shprehur me gjuhën e Stefan Cole, Watt nuk është një shkencëtar që punon në një "boshllëk teorik",[18] por është një shkencëtar i mirëfilltë që temës i futet në thellësi dhe e përpunon atë me metodologji përkatëse.

[15] Watt, *Müslüman-Hristiyan Diyaloğu*, përkth. Fuat Aydın, Birey Yayıncılık, İstanbul 2000, f. 195.
[16] Shprehja paradigmë ka kuptimin e shembullit, të modelit. Sipas Thomas Kuhn, termi paradigmë do të thotë teori, hulumtim, punim, metodë që merret si shembull dhe shfrytëzohet nga të gjithë teoricienët dhe hulumtuesit e një fushe të caktuar shkencore. (shih: Aleksandar Bogdanić, *Komunikologija – Vodeća paradigma*, Čigoja Štampa, Beograd, pa datë, f. 199)
[17] Watt, *Dinlerde Hakikat*, përkth. A. Vahap Taştan, Ali Kuşat, İz Yayıncılık, İstanbul 2002, parathënia e përkthyesit..
[18] Stephan Cole, *Sosyolojik Düşünmenin Yöntemi*, përkth. Bekir Demirkol, Vadi Yayınları, Ankara 1999, f. 180.

Ai siç shprehet edhe vetë, para së gjithash mundohet të jetë shkencor dhe në të njëjtën kohë të mbetet krishter i mirë.[19] Sepse feja s'është në asnjë mënyrë armik i shkencës. Sociologjia një ndër temat kryesore e ka fenë dhe mundohet të përcaktojë funksionion e fesë në shoqëri, të shënojë ndikimet e saj në rrjedhat shoqërore. Nëse sociologjia arrin në konstatimin se feja ka një rol shumë të rëndësishëm në shoqëri, atëherë mund të thuhet se mendimi fetar është një e vërtetë shoqërore,[20] me të cilën njeriu jeton që nga periudha e *homo primigeniusit*.

Për ta analizuar fenomenin e fesë islame, Watt i referohet metodës historike, psikologjike, analitike-strukturale dhe sociologjike. Në veçanti është koncentruar te problemet e shtruara nga sociologjia dhe psikologjia e thellësisë. Ai na del me identitetin e një sociologu që shfrytëzon teknikat hulumtuese bihejvioriste.

Watt është ndalur rreth sentencave si "feja është opium për popullin" dhe "Zoti është refleksion". Është munduar që në përgjithësi ta mbrojë fenë e jo vetëm krishterimin. Sepse sipas tij, "në botën e kohës sonë fetë e mëdha, e pranojnë këtë ose jo, janë aleate kundër fuqive kundërshtare",[21] siç janë shekullarizmi, paganizmi postmodern, lëvizjet e ndryshme sifetare etj.

Watt e ka studiuar origjinën e fesë islame si një sistem besimi, ka krahasuar formën e një shoqërie me karakteristikat e ndryshme të një shoqërie tjetër, ka ekzaminuar ndikimin e fesë mbi individët, natyrën e bashkësisë fetare etj. Watt në analizimin e fesë shfrytëzon qasjen sociologjike, në veçanti atë të sociologjisë së dijes. Ai në trajtimin e fesë dhe të dukurive të tjera shoqërore e shfrytëzon metodën e Max Weberit të mbiquajtur *Verstehen* (të kuptuarit) dhe atë *Erklären* (të shpjeguarit).

Watt anon nga një sociologji e bazuar në fakte. Ai dyshet si islami dhe politika, islami dhe ekonomia nuk i shqyrton vetëm në aspektin

[19] Watt, *Dinlerde Hakikat*, f. 11.
[20] Ibidem, f. 16.
[21] Ibidem, f. 11.

teorik, por merret me faktet konkrete shoqërore si politika, ekonomia, d.m.th., merret me proceset e përjetuara në histori, kohë dhe hapësirë.

Watt thotë se në vlerësimin e statusit të doktrinave ka dy nivele: i pari, me bosht filozofik dhe teologjik, kurse i dyti, është ai sociologjik, të cilin edhe vetë e shfrytëzon. Sipas tij, nëse sociologu i beson një feje dhe nëse do që t'i ndihmojë sistemit të tij ideor atëherë duhet që ta lë mënjanë nivelin e dytë dhe të bjerë në nivelin e parë, pra në atë të një besimtari të rëndomtë.[22]

Watt nuk na shfaqet vetëm si një teknicien, në disa raste shfaqet edhe si vlerësues. Zaten, në teori edhe pse flitet për të kundërtën, në praktikë, "shumica e mendimeve sociologjike, reflektojnë gjykimet vlerore të autorëve".[23] Ai nuk merret vetëm me raportin e fesë me individin, përveç dimensionit besimor merret edhe me *dimensionin organizativ* shoqëror të fesë. Te Watt në shumë vende shfaqet lidhja për vlerat *(value-involvement)*, por marrë në përgjithësi mbizotëron qasja objektive. Siç do të shprehet edhe vetë, megjithëse mundohet t'i zbatojë kërkesat e fesë, në aspektin ideor ndaj islamit dhe krishterimit thuajse është i paanshëm.[24]

Watt mundohet që gjërat t'i zbërthejë edhe më qartë duke përdorur metodën krahasimtare. Për të, myslimanët me historinë e jomyslimanëve merren vetëm nëse kjo e fundit u ndihmon në të kuptuarit e botës islame. Lidhur me "historinë e tjetrit" e njëjta gjë mund të thuhet edhe për qytetërimin perëndimor. Sipas Wattit, perëndimorët, sadoqë janë përpjekur për të kuptuar popujt e Lindjes, prapëseprapë tradita e historisë perëndimore mbetet e kufizuar me Evropën, në veçanti me shoqëritë dhe popujt europerëndimorë.[25]

Watt ka qenë i përkushtuar për të studiuar islamin, është përpjekur të shohë pikëvështrimin e personit tjetër, madje ka pasur një tendencë

[22] Ibidem, f. 212.
[23] İlyas Ba-Yunus, Ferid Ahmed, *İslam Sosyolojisi Bir Giriş Denemesi*, përkth. Rıdvan Kaya, Bir Yayıncılık, İstanbul 1986, f. 22.
[24] Watt, *Modern Dünyada İslam Vahyi*, përkth. Mehmet S. Aydın, Hülbe Yayınları, Ankara 1982, f. 14.
[25] Watt, *Islam and the Integration of Society*, Routledge & Kegan Paul, London, 1966, f. 232.

të preferojë pikëpamjen e tjetrit. Ai është shtangur nga paragjykimet historike të Perëndimit ndaj islamit, për të cilat Norman Daniel në veprën e vet Islami dhe Perëndimi: Ndërtimi i një imazhi thotë se është krijuar nga dijetarët e periudhës shek. XII-XIV si propagandë luftarake për të mbështetur kryqëzatat.[26]

Watt në studimin e fesë i kushton rëndësi shumëshkakësisë, pra merr në konsideratë shumë faktorë shoqërorë si atë kognitiv, shoqëror, politik, ekonomik, kulturor etj. Pra, mbetet shumë i lidhur pas parimit të polikauzalitetit, përkundër qasjes monokauzale, e cila jep rezultate më të kufizuara dhe më të thata.

Watt shpeshherë del jashtë spektrit sociologjik, që përbën një pjesë të rëndësishme të qenies së tij shkencore dhe jep parashikime lidhur me të ardhmen. Për shembull, parasheh afrimin mes këtyre dy komuniteteve të mëdha fetare. "Kontaktet me myslimanët do t'ua përkujtojnë të krishterëve se në fenë e tyre ekziston besimi në njëshmërinë hyjnore, do t'i detyrojë të gjejnë një formulacion të ri që do të pajtonte njëshmërinë me trinitetin".[27]

Duhet shënuar se Watt shpesh e shfrytëzon edhe metodën marksiste të interpertimit ekonomiko-centrist. Shfrytëzimi i kësaj metode ka qenë modë tek orientalistët në drejtim të studimit të historisë dhe shoqërisë islame. Qëllimi ishte ky: refuzimi i faktit se feja islame është me burim hyjnor dhe theksimi i karakterit botëror-shekullar të kësaj feje. Sipas kësaj metodologjie, natyra e ndryshimit ekonomik në një shoqëri të caktuar përcakton zhvillimin e strukturës shoqërore dhe fetare.[28]

[26] http://www.guardian.co.uk/news/2006/nov/14/guardianobituaries.highereducation/25.07.2011
[27] Watt, *İslam Nedir*, İkinci Baskı, përkth. Elif Rıza, Birleşik Yayıncılık, İstanbul 1993, f. 271.
[28] Manzooruddin Ahmed, "W. M. Watt, Islam and the Integration of Society", *Islamic Studies*, vëll. II, nr. 1, mars 1963, f. 143.

5. Pikëpamjet sociologjike të W.M.Wattit

William Montgomert Watt, njëri prej ekspertëve më të mëdhenj perëndimorë lidhur me islamin, për të zbërthyer lindjen, zhvillimin dhe pasqyrimet historike të islamit shfrytëzon disiplina të ndryshme si historia, teologjia, politika dhe sociologjia. Watt, në kuadër të logosit shkencor perëndimor është ndër orientalistët madje edhe shkencëtarët në përgjithësi që islamin e pikturon me “ngjyra simpatike dhe objektive”.

Watt vërtet ka bërë një punë të çmuar me analizat e veta të historisë dhe filozofisë sociale të islamit, me diskursin sociologjik që ka përdorur në interpretimin e kësaj feje botërore. Përveç që merret me të kaluarën e saj, ai arrin deri në ditët e sotme të islamit duke trajtuar marrëdhëniet e ngushta mes besimit fetar dhe doktrinave politike. Veprat e tij përfaqësojnë shqyrtimin e qartë dhe të gjerë të strukturës politike dhe fetare të ndërtuar nga Profeti dhe pasuesit e tij, të dimensionit politik të islamit në botën bashkëkohore. Duke u bazuar në vepra të shkruara në gjuhën arabe dhe të pastudiuara fare mundohet të nxjerrë në pah se si lëvizjet e ndryshme fetare dhe politike kanë ndihmuar në lindjen e *formës standarde të islamit*. Ai thotë se islami nuk është fe vetëm e dimensionit shpirtëror, por që merret edhe me organizimin politik dhe shoqëror.

Në diskursin e Wattit zënë vend edhe tema si mendimi ideologjik i periudhës bashkëkohore, “ristrukturimi intelektual” (M. Ikbal), “arritja e një vetëperceptimi më të vërtetë” e kështu me radhë. Watt trajton edhe konceptin e “pandryshueshmërisë” së islamit duke u nisur nga teoria e evolucionit dhe ajo e përparimit vijëdrejtë. Në këtë drejtim mundohet të argumentojë se islami është fe që s’e pranon ndryshimin social, pohim ky i tij që bie ndesh me realitetin jetik të kësaj feje.

Pikënisja e Watt-it është sociologjiste. Sipas tij, feja në përgjithësi dhe islami në veçanti janë produkte të mjedisit jetësor. Në interpretimin e fesë e përdor pikëpamjen marksiste që ka qenë modë te krahu i orientalistëve, faktorit ekonomik i jep përparësi ndaj superstrukturës

shoqërore. Këtë metodë e shfrytëzon për të refuzuar karakterin hyjnor të islamit dhe për të theksuar botërorësinë e kësaj feje (M. Ahmed). Sipas kësaj metode, bazë e evolucionit të strukturës shoqërore dhe fetare është ndryshimi ekonomik.

Veprat e Wattit janë tekste elementare për ata që merren me politikë, sociologji dhe shkencat islame. Mund të thuhet se ai ka dhënë kontribut të çmuar për sociologjinë fetare-islame dhe shkencat fetare në tërësi.

Sipas Wattit, feja është një nga institucionet kryesore të shoqërisë. Jeta shoqërore si një e tërë është e lidhur ngusht me sistemet besimore.[29] Degjenerimi i fesë nënkupton shkatërrimin e shoqërisë në aspektin moral dhe në aspektet tjera. Pra Watt-i fenë e cilëson si valvulë sigurie të shoqërisë karshi prirjeve patologjike. Watt faktet fetare mundohet t’i zbërthejë përmes metodave të shkencës moderne. Elemente që i dallon studimet e tij lidhur me islamin janë dija sistematike, metodologjia e veçantë dhe korniza e qartë konceptuale. Një pjesë e mirë e qëndrimeve të Wattit lidhur me natyrën e fesë bazohen në përgjithësimet e perëndimorëve rreth krishterimit. Sipas tij, shkencëtari ndikohet nga “vlerat e parapëlqyera”.[30] Qëndrimi i tij ndaj islamit është refleksion i trashëgimisë kulturore të Perëndimit, në veçanti i diskursit orientalist.

Watt sado që është munduar maksimalisht të mbetet objektiv prapëseprapë s’i ka shpëtuar subjektivizmit. Mund të themi si subjektivizmi i Watt-it ndaj islamit është “normal” kur e kemi parasysh të vërtetën se ndërkohë është edhe teolog ose apologjet krishter. Tekefundit objektiviteti absolut është diçka përtej mundësive të njeriut. Njeriu e ka shumë rëndë të bëjë mutacione jashtë botës së vet individuale. Siç thotë Grey, sociologjia e pavarur prej vlerave (*value-free sociology*) paraqet “mashtrim dhe doktrinë të papërgjegjësisë”.[31] Një gjë të tillë e pranon edhe Watt-i. Sipas tij, e gjithë bota jonë ideore madje

[29] Watt, *İslam Nedir*, f. 243.
[30] Watt, *Dinlerde Hakikat*, f. 132.
[31] Ba-Yunus, Ahmed, ibidem, f. 41.

edhe në rastet kur synojmë objektivitetin dhe shkencën mund të helmohet prej elementeve ideologjike.[32]

Në universin shkencor të Wattit rastisim ngjyrime nga mendimi shekullarist-laicist, evolucionizmi darvinian, nga botëkuptimi humanist, si dhe tendencën e zhveshjes së islamit prej elementeve mbikohore, metafizike dhe transhendentale.

6. Përfundim dhe rekomandime

Watt fenë në përgjithësi dhe islamin në veçanti bashkë me parimet e tij i trajton si fryt të shoqërisë dhe ngjarjeve shoqërore. Lidhur me politeizmin për të cilin në Kur'an thuhet se është një mëkat i pafalshëm, shprehet se është refleksion i një marrëveshjeje të përgjithshme mes mylsimanëve. Pra, Watt është një sociologjist, person që shoqërinë e sheh si gjenerues të të gjitha fenomeneve jetike-sociale, i afërt me tezën bergeriane për ndërtimin social të realitetit: feja është sistem simbolik që imponon një rend (kozmos) në gjithë universin, në jetë duke e mbajtur anash kaosin.

Watt si një *homo religiosus*, bart në vete edhe një *homo saeculi*. Kërkimet shkencore të tij bartin në vete nga njëra anë gjurmët e teologjisë shekullare dhe nga ana tjetër ato të sociologjisë fetare *(religious sociology)*.

Rekomandojmë që të bëhet përzgjedhje nga veprat e Wattit dhe së paku dy prej tyre të përkthehen në gjuhën shqipe për të pasur akces të drejtpëdrejtë në vizionin orientalist për islamin, të kuptohet më mirë diskursi "ekstern" për këtë fe.

Sugjerojmë departamentet e orientalistikës dhe të teologjisë që Watt-in ta përfshijnë në plan-programet e veta, që studentët drejtpërsëdrejti të kapin perceptimin e Lindjes dhe islamit nga një orientalist me peshë.

[32] Watt, *Islam an the Integration...*, f. 257.

7. Bibliografia

AHMED, Manzooruddin, "W. M. Watt, Islam and the Integration of Society", *Islamic Studies*, vëll. II, nr. 1, mars 1963

ALICI, Mustafa, *W. Montgomery Watt'da Vahiy ve Nübüvvet Anlayışı*, M.Ü. Sosyal Bilimler Enstitüsü, tezë e pabotuar magjistrature, Stamboll,1995.

BA-YUNUS, İlyas & Ahmed, Ferid, *İslam Sosyolojisi Bir Giriş Denemesi*, përkth. Rıdvan Kaya, Bir Yayıncılık, İstanbul 1986.

BOGDANIĆ, Aleksandar, *Komunikologija – Vodeća paradigma*, Čigoja Štampa, Beograd, pa datë.

COLE, Stephan, *Sosyolojik Düşünmenin Yöntemi*, përkth. Bekir Demirkol, Vadi Yayınları, Ankara 1999.

GÖZE, Ergün, "W. Montgomery Watt ile", *Tercüman*, 24 shtator 1985.

PİCKHTALL, Marmaduke – Watt, W. Montgomery, *Koran*, Everymans Library, 1992.

"Professor W. Montgomery Watt: The Last Orientalist", *Trends*, Cilt 7/5, Essex.

Ultimate Visions: Reflections on the Religions We Choose, edited by Martin Forward, One World, Oxford, England-USA 1995.

WATT, W. Montgomery, "Körfez Savaşı Sonrası Müslümanlar ve Hristiyanlar", përkth. Şinasi Gündüz, *Tezkire*, nr. 11-12.

WATT, W. Montgomery, *Günümüzde İslam ve Hristiyanlık*, İz Yayıncılık, përkth. Turan Koç, İz Yayıncılık, İstanbul 1991.

WATT, W. Montgomery, *Dinlerde Hakikat*, përkth. A. Vahap Taştan, Ali Kuşat, İz Yayıncılık, İstanbul 2002.

WATT, W. Montgomery, *İslam Nedir*, İkinci Baskı, përkth. Elif Rıza, Birleşik Yayıncılık, İstanbul 1993

WATT, W. Montgomery, *Modern Dünyada İslam Vahyi*, përkth. Mehmet S. Aydın, Hülbe Yayınları, Ankara 1982,

WATT, W. Montgomery, *Islam and the Integration of Society*, Routledge & Kegan Paul, London, 1966.

WATT, W. Montgomery, *Religious Truth for Our Time*, Oneworld, Oxford, 1995. Lawrence Conrad, "W. M. Watt, Muhammad's Mecca:

History in the Qur'an", *Journal of Semitic Studies*, 35/2, Oxford,1990.

WATT, W. Montgomery, *Müslüman-Hristiyan Diyaloğu*, përkth. Fuat Aydın, Birey Yayıncılık, İstanbul 2000.

W. L. Treadwell, "W. M. Watt, Muhammad's Mecca: History in the Qur'an", *Journal of the Royal Asiatic Society*, nr. 2 (1989).

Who is Who 1992, An Annual Biographical Dictionary, St. Martins Press, New York, 1992.

ВУЈАКЛИЈА, Милан, *Лексикон страних речи и израза*, Просвета, Београд, 1954.

http://www.guardian.co.uk/news/2006/nov/14/guardianobituaries.highereducation/25.07.2011

Prof. dr. Ali Pajaziti

WILLIAM MONTGOMERY WATT – THE LAST ORIENTALIST

(Summary)

Introduction

There are not that many scientists, who have managed to keep orientalism, which continues to have an ideological and subjective dimension and to be derogatory towards others even nowadays, at a certain level of authentic intellectualism.

One of them is William Montgomery Watt, a Scottish scholar, who had a very deep approach to Islam and its doctrinal and historical discourse. According to S. Calderin, Watt was an important Islamologist or Islamicist, who sticks to the criteria of objectivity.

This article, apart from Watt's life and work, deals with his inner world (which affected him), the methodology he used to analyze facts and Watt's sociological discourse.

علي بايازيتى

ويليام مونتغومرى وات – اخر المستشرقين

(خلاصة البحث)

مدخل

يعتبر علماء الاستشراق الذين حافظوا الجانب الايدولوجي عن" الاخرين" الى يومنا هذه على المستوى الذاتي قليلون جدا ، ومن بينهم بلا شك يعتبر ويليام مونتغومرى وات له مكانة خاصة. و هذا المستشرق السكوتلاندي له دراية عميقة عن الاسلام من حيث الخلفية التاريخية الاصيلة. وات هو عالم اسلامي أو كما يقول س. كالدريني هو عالم اسلامي و عالم اللغة العربية والذى تبع في عمله القواعد العلمية الصارمة خلافا لزمالائه المستشرقين الذين لم يلتزموا بهذه القواعد. في هذا المقال الى جانب الحديث عن حياة وات و اعماله سوف نتحدث عن لعالم الروحي الذى املى عليه أن يقوم بهذه الاعمال معتمدا في تحاليل العوامل قبل تطرق الى اشياء اخرى.

HISTORIOGRAFI

VEPRA *EL-MUKADDIME* E IBN HALDUNIT*

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Parathënia e redaktorit[1]

Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave, i cili është i Vetëm dhe nuk ka shok. Atë e lavdëroj ashtu siç e lavdëruan falënderuesit dhe e falënderoj ashtu siç e falënderuan lavdëruesit.

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të dërguarin - që erdhi si mëshirë për të gjitha botërat.

Gjatë periudhave të ndryshme kohore janë shkruar shumë vepra historike, të cilat trajtuan ngjarjet dhe ndodhitë e kaluara.

Myslimanët e patën njohur *"zanatin e historisë"* qysh nga periudha e shtetit abbasij. Me kalimin e kohës, kjo mjeshtëri u shndërrua në një prej rrugëve më të suksesshme për arritjen e famës dhe popullaritetit.

Shkrimet historike pësuan mjaft nga dora e disa sharlatanëve e të pandërgjegjshmëve, mbase intrigantë e mashtrues, të cilët u përpoqën që ta shuajnë nga brenda forcën e ummetit, t'i dobësojnë ambiciet si dhe t'i shtypin synimet.

* Këto janë disa pjesë nga fillimi i veprës në fjalë, e cila është duke u përkthyer në tërësi dhe së shpejti do ta shohë dritën e botimit. (shënim i përkthyesit)

[1] Ebu Enes Hamid Ahmed et-Tahir el-Bisjuni nga Demenhur – El-Buhajra, është redaktor i veprës *El-Mukaddime*.

Rrëfimi i ngjarjeve historike ndryshon nga njëri historian te tjetri. Kjo, në bazë të pikëpamjeve e botëkuptimeve të cilat një historian i merrte si *"përgjegjësi dhe obligim"* të tij.

Disa prej tyre anuan kah shiizmi dhe ithtarët e tij, me ç'rast përdorën të gjitha mjetet me anë të të cilave ia dolën ta mbushnin historinë me lloj-lloj trillimesh, legjendash e shpifjesh.

"Obligimi" i të tjerëve ishte *"rrëmbimi dhe atakimi historik"* nëpërmjet kontrollimit dhe uzurpimit të ngjarjes së caktuar si dhe përpjekjes që me anë të shpifjes të akuzohen kundërshtarët te gjykatësi apo sunduesi i asaj kohe.

Kësisoj arritën që t'ia mveshin veprën atij që fare nuk e ka bërë.

Shkrimet e grupit tjetër që kishte pikëpamje të dekadencës brenda arenës së historisë kishin për qëllim që ta "mbysin" ummetin, dhe, megjithëse nuk i shkaktuan plagë, e ndalën gjakderdhjen në të.

Mbetën historianët e besueshëm të cilët jetuan në *"burgun e transmetimit"*, pa bërë ndonjë analizë, vrojtim e shqyrtim, duke u përpjekur që vetëm t'i përcjellin ngjarjet dhe rrjedhojat historike.

Mbase, ky ishte pikërisht shkaku që i shtyri disa historianë ta praktikojnë metodën e transmetimit, duke i imituar kësisoj dijetarët e hadithit.

Në punën dhe studimin e tyre, dijetarët e hadithit dhe historianët nuk u përpoqën të japin shpjegime e sqarime, ngase transmetimi ishte ekskluzivisht detyra e tyre themelore. Shtoja kësaj edhe faktorin evident që është koha.

Kësisoj, historianët i regjistronin dhe i tubonin ndodhitë dhe kronikat në një nga periudhat, me shpresë se më pastaj do të kenë kohë që t'i sqarojnë e t'i komentojnë më gjerësisht ato, mu ashtu siç vepruan dijetarët e hadithit në veprat e tyre.

Megjithatë, çështja e *"transmetimit dhe tubimit të ngjarjeve"* mbeti preokupimi kryesor i historianëve në periudha të ndryshme.

Kjo mangësi e goditi historinë me disa sëmundje:

- Paraqitja e varfër dhe e dobët si pasojë e mbështetjes së historianit te fjalët dhe shprehjet e paraprijësit të tij, nga frika se mos largohen prej këtyre parimeve ashtu që t'i ekspozohen kritikës dhe akuzës;

- *“Vdekja e ngadalshme”*, e cila e godet lexuesin e historisë, veçanërisht lexuesit e kronikave, të cilët i kaplon mërzia pas leximit të disa faqeve që përmbajnë një mori ngjarjesh të cilat shkaktojnë *“kapitje dhe plogështi mendore”;*

Por, megjithatë, ata kanë merita të mëdha për ruajtjen e historisë nga zhytja në detin e harresës.

Disa prej tyre si Ibn Kethiri dhe Ibn ‘Asakir e të tjerë ofronin vërejtje mbi transmetimin duke i shpjeguar të metat dhe kundërthëniet lidhur me të.

Hapin e parë të reformimit e bëri historiani dhe njohësi i hadithit, El-Mes’udi (vdiq në vitin 346 sipas kalendarit islam). Vepra e tij *“Et-tenbih ve-l-ishraf”* (Vërejtja dhe mbikëqyrja), pikësëpari kishte për qëllim radhitjen e ngjarjeve sipas përmbajtjes, e jo sipas kronologjisë.

Autori në fjalë i përmblodhi mendimet dhe pikëpamjet e tij mbi filozofinë e historisë, gjithësisë, këndvështrimet e filozofëve lidhur me shkallëzimin dhe lidhjen midis mineraleve, bimëve e kafshëve.

Pas tij erdhi Miskevejhi, autor i veprës *“Texharibu-l-umem”* (Përvojat e popujve), vepër kjo e cila nuk qe thjesht një vepër historike, por një libër që ofronte këshilla, të nxjerra nga ndodhitë e mëparshme dhe rrëfimet të cilat ngërthejnë në vete domethënie të madhe.

El-Biruni, në veprën e tij *“El-atharu-l-bakije ‘ani-l-kuruni-l-halije”* (Gjurmët e mbetura nga kohët e kaluara) provoi ta sqarojë botëkuptimin e periudhave të mëdha historike, të cilat paraqesin fillimin e një bote të re.

Përveç tjerash, ai vuri në dukje idenë se si historian do të mund ta eksperimentonte ngjarjen e caktuar historike, me ç’rast do të fokusohej e do të përqendrohej ekskluzivisht në të duke mos e kthyer vëmendjen në këtë rast te lidhja e së mëparshmes me të mëvonshmen.

Meritat më të mëdha në këtë fushë me të drejtë i takojnë Ibn Haldunit, i cili i mblodhi këto vepra e më pas e shtjelloi tematikën mbi historinë, po jo thjesht si histori, mirëpo duke e konsideruar atë një qytetërim të cilin e themelon dhe e ngrit një popull i caktuar që nga koha e lulëzimit dhe përparimit e deri në periudhat e plogështisë dhe rënies.

Ibn Halduni vuri parimet dhe rregullat të cilat i trajtonin këto zhvillime në dritën e historisë së popujve të mëparshëm.

Në këtë mënyrë, Ibn Halduni e ruajti historinë, jo nga zhytja, por nga bredhja dhe humbja, me qëllim që t’i japë një formë të re shoqërore në suaza të ideologjisë së shoqërisë, të cilën e sajoi ai për të arritur deri tek epoka e krijimit mendor e ideor.

Ibn Halduni, kësisoj, ishte një pishtar i historisë, i cili i mbushi faqet e saj me dritë e shkëlqim.

Mukaddimeja e tij vë në pah një njeri që e ka pasion analizën, hulumtimin e thellë dhe studimin rrënjësor të ngjarjeve e ndodhive, një njeri që ka aspirata krijuese dhe synime për ripërtrirje në periudhat e errësirës, në të cilat ka jetuar ummeti islam.

Duke i përjetuar edhe vetë këto, ai hapi dyert në drejtim të horizonteve të reja në të cilat nuk patën arritur historianët dhe autorët tjerë islamë më parë.

Nga fjalët dhe shprehjet e Ibn Haldunit mund të vihet re se ai është një enciklopedist i llojit të veçantë. Ai nuk përqendrohet vetëm në një fushë të dijes, por flet për secilën lëmi të diturisë, qoftë ajo fetare, filozofike apo praktike a jetësore.

Ibn Halduni, përveç tjerash, vuri në pah edhe zotërimin e mjeteve të njohjes, me ç’rast theksoi lidhjen e çdo grupi me burimin e njohjes së tij.

Ai shpjegoi ndikimet dhe fenomenet e natyrës e të gjeografisë, zanafillën e qenieve si dhe njohjen trashëguese mbi konstruktin e njeriun, krijesë kjo e cila e ndërton dhe e themelon një qytetërim në kohën kur jeton me anë të mjeteve që i posedon, kulturore e ideologjike, me anë të asaj që natyra ia vë në dispozicion t’i përdorë në bazë të qëndrimit të tij në një zonë të ftohtë, të nxehtë apo të ndryshueshme.

Pastaj, duke u mbështetur tek afëria e tij me rrafshinat, luginat e lumenjtë, a jeton në shkretëtirë, banon në qytet apoi përket fisit, gjë që njihet me emërtimin *“ligji i shkakut”*.

Autori në fjalë, çdo gjëje ia dha vendin e duhur duke sjellë argumente të bollshme për ta mbrojtur pikëpamjen dhe këndvështrimin e tij.

Në këtë punë të tij ai ishte objektiv dhe i drejtë, duke e cekur secilin fakt që kishte të bënte me lëminë e caktuar.

Madje, në disa raste, gjatë huazimit të disa fragmenteve, nuk harronte asnjëherë që t'i përmendte autorët e tyre.

Vepra e tij drejtoi edhe akuza ndaj disa historianëve e dijetarëve, të cilët përpiqeshin "të lërojnë në ujë".

Ibn Halduni tentoi ta lidhë të tashmen me të kaluarën duke marrë parasysh faktin se e tashmja është pjellë ligjore e së kaluarës.

Në këtë mënyrë ai arriti deri te caku i tij i ideologjisë së shoqërisë, duke i sqaruar parimet e qytetërimit dhe periudhat e shtetit, që nga ngritja dhe themelimi, më pas përparimi dhe lulëzimi për të arritur në fund te plogështia dhe dobësimi.

Ai sqaroi edhe faktorët ndikues në lëmenjtë e ndryshëm të diturisë, zejes e të tjera.

E lusim All-llahun e Lartësuar të na i falë mëkatet dhe gabimet tona!

Jetëshkrimi i Ibn Haldunit

Emri i tij i plotë është Veliju-d-din 'Abdurrahman ibn Muhammed ibn Ebi Bekr Muhammed ibnu-l-Hasen ibn Muhammed ibn Xherir ibn Muhammed ibn Ibrahim ibn 'Abdurrahman ibn Haldun, njëri nga yjet që e ndriçoi errësirën e natës pas dobësisë e plogështisë së myslimanëve dhe prapambetjes e dekadencës së tyre kulturore e mendore, njëri nga dhuntitë e begatitë, të cilën All-llahu ia fali Islamit në kohën e tij.

U lind në Tunis, në vitin 1332. Që nga rinia e hershme iu përkushtua dijes dhe studimit, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se u lind në një familje që kishte anime politike.

Qendra shkencore dhe shoqërore ishte në zë brenda bashkësisë tunisiane. Kështu, gjyshi i tij, Ebu Bekr Muhammed ibnu-l-Hasen ishte përgjegjës i çështjeve financiare në kohën kur pushtetin e kishte në dorë dinastia e muvehhidinëve në Afrikën veriperëndimore. Babai i tij, Muhammedi, tërë jetën ia kushtoi dijes dhe studimit. Ibn Halduni, më vonë, për të do të shprehet në këtë mënyrë:

"Babai im u largua nga rruga e shpatës dhe shërbimit për t'u drejtuar kah rruga e diturisë dhe hulumtimit".

Nuk ka dyshim se ky është njëri nga faktorët kryesorë të diturisë së gjerë të Ibn Haldunit. Pranë të atit të tij, ai mësoi Kur'anin me shtatë lloje të leximit. Pastaj, studioi veprën *"El-Hashije"* nga Ibnu-l-Haxhib si dhe mësoi sintaksën dhe të gjitha disiplinat e gjuhës pranë të atit dhe dijetarëve tjerë të Tunisit, si: Ebu 'Abdullah Muhammed ibn Ibrahim el-Ebli, tek i cili Ibn Halduni mësoi logjikën dhe filozofinë.

Në atë kohë, Tunisi goditet nga një epidemi si shkak i së cilës humbën jetën të dy prindërit e tij. I mërzitur, në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare u nis për në qytetin Fas, i cili atëbotë qeverisej nga merinidët.[2]

Aty, Ibn Halduni filloi ta shfaqte ambicien e tij politike, me ç'rast arriti të ngjitej në disa poste shtetërore, por pas një kohe hoqi dorë nga të gjitha ato për t'u emëruar në postin e sekretarit dhe mbikëqyrësit në pallatin e sulltanit, Ebu Anan si dhe ligjërues i këshillit të tij shkencor.

Për shkak të shpifjes që ia bënë, dy vjet qëndroi në burg (758 h - 759 h), më saktësisht nga fillimi i vitit 758 h, e deri në mbarim të vitit 759 h.

Pas vdekjes së Ebu Ananit, u lirua nga burgu. Pushtetin pas tij e mori Ebu Salimi, ndërkaq Ibn Halduni u emërua "sekretar i sekreteve të sulltanit".

Megjithatë, trazirat në territorin e Marokut nuk kishin fund. Ato e larguan jashtë Fasit, kështu që u nis për në Granadë, kryeqytet i dinastisë Benu-l-Ahmer.

Duke qenë në lidhje me bashkësinë e krishterë andaluziane, nëpërmjet ndërmjetësimeve zyrtare arriti në mbretërinë e Kastiljes, ku mbreti i saj dëshiroi ta mbajë në pallatin e tij në Sevilje, mirëpo ishin intrigat ato që sërish e larguan nga Granada, me ç'rast shkoi në Bu-

[2] Dinasti berbere në Marok.

xhaja, ku kreu detyrën e mbikëqyrësit të rojtarëve si dhe u angazhua në mësimdhënie, në xhaminë e kryeqytetit.

Përveç kësaj, pati rastin të ketë edhe disa poste politike. Më pas, u largua një kohë nga politika për t'iu përkushtuar diturisë, mirëpo pasioni i tij për arritjen e posteve politike e ktheu sërish në burg.

Pas daljes nga burgu, tentoi t'u bashkohet disa vëllezërive sufiste, mirëpo politika është një pasion dhe dëshirë, sëmundja e së cilës nuk ka shërim.

Në këtë mënyrë, u kthye sërish në Fas dhe pas shpifjes që i është bërë, niset për në Andaluzi. Duke e parë mikun e tij, ministrin Ibnu-l-Hatib, se si varej, iku me vrap nga bota e politikës për t'iu përkushtuar me mish e shpirt librave të tij.

Kishte filluar të udhëtojë në viset e tjera me qëllim që t'i përfundojë shkrimet e tij dhe të njihet më tepër me lëminë e historisë.

Gjatë kësaj kohe përjetoi humbjen e familjes së tij e cila u fundos në Aleksandri. Më pas, e larguan nga posti i gjykatësit në Egjipt, me ç'rast e la Kairon për së dyti.

Ishte bashkëkohanik i periudhës në të cilën Timurlenku ndërmori sulmin ndaj Egjiptit dhe Shamit. Vdiq në vitin 804 h / 1406, duke lënë pas vetes disa vepra të mrekullueshme, si:

1. *El-Mukaddime*;
2. *Lubabu-l-mahsal fi usuli-d-din* (në fushën e teologjisë dogmatike-skolastike);
3. *Et-Ta'rif* (Vepër autobiografike);
4. *Kitabun fi-t-tesavvuf "Shifau-s-sail"* (Libër mbi tesavvufin "Ilaçi i pyetësit");

dhe disa vepra tjera të cilat nuk arritën në duart tona, si: *"Sherhu-l-burde"* (Shpjegimi i poezisë "El-Burde") dhe një libërth mbi logjikën.

E lusim All-llahun e Lartësuar që të kemi dobi nga dija dhe veprat që i la autori.

KREU I PARË

Nga historia e dijetarit ibn haldun

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Robi i varfër që shpreson te mëshira e All-llahut, 'Abdurrahman ibn Muhammed ibn Haldun el-Hadremijj, Zoti i dhashtë sukses, thotë:

"Falënderimi qoftë për All-llahun, të cilit i takon forca e fuqia, i Cili në dorën e Tij ka pushet mbi mbretërinë e kësaj bote dhe asaj qiellore, atij i takojnë emrat dhe cilësitë më të bukura, i Cili di gjithçka, ashtu që nuk i ik as ajo që tregojnë pëshpëritjet apo që i fsheh heshtja; i Cili është i fortë, ashtu që për Të nuk është asgjë e pamundur në qiej dhe në tokë, e as që i shpëton ndonjë gjë; na krijoi nga toka përmes frymës dhe na vendosi në të në formën e gjeneratave dhe popujve, duke bërë që nga toka lehtë të arrijë ushqimi dhe caktimi; aty i kemi mëmëdhetë dhe shtëpitë si mbrojtje; e kemi të garantuar ushqimin dhe furnizimin; ditët dhe koha gjithnjë po na sprovojnë; na arrin fati i cili është i shkruar me shkronja të përkohësisë, derisa përhershmëria dhe ekzistenca i takojnë Atij, pasi Ai është i Gjalli, i cili nuk vdes kurrë. Paqja dhe bekimi qofshin mbi zotëriun dhe mbrojtësin tonë, Muhammedin, pejgamberin arab, të përmendur dhe të përshkruar në Tevrat dhe Inxhil, për shkak të lindjes së të cilit gjithësia kishte shtërzime, para ndërrimit të të dielave dhe të shtunave, ndërsa Saturni dhe Jehemuti[3] i janë bërë njëri-tjetrit kundërshti, e për vërtetësinë e të cilit kanë dëshmuar pëllumbi dhe merimanga.

Më pas, mbi familjen dhe shokët e të dërguarit, ata të cilët, duke e shoqëruar dhe ndjekur atë, kanë lënë famë dhe gjurmë të madhe; të cilët ishin plotësisht të bashkuar duke e përkrahur vazhdimisht atë, sa kohë që armiqtë e tyre ishin tërësisht të përçarë.

---

[3] El-Jehemut - sipas Mukatilit dhe El-Kelbit, *El-Behemut* (me b) paraqet balenën (*en-nun*), të përmendur në suren *El-kalem*: **"Nun. Pasha lapsin"**. (*El-Kalem*, 1-2) dhe se toka është e shtrirë në shpinën e saj. Këtë e përmend Kurtubiu (8/215) në tefsirin e tij. Sidoqoftë, kjo është një çështje nga israilijatet, e cila nuk mbështetet në një argument të prerë.

Allahu e mëshiroftë atë, po edhe ata, derisa Islamin e përcjell lumturia e madhe, kurse litarët e mosbesimit janë të prera e të copëtuara.”

Historia është njëra prej disiplinave e cila bartet dhe përhapet nga një popull te tjetri, nga brezi në brez, ndërsa një numër i madh njerëzish udhëtojnë për t’i shtuar njohuritë historike.

Njohjen e historisë synojnë ta arrijnë masa dhe vegjëlia, kurse rreth kësaj dije garojnë mbretërit dhe prijësit.

Në kuptimin e saj përpiqen të barazohen dijetarët e laikët, meqë, shikuar nga pamja e jashtme, historia paraqet rrëfimin mbi ngjarjet dhe shtetet nga kohët e para.

Rreth saj, njerëzit sajojnë lloj-lloj tregimesh e shembujsh kur mblidhen në ndonjë ceremoni a manifestim.

Nëpërmjet saj vërejmë se si janë ndryshuar mënyrat e jetës, si janë përhapur dinastitë dhe si janë humbur e zhdukur ato.

Shikuar më thellë, historia ngërthen në vete teori dhe përpjekje për të arritur tek e vërteta, shpjegim preciz dhe të thuktë mbi parimet e çdo gjëje ekzistuese si dhe njohje të thellë mbi veçoritë e ndodhive dhe shkaqet e tyre.

Në bazë të kësaj, ajo parimisht i takon filozofisë, andaj edhe duhet shikuar si njëra prej disiplinave të saj.

Historianët më eminentë islamë hollësisht i studiuan dhe i tubuan ndodhitë e kaluara, mandej i shkruan dhe i ruajtën ato në librat e tyre.

Kështu vepruan Ebu Xherir et-Taberi, Muhammed ibn Jahja dhe Muhammed ibn Sa’d.

Megjithatë, disa të vetëquajtur historianë, të padenjë për këtë lëmi, futën në ato vepra të dhëna dhe informata të pavërteta, trillime dhe arbitraritete dhe në këtë mënyrë ndodhitë i bënë të pambështetura dhe të rreme.

Rrugën e tyre e ndoqën një mori “dijetarësh”, të cilët i pranuan ato ndodhi duke i sjellë te ne ashtu si i dëgjuan, pa kushtuar aspak vëmendje te shkaqet dhe rrethanat e ndodhive.

Ata, madje, nuk i refuzuan rrëfimet e sajuara e të trilluara dhe nuk u distancuan prej tyre.

Janë bërë pak përpjekje për të ardhur deri tek e vërteta. Vështrimi kritik, në përgjithësi, është i plogësht.

Mu për këtë, gabimet, hipotezat dhe paragjykimet janë mjaft prezente në ato ndodhi.

Imitimi i verbër është rrënjosur thellë në karakterin e njeriut, ndërkaq studimi sipërfaqësor dhe i papërgjegjshëm i fushave të dijes është i përhapur gjerësisht.

Fusha e injorancës është e papërshtatshme dhe e turpshme midis njerëzve.

Por, megjithatë, askush nuk mund t’i kundërvihet forcës të së vërtetës e ta mposht atë, pasi është pishtari i hulumtimit ai që ngadhënjen e triumfon mbi gënjeshtrat e djallit.

Transmetuesi dikton dhe rrëfen, ndërsa mendjemprehtësia dhe syçelësia kanë për detyrë t’i vërtetojnë faktet dhe argumentet. Faqet e vërteta të diturisë gjithnjë shkëlqejnë dhe ndriçojnë.

Janë shkruar mjaft vepra sistematike të historisë. Janë përmbledhur dhe janë regjistruar kronikat e shumta të popujve dhe të shteteve.

Mirëpo, janë të pakët ata historianë që e meritojnë këtë emër. Historianët e vërtetë dhe të mirëfilltë mund të numërohen në gishta.

Të tillët janë: Ibn Is’haku, Et-Taberi, Ibnu-l-Kelbi, Muhammed ibn ‘Umer el-Vakidi, Sejf ibn ‘Umer el-Esedi, El-Mes’udi e disa të tjerë të njohur e të dalluar në mesin e historianëve.

Këtu, duhet përmendur fakti që veprat e El-Mes’udit dhe El-Vakidiut përmbajnë disa mangësi dhe dobësi që njihen nga ana e studiuesve objektivë dhe të mirëfilltë,[4] megjithatë që të gjithë unanimisht i pranuan informacionet e tyre dhe i ndoqën metodat e tyre gjatë shkrimit të veprave.

Kritiku i vëmendshëm dhe symprehtë duhet t’i peshojë mirë të pavërtetat dhe falsifikimet që i transmetojnë këta autorë.

[4] Kjo, për faktin se El-Mes’udi ishte nga radhët e shiive, një njeri i cili ndryshoi në fund të jetës dhe u ngatërrua.

Shumica e kronikave të këtyre autorëve karakterizohen me mënyra dhe metodologji të përgjithshme të përshkrimit të shtetit islam,[5] bashkë me provincat dhe krahinat e tij.

Ka prej autorëve të cilët i përmendën shtetet dhe popujt para Islamit, siç ishte El-Mes'udi dhe disa të tjerë që e ndoqën rrugën e tij.

Pas tyre erdhën të tjerë të cilët trasuan metodën e kufizimit duke u përqendruar njëherit te ngjarjet e kohës dhe vendit.

Këta u koncentruan vetëm në ndodhitë e shtetit të atëhershëm dhe provincat e tij, siç veproi Ebu Hajjani, historiani i Andaluzisë dhe shtetit emevit dhe Ibnu-r-Rekik, historian i Afrikës dhe i krahinave që ndodheshin në Kajrevan.

Pas këtyre, erdhën njerëz imitatorë, të ngathët e të kokëtrashë, të cilët pasuan metodologjinë e tyre duke mbledhur e grumbulluar[6] ndodhitë mbi shtetet dhe rrëfimet e ngjarjeve nga kohët e kaluara.

Tubuan gjëra, të zhveshura nga përmbajtja e tyre si dhe të dhëna të cilat nuk e gjykojnë injorancën.

Shumica e atyre ngjarjeve janë me burim të panjohur, grupe që nuk janë të klasifikuara e të ndara.

Këta autorë i përsërisnin ndodhitë e njohura në veprat e tyre duke i ndjekur kësisoj gjeneratat e para dhe duke mos e përfillur njëherit çështjen e brezave të ardhshëm, meqë, veprat e tyre vështirë kuptohen.[7]

Gjatë trajtimit të historikut të një shteti, ata i radhitën ngjarjet në mënyrë sistematike, duke u përkujdesur kryekëput për transmetimin, pa marrë parasysh a është i vërtetë apo jo. Në këtë punë të tyre ata nuk e përmendën fillimin e zanafillën, e as shkakun kryesor me të cilin lidhet ndodhia e caktuar.

[5] Këtu ka për qëllim dinastinë emevite dhe atë abaside, meqë shkrimi i historisë islame filloi të regjistrohet në kohën e shtetit abasid.

[6] Fjala është për historianë të tillë si Ibn Abdi Rabbihi, autor i veprës "El-'ikdu-l-ferid" dhe El-Asfahani me veprën e tij "El-Egani", të cilët i përzien veprat e mira me të tjera, të këqija duke futur në to gjëra të nevojshme e të panevojshme, gjë që ua uli vlerën atyre dhe të tjerëve për të cilët ata shkruan.

[7] Ka për qëllim faktin që një numër i madh i tyre nuk i kushtoi kujdes gjuhës së kohës dhe mentalitetit aktual, duke u mjaftuar me imitim, gjë e cila sipas mendimit të Ibn Haldunit (All-llahu e mëshiroftë) ia sjell historisë "vdekjen e ngadalshme".

Andaj, edhe lexuesi detyrohet t'i kërkojë shkaqet dhe arsyet e rrethanave si dhe t'i hulumtojë rrjedhojat e ngjeshura të kronologjisë së tyre, e kësisoj të gjejë një përgjigje të duhur mbi lidhjen dhe përshtatshmërinë e tyre.

Të gjitha këto do t'i përmendim radhazi në parathënien e librit.

Më vonë, u paraqitën të tjerët të cilët shkruan tepër shkurt duke u mjaftuar vetëm me përmendjen e emrave të mbretërve dhe sunduesve pa i cekur gjenealogjitë dhe ndodhitë e tyre. Kështu veproi historiani Ibn Reshik, në veprën e tij *"Mizanu-l-'amel"* (Peshoja e veprës) dhe disa të tjerë që vazhduan rrugën e tij.

Këta nuk sollën diçka që ia vlen të përmendet, madje edhe futën në veprat e tyre gjëra nga të cilat nuk ka kurrfarë dobi.

Pasi i studiova rrënjësisht veprat historike dhe hulumtova thellësinë e së tashmes dhe së kaluarës, u zgjova nga kotja dhe gjumi.

Edhe pse, i vetëdijshëm se nuk jam pjekur për këtë punë, vendosa të përpiloj një vepër historike. E ndava në kapituj të cilat përmbajnë faktet historike, sqarime të veçanta dhe vërejtje të përgjithshme.

Në të kam shtruar shkaqet dhe arsyet e lindjes së shteteve dhe shoqërisë.

Aty kam shtjelluar të dhënat mbi dy popuj, të cilët e ngritën Marokun dhe i zgjeruan krahinat dhe provincat e tij, duke i përmendur njëherësh edhe dinastitë e tyre të gjata e të shkurtra.

Këta janë arabët dhe berberët, dy popuj, vandbanimi i të cilëve ishte Maroku. Ata jetuan aty aq gjatë saqë nuk mund të paramendohej se në të banonte kush tjetër pos tyre.

Materialin e tubova në mënyrë të kujdesshme dhe ua dorëzova të diturve dhe elitës së njerëzve. Gjatë radhitjes së tij kam ndjekur një metodë të parrahur dhe origjinale.

Në të i kam sqaruar rrethanat dhe gjendjet e shoqërisë[8] dhe qytetërimit, me vështrim të veçantë në karakteristikat qenësore të shoqërisë

[8] Shoqëria përbën boshtin e veprës së Ibn Haldunit. Më vonë u bë e njohur me emërtimin *"Doktrina e shoqërisë"*. Në të, Ibn Halduni radhiti epokat dhe periudhat e shtetit si dhe zbërtheu një mori fenomenesh të cilat i shtynë shkencëtarët bashkëkohorë që t'i fusin në

njerëzore në një mënyrë e cila lexuesit ia mundëson t'i njohë shkaqet e ndodhive ashtu siç janë.

Kjo vepër ia ofron lexuesit njohuri rreth asaj se si në skenën historike janë shfaqur themeluesit e shteteve dhe dinastive të ndryshme.

Ajo kërkon nga lexuesi që të heqë dorë nga imitimi i verbër dhe të jetë i vëmendshëm e syçelë për rrethanat dhe gjendjet e kaluara dhe të ardhshme.

Veprën e kam ndarë në parathënie dhe tre kapituj:

- Parathënia: Përparësitë e shkencës së historisë, analiza e metodave të saj dhe flakja e gabimeve të historianëve;

- Kapitulli i parë: Mbi shoqërinë dhe karakteristikat themelore të saj; mbi pushtetin mbretëror dhe qeverisjen e tij; mbi të ardhurat dhe mjetet për jetesë; mbi zanatet, disiplinat shkencore dhe shkaqet e arsyet lidhur me to;

- Kapitulli i dytë: Historia e arabëve, brezat dhe shtetet e tyre që nga zanafilla e deri në ditët tona, me një vështrim mbi disa popuj e shtete të njohura që ishin bashkëkohanikë me ta, si: Nabatejët, sirët, persianët, çifutët, koptët, grekët, romakët, turqit dhe evropianët;

- Kapitulli i tretë: Mbi historinë e berberëve dhe zenatëve që kanë lidhje me ta; mbi zanafillën dhe pasardhësit e tyre, veçanërisht lidhur me shtetet dhe mbretëritë që i formuan ata;

Pas përfundimit të veprës, pasoi udhëtimi në Lindje për ta zbuluar dritën e saj dhe për ta kryer obligimin fetar të haxhillëkut dhe vizitën e Medines si dhe për t'i hulumtuar transmetimet e ndodhitë që ruheshin nëpër përmbledhjet dhe veprat historiografike të lindjes, materiale këto të cilat më mungonin.

Në këtë mënyrë i plotësova zbrazëtirat lidhur me ndodhitë mbi mbretërit persianë në ato vise, pastaj mbi dinastitë turke në krahinat, ku ata sundonin.

Fillova me shkaqet e përgjithshme për të vazhduar me informatat e veçanta, duke u nisur nga më e lehta tek ajo më e vështira.

ombrellën e *"sociologjisë"*. Thelbi i këndvështrimit të tij qëndron në lindjen e qytetërimit, lulëzimin e tij dhe më pas dobësinë dhe dekadencën e tij.

Fillimisht, i përmenda gjenealogjitë e përgjithshme për të vazhduar më tej me informata të hollësishme historike. Kësisoj, kjo vepër përmban historinë e detajuar botërore. Ajo që ishte e papërshtatshme, është hequr.

Këtu janë sqaruar shkaqet dhe arsyet e lindjes së shteteve. Kjo vepër është bërë mburojë e filozofisë dhe provë e mbështetje e historisë.

Këtu përfshihet historia e arabëve dhe berberëve, si ata qytetarë ashtu edhe nomadë. Aty, gjithashtu, përfshihen të dhënat mbi shtetet e mëdha e të forta, bashkëkohanike me ta. Në këtë mënyrë, kjo vepër paraqet një udhëzim dhe manual këshillash, të cilat janë nxjerrë nga hulumtimi dhe studimi i së kaluarës.

Për këtë arsye veprën e emërtova:

"Libri i këshillave dhe përmbledhja e parimeve mbi historinë e arabëve, persianëve, berberëve dhe bashkëkohanikëve të tyre të fortë".

Gjithçka që ishte me rëndësi nuk e kam lënë pasdore pa e përmendur, siç janë çështjet mbi lindjen e popujve dhe shteteve, bashkëkohanikët e popujve të parë, mbi shkaqet e ndryshimeve në të kaluarën, si dhe shoqërinë e shteteve dhe popujve në kohët e kaluara.

Aty bëhet fjalë për të gjitha çështjet inherente të shoqërisë njerëzore: Mbi shtetin, popullin, qytetin e fshatin; mbi qeverisjen dhe nënshtrimin; mbi popujt me numër të madh e të vogël; mbi disiplinat shkencore dhe zanatet; mbi fitimin dhe humbjen; mbi ndryshueshmërinë e rrethanave dhe gjendjeve të përgjithshme; mbi jetën nomade dhe qytetare; mbi të kaluarën dhe të ardhmen.

Këtu gjendet, pra, e gjithë ajo që është karakteristike për një shoqëri njerëzore në tërësi. Tërë këtë e kam shtjelluar thellësisht duke e sqaruar me argumentet dhe shkaqet e duhura.

Nga arabishtja
Mr. Jahja Hondozi

AL-MUQADDIMAH – IBN KHALDUN’S BOOK

(Summary)

In the name of Allah, the beneficent, the merciful

All praise is due to Allah, the lord of the worlds, the one who has no partner. Peace be upon the Prophet, who was sent as a mercy to the universe.

Many historical books were written during different periods of time, which dealt with events from the past.

Muslim interest in history dates back to the Abbasids. As time passed such skills became one of the best ways to reach fame and popularity.

مقدمة ابن خلدون

(خلاصة البحث)

بسم الله الرحمن الرحيم

مقدمة المحرر

الحمد الله رب العالمين الذي لا شريك له نحمده ونشكره كما حمده الحامدون.

الصلاة و السلام على النبي الذي جاء رحمة للعالمين.

خلال الفترات التاريخية المختلفة كتبت اعمال تاريخية والتى تطرقت الى احداث ماضية.

المسلمون عرفوا منذ القدم "صناعة التاريخ" منذ فترة الدولة العباسية ومع مرور الزمن هذه الصناعة تحولت الى انجح الطرق للحصول على الفخر والشعبية.

Dr. Islam Hasani

ORIGJINA E FINANCAVE DHE INSTITUCIONEVE TE KREDITIMIT SIPAS ISLAMIT

Para ardhjes së Pejgamberit a.s. shoqëria Arabe ka qenë e ndarë në fise dhe secili fis është qeverisur dhe kontrolluar nga traditat e tyre fisnore. Me ardhjen e Islamit, ato fise janë unifikuar ku arabët dhe joarabët janë bashkuar dhe qeverisur nga një qeveri dhe të gjithë kanë ndjekur një ligj (ligjin Islam). Unifikimi i ri i cili ka ndodhur e dërgoi atë shoqëri në transformim në dy aspekte: aspekti i parë, transformimi nga vlerat fisnore dhe nomade në vlera universale (vlera islame) dhe e dyta, transformimi në vlera socio-ekonomike. Këto fise të cilat u bashkuan dhe u vendosen në një vend pa bërë plane për jetë nomade atëherë kjo bëri shtytje për zhvillimin e agrokulturës, industrisë dhe prodhimit pasi filloi kërkesa për to kur shoqëria filloi të urbanizohet. Me zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi filloi të zhvillohet edhe aspekti financiar, ku u paraqit nevoja për transaksione finansiare.

Kur diskutohet për ‘bankimin Islam’ mund të mendohet për një sistem bankar i cili përmban të gjitha produktet moderne të bankimit dhe shërbimeve. Ky është një koncept i ri i bankimit në krahasim me konceptin e vjetër i cili është përdorur në ditët e hershme të Islamit,

dhe është një produkt i shoqërisë moderne. Prandaj, një model i hershëm i financave Islame pat filluar në ditët e hershme të Islamit, gjatë jetës së Pejgamberit a.s. ka pasur bankiera dhe aktivitete bankare në funksion para se të ekzistojnë bankat Islame. Shpallja e vërseteve Kur’anore që kanë folur rreth ndalimit të kamatës dhe aktiviteteve ekonomike në përgjithësi i kanë dhënë formën sferës ekonomike duke i përfshirë edhe aspektet e sistemit financiar.[1]

Pejgamberi a.s. ka qenë i njohur si një tregtar shumë i aftë sepse ai ka pasur tregtinë si profesion qysh nga fëmijëria. Ai vet ka marrë pjesë në ekspedita të karvanëve në udhëtime të gjata, kur ka qenë vetëm 12 vjeçar xhaxhai i tij e kishte marrë me vete në Siri ku edhe takohet me priftin Behira (ngjarje shumë e njohur në historinë islame), më vonë ai udhëtoi edhe në vende tjera me karvane të ndryshme për arsye tregtie.[2] I Dërguari i Zotit ka kryer edhe një shërbim tjetër me karakter ekonomik për njerëzit, ka shërbye edhe si vend për ruajtjen e kursimeve për njerëzit tjerë deri në kohën kur ka emigruar prej Mekës në Medine. Pas emigrimit personi i cili e ka zëvendësuar Pejgamberin a.s. në veprimin e kursimit ka qenë Zubair bin Al-Awwam, raportohet se në një kohë të caktuar kursimet e të tjerëve te ai kanë arritur shumën në 2,200,000 dërhem[3]. Kjo ngjarje tregon për besueshmëri që ka ekzistuar ndërmjet njerëzve dhe për traditën ekonomike të asaj shoqërie por edhe nevojën e një sistemi ku njerëzit mund të kursejnë dhe mund të investojnë sepse ato kursime janë investuar në projekte të ndryshme ashtu siç do të diskutohet në vijim.

Pas shpërnguljes së Muhamedit a.s. nga Mekja në Medine, një nga ngjarjet e rëndësishme të cilat kanë ndodhë ka qenë edhe themelimi i institucioneve ekonomike dhe financiare. Pejgamberi a.s. si një person i respektueshëm, i besueshëm dhe tregtar me përvojë, i cili pat vizitu-

[1] Abraham L. Udovitch, “Bankers Without Banks: Commerce Banking, and Society in the Islamic World of the Middle Ages”, Program in Near Eastern Studies No. 30, Princeton: Princeton University. Faqe 255-257.
[2] Joseph De Somogyi, “Trade in the Qur’an and Hadith”, The Muslim World, Vol. 52, No. 2, faqe 110
[3] Haron (1997) faqe 1.

ar vende të ndryshme për qëllime tregtie para pejgamberisë dhe i cili i pat vuajtur efektet e embargos ekonomike të vendosur kundër tij nga paganët e Mekes, ka qenë shumë i vëmendshëm për rendësinë e realitetit të pavarësisë socio-ekonomike e cila shpie në pavarësi politike.[4]

Duke ditur rendësinë e pavarësisë ekonomike ai filloi të zhvilloj të gjitha aspektet e ekonomisë në mënyrë që të jenë krejtësisht të pavarur në shtetin e ri të Medines të sapoformuar.

Në aspektin financiar, e themeloi *Bejtul mal*-in (shtëpinë e thesarit). Financimi i shtetit në atë kohe është bërë përmes *Bejtul mal*-it në nivel qendror dhe atë lokal duke pasur një nivel qendror të vendosur në kryeqendër dhe në degë tjera në provinca të ndryshme për nivelin lokal. Ky vend thesari është mbikëqyrur dhe drejtuar nga një zyrtar i cili është quajtur *hazin al-mal*, ndërsa ata të cilët ishin në nivel lokal janë quajtur *hazin* apo *Amin* ky person përveç aftësisë menaxhuese është dashur të jetë i njohur edhe për besnikëri. Këta persona kanë qenë të pavarur nga udhëheqësi i vendit dhe janë konsideruar prej elitës së popullatës.[5]

Prej burimeve të *Bejtul mal*-it ishin *Zekati*, *Sadakaja* (lëmosha), *Xhizja* (taksa në kokë banori për jomyslimanet të cilët kanë jetuar në shtetin Islam), *haraxh* (taksa ne toka), *hums* (një e pesta në plaçkën e luftës), and *Fejj* (të ardhurat nga tokat e shtetit).[6] Këto fonde janë shpenzuar në dy kategori të shpenzimeve: e para, janë shpenzuar për çka është konsideruar përgjegjësi e shtetit p.sh. shpenzimet e ushtrisë dhe pagat e zyrtarëve shtetëror. E dyta, ka përfshi financimet e aktiviteteve për të mirën e përgjithshme siç është, rregullimi i infrastruktures rrugore, ujësjellësin, dhe të ngjashme.[7]

---

[4] Cengiz Kallek, “Socio-Politico-Economic Sovereignity and the Market of Medina”. The Muslim World, Vol.52, No.2, 1995. faqe 110.

[5] S.M. Imam-ud-din, A Historical background of Modern Islamic Banking: The World of Islam Today, (New Delhi: Indian Institute of Applied Political Research, 1990) faqe 249-249.

[6] Ugi Suharto, Kitab al-Amwal: Abu Ubayd’s Concept of Public Finance, (Kuala Lumpur: ISTAC, 2005) faqe 75-80.

[7] Sudin Haron and Bala Shanmugam, Islamic Banking System – Concepts and Applications, (Kuala Lumpur: Pelanduk Publications, 1997) faqe 2-3.

Bajtul mal-i si një institucion shumë i rëndësishëm në aspektin financiar dhe përkrahës për popullatën në aspektin humanitar nuk është konsideruar vetëm pasuri e Myslimanëve por edhe e jo-Myslimanëve. Nga fondet e *Bejtul mal*-it qeveria ka qenë e obliguar për t'i ndihmuar dhe përkrahur edhe *dhimmijet* (jo Myslimanët brenda shtetit Musliman). Marrëveshja në mes Halid bin Welidit dhe popullit të Hiras ka qenë që të vjetrit nga *dhimmijët* të lirohen nga pagesa e xhizjes dhe gjithashtu atyre do të iu jepet ndihmë financiare përderisa ata jetojnë në shtetin Mysliman.[8]

Lloji i dytë i thesarit është quajtur *Bejtul mal el-Muslimin* i cili ka qenë i vendosur në xhaminë kryesore nën mbikëqyrjen e gjykatësit kryesor të vendit. Ky thesar ka qenë i ndryshëm nga thesari shtetëror. Burimet e këtij thesari kanë qenë sadakaja (lëmosha) dhe është shpenzuar kryesisht për të iu ndihmuar Myslimanëve të varfër dhe të nevojshëm. Gjithashtu ka shërbye edhe për depozitimin e fondeve të vakafit dhe parave të jetimëve. Në mungesë të kujdestarit ligjor për fëmijët jetimë gjykatësi e ka luajtur rolin e kujdestarit të jetimëve dhe ka pas shumë raste kur depozitat që janë lënë në emër të jetimëve janë mbajtur në *Bejtul mal el-Muslimin*. Në raste kur thesari shtetëror nuk ka pasur fonde të mjaftueshme dhe udhëheqësi ka kërkuar nga Gjykata që t'i përdor fondet e këtij thesari për nevoja shtetërore të cilat kanë qenë shumë të nevojshme, për shembull, riparimi i ndonjë fortifikate për tu mbrojtur nga armiku. Gjykatësi ka pasur autoritet për t'i dhënë atij fondet e nevojshme për gjera esenciale që kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës në përgjithësi.[9]

Ka ekzistuar edhe lloji i tretë i thesarit i cili është quajtur *Bejtul mal el-has* i cili është themeluar nga Halifet Emevij të Damaskut dhe është përdorur edhe nga Halifet Abasij, ky thesar është përdorur për mbulimin e shpenzimeve personale të halifëve. Burim për këtë lloj fondi ka qenë një pjesë e plaçkës së luftës.[10]

---

[8] Imam-ud-din (1990), faqe 249.

[9] Ibid, faqe 250-251.

[10] Ibid.

Një institucion tjetër me rëndësi të madhe që është themeluar në kohën e Pejgamberit a.s. menjëherë pas shpërnguljes dhe i cili është shumë i njohur në civilizimin Islam është institucioni i Vakafit. Ky institucion shumë i rëndësishëm është themeluar për të përkrahur mirëqenien shoqërore dhe ekzistonte në çdo vend Mysliman, por në disa vende nuk ishte funksional ashtu si duhej të ishte. Organizimi i fondeve të vakafit dallon prej atyre të *bejtul mal*-it. Kur shokët e Pejgamberit a.s. kanë ofruar fonde në mënyrë vullnetare për mirëqenien e popullsisë, Pejgamberi a.s. këto fonde i ka pranuar dhe futur nën emrin e vakafit.[11] Burimet e vakafit kanë qenë kryesisht donacionet e jo detyrimet sikurse ishte rasti me *bejtul mal*, ky institucion është zhvilluar edhe më shumë në kohët e mëvonshme dhe sot në shtetet Islame ky institucion kontrollon një shumë të madhe të fondeve dhe luan një rol shumë të rëndësishëm për përkrahjen e aktiviteteve dhe zhvillimit të komuniteteve myslimane.

Institucioni i parë financiar i themeluar zyrtarisht si një institucion financiar në shoqërinë Islame është themeluar nga Omeri r.a. 10 vite pas vdekjes së Pejgamberit a.s.. Ky institucion është quajtur ‘Diwan’, i cili është adaptuar nga Persianët. Pas zgjerimit të kufijve të shtetit Islam, posaçërisht pas fitores kundër dy perandorive të mëdha, Bizantine dhe Persiane, është bërë një përkrahje financiare për të gjithë të nevojshmit që kanë jetuar në shtetin Islam. Me themelimin e këtij institucioni është bërë regjistrimi i gjithë popullsisë dhe gjendja e tyre materiale. Të gjithë atyre që kanë pasur nevojë për ndihmë janë selektuar përmes këtij institucioni dhe disave iu është dhënë një formë e pensionit të përhershëm dhe disave iu është dhënë ndihmë sipas nevojës.[12]

[11] Abdul Azim Islahi, “Provision of Public Goods: Role of the Voluntary Sector (Waqf) in Islamic History” Brenda librit Financing Development in Islam Seminar Proceeding Series. Edituar nga: M.A. Mannan, (Jeddah: IDB, 1996) faqe, 371-378.

[12] Lewis & Algoud (2001) faqe. 4-5.

Institucionet e Kreditimit në ditët e hershme të Islamit

Fjala kredit e ka burimin nga fjala latine ‘Credo’, që do të thotë besim në aftësinë e personit apo institucionit për të paguar. Instrumentet e kreditit-kreditimit janë çeqet, premtimet qeveritare, fletë transferet dhe të ngjashme. Instrumentet bazuar në konceptin e financimit në kredit kanë ekzistuar edhe në ditët e hershme të Islamit por me terminologji të ndryshme. Në vijim do të përmenden disa prej terminologjive të hershme të financimit në kredit dhe terminologji e transaksioneve bankare të cilat janë përdorur shumë herët nga Myslimanët.

Praktika e këmbimit të valutave të ndryshme ka ekzistuar edhe në kohen e Pejgamberit a.s., termi i cili i referohet këtij transaksioni në gjuhën e Sheriatit quhet *Sarf*. Historia e fjalës *Sarf* rrjedhë nga fjala *Sajrafah* e cila daton që nga koha e babilonasve. Në ditët e hershme të Islamit filloi të ndihet nevoja për këmbim të dinarëve (prodhuar nga ari) në dirhem (prodhuar nga argjendi) dhe anasjelltas për ta ndihmuar tregtinë ndërkombëtare që vinte nga vendet e ndryshme. Pejgamberi a.s. i mësoi tregtarët e asaj kohe se është e lejuar të praktikojnë ketë lloj biznesi por pagesa e njërës dhe tjetrës valutë duhet të bëhet menjëherë në dorë për të dy valutat, nuk lejohet që njëra të merret menjëherë e tjetra pas një kohe por që të dyja duhet të këmbehen në të njëjtën kohë.[13] Vlera e valutave mund të ndryshoj në çdo moment të kohës dhe si rezultat njëra prej palëve do të jetë në humbje. Humbja apo fitimi i njërës palë e bënë transaksionin në gjendje të pasigurisë e cila kategorizohet në *mejsir* (bixhoz), dhe në anën tjetër përfshin *riba* (kamate), të dyja të ndaluara sipas normave Islame.

Në civilizimin Islam ka qenë e njohur tregtia me përdorimin e letrave komerciale në shekullin e parë hixhri. Ata u jepnin ushtarëve dhe zyrtarëve qeveritar kupona si zëvendësim për pagesë të cilat quheshin *Sakk*. Termi ‘cheque’ - ‘çek’ i cili përdoret në bankimin e sotshëm e ka origjinën nga kjo fjale Arabe *Sakk* shumësi *Sukuk* dhe

[13] Wahbah al-Zuhajli, Al-Fikh al-Islami we Ediletuhu, volumi 4, edicioni i 3 te, (Damascus: Darul Fikr, 1989) faqe 636.

konceptit të fjalës Persiane *Suftaxhah* që në origjinë ka kuptimin 'Para letre' apo 'Letër krediti'.[14]

Një tjetër term i cili ka përdorim të përafërt me suftaxha është termi i cili rrjedh nga gjuha arabe Hawalah. Ky term rrjedh nga fjala arabe al-tahawwul apo al-tahwil që do të thotë transferim apo ndërrim i lokacionit nga një person në tjetrin apo nga një institucion në tjetrin. Është një marrëveshje me të cilën borxhliu lirohet nga borxhi duke marrë përsipër dikush tjetër borxhin e tij. Gjithashtu i mundëson një personi të bëj pagesa në një vend tjetër përmes agjentit. Kontrata e hawalah nuk ka qenë e njohur para ardhjes së Muhamedit a.s.[15] Kjo iu ka ndihmuar tregtarëve të transferojnë paratë nga një vend në tjetrin pa i lëvizur paratë e gatshme. Për shkak të vështirësive kur ata udhëtonin me anë të detit apo shkretëtirës, dhe duke ditur edhe rrezikun e udhëtimit me para të gatshme me vete, ata inicuan përdorimin e asaj që sot njihet si çek (cheque) në transferet e tyre dhe mënyrat tjera të pagesës. Personi që ka lëshuar çekun e parë ka qenë Sayf Dawlah al-Hamdani që ka arritur vlerën 42 mije dinarë dhe kjo ka ndodhë në vititn 970.[16]

Një institucion tjetër i rëndësishëm i kësaj natyre është edhe përdorimi i Xhahbadh i cili si terminologji është marrë nga fjala persiane Kahbadh që kishte kuptimin, këmbimore parash (Money-changer), bankier, apo mbledhës taksash. Kjo ka filluar të përdoret që nga koha e Emevive në kohën e Muavijes. Më vonë në kohën e Abasidëve është zhvilluar edhe më shume dhe aktivitetet brenda këtij instituti janë intensifikuar dhe kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm si mbledhës taksash dhe llogaritje në disa provinca. Obligim i këtij institucioni ka qenë të dijë edhe vlerën e valutave të ndryshme dhe të bëj ndërrimin e tyre në mënyrë sa më efikase.[17]

[14] Will Durant, Kissah al-Hadarah: Asrul Iman, perkthyer nga Muhammad Badran, (Beirut: Dar al-Fikr, 1988) faqe 111.
[15] Abdullah Alwi Haji Hassan, Sales and Contract in Early Islamic Commercial Law, (New Delhi: Kitabbhawan, 1991), faqe 181-182.
[16] Sami H. Hamoud, "Concept and Operation of Islamic Banks" Brenda librit, Islamic Financial Institutions, edituar nga Fahim Khan, (Jeddah: IRTI, 1995) faqe 36-37.
[17] Imam-ud-din (1990) faqe 255.

Tregtia ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik te perandoritë e ndryshme myslimane që nga fillimi i zhvillimit të shtetit mysliman. Me kalimin e kohës dhe me zgjerimin e kufijve të shtetit mysliman tregtia dhe mjetet e tregtisë gjithmonë kanë qenë në zhvillim në mënyrë që t'i përgjigjen nevojës së kohës. Kanë ekzistuar grupe dhe kategori të ndryshme të tregtarëve, janë ndarë në grupe dhe nivele të ndryshme, grupe të cilat janë marrë vetëm me tregti ndërkombëtare, import – eksport, shitës me shumicë dhe shitës me pakicë. Krahas këtyre grupeve tregtare në treg ka pasur edhe agjent të ndryshëm të cilët janë marrë me ndërmjetësime. Në vazhdimësi janë formuar grupe tjera të cilët kanë formuar shoqëri aksionare për të ndërmarrë projekte kolosale si në tregti ashtu edhe në investime të ndryshme. Këto kompani më vonë janë zgjeruar duke hapur degë në tërë territorin dhe i kanë ngjarë shoqërive aksionare të përbashkëta dhe të kufizuara.[18]

Me rritjen e vëllimit të investimeve dhe tregtisë dhe kërkesa në treg e ka bërë që të themelohen lloje të grupeve të tregtarëve të cilët kanë pasur mundësi të financojnë dhe t'i ndihmojnë ata të cilët kanë pasur aftësi në zhvillim. Kjo formë e investimit është në mënyrën e cila ka qenë e pranuar në Islam, dhe këto grupe të tregtarëve i kanë ngjarë institucioneve të sotshme financiare. Këto institucione janë zhvilluar edhe më shume sa që kanë arritur tu japin hua edhe qeverisë dhe përfitimi i tyre në këto hua ka qenë në formë aksionare (pjesëmarrje në humbje dhe fitim). Më vonë këto institucione filluan edhe me marrjen e depozitave dhe investime të mëdha edhe në industri, në realitet këto ishin institucione bankare të një karakteri primitiv që iu ka përshtatur shumë mirë kohës në të cilën kanë funksionuar. Me zhvillimin e tregtisë dhe industrisë edhe këto institucione janë zhvilluar për të iu përgjigjur nevojës së kohës, dhe kanë bërë të gjitha transaksionet financiare të kërkuara në atë kohë.[19]

[18] Ibid.
[19] Rashid Akhtar Nadvi, "Industry and Commerce under the Abbasids", Journal of Pakistani History and Sociology, Vol. 1. No. III, 1953. faqe 260-261.

Me kalimin e kohës, sistemi monetar i shtetit mysliman arriti një përdorim të gjerë deri në atë shkallë sa që në shekullin e 10 dhe 11 dinari i shtypur në shtetin mysliman me mbishkrime islame ishte bërë monedha kryesore në tërë rajonin e Mesdheut. Kjo kohë ka qenë koha kur në Evropë është konsideruar si kohë e errët e Evropës. Shumë më vonë këto zhvillime kanë kaluar në Evropë.[20]

[20] John D. Lowe, "A Medieval Instance of Grasham's Law: The Fatimid Monetary System and the Decline of Bimetallisme", The UCLA Journal of Middle Eastern Studies, No. 2. 1986. faqe 2-3.

Dr. Islam Hasani

THE ORIGIN OF FINANCES AND CREDIT INSTITUTIONS ACCORDING TO ISLAM

(Summary)

Prior to the arrival of the Prophet, the Arab society was divided in tribes. Each tribe was governed and controlled by its own traditions. After the arrival of Islam, the tribes united (both Arabs and non-Arabs) and were governed by a single government and ruled by the same law (Islamic law). Unification helped the transformation of society in two aspects: the transformation from tribal-nomadic values to universal values (Islamic values) and socio-economic transformation. The decision to settle down and give up the nomadic way of living led to the development of agriculture, industry and production. The demand for such products increased parallel to the urbanization of society. With the development of the economy the need for financial transactions arose.

اسلام حسن

اصل التمويل ومؤسسات الإقراض وفقا للاسلام

(خلاصة البحث)

قبل قدوم النبي صلى الله عليه و السلم كان المجتمع العربي منقسما على القبائل و كانت كل قبيلة تخضع لقواعد وتقاليد قبيلتها. و مع مجيئ الاسلام اتحدت هذه القبائل حيث اصبح العرب و غير العرب يتحكمون الى قانون واحد و يخضعون لحكومة واحدة. الاتحاد الذى حصل في ذلك المجتمع ادى الى تحول من ناحيتين: الناحية الأولى التحول من القيم القبلية والبادية الى قيم عامة (قيم اسلامية) و التحول الثاني التحول الى قيم اجتماعية واقتصادية. هذه القبائل التى اجتمعت و اتسقرت في مكان واحد دون وضع الخطط اللازمة لحياة البدو و هذا دفعهم الى تطوير الزراعة والصناعة بعدما ظهرت الطلبات لهذا المجتمع و بدأ يتحضر و مع تطوير الاقتصاد بدأ تطوير الجانب المالي، حيث كانت هناك حاجة للمعاملات المالية.

PORTRETE TË SAHABEVE

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

FAMILJA E JASIRIT
(Jasiri, Sumeja dhe Amari)

"Durim familje e Jasirit …….vendi i juaj është xheneti".

Muhamedi i dërguari i Allahut

Në një mëngjes me lagështi ….

Me mot të freskët…

Karvani që vinte prej Jemenit kishte arritur në periferi të Mekës...

Ku.r Jasir bin Amir El-Ken'ani arriti në Qaben e shenjtë pamja e saj e magjepsoi dhe zemra e tij iu bë mal….

Sytë e tij nuk kishin pasur rast ta shohin atë më parë.

****

Jasiri nuk ishte ardhur për tregti , ashtu siç bënin zakonisht nje-rëzit e karvanëve.

Ai kishte ardhur me dy vëllezërit e tij Harithin dhe Malikun, për të kërkuar një vëlla të tyre, i cili u kishte humbur para disa viteve pa lënë asnjë gjurmë.

****

Tre vëllezërit u nisën për ta kërkuar vëllain e tyre të në çdo vend…

Nuk lanë pa pyetur asnjë njeri apo grup njerëzish që takonin në rrugët e Mekës dhe periferisë së saj..

Më në fund kur humbën çdo shpresë për gjetjen e tij., tre vëllezërit morën rrugë të ndryshme.

Harithi dhe Maliku u kthyen në vendlindjen e tyre në Jemenin e gëzuar.

Jasirin, si duket Mekeja e magjepsoi me madhështinë dhe bukuri-në e saj. Ai vendosi të qëndroj aty. Mekja të bëhet vendlindje dhe atdhe i tij..

****

Jasir bin Malik el-Ken'ani kur e mori atë vendim nuk e dinte se çfarë madhështie do ta pret atë…

Nuk e dinte ai se po hyn në histori nëpër portat më të gjëra të saj…

Jasiri në Meke nuk kishte farefis që mund ta mbronte…

As familje të mbante lidhje me të…

Një jabanxhi si ai, duhej të bënte aleancë me ndonjë zotëri prej zo-tërinjve të popullit që të mund të vazhdojë jetën i sigurt dhe i qetë në atë shoqëri ku nuk ka vend për të dobëtit…..

Ai bëri aleancë me Ebu Hudhejfe bin Mugire el-Mahzumi.

****

Ebu Hudhejfe vërejti tek Jasiri atributet njerëzore dhe fisnike, të cilat bënë që ai ta martojë atë me një robëreshë që quhej Sumeje bintu Hibat.

Fryt i kësaj martese ishte lindja e një djali për të cilin të dy prindërit u gëzuan jashtë mase….

E quajtën me emrin Am-mar.

Gëzimi i tyre u dyfishua kur atë e liroi Ebu Hudhejfe dhe e shpalli të lirë prej robërisë.

***

Familja jetoi nën mbrojtjen e benu Mahzumit, një jetë të qetë e të lumtur…

Ditët kalonin dhe çështjet ecnin…ndërkohë që Jasiri dhe Sumeja po plakeshin …

Jasiri po bëhej djalë i shëndetshëm dhe i pjekur.

***

Deshi i madhi Zot që tokën ta stolis me dritë.…

Në shkretëtirën e Mekës të lind drita e cila do ta përfshijë tërë universin me mirësi dhe begati….

E mbuloi atë me drejtësi dhe bamirësi…

Aty u dërgua pejgamberi që nuk dinte shkrim e lexim, të shpalosë misionin e Krijuesit të vet…

Tu tërheq vërejtjen popullit të vet dhe t'i përgëzon ata…

T'i thërret ata në atë që është krenaria e dynjasë dhe lumturia e ahiretit.

***

Amari dëgjoi lajmet e thirrjes së re prej njerëzve, të cilave ua hapi veshët , mendjen dhe zemrën e tij.. Mirëpo, ai kur vërejti se ajo që arrinte tek ai ishte pak e nga një herë kundërthënëse, nuk e kënaqte shpirtin e tij….

Foli vetmeveti e tha: Medet për ty o Amar?! "Çka të pengon ty që të jesh i etur kur burimin e ujit e ke afër"!...

Eja tek i zoti i misionit…

Eja tek Muhamedi i biri i Abdullahut. Tek ai dhe tek shokët e tij është lajmi i besueshëm….

***

Prej atij momenti, Amar bin Jasir shkon në shtëpinë "El-Erkam bin Ebi El-Erkam…

Atje u gëzua për takimin me Pejgamberin, paqa dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të. Aty dëgjoi prej tij fjalë të bukura që të dridhen zemrën e tij…

Aty mësoi udhëzime që e mbushen zemrën e tij me urtësi dhe dritë…..

Pa u hamendur ia shtriu dorën të dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të e i tha:

"Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se ti je robi dhe i dërguari i Tij".

***

Pastaj, Amari u drejtua te nëna e tij Sumeja dhe e thirri në Islam. Sa shpejt iu përgjigj thirrjes së tij, sikur ajo të ishte marrë vesh paraprakisht me të…

Pastaj iu drejtua babait të tij Jasirit dhe e thirri në atë që kishte thirrur nënën e vet.

Baba i tij u përgjigj menjë herë. Mu ashtu siç kishte vepruar nëna e tij. Kështu, pra varganit të dritës së Islamit, iu bashkëngjit kjo familje tre anëtarëshe, drita e së cilës ende po shndrit zemrat e besimtarëve deri në ditët tona….

Kështu do të mbetet - me ndihmën e Allahut - derisa të trashëgohet toka dhe ata që jetojnë në të.

***

Lajmi i islamit të këtyre tre personave shumë shpejt arriti te beni Mahzumët, të cilët u zemëruan shumë…..

U betuan se patjetër do ti kthejnë në fenë e të parëve ose do t'i ekspozohen vdekjes nga torturat….

I merrnin prindërit si dhe djaloshin e tyre dhe i çonin në luginën e Mekës. Atje ua vishnin gjoksoret e metalta dhe ashtu i ekspozonin në rrezet përcëlluese të dielli të Mekës….

Nuk i jepnin të pijnë ujë. Pastaj i rrihnin njëri pas tjetrit…

Derisa u terej fyti, u thaheshin djersët, u çahej lëkura dhe u rridhte gjaku….

Kështu përfundonte një ditë ditë torture për të vazhduar pastaj ditën tjetër.

Një ditë prej ditësh pranë tyre kaloi Pejgamberi a.s dhe i pa se si po torturoheshin ..

Iu rrëqeth zemra nga persekutimi dhe tmerrin që po ushtrohej ndaj tyre…

Por, ai nuk kishte mundësi tu ofronte çfarëdo ndihme. Andaj, u ndal para tyre e u tha:

"Durim o familja e Jasirit,vendi i juaj do të jetë xheneti…."

U qetësuan shpirtrat e persekutuar ….

U qetësuan sytë e hapur …

Fytyrat e lodhua buzëqeshën të kënaqura….

****

Dy pleqtë nuk jetuan gjatë….

Sumeja ishte duke u torturuar kur pranë saj kaloi Ebu Xhehli. E shau dhe e ofendoi shumë rëndë, por ajo nuk ia vuri veshin…

Atëherë e nxori shtizën dhe ia nguli në fund të barkut, maja e së cilës doli në shpinë…

Ishte shehidi i parë i rënë në Islam…

Mjafton vetëm kjo lartësim dhe madhështi.

Kurse Jasiri vdiq nga torturat, duke dëshmuar se nuk ka zot tjetër dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut.

****

Torturat u shtuan ndaj Amarit pas vdekjes së prindërve të tij. Xhelatët tejkaluan çdo kufi në persekutimin e tij.

Një ditë prej ditësh ia mësyu te Dërguari i Allahut, i lodhur, i pikëlluar e i turpëruar…

U përpoq ta shikoj të dërguarin paqa dhe shpëtimi i Allahut qof-shin mbi të dhe të ngopet me dashurinë e tij, por nuk mundi t'i ngrit

sytë tek ai. Atëherë, Pejgamberi a.s. e pyeti: "Cka të ka ndodhur o Amar?!"

Amari u përgjigj: Një e keqe e përhapur o i dërguari i Allahut.

Pejgamberi e pyeti: "Cili është ajo?!"

Amari ia ktheu: Jam torturuar dje aq shumë sa që edhe mali do të ishte çarë...Armiqtë e Allahut nuk mjaftuan vetëm me vapën e mesit të ditës, por ata nisën ta djegin trupin tim me zjarre…

Ata bënë përpjekje që të përmendi ty për të keq dhe të përmendi zotërat e tyre për të mirë, derisa unë bëra një gjë të tillë…

Pastaj ia nisi të qaj me zë, sa ta thante zemrën…

Pejgamberi a.s., atëherë e pyeti:

"Si e ndiejshe zemrën tënde o Amar?"

U përgjigj: E ndieja plotë iman o i dërguari i Allahut.

Pejgamberi, atëherë i tha: "Nuk ka asgjë o Amar dhe nëse përsëri veprojnë kështu, thuaj atë që ke thënë".

Allahu me madhështinë e Vet, e nderoi Amarin, duke zbritur Kur'an për të, ku thuhet:

"Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit, *(do të dënohet ashpër),* ***përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh".*** *(Kur'ani, En-nahl:106).*

****

Kur Pejgamberi a.s. u lejoi sahabeve të tij të shpërngulen për në Medine, Amar bin Jasir ishte prej të parëve, për ta ruajtur fenë e vet.

Posa arritën në Kuba, ku zbritnin muhaxhirët, bëri thirrje për ndërtimin e xhamisë ku do të falnin namazet. Të gjithë iu përgjigjën thirrjes së tij.

Xhaminë të cilën e ndërtoi Amar bin Jasiri është xhamia e parë e ndërtuar në islam. Mjafton kjo vepër nder dhe respekt për të.

****

Kur Pejgamberi, paqa dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të, u shpërngul në Medine, Amari e përjetoi me gëzim të madh. U gëzua ashtu siç gëzohet dosti kur takohet me dostin e vet. Nuk iu largua asnjë herë, natë e ditë. Vazhdimisht ishte në shoqërinë e Pejgamberit a.s.

Pejgamberi a.s. po ashtu e donte dhe respektonte shumë. Cdo herë kur vinte tek Pejgamberi a.s. thoshte: " Erdhi i miri i biri i të mirit".

****

Ditën e Bedrit, Amari luftoi nën flamurin e Pejgamberit a.s., dhe u dallua me trimërinë e tij..

Ishte myslimani i vetëm që mori pjesë në betejë e dy prindërit e tij ishin besimtarë dhe shehidë.

****

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. dhe braktisjes së Islamit nga një numër i konsiderueshëm i arabëve, në betejën e Jemames ai pati një qëndrim të dalluar…

Në momentin kur numri i të vrarëve nga sahabet e Pejgamberit a.s. mori përmasa marramendëse dhe kur vdekja nisi ti rrëmbejë hafëzët e Kur’anit…

Toka nisi të dridhte nën këmbët e myslimanëve…

Amar bin Jasir hipi mbi një guri të lartë, me veshë të prerë, që kishin mbetur të ngjitur për kokën e tij dhe tha:

O myslimanë a prej xheneti po ikni…

Tek unë, tek unë o myslimanë ejani..

Amari u nis i pari, ndërsa dy laprat e veshëve kishin mbetur të kacavjerrta në faqet e tij.

Ata qëndruan derisa më në fund u mbyt Musejleme El-Kedhab dhe njerëzit filluan përsëri të kthehen në fenë e Allahut grupe - grupe, ashti siç kishin dal prej saj grupe - grupe.

****

Me ardhjen e Omer El-Farukut, halif i myslimanëve, Amarin e caktoi vali të Kufes së bashku me Abdullah ibnu Mes'udin.

Në shkresën që Omeri u dërgoi banorëve të Kufës shkruante:

"Unë po u dërgoj Amarin princ (udhëheqës), kurse Abdullah ibnu Mes’udin mësues dhe ministër…këta dy janë prej të zgjedhurve të sahabeve të dërguarit tuaj Muhamedit a.s., dëgjoni këta dy dhe pasoni urdhrat e tyre".

Pas një kohe Omeri e shkarkoi Amarin nga posti i valiut dhe kur e takoi i tha:

"A je hidhëruar për atë që bëra me ty o Amar?"

Amari ia ktheu: "Betohem në Allahun se më shumë më ka hidhëruar caktimi në postin e valiut se sa shkarkimi nga ai."

****

Allahu qoftë i kënaqur në Amar ibnu Jasirin…

Ishte përplot besim (iman) prej majës së kokës e deri te shputat e këmbëve…

Allahu qoftë i kënaqur me babain e tij Jasirin…

Dhe nënën e tij Sumejen…

Shtëpia e tyre ishte shtëpi e besimit…

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha

FAMILY OF YASIR
(Yasir, Sumayyah and Amar)

(Summary)

Family of Yasir, be patient! Your reward will be paradise!
Muhammad – Allah's Messenger
In a humid morning...
With cool weather...
The caravan that was coming from Yemen had arrived outside Mecca...
When Ammar bin Yasir reached the holy Kaaba its sight captivated him...
His eyes had never seen it before.

عبد الرحمن رأفت الباشا

آل ياسر
(ياسر، سمية والعمار)

(خلاصة البحث)

"الصبر يا آل ياسر...فان موعدكم الجنة".
محمد رسول الله
في صباح رطب....
مع هذا الطقس البارد...
كانت القافلة التي جاءت من اليمن وصلت مشارف مكة المكرمة...
عندما وصل المهاجر ياسر بن عمير الكنعاني الى الكعبة المقدسة فتنه مظهرها و عيناه لم تر مظهرا مثله من قبل .

RECENSIONE

Akad. Dr. Feti Mehdiu

E VËRTETA ËSHTË ILAÇ I HIDHUR POR SHËRUES

Me kusht që ilaçi të përdoret me kohë!

Muhammedi a.s. porosiste: Thuaje të vërtetën qoftë edhe në dëm tëndin, madje edhe kur është e hidhur.

Dhe e vërteta, shumica thonë, është e hidhur! Por, kjo nuk është apsolute. E vërteta i dhembë vetëm atij që nuk e do drejtësinë. Pavarësisht nga kjo, e vërteta është ilaç, ajo shëron, prandaj Sabri Maxhuni – Novosella, pikërishtë ka zgjedhë ilaçin më efektiv për shërim.

Ai këto ditë botoi librin:

Drejt shtetit shqiptar në kufijtë kombëtarë, Prishtinë, 2010, fq.262.



Autori i këtij libri qysh me botimin e librit të parë: *Rezistenca Kosovare mes dy zjarresh*[1], dëshmoi se ky njeri, i cili me gjilpër në dorë diti të therrë burokracinë e Kosovës qysh nga viti 1963, ka prirje që edhe me pendë të afrojë kontributin e vet për ardhmërinë e Kosovës, duke thumbuar strukturat udhëheqëse të një spektri të gjerë të Kosovës me qëllim që të kthjellohen sa më parë dhe ta shohin gjendjen reale në Kosovë.

Ky afinitet dhe gatishmëri e Sabri Maxhunit është treguar më së miri me librin: *Drejt shtetit shqiptarë në kufij kombëtarë.* Libri vjen në një kohë delikate dhe moment shumë të rëndësishëm për situatën në Kosovë. Kjo është një vepër, me të cilën S. Maxhuni i shtie domosdoshmërisht të mendojnë më ndryshe jo vetëm historianët, por edhe politikanët, diplomatët, ekonomistët dhe struktura tjera me përgjegjësi për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, madje jo vetëm të Kosovës.

Kjo për faktin se të dhënat dhe gjykimet, disa origjinale nga përvoja e tij, e disa të mbështetura në literaturën më të re por që u referohet problemeve të vjetra të historisë së popullit shqiptar, e cila literaturë ka qenë nën embargo deri në çlirimin e Kosovës nga thundra e regjimit serb, hap një shteg që do të ndryshojë shumë koncepte të deritashme për një varg çështjesh të cilat deri tash janë trajtuar në bazë të burimeve të selekcionuara nga organet pushtuese të Kosovës me qëllim të orientimit të shqiptarëve në binarë krejtsisht në kundërshtim me realitetin. Madje si pasojë e asaj gjendje ata kanë vazhduar të punojnë kundër interesave kombëtare.[2]

Libri *Drejt shtetit shqiptarë në kufijtë kombëtarë*, pas *Parathënies*, të cilën e ka shkruar Murteza – Xajë Nura, (5-12,) vazhdon me: *Drejt shtetit shqiptarë në kufij kombëtarë*, (13-64) që si një kronologji, siç e ka emërtuar autori, përmban thelbin e tërë librit.

Në vazhdim vijnë një seri artikujsh, të cilët Sabri Maxhuni në kohë të fundit i ka botuar në shtypin e Kosovës, sidomos në *Prishtina Post*, dhe përmbyllet me artikullin *Përcaktimi i veprimtarëve shqiptarë në dy linja me dy filozofi, (*f. 221-249.) Edhe rezymenë (251), e cila është edhe në gjuhën angleze, e ka shkruar Murteza-Xajë Nura.

Libri ngërthen rreth 30 artikuj me përmbajtje të ndryshme. Sa janë të rëndësishëm për lexuesin dhe për stu-

---

[1] Sabri Maxhuni-Novosella, Rezistenca Kosovare mes dy zjarresh (Kujtime), Prishtinë, 2010.

[2] Shih kapitullin: Kongresi famëlartë I Berlinit, shpëtim I kombit shqiptarë, NDSH-ja mburojë e kombit shqiptar, Filozofija e kombëtarëve dhe antikombëtarëve vazhdon edhe pas rënies së komunizmit, etj.

djuesit e fushave të ndryshme shkencore e kulturore, po aq kanë rëndësi edhe për strukturat qeveritare që udhëheqin Kosovën. Me një fjalë për tërë ata që, në radhë të parë kanë përgjegjësi para opinionit dhe popullit të Kosovës për pasqyrën e deritashme, por edhe për rrjedhat aktuale të zhvillimit të Kosovës.

Në këtë libër, studjuesit do t`i tërheq vëmendjen trajtimi i deritashëm i Kongresit të Berlinit, 1878, (f. 131.), sjellja e elitës politike të Kosovës sot në raport me investimet e shqiptarëve të Kosovës për zhvillimin e Kosovës, fq. 109, 163. Obstruksionet e grupacioneve të ndryshme që janë përvjedhur dhe kanë vepruar ose veprojnë në Kosovë, në shpërputhje me interesat e shtetit të Kosovës dhe popullit shqiptarë në përgjithësi. (225, 230, 240, etj). Autori është dëshmitarë i gjallë për veprimet destruktive të disave prej tyre jashtë Kosovës, si në Suedi, (fq. 240) apo edhe brenda në Kosovë.

Në mbështetje të dokumenteve nga arkivat e Vienës dëshmohet se trekëndshi Beograd - Athinë – Moskë, tri dekada para se të shpallet shteti shqiptarë ka investuar në një pjesë të parisë shqiptare për t`i përdorur sipas nevojave të veta me dredhitë bizantine nën moton “premto çdo gjë e mos jep asgjë” (27)

Për të gjitha këto flet me kompetencë dhe me ilustrime konkrete nga dora e parë, sepse është dëshmitar i veprimit e sjelljeve konkrete të administrates së Kosovës me 500 milionerët shqiptarë të Nju Jorkut, (fq.110), me biznismenin Muharem Krasniqi nga Zelanda e Re, të cilit edhe pas dy muajsh përpjekje e bredhje nëpër Prishtinë e Kosovë, për të investuar në Kosovë, organet e pushtetit nuk ia hapën derën. Sabri Maxhuni flet konkretisht për administratën e Prishtinës se si e bllokon rindërtimin e qytetit sipas standardeve botërore dhe stimulon shkatërrimin e hapësirave me vlerë arkitekturale të qytetit të Prishtinës. (f. 163)

Flet edhe për konceptet politike të majtë e të djathë (93), për sjelljet e politikanëve të Kosovës, dhe tëra këto me qëllim që t'u bëjë me dije faktorit kompetentë në krye të Kosovës se si nuk duhet vepruar nëse mendojnë që të ecë përpara Kosova, me ilustrime konkrete për sjelljet e administratës së Kosovës që janë trishtuese për lexuesin e lëre për ata që e kanë përjetuar refuzimin e tillë.[3]

Ka trajtuar edhe çështjen e shpalljes heroj të atyre që nuk e meritojnë dhe i lënë në harresë të merituarit për Kosovën: *Nuk shpallet hero i popullit prof. Ymer Berisha, por Rifat Berisha,*[4] (197). Merr në shqyrtim përcaktimin e veprimtarëve shqiptarë që marshojnë në dy linja për propagandë Kombëtare dhe propagandë antikombëtar, (f. 221,) etj.

[3] Shih: Ftohen investitorët e jashtëm, por jo edhe investitorët vendas nga mërgata; Ndërtimi i Prishtinës, apo i Graçanicës.

Me këtë e përfundon këtë libër që lexohet me një frymë, sepse me artikullin e parë zgjon kërshërinë e lexuesit dhe e mban në ethe deri në fund.

Autori nuk ka zbatuar metodologji të caktuar shkencore, sepse Sabri Maxhuni nuk është përgatit për metodologji shkencore nëpër institucione shkencore por ai ia ka kushtuar jetën e tij themelimit të institucioneve shkencore kombëtare në Kosovë dhe tash kërkon nga përfituesit e atyre institucioneve që të kaluarën dhe të ardhmen e Kosovës ta shikojnë me të dy sytë hapur. Kërkon që të mos nëpërkëmbet gjaku i dëshmorëve që e solli Kosovën deri te shpallja Shtet i pavarur dhe Sovran. Ai nuk mund të duroj dot që në organet e këtij shteti të gjenden njerëz të cilët pengojnë zhvillimin e Kosovës për interesa individuale e klanore duke i refuzuar me sjelljet e tyre tërë ata që janë të gatshëm ta ndihmojnë vendlindjen e tyre – Kosovën. Ndërkaq burimet mbi të cilat ka vënë themelet e kësaj vepre, nuk e humbin aspak rëndësinë e origjinalitetit.

U mbetet punonjësve shkencorë të rishikojnë punën e tyre për çasje të caktuar deri tash. Kurrgjë të keqe nuk ka, nëse kanë të bëjnë korrigjime e plotësime edhe në këto gjykime të autorit, i cili si duket kësajë pune i ka hyrë jo nga dëshira, e as për të bërë karierë shkencore, por nga zemra e plasur duke parë se si historia dhe realiteti i Kosovës nuk janë në harmoni me investimin e brezave të kaluar që kanë flijuar jetën për këtë popull dhe këtë vend. Sabri Maxhunin e ka penguar dhe duhet ta pengojë secilin studjues objektiv shtrembërimi i fakteve historike, ngritja e figurave komuniste dhe shkelja e figurave nacionaliste.

Sabri Maxhuni – Novosella ka vënë në kandar personalitete udhëheqëse shqiptare, duke filluar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në shpërbërjen e sistemit sllavo-komunist. Sipas kategorizimit të tij ata i përkasin *Linjës antikombëtare dhe linjës kombëtare*, dhe nga kjo del se historiografia shqiptare deri tash glorifikon figurat e linjës antikombëtare-internacionalistët dhe i satanizon figurat kombëtare- nacionalistët. Glorifikohen figura të cilat gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tyre kanë trumbetuar se Kosova nuk ka qenë e okupuar nga

[4] Shembuj sikur ky ka gjithandej në hapsirën shqiptare, që janë rezultat i iluzioneve të mbjella nga ideologjia komuniste gjatë LDB-ës, e të cilat një pjesë e shqiptarëve mendojnë edhe sot e kësaj dite ti kultivojnë në literaturën shkencore. Mu kundër asaj ideologjie ngritet i paepuri Sabri Maxhuni dhe ngul këmbë që shkenca t i thotë të bardhës e bardhë e të zezës e zezë.

Serbia, gjë që në burimet origjinale historike del se Kosova në vitin 1945 është riokupuar. Porosia kryesore e librit të Sabri Maxhunit- Novosellës është se me Kongresin e Berlinit nga viti 1878 në formë shumë perfide është mbjellë fara e këtyre dy linjave të cilat vepronin në platformat: Antiosmane dhe proosmane. Proosmanët (kombëtarët) në fund të shekullit XIX, kërkuan "nga Britania e Madhe, që katër vilajetet shqiptare të çlirohen dhe për njëzet vjet të bëhen koloni e Inglizit, d.m.th. e Britanisë së Madhe" (30), gjë e cila është realizuar, në një formë pak më ndryshe, tek në fund të shekullit XX. Ndërkaq antiosmanët (antikombëtarët) që e penguan shpalljen e Pavarësisë së popullit shqiptarë në Shkup praktikisht u futën nën ombrellën e Moskës dhe ajo frymë aktualisht ngrit zërin për formim të kombit kosovar. (35)

Kjo nuk duhet të ndodh sot, kur studjuesit objektivë kanë mundësinë që të plotësojnë informacionet shkencore dhe të veprojnë e të shkruajnë historinë reale, jo të ngulin këmbë edhe mëtutje t`i injorojnë e ta mbulojnë realitetin e luftës së popullit shqiptarë për çlirim dhe pavarësi kombëtare.[5]

Duket një ndarje dhe emërtim i ashpër ky: linja antikombëtare dhe linja kombëtare, por kur krahasohen veprimet konkrete, objektivisht është e pranueshme nëse vendos njeriu ta emërtoj çdo send me emrin e vet, në kohën e vet. Sa më shumë vonesa aq më shumë ngatrresa. Përsa të thuash: është shtrirë, i ka mbyllë sytë, nuk flet, nuk han, nuk përgjigjet, etj., duhet thënë: ka vdek.

Sabri Maxhuni-Novosella, në këtë vepër ka thënë prerazi, lufta, të cilën ai me brezin e vet dhe forcat tjera që u flijuan për këtë që është arritë sot, ka qenë luftë që Kosova sot të ecë me hapa tjerë drejt ardhmërisë. Të zhvillohet normalisht sipas standardeve evropiane dhe botërore duke inkorporuar e kultivuar të kaluarën e vet. Të mos ketë pengesa nga byrokratë të korruptuar. Të emërtohen gjërat me emrin e vërtet. Ai është i bindur se kjo mund të arrihet, por për këtë: "Duhet punë dhe angazhim i historianëve dhe i intelektualëve të linjës kombëtare. Perspektiva është e këtyre të fundit. Duhet vullnet e energji për t'ua mbyllur mundësitë e manipulimit bashkëpuntorëve të djeshëm e të sotëm të okupatorit serb." (171)

[5] Për të mos harruar këtë, duhet ta kenë në dorë librin e Azem Hajdinit-Xani: **Masakra e Tivarit**(memoare), Prishtinë, 1998, 486 faqe; Shaban Braha, **Beteja e Drinit kundër agresionit serb (Nëntor, 1912**), Prizren, 2000; Sabri Maxhuni-Novosella, **Kuvendet, mbledhjet kombëtare 1941-1946 dhe mbledhjet e shqiptaro-komunistëve në bashkpunim me serbo-malazez në Bujan**, Prishtinë;, 2010, si edhe vepra tjera të ngjashme me këto. Vetëm kështu do të ruahen nga ajo linja antikombëtare, për të cilën Sabri Maxhuni flet në veprën e tij për të cilën fliet këtu.

Tëra këto do t`i vlersojë më së miri histortia kombëtare. Ka bërë mirë që i ka thënë, sepse ky është nga njerëzit e rrallë që për Kosovën dhe çështjen shqiptare ka dhënë më së shumti nga mosha më e re, nga viti 1963 dhe që flet e shkruan guximshëm, jo pa mbulesë.

Ai vazhdon dhe sot e tërë ditën, në rrethanat dhe nevojat e reja që i ka Kosova, të japë kontributin e vet që ky shtet i ri të ngritet sa më shpejt në këmbë të shëndosha.

Opinioni shqiptarë ka rastin e përshtatshëm që nga këto shkrime, pasi t`i lexojë, të ndalet dhe të mendojë me kokën e vet dhe le të vlersojë lirisht nëpër çfarë kurthash ka kaluar ky popull dhe sa ka nxjerr mësime nga ajo përvojë e hidhur e viteve 1878, 1902, 1941-45, 1981, etj.

Ata që nuk e pritën këtë ditë, neve na kanë siguruar, të paktën, të shprehemi lirshëm, kurse çmimi që e kanë paguar ata na obligon të shtyjmë përpara zbatimin e qëllimeve për të cilat ata e dhanë jetën.

Historia vonon por nuk harron.

Ajo dënon për atë çka e ke bërë dhe për atë që nuk e ke bërë kur është dashur të bëhet.

Akad. Dr. Feti Mehdiu

12 Shehidët e Kryengritjes së Kosovëse `81[6]

"... Ne i thamë: bjeri me shkopin tënd gurit! Nga ai shpërthyen dymbëdhjetë burime..." (Kur' an, Bekare, 60)*

Mu sikur këta 12 burime për popullin e Musait, ishin këta 12 shehidë të Kosovës, gjaku i të cilëve i dha gjallëri rinisë shqiptare dhe pas 20 vjetësh Kosova çlirohet nga zgjedha e huaj, ndërsa pas 30 vjetësh përkujtojmë lirishtë ata 12 burime me veprën e Selatin Novosellës:

Dëshmorët e Pranverës Shqiptare 81, Prishtinë, 2011, fq. 240.



[6] Prezentim me rastin e përurimit të librit të Selatin Novosellës me titull: *Dëshmorët e Pranverës Shqiptare `81*, në BKUK, më 7 prill 2011.

Më 7 prill, 2011, në prani të familjeve dhe familjarëve të shehidëve të Pranverës shqiptare `81 dhe shumë dashamirëve të shkencës dhe të kulturës kombëtare, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Shoqata e të Burgosurve Politikë Shqiptarë, në bashkëpunim me Institutin Albanologjik organizoi përurimin e veprës së Selatin Novosellës: Dëshmorët e Pranverës Shqiptare `81.

Pata kënaqësinë dhe privilegjën që me atë rast të paraqitem para atij opinioni dhe të shpreh opinionin tim në kujtim të Pranverës shqiptare `81. Në vazhdim vjen teksti i prezentuar përpara auditorit të nderuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Të nderuara familje të shehidëve të Kosovës `81,

Shokë, Miq e dashamirë të shehidëve, dashamirë të shkencës dhe kujtesës historike...

Të gjithë ju që keni ndarë kohën tuaj të shtrenjt dhe keni marrë mundin të jeni këtu, që ta nderoni e ta bëni më kuptimplotë këtë shenjim të 30 vjetorit të Kryengritjes së Kosovës të vitit 1981, keni nderuar shehidët e vitit `81, autorin e këtij libri, Selatin Novosellën, paqi faqen e bardhë dhe paqi bekimin e paqën e All-llahut Fuqiplotë!

Njerëzit e gjallë përjetojnë privilegje por jo vetëm privilegje, ata kanë edhe përgjegjësi. Sot, 30 vjet pas vitit `81, mendoj se :

më të privilegjuarit janë shehidët që gjenden në këtë libër - si edhe mijëra tjerë pas tyre - sepse ata e kanë mbyllë kapitullin e jetës së kësaj bote me faqe të bardhë. Ata më nuk mund t`i devalvojnë meritat e tyre dhe janë fitimtarë për të dy jetët. *Ata janë të gjallë, por ju nuk e ndieni dot.. (f. 222)*

Është i privilegjuar autori Selatin Novosella sepse ka kryer një pjesë të borxhit ndaj gjakut të këtyre shehidëve, dhe unë e shfrytzoj këtë rast ta falënderoj dhe ta uroj për këtë vepër.

Edhe unë jam i privilegjuar, që fal kontributit të autorit Novosella edhe organizatorëve të këtij përurimi, më jepet rasti të dal përpara jush dhe t'u drejtohem me këtë fjalë rasti, me çka shkarkoj një ngarkesë nga ndërgjegja ime;

të gjithë ne sëbashku jemi dy here të privilegjuar:

E para që jemi të gjallë, tash 30 vjetë pas rënies së këtyre shehidëve (dëshmorëve) - këtë ia kemi borxh vetëm Krijuesit të Gjithësisë.

Privilegja e dytë është se kemi qenë bashkëkohanikë të atyre shehidëve - dikush edhe bashkëpunëtor i tyre dhe sot ka rastin t`u shpreh nderimet atyre, veprës tyre dhe familjarëve të tyre.

Mirëpo ne, krahas privilegjës kemi edhe obligime. Jemi në një provim jo të lehtë. Duhet të japim përgjegje vetëvetes dhe atyre që e kanë dhënë je-

tën për këtë ditë, se çka kemi bërë dhe çka duhet bërë për ata.

Fati i Brezit `81-shit është se shokët e tyre, bashkëveprimtarët e tyre e shkruajnë historinë e tyre. Këtë fat nuk e kanë pasë brezat përpara këtij brezi. Ata të vitit 1878, 1910, 1912, 1940-45 e tjerë. Shkrimi është garanca më e fortë që obligon brezat e ardhshëm t'i përmbahen rrugës që e hapën brezat e përparshëm drejt lirisë dhe pavarësisë kombëtare. Duhet ditë se "*Liria nuk fitohet aksidentalisht…*" (41)

Liria ka tre çmime: Paguhet me jetë, me pjesë të trupit ose paguhet me lirinë individuale.

Këtu në mesin tuaj ka plot që e kanë paguar këtë çmimin e tretë. Ka edhe prej atyre që e kanë paguar edhe me pjesë të trupit të vet (kujtonie z. Besa Ahmetin, e cila sot gjendet me ne). E tërë kjo është një obligim për ne që të shohim si trajtohen ata që kanë paguar këto çmime për Kosovën e pavarur (f.203, 207,209,218 etj.)

Asgjë nuk arrihet me veprime spontane por me harmonizim të veprimeve me plane.

Në këtë vepër të Selatin Novosellës të titulluar: DËSHMORËT E PRANVERËS SHQIPTARE `81, me 240 faqe, të pajisur edhe me indeksin e emrave në fund që e bën shumë të përshtatshëm dhe të dobishëm për lexuesin, do ta gjeni portretin e 12 shehidëve të Kryengritjes së vitit 1981 në Kosovë.[7] Do të gjeni, pas faqes 199 edhe një pasqyrë të plagosurëve, për të cilën pasqyrë, autori Selatin Novosella, pas dilemës: "*të prezentohen emrat e të të plagosurve (me shenime dhe të dhëna jo të plota), që i kam identifikuar apo të pritet që këto informata të jenë të plota në të ardhmen…*" me shumë arsye ka vendos dhe ka bërë shumë mire që e vendosi ashtu, sipas parimit më mirë pak se hiç, të prezantojë atë që ka mundësi dhe që ka arritë të sigurojë lidhur me të plagosurit, sepse një Selatin është pak për ta bërë këtë punë të plotë ashtu si e meriton. Me indeksin e emrave në fund të librit e bën edhe më shumë funksional këtë vepër për shehidët e Kryengritjes së Kosovës.

Këtu do të shprehi edhe dy çështje për të cilat, pasi doli libri nga shtypi, u binda se duhet theksuar domosdoshmërisht.

Ne që jemi sot këtu, shumica prej nesh, kemi qenë edhe në vitin 1981, kush ku kemi qenë ka më pak rëndësi

[7] Emërtimin e drejtë le ta shohin teoricientë me kompetencë nga fusha të ndryshme por jo me teoretizime për qëllime të politikës ditore. Të rendisin si duhet: protestën, demonstratën kryengritjen dhe luftën. Në mungesë të emërtimit të saktë për ngjarje të caktuara sot në Kosovë e pësojnë mijëra luftëtarë që sakrifikuan për çlirimin dhe lirinë e Kosovës, për shkak se nuk trajtohen si luftëtarë por si konfliktuozë! Për këtë kategori nuk ka ligj që i mbron!

për këtë moment. Por diku kemi qenë. Ama nuk kemi qenë sikur në pozitën që jemi sot, të flasim shtruar dhe me kthjelltësi t'u vëmë ngjarjeve emrin e saktë. Ta emërtojmë çdo veprim ashtu si duhet.

E para është, se kur lexojmë konstatimin "*u vranë Rizah Matoshi dhe Sherif Frangu…. U plagosën me armë zjarri 9 demonstrues… filloi arrestimi në masë i demonstruesve….*" (172) më del përpara një pikëpyetje, demonstratë a kryengritje? Jo për mua! Unë nuk kam pikëpyetje për këtë. Unë e kam të qartë.

Kjo pikëpyetje kërkon zgjidhje nga institucione kompetente të Kosovës, nga shumë ekspertë duke filluar nga ata të gjuhësisë, të strategjisë së luftës, të historisë, të politikës, të diplomacies etj., sepse emërtimi i pasaktë ka pasoja të rënda. Për shkak të emërtimit të pasaktë edhe sot e kësaj dite invalidët e luftës, familjarët e tyre etj., nuk përfshihen me asnjë ligj për të gëzuar të drejtat që u takojnë. (f. 203, 207, 209, 218). Për këtë çështje jemi të gjithë përgjegjës para atij gjaku që u derdh për këtë ditë ku jemi sot, të gjithë ju që jeni këtu, edhe ata që nuk janë këtu, edhe unë bashkë me ju sigurisht, sepse ne e dimë çka ka ndodhë në Pranverën e vitit 1981.

Ajo që di unë është se në vitin 1981, vetëm nga 11 marsi deri më 25 mars, mund të flitet për demonstrata të studentëve, sepse ashtu filloi. Por nga 26 marsi i vitit 1981, ditën e enjte pas dreke, kur masa e punëtorëve nga fabrika e Amortizatorëve, nga Kombinati Ndërtimor Ramiz Sadiku, ndoshta edhe fshatarë, zejtarë etj., u ngritën bashkë me studentët për çlirimin e Kosovës, kjo më nuk ishte demonstratë. U bë krejtësisht e qartë se tash fillon faza "*…ja me hatër ja me luftë*". Demonstratat kontrollohen dhe zgjidhen nga organet e policisë së shtetit. Në Prillin e vitit 1981 ndërhyri ushtria (APJ) me tëra forcat e veta, me tanke e aviacion dhe ndrydhi, por nuk arriti ta shtyp vullnetin e atyre që kishin vendosur ta çlirojnë vendin e tyre nga okupimi. Gjaku i atyre dhe vullneti i çeliktë i shokëve të tyre e solli Kosovën këtu ku jemi sot.

Aty ku hyn ushtria nuk flitet më për demonstratë! Atëherë i emërtuan edhe ngjarje[8] të pamira për të mos pranuar peshën që e kishte kjo kryengritje. Kjo sigurisht edhe mua më nevrikos e lere

[8] Ky emërtim kishte dy qëllime: Nga administrata jugosllave, me këtë minimizohej rëndësia dhe serioziteti i veprimeve të rinisë shqiptare të Kosovës, kurse administrata e Kosovës me këtë shprehje mendonte se u ndihmon veprimtarëve që t marrin dënime më të vogla. As njëra as tjetra nuk dhanë rezultatin që e mendonin. Prandaj sot pas 30 vjetësh nuk duhet më të shërbehemi me formulimet e pasakta të politikës ditore të viti 1981, por duhet të emërtojmë ngjarjet drejt, saktë dhe qartë, e ajo është Kryengritja e Kosovës e vitit 1981.

ata që i kanë paguar shtrenjtë ato "ngjarje të pamira"!

*E dyta***,** ka të bëjë me një segment të literaturës që ka përdor autori. Ai në mënyrë shumë korrekte ka cituar shprehjen e një publicisti se *"Nuk dihej … kush po i përgatiste demonstratat e reja"* (f. 173).

Kjo shprehje nuk ka asgjë të keqe në thelb, sepse sigurisht nuk e dija unë dhe ai publicisti, por Ahmet Qeriqi me shokë, me ata që kishin vendosur të luftojnë për çlirimin e Kosovës, e dinte mirë kur më 28, mars (të shtunën pas darke) përpara Gjimnazit Sami Frashëri më tha: "edhe kjo e 26 marsit shpejt do të harrohet.! "

Është e palejueshme dhe është përpjekje destruktive që dikush keqpërdor shprehjen se *"nuk dihej…"*[9]* të zhvillojë teorinë e zvarritjes për emërtimin e saktë të Kryengritjes së Kosovës të vitit 1981 me pretekstin se duhet të pritet hapja e arkivave për këtë dhe të bëhen vlerësimet më qartë…!

Arkivat kanë rëndësinë e vet, por mendoj se dëshmia e atij që e ka përjetuar Kryengritjen e Kosovës të vitit 1981, nuk ka nevojë për arkivë! Është vetë arkiv! Për këtë qëllim mendoj se mediat elektronike dhe të shkruara, të cilat po japin kontribut të çmueshëm në përkujtimin e këtij përvjetori, duhet të përpiqen të bëjnë edhe më shumë, sepse kam bindjen se ndihma që mund të japin ata nuk zëvendësohet me asgjë. Ata duhet të shfrytëzojnë pa vonesë burimet e gjalla për Pranverën Shqiptare të vitit 1981, dhe jo vetëm këtë.

Autori Selatin Novosella këtë punë "… të vogël", që u referohet kontributit të rinisë, në radhë të pare si edhe tjerëve, për çlirimin e Kosovës, e ka bërë *"… si një homazh për dëshmorët e Brezit të art, të cilët u bënë një hallkë e fuqishme në varganin e pashkëputshëm të rrugës sonë në bërjen e lirisë së Kosovës"*[10]

Këtë e ka realizuar në mënyrë të denjë. Ky kontribut i tij, përveç faktit se u ka bërë nderim duke i bërë të pavdekshëm edhe te masat më të gjëra, për shkak se sot lufta e tyre bëhet pronë e opinionit të gjerë, nuk është më e mbyllur vetëm në kujtimet individuale, në arka e në sirtarë të punonjësve shkencorë. Ka larë një pjesë të borxhit ndaj atyre 12 gurëve të vënë në themelet e shtetësisë së Kosovës,

Ka bërë edhe më shumë se kaq.

Sëpari ai me vetfinancim e ka bërë këtë vepër pronë të opinionit të gjerë publik.

[9] Sigurisht se veprimet ilegale nuk i dinte gjithkush, aq më pak ata që mendonin se nuk duhet prishur vëllazërimi i popujve të Jugosllavisë... ? Por ata që duhej ta dinë e dinin fort mirë!

[10] Selatin Novosella.... fq. 24.

Pastaj ai me këtë vepër e informon, dhe njëkohësisht e obligon brezin aktual - sidomos mjetet e informimit, sepse këta kanë rol shumë të rëndësishëm - që të jenë më të kujdesshëm për ata që flijuan jetën për të sotmen.

Del përpara këtij opinioni si një model se si duhet të ruhet e të kultivohet ndjenja për historinë kombëtare, duke shfrytëzuar burimet e gjalla dhe duke i ngjeshur ato me burime e akte të shkruara.

I jep një sinjal të qartë e të fuqishëm subjektëve kompetente dhe përgjegjëse, që krahas mirënjohjeve dhe kujdesit për t'I nderuar në përvjetorë të ndryshëm (f.126, 141, 203…) se kanë për obligim të shqyrtojnë veprimet e tyre dhe të vlerësojnë meritueshëm e drejt se çka kanë bërë deri tash dhe çka duhet bërë për t`i dal hakut flijimit të shehidëve të `81-shit dhe jo vetëm atyre, ngase me sa shihet në këtë vepër asnjë familje e atyre shehidëve dhe asnjë invalid i asaj Kryengritje nuk gëzon kujdesin e institucioneve të ndërtuara me gjakun e bijëve të tyre dhe me shëndetin e tyre.

Të shpresojmë se secili nga ne, individualisht dhe institucionalisht do të vemë nga një gurë në themelet e historisë së Kosovës - siç thoshte Sami Frashëri – në kohën e duhur dhe në vendin e duhur!

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
“Al-Az-Hari” dhe aktualitetet në Egjipt.. 5

Nexhat Ibrahimi
Besimi në Allahun xh.sh. 15

Ejup Haziri
Parimet e Legjislacionit Islam 47

Dr. Zaglul Nexhar
Ndalimi i martesës me idhujtare 69

Eglantina Muçaj
Xhamitë e qytetit të Tiranës - (2) 79

Mr. Qemajl Morina
Hasan ef. Nahi – student në universitetin
e “El-Az-harit” në Kajro (1930-1934).. 105

Selim Musliu
Mulla Emin Ali Zhitia 113

Mr. Rexhep Suma
Impakti i fesë në ndërtimin
dhe zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke 129

Thirrje në unitetin Islam.. 147

Prof. dr. Adem Zejnullahu
Mitikja dhe fetarja në tri këngë popullore 151

Prof. dr. Ali Pajaziti
William Montgomery Watt - orientalisti i fundit 161

Vepra El-Mukaddime e Ibn Haldunit.. 179

Dr. Islam Hasani
Origjina e financave dhe institucioneve
te kreditimit sipas islamit.. 195

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha
Familja e Jasirit (Jasiri, Sumeja dhe Amari).................................. 207

Akad. Dr. Feti Mehdiu
E vërteta është ilaç i hidhur por shërues 217

Përmbajtja.. 229